



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Skupština Opština Rahovac/Municipality of Rahovec



01 Nr. 12/22
Rahovec, 19.12.2022

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal, që të marrin pjesë në mbledhjen e dymbëdhjetë (12) e cila do të mbahet më **28 dhjetor 2022 (e mërkurë)**, me fillim në orën **10:00**, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje propozoj këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi i Raporti mbi realizimin e Planit për vitin 2022 si dhe informatë mbi Planin vjetor të prokurimit publik 2023;
4. Shqyrtimi i Raportit të Punës të Kryetarit të Komunës për vitin 2022;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për Planin e Punës të Kryetarit të Komunës së Rahovecit për vitin 2023;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për Planin e Punës të Kuvendit Komunal për vitin 2023;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për Planin e Punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2023;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për Planin e Vlerësimit të Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për Planin e Transportit Rrugor 2022 – 2027;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për Planin e Mobilitetit Urban 2022 – 2027;
11. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2023;
12. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e simbolit përkujtimor të gjenocidit në Kosovë;
13. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr.263/22, i datës: 25.01.2022, për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
14. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljen në interes të përgjithshëm të parcelës P-01041-1 – në zonën kadastrale Xërxë;
15. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 338/22 i datës 29.06.2022 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër;
16. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 341/22 i datës 29.06.2022 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;
17. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit mbi regjistrimin dhe vlerësimin e dëmeve në amvisëri, ekonomi familjare dhe biznese, të shkaktuara nga vërshimet e shiut me datë: 17 shtator 2022.
18. Informatë rreth gjendjes në terren pas të reshurave të fundit në territorin e Komunës së Rahovecit.

KRYESUESI I KUVENDIT

Deftim Kafexhiu



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odhëjënje za Opštu Upravu



Nr. i prot. 5323 Më 30.11.2022
Br. prot. Dt. 20.12.22
RAHOVEC - ORAHOVAC

KOMUNA E RAHOVECIT
OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

Për:	z. Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit
Nga:	z. Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit - Komuna Rahovec
Lënda:	Planifikimi Paraprak i Prokurimit për vitin 2023
Datë:	30/11/2022

I nderuar Kryetar,

Konform Nenit 8. të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, të bashkangjitur keni Planifikimin Paraprak të Prokurimit për vitin 2023. Planifikimi është përgatitur pas kërkesës që Zyra e Prokurimit i ka bërë njësive dhe të dhënave që ka pranuar nga njësitet.

Me respekt:

Zyra e Prokurimit

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës së Prokurimit/Komuna Rahovec
Adresa: Rr."Xhelal Hajda - Toni" p.n. 21000 Rahovec
Tel: 038/200-45316 e-mail: prokurimi.rahovec@gmail.com



KOMUNA E RAHOVECIT
OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC
PLANIFIKIMI PARAPRAK I PROKURIMIT

Sipas Nenet 8 të Ligjit nr. 041-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndërtuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 041-237, ligjin Nr. 054-088 dhe ligjin Nr. 051-082

Për vitin Fiskal 2023

[Planifikimi përfundimtar i Prokurimit duhet të plotësohet dhe të dërgohet në AQP jo më vonë se 15 ditë pas shpalljes së legjislacionit të përveçësimeve]

Data e dërgimit në ZKA	30.11.2022	E rezervuar për AQP
------------------------	------------	---------------------

Planifikimi paraprak	X	Data e pranimit
----------------------	---	-----------------

ENET I. Identifikimi i Autoritetit Kontraktues (AK)

Emri i AK	KOMUNA E RAHOVECIT	Personi kontaktuar s:	Astrit Mullabazi
Adresa	Rr. "Xhelal Hajda - Toni" p.n.	e-mail-i:	prokurimi.rahovec@gmail.com & prokurimi.rahovec@kcs-gov.net
Qyteti	Rahovec	Kodi Postar	21000
Telefoni	038/200-49316	Regjioni	Prizren
email-i	/	Faksi	N/A
		URL:	https://kcs-gov.net/rahovec/

ENET II. Përshkrimi përmbledhës i kontratave të planifikuara për tërë vit fiskal

II.1) KONTRATAT PËR FURNIZIM

Klasifikimi i produktit (2 shifra të para nga FPP)	Përshkrimi i Kontratës	Nr. Rendor	Artikulli	Njësia matëse	Sasia e përafërt Vjetore	Çmimi për Njësi	Vlera e parashikuar e kontratës	Data e parashikuar fillimit të prokurimit	DREJTORIA
22113000-5	Furnizimi i bibliotekeve me libra	1	Furnizimi i bibliotekeve me libra	Copë	1	20,000.00	20,000.00	16.01.2023	DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM
34114100-0	Blerja e dy Autoambulancave	2	Blerja e dy Autoambulancave	Copë	1	50,000.00	50,000.00	17.01.2023	DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE
33000000-0	Furnizime me material shpenzues mjekësor për nevojat e QKMF-së	3	Furnizime me material shpenzues mjekësor për nevojat e QKMF-së	Copë	1	10,000.00	10,000.00	20.01.2023	DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE
17000000-2	Furnizim me pako pedagogjike	4	Furnizim me pako pedagogjike	Copë	1	20,000.00	20,000.00	20.01.2023	DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM
24000000-4	Furnizim me material Higjieniko - Sanitar.	5	Furnizim me material Higjieniko - Sanitar.	Copë	1	60,000.00	60,000.00	20.01.2023	DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM
33192000-2	Karriga stomatologjike	6	Karriga stomatologjike	Copë	1	24,000.00	24,000.00	01.02.2023	DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE
33192000-2	Pajisje mjekësore për nevojat e QKMF-së	7	Pajisje mjekësore për nevojat e QKMF-së	Copë	1	30,000.00	30,000.00	01.02.2023	DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

29860000-5	Furnizim me material teknik për nevojat e komunës së Rahovecit	8	Furnizim me material teknik për nevojat e komunës së Rahovecit	Copë	1	54,000.00	54,000.00	06.02.2023	DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM
28000000-2	Pajisje e shkollave me mjete konkretizimi dhe laboratorike	9	Pajisje e shkollave me mjete konkretizimi dhe laboratorike	Copë	1	40,000.00	40,000.00	10.02.2023	DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM
25212500-5	Furnizim me gypa	10	Furnizim me gypa	Copë	1	50,000.00	50,000.00	15.02.2023	DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
14122100-3	Furnizim me shumësë për shkollat	11	Furnizim me shumësë për shkollat	Copë	1	2,200.00	2,200.00	20.02.2023	DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM
21125400-9	Furnizim me material administrativ, të cilat nuk janë të përfshira në kontratat e AQP – së	12	Furnizim me material administrativ, të cilat nuk janë të përfshira në kontratat e AQP – së	Copë	1	40,000.00	40,000.00	20.02.2023	DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME
17216000-9	Furnizim me Inventar për nevojat e Komunës së Rahovecit, të cilat nuk janë të përfshira në kontratat e AQP – së	13	Furnizim me Inventar për nevojat e Komunës së Rahovecit, të cilat nuk janë të përfshira në kontratat e AQP – së	Copë	1	30,000.00	30,000.00	24.02.2023	DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME
28122111-4	Furnizimi dhe rregullimi i xhamave në shkollat	14	Furnizimi dhe rregullimi i xhamave në shkollat	Copë	1	5,500.00	5,500.00	24.02.2023	DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM
30215100-0	Furnizim me teknologji informative - Menagjimi i radhës dhe digitalsender	15	Furnizim me teknologji informative - Menagjimi i radhës dhe digitalsender	Copë	1	40,000.00	40,000.00	28.02.2023	DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME

28000000-2	Furnizim me rekuizita sportive	16	Furnizim me rekuizita sportive	Copë	1	18,220.00	18,220.00	03.03.2023	DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM
17216000-9	Furnizim me Inventar, paisje teknologjike, informative per nevojat e QKMF - së	17	Furnizim me Inventar, paisje teknologjike, informative per nevojat e QKMF - së	Copë	1	93,000.00	93,000.00	21.03.2023	DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE
33451000-6	Furnizim me kamera për nevojat e Komunës	18	Furnizim me kamera për nevojat e Komunës	Copë	1	10,000.00	10,000.00	20.03.2023	DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME
		19	Kamerat e sigurise në Qytet	Copë	1	30,000.00	30,000.00		DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
18115000-8	Furnizim me uniforma për Stafin Shëndetësor dhe stafin teknik	20	Furnizim me uniforma për Stafin Shëndetësor dhe stafin teknik	Copë	1	10,000.00	10,000.00	12.04.2023	DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE
02000000-4	Furnizimi me dru për nevojat e Komunes	21	Furnizimi me dru për nevojat e Komunes	Copë	1	160,000.00	160,000.00	08.05.2023	DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM
02000000-4	Furnizim me pelet për nevojat e Komunës	22	Furnizim me pelet për nevojat e Komunës	Copë	1	273,000.00	273,000.00	14.05.2023	DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM
24158000-6	Furnizim me Pleh artificial	23	Furnizim me Pleh artificial	Copë	1	50,000.00	50,000.00	01.06.2023	DREJTORIA PËR BUIQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

01113300-5	Furnizim me Farera te llojeve te ndryshme	24	Furnizim me Farera te llojeve te ndryshme	Copë	1	30,000.00	30,000.00	05.06.2023	DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL
01900000-6	Furnizim me Preparate per trajtim te kulturave bujqësore	25	Furnizim me Preparate per trajtim te kulturave bujqësore	Copë	1	20,000.00	20,000.00	07.06.2023	DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL
01900000-6	Furnizim me vaksina per bageti	26	Furnizim me vaksina per bageti	Copë	1	20,000.00	20,000.00	09.06.2023	DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL
33000000-0	Furnizim me material shpenzues për Laborator	27	Furnizim me material shpenzues për Laborator	Copë	1	15,000.00	15,000.00	01.08.2023	DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESIE SOCIALE
33000000-0	Furnizim me mateial për Stomatologji	28	Furnizim me mateial për Stomatologji	Copë	1	9,000.00	9,000.00	01.08.2023	DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESIE SOCIALE
33000000-0	Furnizim me barna ampullare emergjente material sanitar	29	Furnizim me barna ampullare emergjente material sanitar	Copë	1	70,000.00	70,000.00	01.08.2023	DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESIE SOCIALE
						Totali i Vlerës			
						Grand Totali			
						1,283,920.00			
						1,283,920.00			

II.2) KONTRATAT PËR SHERBIME

Klasifikimi i produktit (2 shifra e para nga FPP)	Përshkrimi i Kontratës	Nr. Rendor	Artikulli	Njësia matëse	Sasia e përfaqëruar nga Vjetore	Çmimi për Njësi	Vlera e parashikuar e kontratës	Data e parashikuar fillimit të prokurimit	DREJTORIA
50940000-6	Servisimi i pajisjeve mjekësore	1	Servisimi i pajisjeve mjekësore				30,000.00	10.01.2023	DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE
45112711-2	Mbjellja dhe mirëmbajtja e luleve në hapsira publike	2	Mbjellja dhe mirëmbajtja e luleve në hapsira publike				10,000.00	20.01.2023	DREJTORIA PËR URBANIZËM
74000000-9	Mbikqyrjen e Investimeve Kapitale	3	Mbikqyrjen e Investimeve Kapitale				80,000.00	20.01.2023	DREJTORIA PËR URBANIZËM
74000000-9	Hartimi i projekteve të ndryshme	4	Hartimi i projekteve të ndryshme				350,000.00	20.01.2023	DREJTORIA PËR URBANIZËM
93000000-8	Mirëmbajtja dhe servisimi teknik në objektin e komunës	5	Mirëmbajtja dhe servisimi teknik në objektin e komunës				50,000.00	25.01.2023	DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME
74224000-5	Plani lokal për biodiversitet	6	Plani lokal për biodiversitet				30,000.00	30.01.2023	DREJTORIA PËR URBANIZËM
74224000-5	Plani lokal për cilësinë e ajrit	7	Plani lokal për cilësinë e ajrit				30,000.00	30.01.2023	DREJTORIA PËR URBANIZËM

66311000-3	Sigurimi fizik i objekteve të Komunës	8	Sigurimi fizik i objekteve të Komunës					20,000.00	06.02.2023	DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME
31523000-8	Vendosja e tabelave për emërtim të rrugëve, parqeve dhe shesheve	9	Vendosja e tabelave për emërtim të rrugëve, parqeve dhe shesheve					20,000.00	20.02.2023	DREJTORIA PËR URBANIZËM
74721100-0	Dezinsektim, Deratizim dhe Dezinsektim	10	Dezinsektim, Deratizim dhe Dezinsektim					20,000.00	21.02.2023	DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE
90120000-4	Grumbullimi i mbeturinave dhe mirëmbajtja e rrugëve gjatë dy sezoneve	11	Grumbullimi i mbeturinave dhe mirëmbajtja e rrugëve gjatë dy sezoneve					120,000.00	22.02.2023	DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
77313000-7	Investime në hapësira publike (varreza, parqe, etj)	12	Investime në hapësira publike (varreza, parqe, etj)					150,000.00	24.02.2023	DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
60000000-8	Bartja e të moshuarve, Rahovec-Epopeja e UÇK-së	13	Bartja e të moshuarve, Rahovec-Epopeja e UÇK-së					10,000.00	01.03.2023	DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM
93000000-8	Trajtimi i qenëve endacak	14	Trajtimi i qenëve endacak					10,000.00	20.03.2023	DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL
77313000-7	Mirëmbajtja e shtigjeve të Rahovecit:Denjë, Krushë e Madhe, Gradish, Drenoc, Rahovec (shtegu te Zhdrella, shtegu te Maja e Shkodranit dhe pastrimi i Lumit Boqec në Ratkoc)	15	Mirëmbajtja e shtigjeve të Rahovecit:Denjë, Krushë e Madhe, Gradish, Drenoc, Rahovec (shtegu te Zhdrella, shtegu te Maja e Shkodranit dhe pastrimi i Lumit Boqec në Ratkoc)					20,000.00	01.04.2023	DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM

90120000-4	Intervenime emergjente dhe investime në hapësira publike	16	Intervenime emergjente dhe investime në hapësira publike						100,000.00	16.04.2023	DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
30259500-4	Digitalizimi i infrastrukturës publike	17	Digitalizimi i infrastrukturës publike						50,000.00	20.04.2023	DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
74224000-5	Planet komunale (energj, ajër etj)	18	Planet komunale (energj, ajër etj)						50,000.00	15.05.2023	DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
22110000-4	Hekurosja e librave të gjendjes civile	19	Hekurosja e librave të gjendjes civile						3,000.00	30.05.2023	DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME
32332300-2	Shërbime për të gjitha manifestime e aktiviteteve Kulturore për vitin 2023, Shërbime me LED profesional, zërimet dhe ndriqim për nevojat e komunës së Rahovecit	20	Shërbime për të gjitha manifestime e aktiviteteve Kulturore për vitin 2023, Shërbime me LED profesional, zërimet dhe ndriqim profesional për nevojat e komunës së Rahovecit						5,000.00	01.06.2023	DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT
60000000-8	Bartja e nxënësve në relacionet për vitin shkollor	21	Bartja e nxënësve në relacionet për vitin shkollor						55,000.00	05.07.2023	DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM
66334100-1	Sigurimi i automjeteve të Komunës së Rahovecit	22	Sigurimi i automjeteve të Komunës së Rahovecit						15,000.00	05.09.2023	DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME
77311000-3	Dekorimi i Qytetit të Rahovecit për fund vitë	23	Dekorimi i Qytetit të Rahovecit për fund vitë						4,000.00	10.11.2023	DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT
90120000-4	Mirëmbajtja e objekteve Kulturore, Monamenteve, Fushave Sportive dhe Rekreative	24	Mirëmbajtja e objekteve Kulturore, Monamenteve, Fushave Sportive dhe Rekreative						15,000.00	15.11.2023	DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT
Totali i Vlerës									1,247,000.00		
Grand Totali									1,247,000.00		

II.3) KONTRATAT PËR PUNË

Klasifikimi i produktit (2 shifrat e para nga FPP)	Përshkrimi i Kontratës	Nr. Rendor	Artikulli	Njësia matëse	Sasia e përafërt Vjetore	Çmimi për Njësi	Vlera e parashikuar e kontratës	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit	DREJTORIA
90112200-7	Ndërtimi i kanalizimeve dhe gropa septike	1	Ndërtimi i kanalizimeve dhe gropa septike				450,000.00	24.01.2023	DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
45110000-1	Rrërimi i objekteve pa leje	2	Rrërimi i objekteve pa leje				80,000.00	03.02.2023	DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA
45214210-5	Riparime në shkolla	3	Riparime në shkolla				250,000.00	03.02.2023	DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM
45233120-6	Ndërtimi i rrugëve lokale - Lot 1	4	Ndërtimi i rrugëve lokale - Lot 1				550,000.00	06.02.2023	DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
45242100-6	Ndërtimi dhe Renovimi i QMF-ve dhe AMF-ve	5	Ndërtimi dhe Renovimi i QMF-ve dhe AMF-ve				120,000.00	15.02.2023	DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESIE SOCIALE
30241400-4	Ndërtimi i E-Kioskut	6	Ndërtimi i E-Kioskut				28,000.00	01.03.2023	DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME
45242100-7	Renovimi i objektit të vjetër të QKMF-së në Rahovec-faza e dytë	7	Renovimi i objektit të vjetër të QKMF-së në Rahovec-faza e dytë				175,972.00	01.03.2023	DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESIE SOCIALE

45215220-5	Riparim i objekteve të gjendjes civile	8	Riparim i objekteve të gjendjes civile						28,000.00	07.03.2023	DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME
45212100-7	Ndërtimi i qendrës Rinore dhe Kulturore në Rahovec	9	Ndërtimi i qendrës Rinore dhe Kulturore në Rahovec						840,351.00	10.03.2023	DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT
45110000-1	Ndërtimi dhe rregullimi i Infrastrukturës në stacion të autobuseve në Rahovec	10	Ndërtimi dhe rregullimi i Infrastrukturës në stacion të autobuseve në Rahovec						100,000.00	25.03.2023	DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
36520000-2	Rregullimi i këndit të lojërve afër objektit të Harejës	11	Rregullimi i këndit të lojërve afër objektit të Harejës						65,000.00	30.03.2023	DREJTORIA PËR URBANIZËM
45453100-8	Riparimi i shtëpisë së Kulturës në Celinë	12	Riparimi i shtëpisë së Kulturës në Celinë						11,000.00	14.04.2023	DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT
45212313-3	Ndërtimi i Muzeut për shkrimtarin dhe atdhetarin Sulejman Krasniqi	13	Ndërtimi i Muzeut për shkrimtarin dhe atdhetarin Sulejman Krasniqi						250,000.00	16.04.2023	DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT
45246100-4	Vazhdimi i rregullimit dhe ristrukturimi i shtratit të lumit Rimnik: Rahovec - Fortesë - Celinë	14	Vazhdimi i rregullimit dhe ristrukturimi i shtratit të lumit Rimnik: Rahovec - Fortesë - Celinë						420,000.00	20.04.2023	DREJTORIA PËR URBANIZËM
45233220-7	Ndërtimi i rrugeve në hapësirat për biznese	15	Ndërtimi i rrugeve në hapësirat për biznese						150,000.00	21.04.2023	DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

77313000-7	Investime në turizëm dhe shitje të ecjes	16	Investime në turizëm dhe shitje të ecjes					25,000.00	25.04.2023	DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM
45223300-9	Krijimi i parkingjeve të reja në Qytet	17	Krijimi i parkingjeve të reja në Qytet					150,000.00	27.04.2023	DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
45453100-8	Restaurimi i objektit përkujtimit për 64 të masakruarit në Krushë të Madhe	18	Restaurimi i objektit përkujtimit për 64 të masakruarit në Krushë të Madhe					70,000.00	28.04.2023	DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT
45246100-4	Rregullimi i shtretërve të lumenjëve në fshatrat	19	Rregullimi i shtretërve të lumenjëve në fshatrat					1,000,000.00	28.04.2023	DREJTORIA PËR URBANIZËM
45212313-3	Ndërtimi i shtëpisë Muze "Bajram Curri" Krushë e Madhe	20	Ndërtimi i shtëpisë Muze "Bajram Curri" Krushë e Madhe					68,000.00	04.05.2023	DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT
74000000-9	Ndërtimi i busteve, lapidarëve dhe pllatove të dëshmorve: Sadedin Hajda dhe Mizair Isma	21	Ndërtimi i busteve, lapidarëve dhe pllatove të dëshmorve: Sadedin Hajda dhe Mizair Isma					15,000.00	30.06.2023	DREJTORIA PËR URBANIZËM
45232410-9	Kanalet e kullimit të tokave bujqësore	22	Kanalet e kullimit të tokave bujqësore					50,000.00	14.07.2023	DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL
Totali i Vlerës								4,896,323.00		
Grand Totali								4,896,323.00		

II.4) KONKURSET E PROJEKTIMIT

Klasifikimi i produktit (2 shifra të para nga FPP)	Përshkrimi i Kontratës	Nr. Rendor	Artikulli	Njësia matëse	Sasia e përafërt Vjetore	Çmimi për Njësi	Vlera e parashikuar e kontratës	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit
Grand Total								

0,00



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e kuvendit komunal të Rahovecit, e mbajtur më **25.11.2022 (E premte)** me fillim në ora **10:00**. Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i kuvendit **z.Defrim Kafexhiu**. Konstatohet se kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni t’ju përshëndes. I nderuar kryetar i komunës **z.Smajl Latifi**, i nderuar nënkryetar i komunës **z. Fatmir Iska**, të nderuar kuvendarë, drejtorë të drejtorive komunale, përfaqësues të **KFORI**-it, media, të nderuar qytetarë të komunës së Rahovecit, kjo është seanca e njëmbëdhjetë për këtë vit kalendarik.

Atëherë **KPF** në mbledhjen e mbajtur më 15 nëntor 2022 pas shqyrtimit të pikave të rendit të ditës që janë propozuar nga kryesuesi i kuvendit në koordinim me kryetarin e komunës, ka propozuar këtë rendi dite me 8 pika;

RENDI DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës: **P-02279-0, P-02280-0 dhe P-02281-0**;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 1427 i datës 30.04.2019 për themelimin e çmimit për krijimtari letrare e artistike “**Sulejman Krasniqi**”;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për lirim nga pagesa e Mamografisë për të gjitha gratë e komunës së Rahovecit;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës nr. **P-71510057 -08924-0** personave fizik dhe juridik;
7. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Brendshëm për vitin 2021 dhe diskutimi i planit të veprimit;
8. Shqyrtimi i raportit vjetor të Planit të Integritetit në Komunën e Rahovecit;

Pika shtesë;

9. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për shfuqizimin e vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik **P- 71510033-01041-1** në zonën kadastrale në **Xërxë**;

10. Diskutimi rreth fushatës nacionale “**16 ditë aktivizëm kundër dhënës në baza gjinore**”.

Kryesuesi – Ky është rendi i ditës i përgatitur për sot, nëse dikush prej anëtarëve të kuvendit ka ndonjë propozim?... Nëse jo, atëherë i kemi edhe 2 propozime tjera si pika shtesë në këtë rendi dite. E para është; **Shfuqizimi i vendimit nr. 01 nr 375-22 i datës 23.09.2022 për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-01041-1 në zonën kadastrale në Xërxë**. Pika tjetër shtesë ka të bëjë me fushatën globale **16 ditë aktivizëm kundër dhunës në bazë gjinore**, e kemi parë të arsyeshme që ta propozojmë si pikë shtesë të rendit të ditës

për të diskutuar rreth mekanizmave kundër kësaj dukurie. Atëherë këto dy pika po i vendosi në votim. Kush është për?... Me shumicë votash edhe këto dy pika shtohen në rend dite për seancën e sotshme. Po e vendosim miratimin e rendit të ditës me gjithsej 10 pika. Kush është për?... Me shumicë votash miratohet edhe rendi i ditës për sot.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi – A ka dikush prej anëtarëve të kuvendit ndonjë vërejtje rreth procesverbalit të mbledhjes së kaluar?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është për?... Me shumicë votash miratohet edhe provesverbali i mbledhjes së kaluar të seancë së rregullt.

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;

Ilir Pallqa – I nderuar kryesues, kryetar, kolegë asambleistë, drejtorë të drejtorive, të pranishëm tjerë në sallë. Shumë shpejtë pritet të fillojnë punimet për sheshin qendror. Gjatë punimeve, stadiumi do të priset. Ju kryetar, e keni vendosur një lokacion për ndërtimin e stadiumit të ri. Sipas jush, ky stadium do të ndërtohet te Epopeja e Rahovecit. Ky lokacion, pos juve, nuk i pëlqen ambientalisht hiç askujt për stadium. Nuk kam takuar as edhe një banor të vetëm të Rahovecit që sado pak ka një mendim të mirë për këtë ide. D.m.th. një projekt kaq të madh ju po e bëni pa marrë parasysh mendimin e asnjë banori, asnjë sportdashësi, “veç qysh tu ka tek ty” – ska diskutim. Pra, ti po pretendon me bë një stadium për Rahovecin, në një vend ku çasje më të lehtë kanë banorët e komunës së Malishevës, po ia bëni edhe një stadium tjetër Malishevës, po harron kryetar i cilës komunë je. Ajo pjesë është në mal dhe gjendet në lartësi mbidetari 671m, vështirë e përshtatshme edhe për të shikuar ndeshjen, e lëre më për të luajtur. Para se të bëni diçka kaq të rëndësishme, mes tjerat duhet ta bëni një plan strategjik për të ardhmen, ku interes do të ketë e gjithë komuna, jo vetëm sporti. Duke e parë rëndësinë e sportit në këtë kohë, e sidomos futbollit në Evropë, duket ta kemi parasysh dhe të punojmë në këtë drejtim që pas disa viteve KF. RAHOVECI mund të marrë pjesë në gara evropiane, kjo i bie që klubet evropiane dhe tifozët potencialisht vijnë në Rahovec. Çfarë përshtypje i japim ne, me atë idenë tuaj për stadium?... Ai mundet me qenë vetëm një stadium i zakonshëm i papërshtatshëm dhe i rrethuar me male. Duhet të bëjmë diçka të veçantë – mund ta bëjmë. Stadiumi me mundësi duhet të jetë sa më në qendër të komunës. Ne si grup kemi një propozim konkret për stadium, veçse duhet vullnet nga ana e kryetarit dhe gatishmëri nga ana e asambleistëve. Rahovecit është vend bujqësor, veçantinë ia shtojnë sipërfaqet me vreshta, me rreth mbi 2000ha. Pjesa më e bukur dhe më strategjike është pjesa qendrore e “Stone Castle”, një hapësirë e gjatë me vreshta. Aty po bëhet një resort, një investim i madh që është në interes për komunën tonë. Visitorët që do të vijnë në Rahovec, kuptohet që do të jenë me mbresa, pasi që para vetes shohin hapësirën e bukur të ndërtimit të rrethuar me vreshta. Ne propozojmë që stadiumi i Rahovecit të bëhet në atë lokalitet. Pra, visitorët nga e gjithë Kosova dhe jo vetëm, pasi të vijnë në Rahovec të mos flasin vetëm për lojën por edhe për bukurinë e Rahovecit, si rrjedhojë ata do të vijnë prapë. Do të jetë një formë zingjirore e zhvillimit të asaj pjese, resorti – hardh festi – stadiumi, pra imagjinojeni se si do të duket një stadium në mes të vreshtave – do të ishte stadiumi më i veçantë jo vetëm në Kosovë. Poashtu, ju kryetar e keni pasë si premtim elektoral agroturizmin, plani për agroturizëm mund të niset me këtë projekt. Kjo ishte për pamjen e bukur, veçantinë dhe zhvillimin. Çasja për banorët e komunës dhe Kosovës do të jetë shumë më e lehtë sepse ajo pjesë është në periferi të qytetit por gati në qendër të komunës. Do të jetë stadiumi i komunës që pos qytetit do t'i ketë afër të gjitha fshatrat e komunës, Fortesa, Xërxa, Sapniqi, Malësia, Ratkoci, gjithë Anadriana si dhe pjesa tjetër; Celinë, Krushë, Nagac, Brestoc, Hoqa. Pra do të jetë stadiumi i komunës për të gjithë komunën që poashtu aty është duke u rregulluar një rrugë me katër korsi që do të jetë lehtë e çashme për të gjithë. Nga autostrada, vozitësi i bie ta ndërroj anën dy herë që të mbërrij në stadium (ata që janë mysafirë). Nuk ka dyshim që është një lokacion më i përshtatshëm dhe me interes për komunën. Një detaj tjetër për fund, duke iu referuar një shkrimi të Asociacionit Ndërkombëtar për Sport dhe Rekreacion, sugjerohet që stadiumet moderne të kenë tre parakushte që të jetë të

qëndrueshme dhe stabil; Mjedisi, biznesi dhe komuniteti. Ky lokacion i përmbush këtë parakushte, ju lutem merreni parasysh këtë propozim.

Sejfullah Sejfullahu – Përshëndetje kryesues, kryetar, drejtor, kolegë asambleistë. Urime festat e nëntorit. Po kaloj prej temës në temë, por kemi shumë telashe me qentë endacak, na duhet një zgjidhje sa më e shpejtë. Nuk e di komuna si e ka të rregulluar këtë çështje, por duhet të bëjmë zgjidhje. Tash në ora 16:00 në mbrëmje terrohet, fëmijët janë në shkollë deri vonë dhe kemi shumë probleme, sidomos tani që është “shtrenjtuar mishi” janë bërë më agresiv.

Burim Krasniqi – Përshëndetje kryesues, kryetar, ekzekutiv, kolegë asambleistë, të gjithë në sallë. Kryetar, i kam vetëm dy çështje që mendoj që janë shqetësuese. E para; Kam informata që është duke u punuar rreth rikthimit të një gurthyesi në dalje të Rahovecit në drejtim të Opterushës (mbi pompën e benzinës Fatmiri Comerc). Ka qenë dikur, është jofunksionale, por kam informacione që kanë filluar shpimet për rikthim të atij gurthyesi. Mendoj që nëse funksionalizohet prapë, do të jetë një gjë jo e mirë për komunën në përgjithësi dhe shumë shqetësuese në çoftëse planifikojmë ta zhvillojmë zonën industriale atje, e gurthyesi ta jep imazhin më të keq edhe hyrjes së qytetit por edhe asaj zone komplet. Do të ndodh ndotja e ambientit dhe një gjë e shëmtuar, shembullin më të thjeshtë e kemi rrugës për Malishevë para se të hyjmë në Astrazub. E dyta; Çështja e pagave jubilarë dhe çështja e tri pagave pas pensionimit. Unë e kuptoj që komuna nuk mund ta përballojë kontratën kolektive sa i përket shujtave dhe udhëtimeve, për shkak të akumulimit të borgjit që ka ndodh dhe rregullimi jo të mirëfillt në mes qeverisë dhe komunave për koston që e ka dhe si rezultat i kontratës kolektive të nënshkruar nga qeveria. E di që ka padi për atë pjesë, por tri pagat pas pensionimit i takojnë secilit të punësuar - arsimtar dhe ka prej tyre që presin dy vite dhe ende nuk iu ka realizuar, si dhe kam informata që ka realizim selektiv, dikujt i paguhen e dikujt jo. Paga jubilarë nuk është kosto e përfunduar, nuk është situatë që vjen befasisht, sepse për secilin shërbyes civil ose punëtorët e arsimit dhe shëndetësisë janë në dijeni kur e bëjnë pagën jubilarë dhe planifikohet në buxhet. Kërkoj që si komunë të ndërmerri masa me autoritetin që e keni fillimisht me gurthyesin që të mos lejohet funksionalizimi dhe të kujdeseni për obligimet rreth pagës jubilarë dhe për tri pagat pas pensionimit, e di që ka padi në gjykatë si dhe ka prej atyre mjekëve prapë edhe një kontest tjetër gjyqësor rreth pagës jubilarë dhe është në procedurë përmbartimore.

Sinan Kryeziu – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë. Desha ta parashtroj si pyetje poashtu edhe si koment; Fillimisht po iu përkujtoj që komuna e Rahovecit ka lidhë kontratë me përfaqësues ligjor privat për t'i mbrojtur interesat e komunës. Në atë kohë pata propozuar prishjen e kësaj kontrate sepse e kam gjykuar që ka qenë e dëmshme. Në seancën e radhës në mënyrë zyrtare kisha dashtë të kërkoj nga komuna që të na prezantoj në mënyrë të shkruar të arriturat e këtij avokati që e ka marrë kontratën 50.000euro për shërbime 6 mujore, si dhe rezultatin që e ka arritur komuna që e ka lidhur këtë kontratë. Nuk e di sa jam i kjashtë, unë jam munduar me të gjitha format e mia që ta ndali këtë kontratë të dëmshme, por kryetari pat thënë që jemi vonë për këtë kontratë, është dashur ta lidhim prej 2011-tës me një avokat privat, pavarësisht asaj që i kam thënë kryetarit që i ka 5 jurista për përfaqësim rreth interesave të komunës. Kështuqë më jipet e drejta e “dynjasë” t'i kërkoj rezultatet dhe të arriturat në mënyrë të shkruara se çka kemi përfituar ne prej kësaj kontrate me këtë avokat privat. Shpresoj që në seancën tjetër do t'i kemi shkresat.

Eqrem Spahiu – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Do të flas në emër të banorëve të Opterushës, Zoqishtit dhe Retijës për disa shqetësime që i kanë rreth fshatit. Në një lagje të fshatit Opterushë (aty ku shtrihet rruga për Retijë) ka probleme të mëdha me rrjetin e rrymës, nuk ka rrymë të mjaftueshme, si pasojë e kësaj aty duhet të punëhet çdo gjë me korrektor. Është kërkuar ndihmë nga KEDS-i por nuk ka pasë reagim asnjëherë. Në rrjetin elektrik aty që nga pas lufta nuk është bërë asgjë, rrjeti është nëpë shtylla të drurit të vendosura nga vet banorët. Probleme kanë edhe me ujë të pijshëm. Rrjeti i dobët i ujit dhe KRU – Gjakova nuk reagon fare për sanim. Shumë probleme do t'i kemi, sidomos tani gjatë kohës së dimrit. Tjetër problem në fshatin Opterushë

është edhe kanalizimi, disa pjesë të lagjeve nuk janë të përfshira në kanalizim, prej atyre është edhe restoranti që është hapur "Panorama" që po pritet të hapet edhe një tjetër, kanalizimin e hedhin nën asfalt. Ky kanalizim shumë shpejt do të vie edhe në fund të fshatit nëpër prrockën që është punuar në vitin 2020. Problemi tjetër është te përrocka, kryetari e din që është punuar shumë mire, por kanë mbetur edhe 60 metra pa dalur në rrugë dhe të përfundoj si duhet. Në një pjesë të përrockës derdhet kanalizimi dhe për fat të keq drejtori i shërbimeve publike është në dijeni. Problemi më i madh është në atë se në fshatin Opterushë, Zoqisht që dy vite asnjë metër rrugë fushore nuk është bërë. Problemi tjetër është në ambulancën e fshatit të cilën ka 5 muaj që e keni përruar, aty kemi një problem serioz, kanë filluar të myken muret. Aty nevojitet intervenim sepse dëmtimet do të jeni të mëdha prej lagështisë. Isha në inspektim aty në ambulancë kundërmon një erë e kanalizimit, mirë kishte me qenë që, une, ti, drejtoresha dhe Përparimi të shkojmë në mëngjes ta bëjmë hapjen e ambulancës dhe ta shohim nga afër se çfarë ere kundërmon. Ndriqimi publik pothuajse vetëm në mes të fshatit është si në Zoqisht ashtu edhe në Opterushë, nëpër lagje tjera nuk ka fare. Problemi tjetër qëndron te lapidari që është bërë në fshatin Retijë, kur do të fillon të punohet sepse ka mbetur vetëm betonimi.

Lirigzon Kastrati – Faleminderit kryesues, kryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë asambleistë, përfaqësues të KFOR-it, qytetarë të komunës së Rahovecit. Në seancën paraprake unë e ngrita çështjen e rregullimit të shtratit të lumit, mirëpo nënkryetari me ekspres përgjigje tha që nuk kemi para, kur nuk kemi para nuk kemi çka bëjmë d.mth. kjo ishte përgjigja. Sa jodinjitoze por edhe e papranueshme çasja e ministrisë dhe e ekzekutivit në raport me mijëra qytetarë të komunës së Rahovecit për këto 5 fshatra; Brestoc, Hoçë e Vogël, Nagac, Krushë e Madhe dhe Hoçë e Madhe, për zvarritjen e projektit për rregullimin e shtratit të lumit. Ky projekt që ka nisur në 2019 është neglizhuar dhe nuk i është dhënë mbështetja e domosdoshme që e meriton, vazhdimisht në seanca e kemi ngritë shtetësimin e banorëve të këtyre lokaliteteve që për çdo vërshim ose punim ata kanë probleme me prona. Deri më sot ende nuk kemi një përgjigje definitive për këtë projekt. Fakti që, një muaj më parë kryetari ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me ministrinë e infrastrukturës dhe mjedisit për financimin e projektit në vlerë prej 60.000euro është dëshmi e joseriozitetit përball vlerës financiare që kërkohet për përfundimin e këtij projekti. Kërkojmë nga kryetari i komunës konkretisht, ta dijme se çfarë obligimi ka komuna në këtë projekt dhe të na njoftoj se si do të vazhdoj shfrytëzimi i këtyre mjeteve. Është nevojë esenciale për këto lokalitete që ky shtrat i lumit të pastrohet fillimisht dhe të hiqen të gjitha ato pengesa që e pamundësojnë punimin e pronave. Çështja e dytë lidhjet me vërshimet. Kryetari i komunës e ka formuar komisionin për vlerësimin dhe kompensimin e dëmeve, besoj që kërkesën e ka bërë edhe në qeveri sepse dihet që qeveria duhet ta bëjë kompensimin. Kur kryhet ky kompensim i dëmeve kryetar?...

Vlora Vuçitërna Çmega – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. E kam një pyetje të shkurtë për drejtorinë e shëndetësisë. Si qëndron puna me ekipe mobile të posaçme shëndetësore të cilat i keni premtuar gjatë fushatës dhe që do të jenë në shërbim të qytetarëve?... A janë duke funksionuar këto ekipe?... Sepse sa kam informacione unë, ekipe mobile nuk ka për momentin, kjo për shkak të mungesës së stafit shëndetësorë. Nevoja për ekipe të tilla është e madhe. Nuk po i përmendi me emra, mirëpo X pacienta të paralizuar të cilët unë i njoh dhe i kam pacienta janë të detyruar që dikush t'iu bëj zgjidhje për një shërbim në nevojë.

Leonard Morina – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë, kryetar, kolegë asambleistë, qytetarë. E kam një pyetje për kryetarin e komunës; Tenderi i hapur me 16.09.2022 për furnizim me dru për nevojat e komunës është mbyllur me 03.10.2022. Në këtë tender kanë ofertuar dy kompani, njëra me çmim 140.000, tjetra me 132.000euro. Këtu del që kontrata është nënshkruar me një operator tjetër dhe jo me këta dy ofertues që janë edhe në faqe të prokurimit. Një shqetësim të tillë e kam patur edhe në seancën e kaluar se si ofertuesi e ka nënshkruar kontratën me 159.000 përderisa kanë qenë dy ofertues më të lire për furnizim me dru. Dhe pse nuk është nuk faqe të prokurimit ky ofertues i tretë që e ka nënshkruar kontratën.

Edona Kryeziu - Faleminderit kryesues. I nderuari kryetar, kolegë kuvendarë, të gjithë tjerë që janë prezent në përcjellje të kësaj seance. Duke e parë që kohet e fundit është duke u investuar në shumicën e shkollave, një gjë që ka qenë mëse e nevojshme. Një fshat që është lënë anash është Zoqishti, shkolla e këtij fshati është komplet e demoluar. A ka shpresë që do të ketë investim në këtë shkollë? ...

Sejfullah Sejfullahu – Nuk dua ta teproj, por desha të pyes rreth varrezave të Celinës, kur do të vazhdojnë punimet sepse kanë mbetur shumë keq.

Kryetari – Përshëndetje kryesues, drejtorë të drejtorive, nënkryetar, anëtarë të kuvendit, pjesëmarrës nga LMT, nga OSBE, media, faleminderit për kontributin. Fillimit urime festën e shumëfishtë kombëtare, 28 nëntorin – Ditën e Flamurit, ditëlindjen e komandantin legjendar Adem Jasharit, ditën e themelimit të shtetit modern shqiptar 28 nëntor 1912, si dhe daljen publike të UÇK-së. Urime, nëntorat e ardhshëm çofshin me bilanc shumë më pozitiv sesa që e kemi tani. Lavdi për të rënit ndër breza për flamur dhe çlirimin e kombit.

Faleminderit Sefë, te varrezat e martirëve sivjet është bërë një punë, shpresojmë që të vazhdoj puna dhe jam i bindur që 25 marsi 2023 i gjithë projekti do të përfundoj.

Edona Kryeziu; Shkolla e Zoqishtit, Sapniqit, Pataqanit nuk janë ende të përfshira në projektin e eficiencës së energjisë, shpresoj çoftë me fondin e eficiencës, por çoftë edhe vet si komunë ne do të kemi një ndërhyrje për vitin e ardhshëm edhe të shkollës “Haki Stërmilli” në Zoqisht, në Pataqan, Sapniq por edhe te ndonjë shkollë që ka ngelur.

Leonard Morina ka folur rreth tenderit për furnizim me dru; E para, sivjet kemi një situatë shumë më pozitive nga pikëpamja e shpërndarjes së lëndëve djegëse nëpër shkolla. Fatbardhësisht nuk kemi pasë vonesa edhe për shkak të krizës globale e që kosotoja e shpenzimit të lëndëve djegëse është shumë shumë më e lartë. Ligji aktual i prokurimit në thelb e thotë këtë; Fitues i një aktiviteti të prokurimit është ai që është më i lirë dhe më i përgjegjshëm. Mund të jetë dikush më i lirë dikush, por nuk i plotëson kriteret ligjore me mungesë dokumentacioni. Tjetri mund të jetë më i shtrenjtë por i përgjegjshëm. Firma e parë dhe e dyta mund të jenë më të lira, fiton e treta për shkak se dy të parat nuk i plotësojnë kushtet në dokumentacion. Për ndryshe në seancën e ardhshme mund ta jap edhe përgjigjen më të plotë, në thelb kjo është përgjigja.

Vlora Vuçiterna, faleminderit për pyetjen. Ekipi mobil ekziston, është funksional. Veprimet e këtij ekipi mund të jeni të pamjaftueshme për shkak të numrit të punëtorëve të angazhuar. Këtë temë e kam trajtuar edhe në takimin që e kemi mbajtur me punëtorët shëndetësorë. Në seancën e ardhshme do t'i jap të gjitha informatat për arritjet konkrete si dhe sa shërbime i ka krye ekipi mobil nga 5 janari i këtij viti e deri në seancën e dhjetorit.

Te Lirigzon Kastratit rreth rregullimit shtratit të përroit Hoqë e Madhe, Brestoc, Hoqë e Vogël, Nagac, e deri në Krushë të Madhe, është projekt i financuar nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Ngecjet në realizimin e këtij projekti janë shumë evidente dhe të dukshme. Projekti kushton rreth 1.390.000euro. Jemi kujdesur që kontrata t'i takoj dy kompanive, dy lotte dhe të kryhet më shumë punë. Unë me Ministrin Liburn Aliu e kam nënshkruar një momerandum në vlerë 60.000euro, të gjitha kanë qenë të planifikuara për këtë vit. Qeveria e Kosovës në një nga propozimet për ndarje buxhetore i ka hequr këto 60.000, tani me aneks memorandum janë rikthyer. Këto 60.000 që i kemi, i kemi lutur të dy kompanitë, a po dilni në punë t'i shpenzojmë të paktën këto?... Tani e kemi amandamentimin e ligjit për buxhet që ka kaluar në lexim të parë dhe shpresojmë shumë, nëse jo, ne jemi duke e shqyrtuar mundësinë financiare që këtë projekt ta realizojmë vet si komunë, në çoftëse ligji për buxhet për vitin 2023 kalon pa këtë projekt në të. Kemi shpresuar që është gabim teknik. Si ka mundësi të hiqet një projekt i cili është i financuar nga ministria qe tre vite. Realizimi i këtij projekti i jep zgjidhje të gjithë problemeve që aktualisht ballafaqohen qytetarët e atyre zonave.

Te Eqrem Spahiu; Udhëheqësit kryesor të KEDS-it kanë qenë në zyrën time në nivel vendi. Ata e kanë një plan të investimeve që fillon nga viti 2024. Në 2023 vetëm qka mund të nxjerrim, duke iu bërë presion, e duke i sfiduar. Te uji i pijshëm; Ministria e Zhvillimit Ekonomik asnjë cent nuk ia ka dhënë KRU-Gjakovës. Kemi një ngecje

serioze nga pikëpamja e synimeve të investimeve konkrete nga KRU-Gjakova. Shpresoj që do të ndryshoj situata për Opterushën, Zoqishtin, Hoqën e Madhe dhe për zonën ekonomike, poashtu edhe për Senocin, Drenocin. Këto dy projekte që janë të gatshme dhe siç e dini, zotohem që në momentin kur KRU-Gjakova është gati për intervenime, ne jemi gati gjithashtu, sepse ata janë iniciues të procedurave në projekte. Ne do të kërkojmë ndërhyrje sidomos kur ka reshje në Opterushë dhe në ato zona ku furnizimi me ujë të pijshëm nuk bëhet KRU – Gjakova, por që janë asate në menaxhim të KRU-Gjakovës. Restoranti “Panorama” është restoranti më i mirë që tani e ka komuna e Rahovecit. Problemi me kanalizim; Është një lajm i mirë që Ministria për Tregti Ndërmarrësi dhe Industri, e ka shpallur njoftimin paraprak për zonën ekonomike, 1.8 milion janë para që 1.5 milion i paguan shteti, ndërsa 300.000 euro komuna, edhe pse projekti kushton më shumë, por kjo ka qenë mundësia buxhetore e ministrisë. Ata i kanë inicuar procedurat, ata do të udhëheqin me gjithë procesin, kurse ne do të jemi në cilësinë e vëzhguesit dhe me memorandum mirëkuptimi i kemi edhe kontributet tona. Në këtë projekt punët e para që do të bëhen janë; Kanalizimi i ujërave të zeza, rrugët dhe trafoja. Në Rrugët fushore në zonën Opterushë, Zoqisht dhe Retijë, këtë vit kemi pasë ngecje poashtu edhe në Krushë të Madhe, Celinë, Hoqë e Vogël, Nagac, Brestoc, gjithashtu edhe në qytet, sepse nuk është turp të themi që operatorët kanë qenë më të lodhur, arsyetimet tashmë dihen – mitja e çmimeve. Te problemi i QMF-së, shqetësimi është i adresuar, operatori “Etniku” zyrtarisht i ka marrur përsipër të gjitha ndërhyrjet që do të bëhen. Të Kompleksi memorial në Retijë, ne e kemi shkëputur kontratën me operatorin e “vjetër” i cili për 5000 euro punë nuk e ka kryer projektin. Fatbardhësisht e kemi lidhë kontratën e re dhe sivjet kryhet. Sinan, ne kemi kontratë ligjore me një avokat privat. Me procedur të prokurimit kanë aplikuar përfaqësuesit ligjor (avokatura) dhe dikush e ka fituar. Në thelb mund të iu them, që dikush në QMF e ka bërë një padi dhe i ka fituar mbi 80.000 euro nga kategoria mallra dhe shërbime, falë avokatit me të cilin ti rrin çdo ditë me të, e unë më rrallë, e kemi fitu të drejtën (e kemi rikthyer). Pra, kemi disa momente ku ne i kemi fituar betejat ligjore në interes të komunës së Rahovecit. Kontrata që ka qenë për 6 muaj, nuk i ka shpenzuar as gjysmëm, sepse ai më raporton në baza mujore. Pavarësisht asaj që ne kemi jurista edhe këtu në asamble dhe shumë mirë që ka, por nuk është e lehtë të mbrojmë ligjërisht, të fitojmë ligjërisht shumë beteja që mund t’i ketë komuna jonë në raport me subjektet fizike e juridike, prandaj komunat krijojnë marrëdhënie kontraktuale me sektorin privat. Ne i kemi 5-6 jurista, por ata kanë punë tjera që duhet bërë. Padia merr kohë dhe kapacitete tjera. Burim Krasniqi rreth gurthyesit i cili e ka marrë licencën nga institucionet tjera, jo nga komuna sepse komuna nuk lëshon licenca. Është penguar nga komuna, kemi patur një takim në zyrë, vendimi ynë është që nuk i lejohet atij të vendos makineri. Kjo çështje është duke u diskutuar edhe në nivele tjera dhe këtë vendim nuk e kemi ndërmend ta ndryshojmë sepse qëndrimi jonë është i përcaktuar në vendimin e drejtorisë së urbanizmit. Pagat jubilarë; Në informacionet që unë i disponoj, ka plotë mësimdhënës që janë trajtuar, ka edhe prej atyre që nuk i kanë marrë pagat jubilarë. Veprimet selective; Po, një baba i dëshmorit Mustafë Hoti, jam munduar të ndërhyj, t’ia japim para kohe për shkak të gjendjes shëndetësore të gruas së tij. Në fund nuk u realizua. Pra, ka një renditje që lidhet me datat kur dalin në pension. Ne jemi të interesuar çdo herë t’i japim pagat jubilarë përkundër asaj që na ka ardhur vendimi zyrtarisht për shkëputjen e kontratës kolektive nga MASHTI. Na vie keq për ata që nuk i kanë marrë ende e që presin t’i marrin. Sejfullah Sejfullahu për qentë endacak; Ne e kemi pasë një projekt dhe veprime më herët për qentë endacak. E kemi zvogëluar numrin e tyre duke marrë veprime legale, mirëpo tash dikush thotë, po i bijnë prej Serbisë, dikush prej komunave tjera dhe prap ka filluar numri i tyre të rritet. Do ta shqyrtojmë me shumë vëmendje këtë çështje. Për fund e kam lënë Ilir Pallqën (qershia mbi tortë). Ministrin Liburn Aliu e kam takuar këtu, më është zotuar që për shkak të përmbytjeve dhe vërshimeve të gjitha kontratat që i kemi në rregullim të shtretërve, lumenjëve, kanaleve të kullimit dhe drenazhimit e tokave bujqësore, do të ndërhyjmë me një program të veçantë dhe të gjitha do t’i marr përsipër unë. E kam kuptuar jashtëzakonisht ambicioz këtë deklaram të tij dhe kam besuar që ky ka fuqi, mundësi dhe instrumente ta dëshmoj këtë punë. Çka ka ndodh?... Kur ka kaluar buxheti në qeveri, lëre që nuk ka hy asgjë, por është hequr edhe projekti për të cilin folëm, lëre që

është hequr ai, por është hequr edhe stadiumi i Rahovecit si projekt. Kodi për stadiumin e Rahovecit, kodi për palestrën sportive në Krushë të Madhe, kodi për stadiumin në Krushë të Madhe dhe kodi për stadiumin në Ratkoc. Shpresoj që në leximin e dytë mund të rikthehet diçka, prandaj nuk kam folur publikisht sepse nuk kam dashur ta krijoj një situatë “të flas para kohe”. Stadiumi te Epopeja e UÇK-së; Prona ka qenë e menaxhuar nga agjensioni pyjor i republikës së Kosovës. Në kohën e qeverisjes Haradinaj i kemi marr 7 ha dhe i kemi kthyer në pronë komunale. Në atë kohë ministër i Kulturës Rinisë dhe Sportit ka qenë Kujtim Gashi (PDK) dhe luftën më të madhe e kam bërë që mos të lejohet të investohet në stadiumin ekzistues në qytet. Sepse e kemi ditur që do të bëhet sheshi, kemi luftuar për vend dhe kemi arritë t’ia mbushim mendjen ministrit Gashi për një vend tjetër. Iliri e din që ne kemi hulumtuar shumë seriozisht, e kemi parë që prona publike për stadium në qytet nuk ka, mund të ketë pas 50 viteve në çoftëse e marrim përsipër ta rrënojmë ndonjë lagje në qytet. Prona në periferi të qytetit nuk ka, kërkon çasje në drejtori të gjeodezisë dhe kadastrës dhe në program i shihni se ku janë pronat e komunës, të agjensionit pyjor apo edhe të Agjensionit Kosovar të Privatizimit që janë në menaxhim. Ne nuk kemi pronë as për skaj rrugës për Xërxe. Nuk kemi pronë në rrugën për Malishevë dhe nuk kemi prone në rrugën për Drenoc, as në rrugën për Pataqan. Kemi pronë në rrugën Rahovec-Suharek te zona ekonomike. Te Epopeja e kemi gjetë pronën, e që është përcaktuar vendi për stadium. Ministria për Kulturë Rini dhe Sport ka krijuar marrëdhënie kontraktuale me një operator për hartimin e projektit (matjet gjeodezike). Është hartuar projekti ideor dhe kryesor, janë paguar mjete financiare për këtë projekt, kanë filluar procedurat e prokurimit, madje është shpallur edhe fituesi, nuk e di pse është anuluar procedura e prokurimit e tani janë hequr edhe kodet. Smajl Latifi nuk ka vendosur se ku do të bëhet stadiumi, kish pasë qejf vet është boll i zoti, por nuk ka fuqi vendim-marrëse se ku do të bëhet stadium. Ndërsa Smajl Latifi në cilësinë e kryetarit të komunës në process e ka gjetur mezi një pronë që e ka bërë pronë komunale, mos harro, është arritje sepse prona ka qenë e agjensionit pyjor, tani është e komunës – 7 hektar. Ne e kemi këtë pronë komunale për stadium, ndërkohë ka lind një ide interesante nga Ilir Pallqa, të cilën e kemi diskutuar me Ilirin, Visarin, kryesuesin dhe plotë tjerë. Te Stone Castle; Është tokë bujqësore, tokë që duhet të ridentinohet të bëhet tokë për ndërtim, sepse stadiumi është ndërtim dhe me do arsyeime që unë i kuptoj shumë mire. Ministria na ka hequr projektin e në anën tjetër kërkojmë shpronësim, kompenzim që kushton 3-4 milion, edhe pse ndoshta pronari nuk ka fare vullnet për ta dhënë dhe Iliri thotë që a ka vullnet kryetari. Vullnetin për stadium të kategorisë së parë e kam, bile me mundësi kampionatin botëror do ta organizoja në Kosovë, mundësisht 3-4 ndeshje në Rahovec. Iliri thotë ti e ke punët mirë me Stone Castlen, unë e kam mirë me të gjithë, bile edhe me Ilirin. Po nuk mund t’i them një pronarit që e ka në menaxhim 99 vite, ma jep këtë parcelë falas ndërkohë kur ka shku dikush prej këtyre të flas me ta, është folur për shpronësim. Nuk mund t’i them qytetarëve të Rahovecit me kaq pakujdes që flet Iliri, që Epopeja e UÇK-atje mbi Rahovec është stadium për Malishevën, ndërkohë që ajo zonë po urbanizohet me kompleksin sportiv, me shtegun e ecjes, është infrastruktura, rryma dhe uji, është Maja e Shkodranit etj. Në këtë situatë fatkeqësisht nuk e ka prioritet stadiumin, sepse e kanë hequr kodin dhe shakatë pa kripë të Ilirit ose të ndonjë Iliri tjetër nuk shkojnë te unë, sepse kodi është hequr nga qeveria dhe luftën më të madhe e kam ta rikthejmë, në vend që të luftojmë për një projekt të ri. Nuk po them që këto projekte i ka heq Liburn Aliu ose Hajrullah Çeku, po ndoshta ministri i financave. Në moment kur rikthehet kodi për stadiumin në Rahovec, për stadiumin në Ratkoc, për palestrën sportive në Krushë, për stadiumin në Krushë, tani flasim për vende se ku do të mund të bëhet stadiumi. Shqetësimi është me vend, mirëpo momenti jo. Lajm i mirë në buxhet është që shtohen vendet e reja për dukatore për qerdhe dhe numri i punëtorëve shëndetësor. Ndërsa mos harro Ilir, qerdhja në qytet është dashur të filloj sivjet, sikurse në Gjakovë, mjetet për qerdhe kanë qenë të ndara. Është mirë të reflektoni edhe ju. Shkolla në Pastasel është dashur të fillor sivjet, sikurse në disa komuna. Faleminderit për durimin, jam përpjekur të jap sqarime sa më të paanshme, të drejta dhe korrekte.

Ilir Pallqa – Kryetari ka fol pak gjatë dhe e kemi problem t’a përfshijmë krejt. Po ta bëj me dije që 50 minuta ke fol. (Kjo është kritikë për ty kryesues). Projektin e stadiumit ia lëjmë në përgjithësi ministrit dhe e thërrasim atë në

përgjegjësi. Unë kam folur për lokacion. I ke marr 7 hektar te Epopeja, ke pasë mundësi edhe 100 m² i marr, sepse në të ardhmen mund të bëhet çdo gjë atje, për stadium nuk është i përshtatshëm, i kam cekur arsyet e mia. Ne nuk duhet t'i shikojmë pronat a janë publike apo private, si institucion jemi këtu për interes publik dhe interesi publik mund të jetë edhe në prona private, për këtë arsye ekziston ligji për shpalljen me interes të përgjithshëm publik në prona private. Sa i përket ridestinimit të tokës bujqësore, ka precedent në po atë pjesë me të njëjtin pronar. Me 30 maj 2018 janë ridestinuuar 97 ari nga toka bujqësore në tokë ndërtimore në këtë kuvend, në të njëjtën pjesë, me të njëjtin pronar. Për interes privat është dhënë pëlqimi për ndërtimin e Resortit dhe tani jeni në hamendje se a e jep pëlqimin ministria për interes publik?! A e jep falë? Nuk e di a e jep falë, por ka precedent që e ka dhënë falë për trafon e rrymës dhe për shkollat në Pataqan. Mendoj që duhet të shkosh për diskutim te ai, t'ia shfaqësh si interes reciprok sepse edhe atij i zhvillohet ajo pjesë duke iu rritur vlera asaj prone, besoj që edhe ai ka interes që stadiumi të ndërtohet atje. Ne, përmes deputetit tonë, kemi bërë çmos për adresimin e këtyre projekteve në leximin e dytë të buxhetit siç edhe jeni në dijeni kryetar.

Kryetari – Interesi publik mbrohet edhe duke e trajtuar sektorin privat. Çështja e shpronësimit është e rregulluar me ligj. Mendoj që interesi publik përfaqësohet më mirë kur e kemi pronën publike dhe interesi privat ose parcelat private vijnë në shprehje kur skemi pronë publike dhe tani duhet të bëjmë marrëveshje shpronësimi për interes publik etj etj... Këndvështrimi i dikujt mund t'i duket që nuk është interes publik te Epopeja e UÇK-së. Në çoftëse nuk është interes publik për stadiumin, pse atëherë po e ndërtojmë kompleksin sportiv atje, shtëpia për të moshuar, Maja e Shkodranit, restorant "Bjeshka" dhe nuk është dashur hiç t'ia marrim sektorit pyjor ata hektarë. Vend tjetër publik në Rahovec nuk ka pos atij. Unë kam biseduar me ta, the për trafon – sa i përket trafos mu në atë vend është gjykuar dhe vlerësuar të bëhet ajo trafo dhe e ka dhënë falas. 2 hektarë tjerë për shkolla në Pataqan të Epërm, gjithashtu falas, mirëpo ti nuk po i kërkon pronë për varreza të dëshmorëve të martirëve apo edhe për civile, apo edhe për sistem të ujitjes e as për Teqe e Xhami sepse ta jep. Për ridestinim në atë kohë ka folur kuvend i komunës por gjithashtu edhe ambasadori i SHBA-së në republikën e Kosovës Greg Delawie, i jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë. Ndërsa sot as ministri Çeku nuk flet për këtë punë, sepse është hequr komplet kodi, të gjitha projektet që kanë qenë. E nëse flet ministri, flet edhe kryeministri por edhe ambasadori i ri Jeffrey Hovenier dhe të siguroj që këta mund ta ndihmojnë edhe ridestinimin dhe më pas zëri im ka me qenë shumë i fortë. Dikush në emër të juajin ka folur dhe ka thënë shpronësim dhe shpronësimi në atë vend dhe në ato kushte dihet sesa kushton. Të lutem Ilir, po flet në emër të sportit dhe në emër të qytetarëve të Rahovecit me rreth 300 vota, e unë nuk po "guxoj" të flas dhe për atë arsye po foli para juve në kuvend edhe pse i kam 11.000 vota. Ju lutem mos folni në emër të qytetarëve dhe sportistëve pa e ditur mirë mendimin e tyre. Mos e gjykoni një veprim të kryetarit të komunës, pa qenë të informuar drejtë. Ju siguroj që kompleksi sportiv që po ndërtohet atje, e që pritet vitin e ardhshëm të kryhet, sipas federatës së futbollit i plotëson më shumë kushtet sesa stadiumi ekzistues. Ata i bëjnë matjet dhe kriteret – janë kompetent, e jo Ilir Pallqa e Smajl Latifi.

Lirigzon Kastrati – Kryetar, pyetjen e dytë që e bëra ishte rreth kompenzimit të dëmeve për shkak të vërshimeve, e di që raportin e keni dorëzuar, por a e keni ndonjë informacion se kur do të mund të bëhet kompenzimi?... Sepse është kërkesë dhe adresim i disa bujqëve por edhe i ekonomive familjare.

Kryetari – Më fal Lirigzon, pytjen tënde e kam shënuar, por më doli nga mendja. Ne, raportet i kemi përgatitur herët, por ka qenë një paqartësi te ministrinë e lindjes. E kanë bërë një udhëzim dhe një rregullore për trajtimin dhe vlerësimin e dëmeve në bujqësi dhe tani ata na thonë; Ju e keni formuar komisionin ende pa e patur udhëzimin administrativ. Në fakt ata e kanë vonuar udhëzimin administrativ, ne nuk mund t'i vlerësojmë dëmet në bujqësi pas 3 muajve, por duhet të vlerësohen në ato ditë kur kanë ndodhur vërshimet, sepse dëmet do të asgjësoheshin me kohë. Megjithatë na kanë dërguar disa formularë të rinj dhe i kemi plotësuar. Është një komision shtetëror për vlerësimin e dëmeve në bujqësi, amvisëri, ekonomi familjare, infrastrukturë publike dhe biznese. Vetëm një e

dijmë, besoj që ka ardhur koha që ndoshta brenda dhjetorit ta marrin vendimin për vlerën financiare të kompensimit. Jemi në pritje. Shtatë komisione e kanë kryer punën në mënyrë profesionale.

Hasan Përboqi – Faleminderi kryesues. Përshëndetje kryetar, kryesues, nënkryetar, drejtor të drejtorive, kolegë asambleistë, media të pranishme. Realisht desha të inkuadrohem në çështjen e diskutimit rreth leximit të parë të buxhetit të qeverisë i cili ka kaluar javën e kaluar në parlament të Kosovës. Duhet të jemi në dijeni se çka ka hequr kjo qeveri, e çka ka shtuar rreth komunës së Rahovecit. Nuk bën ta harrojmë se kjo qeveri me 14 shkurt i ka marrë 51% të votave në nivel vendi e në Rahovec mbi 10.000. Nuk bën me harru fakti as pas çdo vërshimi që ka ndodhë prej 14 shkurti e këndej, kjo qeveri është “knaq” duke bërë fotografi nëpër toka bujqësore e terrene të fshatrave. Ta shohim tani se si po implementohet buxheti i vitit 2023. Një fakt që unë tash për herë të parë e dëgjova që stadiumi qenka hequr, ndërkohë që ne po luftojmë për ndonjë projekt të ri në buxhet. I bashkangjitem bisedës së kolegut Ilir dhe mendova të kontriboj në diskutim për stadium, e tash po del që stadium është hequr. Kjo i bie “Peshku n’deti – fërterja n’zjem”. Kjo qështje rreth buxhetit që është shumë me rëndësi, po e lë ta diskutojmë për seancën tjetër, pasi që kolegu asambleist tha që presim që në leximin e dytë të rikthehen projektet e janë hequr dhe të shtyhen tutje projektet e reja. Në rast se kjo nuk ndodh, kisha propozuar ta bëjmë një seancë të jashtzakonshme ne si kuvend dhe të diskutojmë rreth kësaj padrejtësie që po i bëhet Rahovecit si komunë. Pse po hiqen paratë e vitit 2023 që kanë qenë të planifikuara për qerdhen në qytet, e po dërgohen në Kamenicë?... A jemi edhe na pjesë e Kosovës dhe taksapagues në atë buxhet?... Po e lë këtë diskutim për seancën tjetër, duke shpresuar që kalon buxheti edhe në lexim të dytë në parlament dhe atëherë dihen konkretisht gjërat. Prej kryetarit kisha kërkuar, nëse paraprakisht para seancës tjetër kalon në lexim të dytë buxheti, të na përgatit një dokument që të jemi në dijeni për të gjitha ato se çka përmban buxheti e çka jo, për komunën tonë.

Kryesuesi – Faleminderi shumë Hasan. Me gjithë respektin, por unë besoj që kompetencat e kuvendit komunal të Rahovecit janë që të mirremi këtu me çështje lokale. Kemi shumë probleme brenda komunës, çoftë infrastrukturë, çoftë probleme tjera të përditshme që jemi duke i përjetuar në komunë. Te çështja e buxhetit; Është Parlamenti i Kosovës që merret të, e kemi një deputet atje dhe mund të bëjmë kërkesë duke i shfrytëzuar të gjitha format ligjore. Nuk besoj që është e arsyeshme që këtu t’a diskutojmë buxhetin e Republikës. Sa i përket largimit të kodit për stadiumin, raste të tilla ka pas edhe gjatë qeverisjes Haradinaj, nuk është vetëm çështja që tash Vetëvendosja e ka qeverinë. Pavarësisht kësaj, nuk besoj që ia vlenë që këtu në kuvend komunal t’i diskutojmë çështjet e kuvendit të Kosovës.

Sejfullah Sefullahu – Është shumë shqetësuese dhe irrituese kjo gjendje. Mirë është të diskutohet dhe të gjithë ta përdorim ndihimën tonë te Avdullah Hoti, te Visar Korenica edhe te Yllza Hoti nga Krusha, e që identifikohet si e Prizrenit. Është shumë shqetësuese që për Krushën e Madhe dy projekteve më të mëdha iu kanë hequr kodet, stadiumit dhe palestrës sportive dhe më vie keq që sot e kuptova këtë gjë. Duhet protestë dhe grevë urie. Fjalën e kërkoja që kryetarit t’ia bëjë një pyetje shumë relaksuese, por ja që nuk po ia bëj pasi e kuptova këtë gjë, u irritova shumë.

Kryesuesi – Pajtohem plotësisht me kritikën e tua, por drejtimi i tyre është i gabuar. Nuk dua ta amnistoj çështjen e kodeve dhe investimeve, por në kërkesat që i kemi si komunë, unë rreshtohem gjithmonë krah juve.

Hasan Përboqi – Të kemi kryesues, të kemi shok-mik e bashkëvendas, por ajo që the është shumë e pakuptimtë. Mos t’i diskutojmë këtu?... Nëse komuna nuk ka kapacitet që prej buxhetit të vet ta ndërtoj stadiumin, atëherë është shumë normale të kërkojmë ndihmë prej qeverisë. Kolegu Iliri poashtu e ngriti çështjen e stadiumit, edhe atij është dashtë t’i thoni njëjtë si mua sepse stadiumi është kompetencë e qeverisë për ndërtim. Nuk besoj që është e drejtë që t’i thoni një asamblesiti këtu që çështjet që janë të lidhura me buxhet dhe interes të qytetarëve nuk bën të diskutohen në asamble. Pikërisht kjo seancë është mirë që po zhvillohet në kohën e dy leximeve dhe është mirë t’i diskutojmë gjërat. Lehtë është që opozita ta kritikoj kryetarin për shumë gjëra, por duhet pranuar edhe kjo që ne po e kërkojmë prej qeverisë, nuk po kërkojmë asgjë ekstra, por pasi ka të drejtë që një stadium ta bëjë në Gjilan,

Mitrovic, Prishtinë e pse në Rahovec jo?... E kemi rrugën katër korsi dhe që dy vite prej kësaj qeverie po barten mjetet. Këto janë problematikat, inate personale nuk kemi me askënd.

Kryesuesi – Atëherë përshëndetje edhe një herë për të gjithë. Më vie keq që ky diskutim po bëhet në këtë formë edhe pse e kemi pa të arsyeshme të marrim pauzë prej 12:00-13:00 për shkak që e kemi një promovim të një libri të profesor Sabaudin Cenës prej orës 14:00. Ju sugjeroj që diskutimet t'i bëjmë më të shkurtëra që seancën ta përfundojmë në orën dy. Sa i përket çështjes së investimeve, Iliri foli për lokacionin e stadiumit – jo për stadiumin. Është e pakuptimtë nëse më sheh si “një dikushi” që jam pro asaj që është hequr një kod i stadiumit prej Ministrisë së Financave apo nga ajo e Kulturës. Në kërkesat për investime në komunën e Rahovecit gjithmonë rreshtohem me juve, por diskutimi për buxhetin e Republikës së Kosovës më duket i paarsyeshëm kur këtu mundemi t'i diskutojmë 100 telashe që i ka komuna e Rahovecit, duke ia përmirësuar jetën qytetarëve. Besoj që ne i përfaqësojmë qytetarët e komunës së Rahovecit për problemet këtu. E kemi mbajtur një takim me kryetarin, aty ka qenë deputeti dhe dy anëtarë të kuvendit të lëvizjes Vetëvendosje Sinani dhe Iliri. Kryetari i kemi thënë kështu; e E ke përkrahjen tonë të plotë për çdo kërkesë që e bën në qeverinë e Republikës së Kosovës që udhëheqet prej Albin Kurtit. Në çdo takim që mund të shkoj kryetari, ne shkojmë me të sepse interesi jonë është për investime në komunën e Rahovecit. Hasani e përmendi që ministrat kanë qenë dhe i kanë vizituar tokat bujqësore këtu, ministrat poashtu kanë qenë në zyrën e kryetarit në takimet që i kanë mbajtur. Pse kryetari asnjëherë nuk e ka ftuar një anëtar të kuvendit të lëvizjes Vetëvendosje dhe ta shihni çasjen tonë që ju nuk po i besoni, ndaj tyre për interes të komunës së Rahovecit. Akuzat janë të drejta, parimore dhe me interes të komunës së Rahovecit, por janë në drejtim të gabuar.

Kryetari – Këtu po diskutohet edhe për temat që në të vërtetë nuk janë kompetencë e jona, mirëpo ata që flasin duhet të provojnë të flasin saktë. Qeveria e Kosovës e ka një çasje tjetër t'i ruaj mjetet, inflacioni po bie, kriza po tejkalohet dhe do të kemi mjete të mjaftueshme për paga dhe për të gjitha projektet pas vitit 2025, kur ndoshta plotë qytetarë do të largohen nga këtu dhe do të mbesim këtu në kuvend. I sugjeroj kryesuesit të kuvendit që mirë është mos të bëj komente politike. Kryetari i komunës nuk bëri komente politike. Të ruhem nga kualifikimet partiake. Kënd e thirr kryetari i komunës kur e ka një ministër në takim, e kënd nuk e thirr, kjo nuk është çështje e një asambleisti ose e kryesuesit të kuvendit të komunës, pushtete janë të ndara. Edhe nëse janë 10 asambleista, kurrfarë kontributi nuk mund ta japin më shumë se sa kryetari i komunës. Nuk bëhet politika kështu kryesues, “demek” ne jemi më të fortë kur janë edhe asambleistat e VV-së në takim. Mos mendoni që ekskluziviteti i zhvillimeve në këtë vend i takon vetëm një partie edhe nëse i ka 60%, është kontribut i përbashkët. Nuk e kemi vetëm një deputet, deputet është edhe Avdullah Hoti, Yllza Hoti poashtu. Nëse dëshirojmë të punojmë, adresimi duhet të jetë te tre deputetët. Duhet ta kuptojmë edhe që Visar Korenica nuk është në kohën apo disponimin më të mirë, unë e mirëkuptoj. Unë kam qenë deputet 2001-2004, vet si LKÇK dhe më shumë është dëgjuar zëri im atëkohë sesa deputetëve që janë sot në grupe të mëdha politike. Zëri i Visarit ndoshta sot dëgjohet më pak, për shkak të situatave që nuk ia jap vetës të drejtën t'i komentoj. E kam takuar Visarin, shpresoj që do ta bëj punën e vet sepse për Rahovecit duhet të jemi gjithë bashkë. Sheshin nuk e kanë vendos në buxhet, unë ndoshta zyrtarisht do t'i kërkoj kryetarit të Prishtinës, Përparim Ramës të na jep një donacion për sheshin qëndror sepse ka qenë kryetar i jurisë kur është bërë përzgjedhja e objektit. Më ka premtuar që po, tani jemi duke i shqyrtuar modalitetet. Unë jam në pritje të lidhjes së kontratës dhe sheshi qëndror i qytetit do të kryhet. Sidoqoftë pavarësisht që nuk jemi kompetent, ne i apelojmë në emër të qytetarëve duke i kërkuar qeverisë së Kosovës dhe deputetëve, mbi të gjitha Komisionit Parlamentar për Buxhet - Punë dhe Transfere, në adresimin e çështjes që ka të bëjë me amandamentimin e ligjit për buxhet të rikthehen projektet e hequra dhe të futet ndonjë projekt i ri.

Kryesuesi – Faleminderit kryetar, gjithashtu edhe unë shpresoj që projektet do të kthehen. Për të çështja e takimeve, mos të keqkuptohemi, nuk jemi ftuar shkaku që nuk jemi kompetent për çështjen. Ata kanë ardhur të takohen me kryetarin e komunës. Po e them këtë, që ju ta vërtetoni çasjen tonë ndaj qeverisë për interes të

komunës së Rahovecit sepse po na shikoni me një sy kinse ne nuk bëjmë asgjë ose po veprojmë qëllimshëm keq në dëm të komunës. Absolutisht jo, çasja jonë gjithmonë është fuqishëm në interes të komunës. Po vazhdojmë me një pauzë deri në ora 13:00...

Kryesuesi – Atëherë përshëndetje për të gjithë. I nderuar nënkryetar i komunës, të nderuar anëtarë të kuvendit komuna, drejtorë të drejtorive. E vazhdojmë kështu pjesën e mbetur të seancës së rregullt pas një pause pak të zgjatur.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës: P-02279-0, P-02280-0 dhe P-02281-0;

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues. Të nderuar anëtarë të kuvendit, sipas ligjeve dhe akteve tjera nënligjore, para jush keni një vendim për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës. Komisioni sipas pikës 1 të këtij vendimi do të përbëhet prej 5 anëtarëve; 2 nga ekzekutivi, 2 nga kuvendi dhe një nga sektori joqeveritar. Bëhet fjalë për një komision i cili do të merret me procedurë për dhënien në shfrytëzim të tri parcelave; nr. P- 02279-0, P-02280-0, P-02281-0 në zonën kadastrale në Rahovec. Ftoj anëtarët e kuvendit që pas propozimit të emrave për komision, ta votojnë propozimin vendimin për formimin e komisionit.

Kryesuesi – Faleminderit shumë drejtor. Atëherë prej kuvendit të komunës në këtë komision do të delegohen 2 përfaqësues. I ftoj grupet e asambleistave për propozime.

Besë Bytyqi – Faleminderit kryesues, shfrytëzoj rastin ta përshëndes deputetin Visar Korenica. Grupi i Aleancës për këtë komision propozon Rumir Zhuniqi-n.

Leonard Morina – Grupi i Vetëvendosjes nuk ka propozim.

Lirigzon Kastrati – Në emër të grupit të asambleistëve të LDK-së e propozojmë z. Eqrem Spahiu-n.

Sejfullah Sejfullahu – Në emër të PDK-së, propozojmë dr. Amir Vuçiterna.

Kryesuesi – Meqenëse i kemi tre propozime, duhet të shkojmë me vota për secilin prej anëtarëve.

Burim Krasniqi – Meqenëse janë më shumë se dy emra, LDK tërhiqet prej propozimit.

Kryesuesi – Faleminderit shumë për mirëkuptimin. Atëherë për këtë komision kemi dy propozime; Rumir Zhuniqi (AAK), Amir Vuçiterna (PDK). Prej ekzekutivit gjithashtu i kemi gati dy propozime prej kryetarit.

Kryetari – Përshëndetje. Albtor Mullabazi dhe Nora Boshnjaku.

Kryesuesi – Atëherë përveq përfaqësuesit joqeveritar që do të zgjedhet pas thirrjes nga ekzekutivi, anëtarët e këtij komisioni janë; Rumir Zhuniqi, Amir Vuçiterna (kuvendi). Albtor Mullabazi dhe Nora Boshnjaku (ekzekutiv). Si të tillë po e vendosim në votim këtë komision. Kush është për?... Me shumicë votash aprovohet edhe komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 nr. 1427 i datës 30.04.2019 për themelimin e çmimit për krijimtari letrare e artistike “Sulejman Krasniqi”;

Afrim Dina – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë drejtor, i nderuar deputet i republikës së Kosovës, të nderuar anëtarë të kuvendit. Para vetes keni propozim-vendimin e kryetarit të komunës për plotësim-ndryshimin e vendimit 1427 të datës 30.04.2019 për themelimin e çmimit letrarë “Sulejman Krasniqi”. Ky çmim ka për synim rritjen e interesimit për krijimtari letrare në komunën e Rahovecit. Kërkesa për plotësim-ndryshim të këtij vendimi, lidhet rritje dhe motivimin e krijueseve që marrin pjesë në konkursin letrarë dhe mbi këtë bazë synohet fuqizimi akoma më shumë i personalitet të madhit Sulejman Krasniqi. Duke ndryshuar shpërblimin financiar nga 500 euro sa ka qenë në vitin 2019 në 1000euro, synohet që të bohet masivizimi i kësaj gare. Poashtu në vendimin e vitit 2019 figuron shuma fikse që është në pikën 3 me 500euro për fituesin e këtij konkursi. Tani propozohet që; Në shumë prej 1000eurove, të jeni 500 për vendim e parë, 300 për vendin e dytë dhe 200 për të

tretin. Mbi këtë bazë mund të kemi numër më të madh të krijimeve artistike që vijnë në konkursin letrar për çmimin “Sulejman Krasniqi”. Plotësim-ndryshimi kërkohet vetëm te pika 3 e vendimit paraprak të vitit 2019.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor. A ka dikush diçka rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është për?... Me shumicë votash miratohet edhe propozim vendimi për plotësim ndryshimin e vendimit për themelimin e çmimit për krijimtari letrare artistike “Sulejman Krasniqi”.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për lirim nga pagesa e Mamografisë për të gjitha gratë e komunës së Rahovecit;

Nënkryetari – Faleminderit i nderuar kryesues. Të nderuar kolegë, i nderuar kryetar, i nderuar deputet. Ideja është kështu; Meqenëse muaji tetor ka qenë “Muaji i ndërgjegjësimit të kancerit të gjirit” dhe ka qenë e paraparë një taksë për secilin pacientë i cili është trajtuar me mamografi. Ideja e komunës është që të lirohen nga pagesa të gjithë pacientët që trajtohen me aparatën e mamografisë. Sa e di unë, taksa ka qenë 10euro e paraparë me udhëzim administrativ prej QKMF-së. Ky veprim institucional do të ishte shumë i mirë. Ju ftoj të gjithëve ta përkrahni këtë propozim.

Besmire Bytyqi – Faleminderit kryesues, faleminderit nënkryetar. Përgëzoj ekzekutivin për këtë iniciativë për të gjitha gratë, ashtu siç e kemi diskutuar në KPF. Kjo ka qenë edhe një shtytje nga grupi joformal i grave ku bëjnë pjesë të gjitha asambleistët e kuvendit komunal dhe dy drejtoreshat, uroj që shumë gra do ta marrin trajtimin e duhur nga ky aparat.

Kryesuesi – Faleminderit shumë Besë. Respekt për ekzekutivin, por vendimi do të merret në kuvend dhe duhet t'i falënderojmë anëtarët e kuvendit pas votimit. Atëherë po e vendosim në votim. Kush është për?... Me shumicë votash aprovohet propozim-vendimi për lirim nga pagesa për Mamografi për të gjitha gratë e komunës së Rahovecit. Një shembull që duhet të duartrokitet.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës nr. P-71510057 -08924-0 personave fizik dhe juridik;

Isak Hoti – I nderuar kryesues, kryetar, delegatë, drejtorë të nderuar. Gjithashtu në KPF e kemi trajtuar si çështje. Është hera e parë si vendim. Realisht në të gjitha komunat e Kosovës, në Gjilan është iniciuar si procedurë dhe sot ne po fillojmë këtë procedurë për miratim të ofertës për negocim. Baza ligjore e këtij akti është në ligjin për vetëqeverisje lokale. Te Neni 11 i ligjit për dhënien në shfrytëzim – këmbim të pronës së paluajtshme komunale si dhe në rregulloren për procedurat për dhënien në shfrytëzim – këmbim të pronës së paluajtshme komunale. Më lejoni që para jush ta prezantoj propozimin e kryetarit të komunës për dhënien e pronës në shfrytëzim për 99 vite. Qëllimi i gjithë kësaj është bazë e shprehjes së interesit nga fondacioni “Adrian ORLLATI” nga Zvicra (Llozanë). Kryetari i komunës sipas ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale ka të drejtën e negocimit, këtë të drejtë ia parasheh ligji dhe rregullorja për këmbim dhe dhënie në shfrytëzim të pronës komunale, përkatësisht neni 23, ku këtë të drejtë kryetari i komunës mund ta shfrytëzojë në rastin kur vlera e investimit është së paku 10% e buxhetit të përgjithshëm për investime kapitale të komunës për vitin paraprak që d.m.th për vitin 2021. Kjo pronë gjendet te ish-Balltazari me sipërfaqe prej 3402m katror, me datë 26.09.2022 te zyra e kryetarit të komunës ka qenë presidentja e fondacionit “Adrian ORLLATI” zonja Micheline Calmy-Rey dhe përfaqësuesi Avni Orllati në prezencë edhe të zyrtarëve tjerë kanë diskutuar për këtë çështje. Ky fondacion është i interesuar që të bëjë një ndërtim të banesave, 30 deri në 35 dhoma për persona me nevojë dhe papërkujdesje. Sipas tyre qendra do të ketë mirëmbajtje, mjekë, infermierë, ushqim, barna etj... Është e domosdoshme që vlera për negocim duhet të jetë 10% e vlerës së përgjithshme të buxhetit për investime kapitale të vitit paraprak. Në vitin 2021 kemi patur gjithsej 4.286.979euro, kurse 10% e kësaj vlere është 428.697 euro dhe që sipas projektit ideor dhe parallogarisë që e kanë bërë, kjo vlerë për investim është 1.1 milion. Besoj që MAPL nuk do të na nxjerr telashe të panevojshme dhe mendojmë që kjo punë do të përfundojë ashtu siç është më së miri sepse si projekt është për çështje humanitare.

Kryetari – Faleminderit kryesues. Të nderuar anëtarë të kuvendit, drejtorë të drejtorive, nënkryetar, deputet i kuvendit të Kosovës z. Visar Korenica. Shpresova që këta të LDK-së e ftojnë edhe Avdullah Hotin. Do të përpiqemi që me deputetë nga komuna jonë dhe me grupe parlamentare dhe me komisionin funksional që t'i adresojmë dhe përfitojmë projektet që i takojnë komunës së Rahovecit. Jemi në pikën e rendit të ditës për dhënien në shfrytëzim të një parcele në të cilën parashihet të ndërtohet një vepër plotësisht humanitare dhe e pastër e bamirësisë. Fjala është për grupin “Orllati” nga Brestoci i komunës së Rahovecit, e që kanë shënuar mitje të jashtëzakonshme në Zvicër. Në nderim të kujtimit për nipit që u ka vdekur “Adrian Orllati” kanë krijuar një fondacion me po të njëjtin emër, i cili financohet prej tyre dhe udhëhiqet nga mikja e madhe e Kosovës, ish presidentja e konfederatës së Zvicrës, Micheline Calmy-Rey. Kemi patur dy takime zyrtare me drejtuesit e këtij fondacioni me “Orllati group” dhe zonjën Calmy-Rey, një takim në komunën e Rahovecit dhe poashtu kemi qenë të ftuar dhe kemi patur një vizitë me të gjitha shpenzimet e hequra në Zvicër. Fjala është për ndërtimin e një objekti banesorë për të moshuar që janë pa përkujdesje shoqërore dhe institucionale. Bëhet fjalë për banesa që i dedikohen atyre, 30-35 banesa. Ky objekt do të ndërtohet, funksionalizohet dhe mirëmbahet nga ata, pa asnjë lloj implikimi financiar nga buxheti i komunës ose i shtetit. Kanë kërkuar që t’ia japim një parcelë publike në shfrytëzim për 99 vite. Mendoj që është momenti i duhur dhe i përshtatshëm që ta vlerësojmë interesimin e tyre për t’u futur seriozisht në ndërtimin të një objekti që i dedikohet kategorisë së qytetarëve tanë që janë pa përkujdesje ose me përkujdesje të pamjaftueshme. Ju e dini që presidentja dhe kryeministri i kanë pritur këta në zyrë dhe kur i kanë pyetur se çka dëshirojnë në investojnë në Kosovë, këta iu kanë përgjigjur duke u thënë që një herë dëshirojmë investimin ta nisim në Rahovec. Në fillim projekt humanitar, ndoshta në të ardhmen do të ketë edhe ide të tjera. Parcela është objekti i vjetër i gjykatës ose ish Baltazari dhe bëhet fjalë për 34 ari. Aty janë edhe disa banorë që jetojnë, 5-6 familje që kanë marrëdhënie kontraktuale me ato banesa ekzistuese. Atyre familjeve duhet t’u jepet zgjidhje dhe këtë kërkesë që e kemi parashtruar para investitorit, ata e kanë marrë përsipër edhe këtë gjë dhe do të kujdesen që edhe atyre familjeve ndoshta edhe t’ia japin mundësinë të jetojnë në objektin e ri. Po të isha sot në vend të juajin dhe ta kisha mundësinë të votoj 31 herë, as që e kisha diskutuar këtë temë. Interesi më i madh tutje është që edhe MAPL ta konsideroj vendimin të arsyeshëm dhe mos ta vonojnë. Projekti ideor është i gatshëm dhe për 1 vit e 6 muaj ndërtimit t’i japin fund dhe brenda 2 viteve të funksionalizohet. Kostoja e ndërtimit kalon shifrën e 1 milion eurove, ndërsa sa i përket kostos së mirëmbajtjes, ata i dinë vet ato punë, përveç që parcelën duhet ta japim në shfrytëzim. Çështja nuk është se ata nuk kanë mundësi ta blejnë një pronë private, por çështja është sesi ne i krijojmë marrëdhëniet me një investitor që ka karakter bamirësie.

Lirigzon Kastrati – Faleminderit kryesues. I nderuar kryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë asambleistë, deputet i kuvendit z. Korenica. Diskutim nuk kemi, mirëpo e vlerësojmë investimin që do të bëhet në komunën e Rahovecit. Në emër të grupit të asambleistëve të LDK-së, e falenderojmë investitorin, konkretisht fondacionin “Adrian Orllati” me presidenten zonjën Micheline Calmy-Rey dhe përfaqësuesin z. Avni Orllati. Një projekt i vonuar por i domosdoshëm, qëllimi i së cilit dihet dhe natyrisht si grup e përkrahim propozim vendimin.

Kryesuesi – Faleminderit Lirigzon. Për shkak të çështjes së rëndësishme, i kisha ftuar prej secilit grup të asambleistave nga një anëtar të deklarohen për këtë propozim nëse e shihni të arsyeshme.

Sejfullah Sejfullahu – Përshëndetje për deputetin. Faleminderit për prezencën. “Sa më shumë që e zgjaste kryetari, ne këtu u ndiheshim më në faj.” Është vendim shumë i mirë, përshëndesim investimin dhe angazhimet. Për gjëra të tilla të mira e ke mbështetjen gjithmonë si opozitë. Shpresoj që edhe afaristët e tjerë të motivohen pas këtij investimi dhe në emër të PDK-së e vlerësojmë shumë.

Besë Bytyqi – Faleminderit kryesues. Faleminderit për sqarimet kryetar, në emër të grupit të AAK-së i shprehim falenderimet për fondacionin “Adrian Orllati” uroj që investimet e tilla dhe donatorët e tillë që shërbejnë për

mirëqenien e qytetarëve të Rahovecit të ndalen asnjëherë. Iu bëj thirrje njerëzve tjerë të vullnetit të mirë që të kontribuojnë në donacione të tilla.

Ilir Pallqa – Faleminderit kryesues. Ne vazhdimisht ankohemi për mungesë të pronave publike në qytet, por kur ka vullnet, pronat po dalin në pah. Uroj që e keni menduar mirë këtë projekt.

Kryesuesi – Faleminderit Ilir, edhe unë si kryesues po e shpreh falenderimin për fondacionin “Adrian Orllati” dhe për idenë e këtij projekti. Shpresoj që të shërbej për të mirën e qytetarëve tanë. Pa humbur kohë po e vendosim në votim. Kush është për?... Me shumicë unanime miratohet edhe propozim vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës personave fizik apo juridik.

7. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Brendshëm për vitin 2021 dhe diskutimi i planit të veprimit;

Ruzhdi Kabashi - Përshëndetje kryesues, kryetar, asambleistë dhe të gjithë të pranishëm. Para jush kemi sjellë raportin informues për punën e njësies së auditimit për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2021. Në këtë periudhë njësia e auditimit të brendshëm për punën e vet është bazuar kryesisht në planin vjetor të punës për vitin 2021 i cili plan ka qenë i aprovuar nga kryetari i komunës së Rahovecit. Bazë ligjore kemi pasur; Ligjin 06L-2021 për kontrollën e brendshme të financave publike, udhëzimet administrative për auditim të brendshëm, doracakun e auditimit të brendshëm, statutin e auditimit të brendshëm dhe instrukcionet lidhur me standartet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm. Sipas planit vjetor të njësies së auditimit të brendshëm për periudhën janar – dhjetor 2021 kemi arritur t'i kryejmë 10 auditime, po aq sa ishin të planifikuara. Vlerësimi i objektivave për auditimin sipas shkallës së rrezikshmërisë është bërë në planin strategjik të njësies së auditimit për vitin 2022-2024. Raporti 6 mujor i dytë i vitit 2021 është adresuar në njësinë qendrore për harmonizim të auditimit të brendshëm, kryetarit të komunës dhe komitetit për auditim të brendshëm. Gjithsej nga 10 auditime që janë kryer, janë dhënë 40 rekomandime nga të cilat 8 janë zbatuar, kurse 32 janë në proces. Si aktivitete tjera mund të cekem, ofrimi i ndihmave profesionale të vazhdueshme për të gjitha drejtoritë komunale, që kanë shfaqur interesim dhe nevojë lidhur me të kuptuarit e rreziqeve në implementimin e rekomandimeve, identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e tyre. Gjithashtu njësia e auditimit të brendshëm ka pasur angazhime me të gjithë zyrtarët të cilët me një formë ose tjetër kanë qenë të kyçur në procesin e implementimit të rekomandimeve. Kjo ishte në pika të shkurtëra sa i përket raportit.

Burim Krasniqi – Faleminderit kryesues, faleminderit delegatë. Njësinë e auditimit e falënderoj për raportin e dorëzuar kësaj radhe, për punën e bërë dhe të them të drejtën për atë paraqitjen goxha të guximshme. Besoj që është faktike dhe në të mirë të komunës ajo çfarë është paraqitur në raportin e auditorit. Unë nuk jam profesionist i fushës por në bazë të asaj që e lexova është goxha parimor si raport i auditimit. Kryetari i komunës duhet ta merr në konsideratë me të vërtetë këtë çështje sepse përpos raportit të auditorit të Zyrës Kombëtare të Auditimit që del i kualifikuar me të gjetura, e kemi edhe raportin e Auditorit të Brendshëm që i ka 40 të gjetura. Është goxha shumë dhe besoj që kjo duhet të shfaqë shqetësim për krytarin e komunës. Nëpër secilën drejtori kemi të gjetura, faktikisht asnjë drejtori nuk është mbyllur pa të gjetura, është shumë shqetësuese. Duke përfshirë; Mangësi në kompenzim të pagesave përcjellëse, te menaxhimi joefikas i pronës shtetërore, dobësi në menaxhim të kontratave, deri te e fundit (që mos të marrim shumë kohë për shkak të agjendës në orën 14:00, në respekt të profesorit Sabaudin Cena) te zyra e brendshme e prokurimit. Me të vërtetë të gjeturat këtu të bëjnë të mendosh që nesër përsëri mund të jetë një raport i kualifikuar i ZKA-së. Nëse themi që ka mungesë të mbulueshmërisë së fondeve në projekte, ka mungesë në zotimin e fondeve, ka vonesa në vlerësime dhe njoftime të kontratave të nënshkruara, ka mungesë të planit të menaxhimit të kontratës. Sot po them që nëse kryetari i komunës nuk e merr seriozisht dhe me përgjegjësi të plotë ta lëshoj autoritetin e vet edhe te zyra e prokurimit, jo në ndërhyrjen të dhënies së kontratave, por në bërjen mirë të punës së tyre. Unë jam i bindur që vetëm këto të gjetura përsëri e nxjerrin të kualifikuar raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit. Auditor, faleminderit për

njoftimin dhe punën që e keni bërë. Kryetar, besoj që e dëgjon dhe e merr me shqetësim këtë raport dhe kur të vie raporti për vitin 2022 të gjeturat (32) mos të jenë të përsëritura dhe çështje të mbyllura në vitin fiskal 2022.

Sejfullah Selfullahu – Faleminderit kryesues. Gjithashtu edhe për PDK-në raporti është shumë shqetësues. Në fakt raporti është shumë në rregull, por veprimtaria dhe këto 40 të gjetura nuk janë të rastësishme. Ajo që na intereson neve është se a ka ndonjë zotim që do të korrigjohet kjo gjendje dhe cilat janë veprimet konkrete të qeverisë komunale për këtë raport, sepse po flasim për 2021 dhe sipas të gjitha gjasave edhe 2022 do të jetë njëjtë. Duket të mendojmë se çka mund të bëjmë në 2023.

Edona Kryeziu – Përsëritje edhe një herë. Duke iu referuar raportit të auditimit, gjegjësisht çështjes 5 që flet për neglizhencën e drejtorisë së zhvillimit ekonomik, qartazi na lë të kuptojmë që kjo drejtori nuk po e kryen punën ashtu siç është zotuar. Është vlerësuar që procesi i të hyrave nuk është inkasuar në nivelin e duhur, padyshim që unë jam e interesuar të dijë se ku po qëndron problemi, a ka kapacitet drejtoria për ta bërë inkasimin e resurseve humane, nëse po, atëherë cilat janë ato pengesa?... A po këtu kemi të bëjmë me ndonjë bashkëpunim që këtë biznese kanë me suportimin e ekzekutivit.

Leonard Morina – Faleminderit kryesues. Sa i përket raportit e kam parë se të gjitha ato që i kemi theksuar nëpër seancat e kaluara, janë të gjetura edhe këtu në raport. Gjithmonë shqetësim e kemi pasur planifikimin dhe realizimin. D.m.th kanë planifikuar shumë, kanë realizuar pak, pothuajse ky problem është në të gjitha të gjeturat. Megjithatë drejtoria e arsimit është e para, po ia nisi prej saj. Shkollat e kanë një buxhet, që e planifikojnë brenda vitit sesi do të shpenzohet. Drejtori i arsimit te pagat përcjellëse ka nënshkruar urdhrë blerje pa i pyetur drejtorët e shkollave, d.m.th iu ka shpenzuar buxhetin e shkollave pa dijeninë e drejtorëve të shkollave. Nëse ata për muajin tetor kanë planifikuar të bëjnë diçka me ato para, kur i kanë shikuar financat e kanë marrë vesh që ato para nuk janë më dhe drejtori nuk i ka kontaktuar t'i njoftoj që ato para i kemi shpenzuar. Drejtori ka të drejtë, por duhet të merret pëlqimi i drejtorëve të shkollave. Te pika 6, nëpër shkolla ka të gjetura te përpilimi i dosjeve të mësimdhënësve. Që 5 vite drejtor i arsimit dhe të ketë ende këto probleme që janë çështje teknike d.m.th. mungojnë letërnjoftime, diplomat – dosja bazë u mungon mësimdhënësve. Te bujqësia; Këtu në raport po del që ka planifikuar për 62% më shumë për vitin 2021, faktikisht për 56% është ulur planifikimi i përealizuar. Ka shumë mospërputhje në këtë raport, në asnjë drejtori nuk ka raporte të mirëfillta që duhet të bazohen në 3 muaj, 6 muaj dhe 1 vjeçar, ka mangësi të shënimeve përkatëse.

Lirigzon Kastrati – Faleminderit kryesues. Si anëtarë të kuvendit komunal, në seancat paraprake e kemi marrur raportin e auditorit të jashtëm për të cilin kemi diskutuar. Mirëpo sa i përket kësaj pike rreth këtij raporti, nëse e analizojmë vetëm në vija të trasha, ky raport informues i auditimit të brendshëm tregon një formë të gabuar të menaxhimit nga ana e drejtorive komunale. Natyrisht, ne shprehim shqetësim lidhur me këtë raport dhe më mbetet ta pyes kryetarin se si do të reflektoj pas këtyre të gjeturave dhe çfarë veprime do të ndërmerret rreth rekomandimeve të dalura nga ky raport.

Merisa Sharku – Përsëritje për të gjithë. Në raport në auditimit, drejtoria e urbanizmit prapë del shumë keq. Citoj; Çështja 1: Mangësi në planifikim, regjistrim dhe realizim të të hyrave. Çështja 2: Zbatimi i taksës për leje të ndërtimit dhe legalizim të objekteve. Në këtë të fundit ka dalë keq sepse gati në çdo seancë e kam ngritë çështjen se duhet të ketë stimulim për të marrur leje ndërtimore, e ktu po del që kemi rënie në këtë aspekt. Gjithashtu numri i lejeve ndërtimore qëndron shumë keq.

Kryetari – Këta që janë më të vjetër dhe me më përvojë e dijnë që Raporti i Auditimit të Brendshëm nuk paraqitet në kuvend. Me kërkesën e raportit për performancë, që është një tregues dhe në këtë rast kemi dashur të japim shembull që duhet t'i shmangemi pak ligjit dhe ta paraqesim para kuvendit. E vërtetë është që aty ka të gjetura, konkluzione, rekomandime. Pra, njësia e auditimit të brendshëm i përgjigjet vetëm kryetarit të komunës dhe ekipit të kryetarit. Sidoqoftë për ta përmbushur një kërkesë të performancës, e kemi vendosur këtu. Është gjithashtu e vërtetë që ka edhe plane të veprimit për adresimin e të gjeturave, konkluzioneve dhe zbatimin e

rekomandimeve. Poashtu nuk ka drejtori që nuk ka rekomandime, rrjedhimisht të gjetura, sikurse nuk ka shansë mos të ketë angazhime për zbatimin e këtyre rekomandimeve. Sa i përket buxhetit të shkollave; Pse tani ne e përdorim autoritetin tonë, sepse ligji neve na thotë: Nuk është përgjegjëse shkolla pse nuk e ka shpenzuar, administruar dhe shpërndarë buxhetin si duhet, por është përgjegjëse komuna e Rahovecit Leonard. Drejtoria e financave dhe kryetari i komunës ka autoritet të plotë në ato situata kur nuk vepron shkolla, kur nuk i ka kryen procedurat as në investime kapitale as në mallra dhe shërbime, sepse nuk guxojmë të lejojmë që buxheti të shkon në suficit pa arsye. Sa i përket shënimeve nëpër dosje, ti ke qenë drejtor vet dhe imagjino tani që një punëtor i arsimit nuk e bie kopjen e letërnjoftimi. Kjo është kompletar sepse është kërkesë e auditorit. I ftoj mësimdhënësit, drejtorët e shkollave, punëtorët e administratës, të sektorit publik që t'i plotësojnë dosjet e veta, është detyrë e tyre. Shpresoj që rekomandimet që janë në auditimin e brendshëm dhe të jashtëm nuk janë subject i hetimit të njësisë për hetimin e krimeve ekonomike, për shkak se nuk bëhet fjalë për ndonjë keqpërdorim financiar.

Kryesuesi – Faleminderit kryetar. Para se të fillojmë me pikën 8-të, e kemi një rekomandim nga organizatat monitoruese sa i përket konsultimeve publike, e që pjesëmarrja dhe aktiviteti i anëtarëve të kuvendit nëpër konsultime publike është e zbehtë. Rekomandohet që të jemi sa më aktiv, kështu që të martën 29 nëntor, e kemi konsultimin publik për Planin e Kuvendit të Komunës (plani vjetor 2023). Poashtu edhe një vërejtje që e kemi nga MAPL si kuvend komunal për çështjen e asaj që seancat kanë mbetur pa kuorum gjatë mbledhjeve, e kemi edhe listën ku duhet të jenë nënshkrimet e mbarimit të seancës, përndryshe do të penalizoheni në mëditje mujore, nuk do të ketë tolerime.

8. Shqyrtimi i raportit vjetor të Planit të Integritetit në komunën e Rahovecit;

Kryesuesi – Raportin e kemi përpara, atëherë nëse nuk ka nevojë për prezantim, ta kemi në konsideratë pak çështjen e promovimit të atij libri, por nëse dikush dëshiron që zyrtari të dalë dhe ta prezantojë?...

Valmir Gashi – Faleminderit kryesues. Komuna e Rahovecit konform mandatit ligjor që e e ka, në bazë të planit vjetor 2022 ka paraparë që të hartohet edhe raporti për zbatimin e planit të integritetit. Raporti përfshin periudhën maj-dhjetor 2022 dhe përfshin dy fusha të rrezikut; Fushën e përgjithshme dhe fushën e veçantë. Në kuadër të këtyre dy fushave janë gjithsej 17 nënfusha me 98 masa ose propozime nga të cilat 82 ose 84.32% janë zbatuar dhe 16 masa ose 15.68% nuk janë zbatuar. Në kuadër të fushës së përgjithshme janë 4 nënfusha me 34 masa ose propozime nga të cilat 30 janë realizuar, 4 nuk janë realizuar ose janë në proces. Sa i përket fushës së veçantë janë 13 nënfusha dhe 64 masa, 52 janë realizuar dhe 12 janë në proces.

9. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për shfuqizimin e vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P- 71510033-01041-1 në zonën kadastrale në Xërxë;

Isak Hoti – Faleminderit kryesues. Do të mundohem të jem shumë i shkurtër, mirëpo me këtë vendim të kthyer nuk e dijnë as ata vetë nuk e dijnë pse e kanë kthyer. E para e punës është, që pas 15 dite ne duhet ta kemi konfirmimin e ligjshmërisë së aktit prej MAPL-së, gjë që nuk ka ndodhur dhe e kemi pas një muaji e gjysmë. Me 23.09 është marrur vendimi në kuvend, me datë 02.11.2022 është kthyer vendimi. Jo rrallë hasim në jomirëkuptim. Vendimi është shpallur me interes të përgjithshëm public për hapjen e një rruge, ndërsa ministria në përgjigje të pika 2 e arsyetimit thotë: Pas sigurimit të provave të komunës së Rahovecit, gjegjësisht ekstraktit të planit zhvillimor komunal 01256 i datës 30.05.2013 për parcelën kadastrale 01041-1 në zonën kadastrale në Xërxë, vërtetohet se i njëjti është i destinuar për ndërtim, (është brenda kufijve ndërtimorë) mirëpo nuk është planifikuar rrugë. Në kuadër të këtij plani zhvillimor komunal, në çoftëse është ndërtim, atëherë është rruga, është kanalizimi, është ujësjellësi etj... Plus e mëtej e kësaj që nuk ka pasur rrugë, ne duhet ta shpronësojmë prej dikujt tjetër dhe ministria e ka gjetur këtë pikë që të na rikthejë në rishqyrtim këtë vendim. Ne dëshirojmë ta shfuqizojmë, mirëpo do të gjejmë rrugë tjetër që ta kometojmë këtë pjesë të mbetur nga ministria.

Kryetari – Faleminderit Isak. Atëherë po e vendosim në votim këtë shfuqizim, kush është për?... Me shumicë votash shfuqizohet vendimi 01 nr 375/22 i datës 23 shtator.

10. Diskutimi rreth fushatës nacionale “16 ditë aktivizëm kundër dhënës në baza gjinore”.

Kryesuesi – Nëse dëshironi, vazhdojmë me disa fjalë rreth kësaj teme, ose mund t’i publikoni shkrimet në rrjetet sociale për këtë tematikë.

Besmira Bytyqi – Të flasim për këtë temë, duhet të diskutojmë mbi 2 orë; Çka mund të bëjmë ne si kuvend? Si dzekutiv? Të propozoj ty kryesues, ta organizosh një tryezë mrenda këtyre 16 ditëve, na fton neve, shoqërinë civile, QPS-në, gjykatën, policinë etj... Aty mund ta bëjmë një diskutim kredibil. Ndërsa, grupi joformal i grave është duke përgatitur një organizim - një marshi paqësor, ju ftoj për pjesëmarrje.

Sejfullah Sejfullahu – Po ju drejtohem në emër të burrave të kuvendit. Ne, përveq që nuk jemi të dhunës aspak. Po i drejtohem gruas time me një poezi të shkurtër:

Eja sonte tek unë, shejtan.

Nerri këpucët në dorë, ec pa zhurmë.

Universin ta bëjmë sa një dhomë

Kur bota e madhe të bien në gjumë

Le të fryen veriu, rrebeshi puhiza.

Në zjarrin e trupit do t’i thajmë teshat

Veç zoti për mëkatet, i fshehu ditët – na dhuroi netët

Mike më ke, para Shën Pjetrit nuk të ndaloj brenda të hysh

Pa dyshim në çast edhe ai do të ketë puthur, natyrisht.

Kryesuesi – Faleminderit Sejfullah. Kështu, me vendosjen e këtij propozimi në rend dite, besoj që simbolikisht kemi dhënë një kontribut në fillimin e kësaj fushate globale kundër dhunës me bazë gjinore. Më këtë, unë po e pëmbylli seancën e 11-të të rregullt. Mirëmbetshi.

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi

K R Y E S U E S I


Defrim Kafexhiu

Njësia Nr./Br./No 02/Kabineti i Kryetarit të Komunës

Nr./Br./No 3170 Nr. i faq./Br.str./No pg 88

Data/Datum/Date 15/12/22

RAHOVEC / ORAHOVAC



RAPORTI VJETOR I PUNËS

(JANAR – DHJETOR 2022)

KOMUNA E RAHOVECIT

TABELA E PËRMBAJTJES

KRYETARI I KOMUNËS	2
PRIORITETET E PROGRAMIT QEVERISËS	2
ZOTIMET.....	2
PRIORITETET KRYESORE PËR VITIN 2023.....	3
SYNIME PËR VITIN 2023	4
SFIDAT KRYESORE PËR VITIN 2023	5
ZYRA E KRYETARIT.....	5
DREJTORIA PËR ADMINISTRATË.....	12
DREJTORIA PËR FINANCA DHE BUXHET.....	15
DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE	17
DREJTORIA PËR ARSIM	19
DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM	22
DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT.....	25
DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE	27
DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL.....	29
DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË.....	36
DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT	38
DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE.....	40
DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM	42
PËRFUNDIM	43

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

KRYETARI I KOMUNËS

FJALA HYRËSE

Qytetarë të komunës së Rahovecit,

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe Statutin e Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, si dhe në Planin e Punës së Kryetarit të Komunës dhe Qeverisë Komunale 2022, kemi kënaqësinë të paraqesim para jush raportin vjetor për punët, angazhimet dhe arritjet e Komunës së Rahovecit për periudhën: janar – dhjetor 2022.

Raporti pasqyron aktivitetet dhe angazhimet Kryetarit, të drejtorive komunale në Komunën e Rahovecit si dhe njësive të cilat veprojnë në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës së Rahovecit, njëkohësisht reflekton angazhimin dhe rezultatet e shënuara në këtë periudhë.

Ky raport gjithëpërfshirës ka për qëllim të nënvizojë, përparimin e arritur në realizimin e prioriteteve të Komunës, ballafaqimeve me vështirësitë dhe përpjekjet për t'u dhënë zgjidhje një sërë çështjesh me interes publik dhe ka si pikë reference Programin Qeverisës.

Jemi angazhuar fuqishëm që të arrijmë nivel më të lartë të transparencës komunale dhe në vazhdimësi jemi përkujdesur që praktikat më të përparuara demokratike, të aplikohen gjatë vendimmarrjes në Qeverinë Komunale. Raporti vjetor i punës është mjet i komunikimit i të arriturave të pushtetit lokal, përkushtimit, angazhimit dhe vendosmërisë së treguar në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve, me qëllim të rritjes së cilësisë së jetës dhe mirëqenies së qytetarëve të Komunës së Rahovecit.

PRIORITETET E PROGRAMIT QEVERISËS

- BUJQËSIA;
- EKONOMIA, AGROTURIZMI DHE PUNËSIMI;
- ADMINISTRATË BASHKËKOHORE ME SHËRBIME TË SHPEJTA DHE CILËSORE;
- ARSIMI, SHËNDETËSIA DHE PËRKUJDESJA SOCIALE;
- INFRASTRUKTURË PUBLIKE TË RREGULLUAR DHE TË MIRËMBAJTUR;
- INVESTIME NGA FONDI I EFIÇIENCËS SË ENERGJISË NË SEKTORIN PUBLIK DHE PRIVAT;
- INVESTIME NË INFRASTRUKTURË KULTURORE, SPORTIVE DHE HAPËSIRA PËR TË RINJTË SI DHE RITJA E PËRKRAHJES PËR KËTA SEKTORË;
- PROMOVIMI I POTENCIALIT DHE MUNDËSIVE PËR INVESTIME NGA MËRGATA JONË;
- TRASHËGIMIA KULTURORE, HISTORIKE DHE INVESTIME PËR TA NDERUAR HARTËN E SAKRIFICËS DHE LIRISË.

ZOTIMET

- KOMUNË E HAPUR PËR QYTETARËT - TRANSPARENCË E PLOTË DHE LLOGARIDHËNIE;
- KOMUNË QË QEVERISËT DREJTË DHE MIRË, LIGJSHËM DHE ME PERFORMANCË TË LARTË;
- KOMUNË KU JU SHËRBEHET QYTETARËVE PA DALLIM;
- KOMUNË ME SHËRBIME GJITHNJË E MË BASHKËKOHORE;
- KOMUNË KU PROMOVohen POLITIKAT DHE PRAKTIKAT MË TË MIRA SI DHE STANDARDET E LARTA TË QEVERISJES;
- KOMUNË KU RESPEKTOHEN VLERAT NJERËZORE E QYTETARE;
- KOMUNË PA DISKRIMINIM E QË QYTETARËT I TRAJTON BARABARTË;

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

- KOMUNË KU RESPEKTOHEN VLERAT KOMBËTARE, HISTORIKE, VLERAT E LUFTËS DHE TË LIRISË;
- KOMUNË QË NDERON SAKRIFICËN DHE GJAKUN E DERDHUR PËR LIRI;
- KOMUNË QË TRAJTON DHE MBËSHTET QYTETARËT QË KANË NEVOJA TË VEÇANTA;
- KOMUNË QË NDERON, PROMOVON E I JEP PËRKRAHJE TRADITËS, TRASHËGIMISË DHE GJITHË PASURISË SONË TË PËRBASHKËT, GJITHË ASAJ QË ËSHTË VLERË DHE IDENTITET I RAHOVECIT;
- KOMUNË KU PËRFAQËSOHET, MBROHET DHE PUNOHET PËR INTERESIN PUBLIK;
- KOMUNË KU PËRKUSHTIMI PËR TË VEPRUAR NDERSHËM DHE NË PAJTIM ME LIGJIN, PËRVEÇSE VULLNET, PËRCAKTIM I TË ZGJEDHURVE, JETËSOHET EDHE SI DETYRIM MORAL NDAJ ZGJEDHËSVE SI DHE NDAJ LIGJIT;
- KOMUNË KU RESPEKTOHET MOZAIKU I VLERAVE NJERËZORE, DEMOKRATIKE, KULTURORE, TË TRASHËGIMISË E TË BESIMIT NË ZOT;
- KOMUNË KU RESPEKTOHEN PAKICAT DHE PROMOVohen VLERAT E TYRE.

PRIORITETET KRYESORE PËR VITIN 2023

- SHESHI QENDROR I QYTETIT;
- FUNKSIONALIZIMI I SHTËPISË PËR TË MOSHUAR;
- FUNKSIONALIZIM, MIRËMBAJTJE DHE MENAXHIM TE MAJA E SHKODRANIT;
- FUNKSIONALIZIM, MIRËMBAJTJE DHE MENAXHIM I KULLËS PËR HERONJË TONI DHE MICI DHE BASHKËLUFTËTARËT E TYRE NË OPTERUSHË;
- EDUKIM DINJITOZ I BREZAVE TË RINJË DUKE IU OFRUAR MËSIMDHËNIE DHE MËSIMNXËNIE CILËSORE BASHKËKOHORE, MJEDIS TË PËRSHTATSHËM MËSIMOR ME INFRASTRUKTURË ADEKUATE DHE GJITHËPËRFSHIRËSE;
- DO TË INVESTOHET NË FUNKSIONALIZIMIN E PLOTË TË ÇERDHEVE EKZISTUESE;
- BURSA PËR STUDENTË;
- BIBLIOTEKAT – DO TË KETË KUJDES TË SHTUAR PËR BIBLIOTEKAT, DUKE U PËRKUJDESUR PËR BLERJEN E TITUVJE TË RI, POR EDHE DUKE I MIRËMBAJTUR DHE INVESTUAR NË OBJEKTET E BIBLIOTEKAVE EKZISTUESE;
- LABORATORË DHE KABINETE – ME QËLLIM TË RITJES SË KAPACITETEVE MËSIMNXËNËSE, KOMUNA DO TË INVESTOJË NË ZHVILLIMIN DHE KRIJIMIN E LABORATORËVE TË RINJ PËR SHKENCAT NATYRORE DHE KABINETEVE;
- PËRKRAHJE E FERMERËVE ME SERRA, STALLA, FERMA TË VOGLA, INPUTE DHE PAJISJE BUIQËSORE;
- RRUGË FUSHORE;
- PËRKRAHJE PËR PIKAT GRUMBULLUESE TË QUMËSHTIT;
- KANALE TË KULLIMIT TË TOKAVE BUIQËSORE;
- SHËRBIME VETERINARE PERIODIKE, FALAS;
- KONSULENCË DHE HARTIM TË PROJEKTEVE FALAS PËR BUIQ DHE BIZNESE;
- NDËRTIM I RRUGËVE TË REJA DHE MIRËMBAJTJA E RRUGËVE EKZISTUESE;
- NË BASHKËPUNIM ME KEDS, FURNIZIM STABIL ME ENERGJI, NDËRRIM I RRJETIT, I SHTYLLAVE, INSTALIME NËNTOKËSORE ETJ;
- BASHKËPUNIM ME KRU GJAKOVA DHE DONATORË TË TJERË PËR FURNIZIM MË TË MIRË ME UJË TË PUSHËM;
- EFICIENCA E ENERGJISË NË OBJEKTE PUBLIKE DHE NË SEKTORIN PRIVAT PËRMES FONDIT TË MILENIUMIT;
- MIRËMBAJTJE E RREGULLT E HAPËSIRAVE PUBLIKE, E OBJEKTEVE PUBLIKE DHE TË GJITHA LLOJEVE TË INVESTIMEVE PUBLIKE NË KOMUNËN E RAHOVECIT;
- LEGALIZIMI I PARKINGJEVE EKZISTUESE DHE KRIJIMI I PARKINGJEVE TË REJA;
- RREGULLIMI I INFRASTRUKTURËS PËR PERSONA ME NEVOJA TË VEÇANTA;
- TRAJTIMI I UJËRAVE TË ZEZA DHE RRUGËVE NË PJESË PROBLEMATIKE TË QYTETIT;
- MJEDISE TË BUKURA DHE HAPËSIRA PËR TË RINJË;
- KËNDE LOJËRASH PËR FËMUË;
- RITJE E STANDARDIT TË SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE, PËRMES MENAXHIMIT TË MIRË DHE PROFESIONAL. NË BASHKËPUNIM ME NIVELIN QENDROR, DO TË INVESTOHET NË PAJISJE TË REJA E KAPACITETE NJERËZORE, PËR TA MUNDËSUAR RITJEN E KAPACITETEVE DHE KUALITETIT TË SHËRBIMEVE TË OFRUARA;
- TRADITA E INVESTIMIT NË SEKTORIN E KUTURËS, RINISË DHE SPORTIT DO TË VAZHDOJË PËRMES PËRKRAHJES SË TË RINJVE, SHOQATAVE KULTURORO-ARTISTIKE DHE KLUBEVE SPORTIVE;

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

- DO TË VAZHDOJË SUBVENCIONIMI I PROJEKTEVE KULTURORO-ARTISTIKE DHE SPORTIVE, QË JANË NË INTERES TË KOMUNITETIT;
- ZBATIMI I STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL PËR KOMUNËN E RAHOVECIT 2021-2025, E MIRATUAR EDHE NË KUVENDIN KOMUNAL TË RAHOVECIT;
- PËRKRAHJE DHE LEHTËSIRA PËR PRODHUESIT, TREGTINË, ZEJET E VEÇANTA, ARTIZANALET, ETJ;
- TRAJTIM DHE RREGULLIM I SHTRËTËRVE TË LUMENJVE DHE PËRRENJVE;
- PZHK DHE HZK - DO TË MIRATOHET PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL DHE HARTA ZONALE E KOMUNËS, PAS SHQYRTIMIT PUBLIK;
- RRYTJA E KAPACITETEVE INSPEKTUESE PËR MBROJTJEN E MJEDISIT, DUKE I PARANDALUAR NDOTËSIT E SHKATËRRUESIT E AMBIENTIT ME SHQIPTIM TË GJOBAVE MANDATORE;
- INVESTIM NË STACIONIN E AUTOBUSËVE NË RAHOVEC, FAZA E DYTË DHE INSTALIMI I KABINAVE INNOVATIVE NË STACIONET E PRITJES, NË QYTET DHE FSHATRA;
- MIRËMBAJTJE E RREGULLT E HAPËSIRAVE PUBLIKE, E OBJEKTEVE PUBLIKE DHE TË GJITHA LLOJEVE TË INVESTIMEVE PUBLIKE NË KOMUNËN E RAHOVECIT;
- ADMINISTRATË EFIKASE, E PËRGJEGJSHME DHE ME SHËRBIME MODERNE;
- QEVERISJE ENERGJIKE, VEPRUESE DHE VENDIMMARRJE PA VONESË;
- REALIZIM I SUKSESSHËM I PROJEKTEVE DHE I BUXHETIT;
- REALIZIM I PLANIT TË TË HYRAVE KOMUNALE;
- PROMOVIMI DHE PËRMIRËSIMI I MJEDISIT TË RAHOVECIT SI QYTET LIDER PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE TË BIZNESEVE EKZISTUESE, ZGJERIMIN E TYRE SI DHE PËR ATO TË REJAT;
- BASHKËPUNIM I MIRË ME DONATORËT E JASHTËM,
- KOMUNIKIM DHE BASHKËPUNIM ME OJQ-TË.

SYNIME PËR VITIN 2023

- BUJQËSI TË PËRKRAHUR;
- RIPARIMI DHE MIRËMBAJTJA E RRUGËVE FUSHORE;
- INTERVENIMI NË NDËRTIMIN E KANALEVE TË KULLIMIT DHE DRENAZHIMIT TË TOKAVE BUJQËSORE;
- ZGJERIMI I SISTEMIT TË UJITJES NË PJESËT KU MUNGON;
- PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA E PËRROSKAVE;
- INVESTIME NË RRYTJEN E CILËSISË SË SHËRBIMEVE, ZGJERIMIN E TYRE, ZGJATJEN E ORARIT TË SHËRBIMEVE, PAJISJE MJEKËSORE DHE INVENTARIZIM PËR QKMF DHE PËR GJITHË RRJETIN E SHËRBIMEVE PARËSORE SHËNDETËSORE;
- ARSIM CILËSOR DHE BIBLIOTEKA, PAJISJE BASHKËKOHORE, LABORATORË, MË SHUMË TEKNOLOGJI INFORMATIVE DHE MJETE KONKRETIZIMI NË SHKOLLA;
- HARTIMI I PLANEVE URBANE;
- ZHVILLIM EKONOMIK DHE PUNËSIM NËPËRMJET FUQIZIMIT DHE MBËSHTETJES SË SEKTORIT PRIVAT;
- PËRQENDRIM PËR ZHVILLIMIN E PLANIFIKUAR TË AGROTURIZMIT;
- RRYTJEN E TË HYRAVE VETANAKE PËRMES LËSHIMIT TË LEJEVE NDËRTIMORE, PROCESIT TË LEGALIZIMIT DHE LEJEVE MJEDISORE KOMUNALE;
- NË BASHKËPUNIM ME DREJTORINË PËR PUNË INSPEKTUESE LEGALIZIMIN E OBJEKTEVE PA LEJE DHE RESPEKTIMIN E LIGJIT TË RI PËR TRAJTIMIN E OBJEKTEVE PA LEJE;
- MBIKËQYRJE AKTIVE DHE RRYTJE E CILËSISË NË INVESTIMET PUBLIKE;
- VAZHDIMI I EVIDENTIMIT DHE LIRIMIT TË PRONAVE TË UZURPUARA NË NIVEL TË KOMUNËS;
- DYFISHIM I PËRPPJEKJEVE PËR MBROJTJE TË MJEDISIT, MBROJTJEN E TOKAVE BUJQËSORE, MBROJTJEN E PRONËS PUBLIKE, PARANDALIMI I NDËRTIMEVE PA LEJE;
- PLANIFIKIMI I MASAVE PËR MBROJTJE, SHPËTIM DHE NDIHMË NË RAST TË FATKEQËSIVE NATYRORE DHE FATKEQËSIVE TË TJERA;
- PROJEKTE ME PARTNERITET PUBLIKO-PRIVAT;
- HARTIMI I PLANEVE, NXJERRJA E AKTEVE DHE RREGULLOREVE TË TJERA TË PUNËS;

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

- ZHVILLIMI I RAHOVECIT NË PËRPUTHJE ME PLANET ZHVILLIMORE KOMUNALE DHE MENAXHIMI I BURIMEVE FIZIKE BAZUAR MBI PARIMET E SHËNDOSHA MJEDISORE SI DHE MBI PARIMET E PARTNERITETIT ME MEKANIZMA VENDOR E NDËRKOMBËTAR, TË CILËT NDIHMOJNË NË ARRITJEN E VIZIONIT PËR KOMUNË MODEL ME NJË QEVERISJE KUALITATIVE, EFIKASE DHE LLOGARIDHËNËSE;
- VAZHDIMIN E TRAJTIMIT TË SHITRËTËRVE TË LUMENJVE DHE PËRRENJVE, PËRMES INVESTIMEVE KAPITALE NGA KOMUNA E RAHOVECIT DHE MBËSHTETJES NGA QEVERIA E KOSOVËS, ME QËLLIM MBROJTJEN NGA VËRSHIMET DHE RUAJTJEN E MJEDISIT;

SFIDAT KRYESORE PËR VITIN 2023

- BUXHETI I ULËT I QEVERISË SË KOSOVËS, MUNGESA E MJETEVE TË MJAFTUESHME FINANCIARE NGA QEVERIA QENDRORE SI TREND I VAZHÐUESHËM NË KOSOVË, QË I BËN INVESTIMET EDHE MË TË VËSHTIRA (ANGAZHIME TË SHTUARA NË KËRKESA NGA QEVERIA QENDRORE);
- INTEGRIMI I SA MË SHUMË QYTETARËVE DHE THELLIMI I BASHKËPUNIMIT TË NGUSHTË ME ORGANIZATAT JOQEVERTITARE (OJQ-TË), BIZNESET, ZANATLINJTË, TREGTARËT, BUJQIT, SHOQËRINË CIVILE ETJ;
- MUNGESA E HAPËSIRAVE PUBLIKE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË RAHOVECIT;
- MUNGESA E BURIMEVE TË MJAFTUESHME NJERËZORE DHE PROFESIONALE;
- PËRFSHIRJA MË E MADHE E QYTETARËVE TANË NË AKTIVITETET TONA DHE DUKE I MBAJTUR ATA TË INFORMUAR PËR TË GJITHA KËTO ZHVILLIME

ZYRA E KRYETARIT

Zyra Ligjore

Në periudhën: janar – dhjetor 2022, Sektori Ligjor në Komunën e Rahovecit ka arritur këto objektiva:

Rregullore	1
Vendime për Kryetarin	597
Vendime për Kuvend	81
Urdhëresa	63
Autorizime	41
Kërkesa	9
Marrëveshje	11
Propozime për Kuvend	39
Akte përcjellëse	27
Kontrata	23
Konsultime	Permanente
Përgjigje në kërkesë	15
Përgjigje në ankesë	1
Vendimet për drejtori	6
Njoftime	12
Puna në Komisione	45
Rekomandime	1
Ankesa	3
Totali i akteve të hartuara për periudhën janar-dhjetor 2022 nga sektori ligjor është:	975

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

Zyra e Burimeve Njerëzore - Njësia e Personelit

REKRUTIMET

Janë shpallur 42 konkurse publike në shërbimin civil, prej të cilave 17 janë konkurse të brendshme - lëvizje paralele dhe 25 konkurse të jashtme – pranim në punë, si dhe një konkurs publik – pranim në punë nga kategoria e stafit mbështetës. Të gjitha procedurat e shërbimit civil realizohen përmes programeve elektronike që është unike për Republikën e Kosovës.

PUSHIMET VJETORE

Punëtorët janë duke shfrytëzuar ditët e mbetura të pushimit vjetor të vitit 2022, ku afati i fundit për shfrytëzimin e pjesës së parë është data 30.12.2022.

LËSHIMI I AKTEVE ADMINISTRATIVE

Njësia e Personelit gjatë kësaj periudhe ka hartuar gjithsej 220 shkresa administrative, si në vijim: Kontrata, vërtetime, vendime, projekt-vendime, propozim, aktemërime, informata, njoftime, kërkesa, raporte dhe shkresa të tjera.

TABELAT STATISTIKORE

Të dhënat statistikore të personelit, Njësia e personelit i procedon drejtpërdrejtë në programin elektronik SIMBNJ, sipas kërkesës së MPB/DASHC-së, që bëhet rregullisht.

VLERËSIMI I PUNËS PROVUESE

Gjatë kësaj periudhe kohore nuk kemi pasur asnjë rast të vlerësimit të punës provuese.

VIJUESHMËRIA E PUNËTORËVE NË PUNË

Funksionon Sistemi i mbikëqyrjes së vijueshmërisë së punëtorëve në punë-SMVP.

NDËRPRERJA E MARRËDHËNIES SË PUNËS

Gjatë kësaj periudhe (4) punëtorëve iu ka pushuar marrëdhënia e punës dhe 4 kanë dhënë dorëheqje.

TRAJNIMET E NËPUNËSVE CIVIL

Është hartuar Plani i trajnimit të nëpunësve civil të komunës për vitin 2022 dhe është dërguar në DASHC/ MAP.

VENDIMET NGA KPMSSHCK-së

Nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, nuk kemi asnjë vendim.

MENAXHIMI I BURIMEVE NJËRËZORE SIPAS PROGRAMIT "SIMBNJ".

Në vazhdimësi, Njësia e Personelit menaxhon me programin elektronik SIMBNJ, duke e populluar dhe freskuar me të dhëna këtë program sipas kërkesave që parashtron MPB-ja.

PLANI INDIVIDUAL I PERSONELIT

Njësia e personelit ka hartuar Projekt-planin Individual të Personelit të komunës së Rahovecit për vitin 2023 dhe është hartuar në mënyrë elektronike sipas programit "hrmis".

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

Zyra për Përfaqësim Ligjor - Avokatura

Zyra për Përfaqësim Ligjor (ZPL) e Komunës së Rahovecit, kryen detyrat dhe punët në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës, në bazë të praktikës së Avokaturës Publike Komunale dhe Ligjit për Avokaturën Shtetërore.

1. PASQYRA TABELARE (SI MË POSHTË) PËR TË GJITHË REGJISTRAT, PARAQET LËNDË NË PUNË, TË PRANUARA, TË KRYERA, TË PAKRYERA DHE LËNDË TË MBETURA SI DHE PASQYRA PËR AKTIVITETET E NDËRMARRA.

PASQYRA TABELARE E LËNDËVE SIPAS REGJISTRAVE – PERIUDHA RAPORTUESE

	Sipas regjistrave të ZPL	Civile	Përmbartimore	Konflikt Administrativ	CN Ndryshme	Proc.At_hezionit	Gjithsej punë të kryera:
1	Lëndë të pa zgjidhura - të bartura	1150	204	12	33	16	1415
2	Lëndë të pranuar	346	65	1	2	2	416
3	Të gjitha lëndët në punë	1496	269	13	35	18	1831
4	Lëndë të zgjidhura	17	84	1	0	1	103
5	Lëndë të mbetura	1479	185	12	35	17	1728

2. LËNDË TË REJA TË PRANUARA GJATË VITIT 2022:

PADI TË REJA SIPAS REGJISTRAVE – PERIUDHA RAPORTUESE

	Lëndë të reja të pranuar gjatë periudhës raportuese	Civile	Përmbartimore	Konflikte Administrative	Civile Ndryshme	Pro.At-hezionit	Gjithsej punë të kryera:
1	Vërtetim i pronësisë	5					3
2	Kompensimet sipas Kontratës Kolektive	339	58				280
3	Konteste pune	2	2				4
4	Lëndë të tjera	2	5	1	2	2	13
	Gjithsej:	346	65	1	2	2	300

SHËNIM lidhur me paditë e reja të pranuar:

Gjatë periudhës raportuese, kemi pranuar një numër të konsiderueshëm të padive nga paditës mësimdhënës dhe punëtorë shëndetësor, të cilët paditë e tyre i kanë bazuar në Kontratat Kolektive respektive. Gjithsej, padi të reja të pranuar për kompensimin e pagave përcjellëse, pagave të shpërblimit jubilar, në emër të shpenzimeve të ushqimit, shpenzimeve të udhëtimit, në emër të kualifikimit dhe licencimit, janë pranuar 339 padi, siç shihet edhe në tabelarin e mësipërm. Shuma e kontesteve nga këto padi nuk është caktuar nga paditësit, në ato raste kur është caktuar e njëjta, ndryshon me ndryshimin dhe plotësimin e kërkesëpadisë në aspekt objektiv dhe subjektiv.

Raport i detajuar i të gjitha padive të mësimdhënësve të pensionuar, u është dërguar Drejtorisë së Arsimit dhe Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, me qëllim të informimit me numrin e padive dhe shumat kontigjente të kërkesëpadive.

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

3. PASQYRA E AKTIVITETEVE SIPAS REGJISTRAVE PËR PERIUdhËN RAPORTUESE

PARASHTRESA TË PRANUARA	CIVILE	PËRMBARIMORE	KONFLIKTE ADMINISTRATIVE	CIVILE NDRYSHME	P_Athezionit	Deperatamenti Ekonomik	GJITHSEJ
Aktvendim+Aktgjykim I	134	33	1	0	0		168
Aktvendim+Aktgjykim II	46	22	0	0			68
Aktvendim+Aktgjykim III	2		1	0			3
Aktgjykim+Aktvendim DHPGJS	0						0
Urdhër përmbarimor		21					21
Aktvendime për lejin e përmbarimit		35					35
Aktvendim për 180 ditë	0						0
Padi me prova	342		0	0	0		342
Aktvendim për përgjigje në padi	0		0	0			0
Përgjigje në ankesë C	25		0	0			25
Përgjigje në ankesë P		0					0
Përgjigje në prapësim		0					0
Përgjigje në revision	0						0
Përgjigje në propozim për ML	1						
Precizimi i padisë	70		0				70
Prapësim i debitorit		0					0
Ankesë C e paditësit	0						0
Ankesë P e kreditorit		0					0
Revizion C i paditësit	0			0			
Ekspertizat	0			0			0
Aktakuzë					0		0
Parashtresat tjera	0	0		0			0
Gjithsej	620	111	2	0	0	0	732

Të gjitha shkresat e pranuar janë sistemuar nëpër lëndë përkatëse dhe është vepruar në interes të Komunës, varësisht nga rasti. Vendimet e pranuar gjyqësore të shkallës së parë, të dytë dhe të tretë, pas analizimit të tyre, ato të cilat kanë qenë në dëm të Komunës janë ankimuar në shkallë tjetër gjyqësore.

Të gjitha vendimet gjyqësore të shkallës së parë ku e paditur ka qenë Komuna e Rahovecit, janë ankimuar në afat ligjor.

PARASHTRESA TË DËRGUARA	CIVILE	PËRMBARIMORE	KONFLIKTE ADMINISTRATIVE	CIVILE NDRYSHME	P_Athezionit	Deperatamenti Ekonomik	GJITHSEJ
Ankesat	149	5	0	0	0		154
Përgjigje në ankesë	0		0	0			0
Përgjigje në padi	324		0	0			324

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

Mbrojtje në padi DHP GJS	0						0
Revizion	15						15
Përgjigje në revision	0		0				0
Propozim për ML	0		0				0
Përgjigje në ML	0						0
Prapësimet		11					11
Përgjigje në prapësim		0					0
Ushtrimi i kundërpërmbarimit		1					
Ushtrimi i padisë	1						1
Kundërpadi	0						0
Kallëzim Penal						0	0
Ushtrimi i propoz. për përmbarim		0					0
Parashtresat tjera	7	1	3	0	0	0	11
Gjithsej:	496	18	3	0	0	0	516

Seancat e caktuara nga kontestet civile, përmbarimore, etj. nga gjykatat për periudhën raportuese

Për të gjitha lëndët aktive, gjykatat kanë caktuar dhe janë mbajtur seancat gjyqësore në të cilat Komuna është e paditur ose paditëse, si në vijim:

Seancat gjyqësore gjatë vitit 2022	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej
Nr.i seancave të mbajtura:	15	35	39	22	23	38	0	0	0	0	0	0	172
Sipas kontesteve - seanca të caktuara													
Civile		257											
Përmbarimore		14											
Konflikte Administrative		0											
Civile Ndryshme		6											
Proc.At_hezionit		1											
Gjithsej:		278											

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

Zyra për Informim, gjatë periudhës raportuese, korrik - dhjetor 2022, ka vazhduar me përcjelljen e aktiviteteve ditore të Komunës së Rahovecit. Përmes vegëzës zyrtare: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/>, Webfaqes së Komunës, janë publikuar të gjitha aktivitetet e mbajtura dhe janë publikuar të gjitha vendimet, rregulloret, raportet, njoftimet, konkurset dhe dokumente të tjera në interes të gjithë qytetarëve të Komunës. Ka mbajtur kontakte të rregullta me media, ku i ka përcjellë njoftime e lajme ditore për aktivitetet e zhvilluara në Komunë, ftesa etj., gjithsej janë përgatitur dhe publikuar 234 lajme, 26 njoftime, 5 ftesa, 6 thirrje dhe 11 konkurse.

KONSULTIMET, TAKIMET DHE DËGJIMET PUBLIKE

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

Në vazhdimësi përgatiten raporte për procedurat e ndjekura për secilin konsultim-takim dhe dëgjim publik të mbajtur me qytetarë dhe të njëjtit janë publikuar në ëebfaqe zyrtare të komunës në vegëzën: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/category/konsultime-publike-al/raporte-konsultime-plublike/>.

Rreth konsultimeve publike, janë publikuar:

- 10 njoftime për mbajtjen e konsultimeve publike;
- 7 procesverbale nga konsultimet publike;
- 5 raporte nga konsultimet publike.

Rreth takimeve publike, janë publikuar:

- 2 njoftime nga takimet publike
- 22 njoftime për zgjedhjen e kryetarëve të fshatrave
- 7 procesverbale nga takimet publike
- 1 raport nga takimi i parë publik i kryetarit

Rreth dëgjimeve publike publike, janë publikuar:

- 6 njoftime
- 6 procesverbale
- 2 raporte

QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE

Janë pranuar gjithsej 9 kërkesa për Qasje në Dokumente Publike dhe të gjitha kërkesave u është dhënë qasje dhe të gjitha kanë marrë përgjigje pozitive.

PLATFORMA E KONSULTIMEVE PUBLIKE

Në Platformën për Konsultime Publike: <http://konsultimet.rks-gov.net/> janë publikuar 9 njoftime për konsultime publike, një njoftim për takimin e dytë publik të kryetarit dhe 5 njoftime për dëgjime publike. Poashtu janë publikuar 3 Raporte finale për konsultime publike dhe dëgjime buxhetore.

Të gjitha vendimet e nënshkruara nga kryetari i komunës gjatë kësaj periudhe raportuese janë dërguar tek zyrtarët përkatës në MAPL dhe janë publikuar në uebfaqen zyrtare të komunës. Për këtë periudhë raportuese, kryetari ka nënshkruar 297 vendime.

Është bërë plotësimi i dokumenteve-raporteve, të cilat kanë ardhur si nga ministritë gjithashtu edhe nga OJQ-të e që kanë pasur të bënin me transparencë, performancë dhe llogaridhënie komunale, raportet janë publikuar në ëeb faqen e komunës.

Zyra e Auditimit të Brendshëm

Në periudhën janar – dhjetor, Njësia e Auditimit të Brendshëm për punën e vet, është bazuar kryesisht në Planin vjetor të punës për vitin 2022, i cili plan është i aprovuar nga Kryetari i Komunës së Rahovecit.

Sipas Planit Vjetor të NJAB-së, për periudhën janar – dhjetor të vitit 2022, janë kryer 5 (pesë) auditime, dhe 1 (një) është në process, do të përfundojë gjatë muajit dhjetor.

Aktivitetet dhe angazhimet e tjera të Njesisë së Auditimit të Brendshëm:

- Gjatë muajit Janar është përgatitur raporti i gjashtëmujorit të dytë dhe raporti vjetor i NJAB-së për vitin 2021, i janë dorëzuar Njesisë Qendrore për Harmonizim të Auditimit të Brendshëm (NJQHAB), Kryetarit të Komunës dhe Komitetit për Auditim të Brendshëm, të gjitha janë dorëzuar brenda afatit kohor të paraparë me ligj;
- Gjatë muajit Korrik është përgatitur Raporti i gjashtëmujorit të parë për vitin 2022;
- Në mënyrë të vazhdueshme kemi përcjellë planin për zbatimin e rekomandimeve nga viti 2021/22;
- NJAB-ja ka pasur angazhime me të gjithë zyrtarët, të cilët me një formë ose tjetër kanë qenë të kyçur në procesin e zbatimit të rekomandimeve.

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

Zyra e Prokurimit

Gjatë kësaj periudhe raportuese janar – dhjetor, Zyra e Prokurimit ka proceduar:

- 61 aktivitete të prokurimit, vlera e parashikuar e këtyre aktiviteteve është **14,890,732.02 €**;
- Janë nënshkruar **48** kontrata të të gjitha prokurimeve, punë, furnizime, shërbime, ku vlera e kontratave të nënshkruar është: **6,519,001.54 €**;
- Tre (3) aktivitete të prokurimit janë anuluar;
- Dhjetë (10) aktivitetet të zyrës së prokurimit janë në PROCEDURË të aktivitetit të prokurimit;
- Personeli i Zyrës së Prokurimit ka proceduar: **1433** urdhërblerja, pagesa të ndryshme të Investimeve Kapitale dhe Mallra dhe Shërbime, vlera e të cilave është: **6,691,009.71 €**.

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

Aktivitetet në periudhën: janar- dhjetor 2021

- ZKKK ka ndërmjetësuar në informimin, kompletimin e dokumentacionit dhe procedimin e tyre në ministri për 7 nxënës Rom, Ashkali dhe Egjiptian, të shkollave të mesme për aplikim për bursë me vlerë prej 300 euro nga MASHT;
- ZKKK ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me organizatën ndërkombëtare IOM mbi hapjen e “QENDRËS MËSIMORE ME BAZË NË KOMUNITET” – në Shkollën “GËZIM HAMZA - PIKTORI”;
- Realizimi i vizitave sistematike mbi procesin mësimor të komuniteteve jo-shumicë dhe parandalimit të braktisjes;
- ZKKK ka hapur thirrje për mbështetje me material ndërtimor për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian pas bashkëfinancimit të projektit nga OJQ-VORAE & ZKKK;
- Është nënshkruar marrëveshja për bashkëpunim për hartimin e Planit të Veprimit për Banimin Social në mes të OJQ-VORAE dhe Komunës së Rahovecit;
- Në KK është miratuar Plani për Banimin Social, 2022-2025;
- Janë selektuar 5 përfitues të renovimit të shtëpive në kuadër të marrëveshjes OJQ-VORAE & ZKKK;
- Mbështetja me Pajisje për Agrobiznes (kultivuesit e mjaltës) start Up Biznes .
- Mbështetja me Vegla pune dhe Start UP Biznes (1 egjiptian) - Organizata Gjermane “HELP”;
- Janë realizuar takime verifikimi të gjendjes në infrastrukturë rrugore në vendbanimet e komuniteteve dhe janë adresuar projekt-propozime në MAPL - për mbështetje në kuadër të thirrjes publike;
- Është nënshkruar mbështetja e MAPL-së për intervenimin në infrastrukturë në Lagjen e komuniteteve;
- Kanë filluar punimet me kubëzimin e rrugës dhe parkut të fëmijëve në lagjen e komuniteteve, tek AMF;

Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut

Duke u bazuar në objektivat që i ka të planifikuara për realizim të aktiviteteve gjatë gjithë vitit, NJKDNJ gjatë këtij viti për zbatim, monitorim dhe raportim mbi zbatimin e legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar mbi promovimin dhe përhapjen e vlerave në fushën e të drejtave të njeriut, e në veçanti të gruas si dhe fuqizimi, integrimi i saj në jetën shoqërore, ka realizuar një sërë aktivitesh.

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

- Puna disa nga gra të dhunuara gjatë luftës, duke ju ndihmuar në aplikacione për komision, Komisioni Qendror na ka njoftuar se 2 prej tyre, u është njohur statusi dhe tani do të jenë të kompenzuar;
- Në kuadër të përgatitjes së Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Dhunës në Familje kemi mbajtur 4 takime me Grupin punues dhe tani jemi para finalizimit;

Zyra për Integritet Evropiane

Zyra për Integritet Evropiane ka kryer funksionin dhe detyrat e veta, duke u bazuar në rregulloren nr. 08/2011, për organizimin dhe përgjegjësitë e zyrtarit komunal për integritet evropiane, në monitorimin, bashkëpunimin dhe raportimin e rregullt për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Departamentin për Integritet Evropiane.

Aktivitetet:

- Mbikëqyrja e aktiviteteve të drejtorive që burojnë nga PKZMSA-ja, si dhe dokumentet e tjera strategjike të MAPL-së dhe Qeverisë së Kosovës;
- Obligimet e komunave që dalin nga Agjenda Evropiane, duke u bazuar në Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit;

Procesi i ri- integritetit për personat e riadhesuar:

Ofrimi i shërbimeve sociale dhe familjare, monitorimi dhe vlerësimi i projekteve të përbashkëta, banimi përmes qirasë, regjistrimi civil dhe pajisja me dokumente personale, përfshirja e të riadhesuarve në përfitimet nga skemat sociale sipas legjislacionit në fuqi, verifikimin e rasteve në terren në bashkëpunim me koordinatoren regional dhe futja e të dhënave në SMR-në.

Zyra për Barazi Gjinore

Edhe pse në komunën tonë sfida në vetvete mbetet zbatimi i Ligjit për Barazi Gjinore dhe arritja e barazisë gjinore, falë mbështetjes komunale, organizatave të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare dhe angazhimit të përbashkët i të gjithë akterëve, si dhe i ZBGj, kemi arritur të realizojmë një pjesë të madhe të aktiviteteve të parapara për këtë periudhë raportuese, njëherit të bazuara në Planin Vjetor të Punës për arritjen e barazisë gjinore.

DREJTORIA PËR ADMINISTRATË

Administrata Komunale gjatë kësaj periudhe ka bërë përpjekje të jetë sa më funksionale dhe në pajtim me standardet bashkëkohore, duke ju ofruar qytetarëve të saj, si në aspektin kohor dhe atë cilësor realizim të të drejtave të tyre nga përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës. Në këtë drejtim fokusi ka qenë realizimi i synimeve programore, respektimi dhe zbatimi i ligjit si dhe akte të tjera juridike, parakushte këto për një administratë funksionale dhe efikase, gjithmonë në shërbim të përmbushjes së kërkesave individuale dhe të përgjithshme të qytetarëve, pa asnjë dallim.

Sektori i Gjendjes Civile

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

Gjatë vitit 2022, janë realizuar punët bazuar në ligjet, rregulloret dhe udhëzimet administrative mbi dokumentet dhe lëshimin e dokumenteve zyrtare. Në këtë sektor janë kryer veprime të shërbimit të gjendjes civile, siç janë: plotësimi, përditësimi dhe administrimi i regjistrave të gjendjes civile, zhvillimi i procedurave administrative, mbajtja e akteve të gjendjes civile, lëshimi i dokumenteve të gjendjes civile si dhe veprimeve të tjera juridike administrative në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Certifikata e Lindjes	24727	Lindjet Vendore	22
Certifikata e Lindjes pa pagesë	3563	Lindjet e Jashtme	419
Deklarata e Bashkësisë Familjare	3784	Martësat Vendore	577
Deklarata e Bashkësisë Familjare P.P	999	Martësat e Jashtme	71
Statusi Martesor	1401	Vdekjet Vendore	82
Statusi Martesor pa pagesë	72	Vdekjet e Jashtme	65
Certifikata e Martesës	4842	Aktvdekjet	169
Certifikata e Martesës pa pagesë	820	Pranimi i shtetësisë	27
Certifikata e Shtetësisë	284	Aktvendimet e korrjigimit të emrit ose mblemrit	18
Certifikata e Shtetësisë pa pagesë	42	Atvendimet e regjistrimit të mëvonshëm të lindurve	18
Certifikata e Vendbanimit	1370	Atvendimet e regjistrimit të mëvonshëm të vdekurve	1
Certifikata e Vendbanimit pa pagesë	249	Aktvendimet e ndërrimit të emrit dhe mblemrit	15
Certifikata e Vdekjes	1022	Anulimet e regjistrimeve të dyfishuara me aktvendim	10
Certifikata e Vdekjes pa pagesë	186	Aktvendimet e vërtetimit të kurorëzimit	0
Vërtetim nga Arkiva	1263	Fotokopjet nga kartoteka e letërnjoftimeve të ish Jugosllavisë	572
Vërtetim nga Arkiva pa pagesë	180		
Të dëmtuara	809		
Letër e bardhë	1017		

Sektori i Teknologjisë Informative

Ka vazhduar zbatimin e planifikimit vjetor të punëve si dhe punëve të përditshme, siç janë: monitorimi i rrjetit, sistemeve, përkrahja e zyrtarëve etj.

- Është bërë testimi i kabllave prej burimit të pikave ndërlidhëse deri te kompjuterët, printerët dhe pajisjet e tjera, poashtu, është bërë pastrimi i rregullt i serverëve, bartja e incizimeve nga kompjuteri i sallës së kuvendit në NAS;
- Është bërë instalimi i sistemit operativ windows 10 në ata kompjuterë ku kemi pasur mundësi dhe paketën e office;
- Ka pasur mjaft kërkesa për përkrahje Ad-Hoc, të cilave iu jemi përgjigjur (intervenim në kompjuterë, përkrahja në krijimin e dokumenteve të ndryshme etj);
- Në vazhdimësi jemi duke u marrë me sistemin e intranetit dhe ku ka nevojë e bëjmë edhe përkrahjen te stafi që ka nevojë për shfrytëzimin e këtij sistemi, ndërkohë që në intranet me kërkesë të drejtorëve janë bërë ndryshimet në kodet ekonomike dhe shenjave të klasifikimit.

Sektori për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

- Ndërmarrje e të gjitha masave të nevojshme për organizimin më të mirë të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, përgatitja e materialeve të nevojshme, dërgimi i ftesave dhe çështje të tjera rreth organizimit të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit Komunal;
- Organizimi i mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës (12 mbledhje) të Kuvendit Komunal;
- Organizimi i mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa;
- Dërgimi i të gjitha akteve në MAPL, sipas kërkesës së tyre;
- Përpilimi dhe lektorimi profesional i materialeve literare në gjuhët zyrtare në Komunën e Rahovecit.

Sektori për Mirëmbajtje, Logjistikë dhe Sigurim të objekteve

- Brenda kompetencave ka kryer punët rutinore pa ndonjë specifike, ky sektor është marrë me rregullimin e çështjeve logjistike (pastrim, kujdes për gjelbërim etj).
- Kemi menaxhuar me racionalitet të plotë dhe të domosdoshëm me fushën e logjistikës, ku përfshihet menaxhimi i automjeteve, titullar pronësor e të cilave është Komuna e Rahovecit, duke ushtruar në permanencë mirëmbajtjen e automjeteve zyrtare, servisimin, sigurimin dhe regjistrimin e tyre, furnizimin transparent me derivate etj.

Qendra për Shërbime me Qytetarë

Është arritur ngritje e dukshme e bashkëpunimit me të gjitha drejtoritë e administratës komunale, organet e komunës dhe njësitë e tjera për shqyrtimin dhe vendosjen e kërkesave/lëndëve, brenda afateve ligjore.

Përmes Qendrës për Shërbim me Qytetarë – Sektorit Pritës – Protokoll, ka qenë mjaft efikase dhe funksionale në realizimin e lëndëve si të përfunduara – vendosura lëndët sipas kërkesave të qytetarëve me kohë dhe brenda afateve ligjore, d.m.th. të gjitha lëndët janë përfunduar sipas Ligjit të Procedurës Administrative, me çka mund të thuhet se shërbimi ndaj qytetarëve ka qenë në nivelin shumë të kënaqshëm.

Gjatë kësaj periudhe janë pranuar gjithsej 14.084 kërkesa të ndryshme.

Indikatorët e performancës për Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME	
Komuna	Rahovec
Referenca	1.1.1
Fusha	SHËRBIMET PUBLIKE ADMINISTRATIVE
Rezultati	Ofrimi i shërbimeve administrative sipas kërkesave të qytetarëve
Emri i treguesit	Kërkesat administrative të shqyrtuara gjatë vitit

- Gjithsej numri i lëndëve të parashtruara gjatë vitit nga qytetarët dhe palët e tjera të interesit – 53899;
- Numri i lëndëve të shqyrtuara gjatë një viti nga ana e komunës – 53427 dhe të tjera në proces kanë afat ligjor.

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME	
Komuna	Rahovec
Referenca	1.1.2
Fusha	SHËRBIMET PUBLIKE ADMINISTRATIVE
Rezultati	Ofrimi i shërbimeve administrative sipas kërkesave të qytetarëve
Emri i treguesit	Kërkesat administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

- Numri i lëndëve të shqyrtuara gjatë një viti nga ana e komunës 53427 dhe të tjera në proces kanë afat ligjor;
- Numri i lëndëve të cilat janë shqyrtuar brenda afateve të përcaktuar me ligj – N/A.

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

Komuna	Rahovec
Referenca	1.1.4
Fusha	SHËRBIMET PUBLIKE ADMINISTRATIVE
Rezultati	Ofrimi i shërbimeve administrative sipas kërkesave të qytetarëve
Emri i treguesit	Shërbimet administrative të ofruara në mënyrë elektronike nga komuna

- Kërkesa në formë elektronike për certifikatë të lindjes – 29307;
- Kërkesa në formë elektronike për certifikatë të martesës – 5662;
- Kërkesa në formë elektronike për certifikatë të vdekjes – 1208;
- Kërkesa në formë elektronike për certifikatë të shtetësisë – 326;
- Kërkesa në formë elektronike për certifikatë të gjendjes familjare – 4783;
- Kërkesa në formë elektronike për certifikatë të pronës (fleta poseduese) – 3930;
- Fatura e mbeturinave e lëshuar në formë elektronike – N/A, kanë lëshuar vetëm fatura në kopje fizike 82852;
- Fatura për tatimin mbi pronë e lëshuar në formë elektronike – N/A, kemi lëshuar vetëm fatura në kopje fizike dhe numri i faturave të lëshuara është 12504;
- Kërkesa në formë elektronike për leje të ndërtimit – 68;
- Kërkesa në formë elektronike për leje mjedisore – 37;

DREJTORIA PËR FINANCA DHE BUXHET

Përmbledhje e shkurtër e aktiviteteve të kryera në periudhën raportuese, bazuar në ligjet, udhëzimet administrative, rregulloret të cilat e rregullojnë fushën të cilën e mbulon DPF, në programin e punës së Kryetarit të Komunës, planin e punës së drejtorisë, poashtu në planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit komunal, të inkasimit të të hyrave vetanake, si dhe në mbajtjen e lidhjeve dhe korrespondencave me ministritë e linjës e në veçanti me Ministrinë e Financave.

Më poshtë po paraqesim në vijë të shkurtëra disa nga punët dhe aktivitetet më kryesore në sektorë të drejtorisë:

Sektori për Buxhet dhe Financa

Bazuar në obligimet ligjore të cilat dalin nga Ligji mbi Financat Publike dhe Përgjegjësitë, kemi kryer të gjitha detyrat dhe obligimet që i takojnë kësaj drejtorie. Në DBF, kemi arritur që detyrat dhe obligimet të kryhen në afate ligjore duke evidentuar dhe regjistruar të gjitha të hyrat sipas kategorive të tyre, si dhe shpenzimin e buxhetit në të gjitha kategoritë.

Kemi mbajtur takime të ndryshme me MF-në, Asociacionin e Komunave të Kosovës, organizata të ndryshme apo donatorë, në të cilat kryesisht janë trajtuar çështjet financiare. Te shpenzimet operative kemi arritur të kursejmë disa shpenzime, kryesisht Mallra dhe Shërbime, pa e dëmtuar Buxhetin në kategori të tjera, duke i rritur disa shpenzime-shërbime, që në të kaluarën janë paguar nga kapitalet e realisht kanë qenë Mallra dhe Shërbime, siç

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

janë: mirëmbajtja e ndërtesave dhe rrugëve, pastrimi i rrugëve, rrënimi i objekteve pa leje, sinjalizimi i rrugëve etj. Planifikimi dhe përgatitja si dhe miratimi i buxhetit për vitin 2023, janë brenda afateve të caktuara ligjore.

Në DBF, janë realizuar detyrat kryesore duke respektuar edhe afate ligjore të rregulluara me ligjet që rregullojnë financat publike.

BUXHETI 2022

Grandi i qeveritar	13703,112.00, €
Të hyrat vetanake	1,350,548.00 €
Gjithsej	15,053,660.00 €

Shpërndarja e buxhetit nëpër kategori ekonomike në vitin 2022 është siç vijon:

Paga e mëditje	7,897,674.14 €
Mallra dhe shërbime	1,735,094.03 €
Shpenzime komunale	27,000.00 €
Subvencione	360,000.00 €
Investime kapitale	4,790,891.83 €
Rezerva	690,000.00 €
Donacione	106,054.84.00 €

Në vitin 2022 kemi realizuar këto detyra:

- Zotime, pranime, shpenzime për Mallra dhe Shërbime, shërbime komunale, subvencione dhe transfere, investime kapitale dhe përgatitja e ndryshimeve në listën e pagave për punëtorë;
- Përgatitja e raportit financiar në baza tremujore 2022 për Kuvendin Komunal dhe Kryetarin e Komunës;
- Raportimi i obligimeve financiare në baza mujore në Ministrinë e Financave;
- Përgatitja e KAB-it 2023-2025 për Kuvend;
- Përgatitja e raporteve mujore dhe tremujore(shpenzimet dhe të hyrat) për publikim në Ueb faqen e Komunës;
- Përgatitja e dokumentacionit për bartjen e mjeteve nga viti 2021 për Kuvendin Komunal dhe Ministrinë e Financave;
- Përgatitja e shkresave, kërkesave të ndryshme gjatë kësaj periudhe.

JANAR-DHIETOR 2022 (BUXHET, ALOKIM, SHPENZIM)


Përshkrimi	Pendëte kryera	Buxheti fillestar	Buxheti final	Alokimi	Shpenzimet	Shpenzim Buxhet fillestar %	Shpenzim Buxheti final %	Shpenzim Alokim %
Paga dhe Mëditje		7,872,843.00	7,965,556.29	7,251,148.63	6,986,774.04	88.74	87.71	96.35
Mallra dhe Shërbime	2248	1,735,094.03	1,855,094.03	1,855,094.03	1,789,356.48	103.12	96.45	96.45
Shpenzime Komunale	595	270,000.00	270,000.00	270,000.00	261,092.45	96.70	96.70	96.70

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

Subvencione dhe Transferte	131	360,000.00	360,000.00	360,000.00	308,697.17	85.74	85.74	85.74
Investime Kapitale	279	4,125,816.00	5,993,784.31	5,993,784.31	4,966,450.33	120.375	82.86	82.86
Rezervat (përzbatim i ligjit të pagave)				0.00	0.00			
Donacione			106,054,84.00					
Totali		15,053,659.00	15,703,026.97	15,730,026.97	14,312,370.47	99.64	87.03	90.98

Sqarim: Dallimi ndërmjet buxhetit fillestar dhe final është për arsye të bartjes së mjeteve të mbetura nga viti 2021 në kategorinë e Investimeve kapitale, Donacionet, Grandi Performancës, Alokimi i huamarrjes në Arsim dhe Shëndetësi në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve, Rezervat.

4.1 Paraqitja grafike



Të hyrat vetanake

Të hyrat e përgjithshme vetanake të planifikuara për vitin 2022 janë 1,350,548.00 euro, për këtë periudhë janë realizuar në shumën prej: 1,378,325.84 € apo 102.06 % të planifikimit vjetor.

Sektori i Tatimit në Pronë

- Objekte të reja të regjistruara: 823 ose 156,171 m²;
- Verifikim i pronave ekzistuese: 3,604 ose 608.185 m²;
- Të hyrat e realizuara, janar- dhjetor 2022 - Sektori i Tatimit në Pronë: 442,896.78 € apo 63.08% të planifikimit vjetor (planifikimi vjetor 702,117,00).

Vërejtje: Të gjitha të dhënat e paraqitura janë përgatitur në bazë të raporteve deri më 10.12.2022.

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

Janë zhvilluar aktivitete në të gjitha fushat e veprimtarisë, me qëllim të rritjes së cilësisë të shërbimeve të kujdesit shëndetësor si dhe ngritjes së përgjithshme të cilësisë së jetës së qytetarëve të komunës, përfshirë këtu edhe mbështetjen në fushat e shërbimeve sociale dhe më gjerë. Raport përfshin shërbimet e ofruara në fushën e kujdesit parësor shëndetësor si dhe atë të veprimtarisë sociale, të arritura dhe vështirësitë e hasura gjatë kësaj periudhe kohore.

Aktivitetet në periudhën: janar - dhjetor

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

- DSHMS qysh në fillim të vitit 2022 ka zhvilluar aktivitete të shumta, në kuadër të përgjegjësisë të përkrahur, kemi realizuar gjithë aktivitetet e planifikuara;
- Janë mbështetur projektet në të gjitha fushat e veprimit - shëndetësi dhe mirëqenie sociale si: OJQ-të lokale në vlerë prej: 10,700.00 €, janë përkrahur 2 OJQ (Hendikos -4.800 € dhe Hareja-5.900 €) të cilat kanë ofruar projekte konkrete;
- Është bërë shqyrtimi dhe përgjigja me kohë në kërkesat e ndryshme të qytetarëve, kryesisht për ndihma momentale – financiare, prej të cilave : 153 janë të miratuara dhe 199 të refuzuara;
- Në Rahovec është duke funksionuar shërbimi i ri mjekësor (Ekipi Mobil për Kujdes Shtëpiak), që do të lehtësojë marrjen e trajtimit shëndetësor për të moshuarit dhe ata me sëmundje të rënda, për ata që e kanë të vështirë mobilitetin deri te QKMF-ja apo QMF-të. Një mjek dhe dy infermierë janë në lëvizje për të ofruar shërbime anembanë Rahovecit nga ora 7:00 deri në 21:00, dhe përveç shërbimeve të tjera ekipi mobil po bën edhe testime rapide për COVID-19. Sipas raportit të mjekut janë kryer 320 vizita mjekësore shtëpiake nga ekipi mobil;
- Në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" është funksionalizuar NUMRIN EMERGJENT 080011008. Ky numër do të jetë pa pagesë dhe funksional, 24 orë.
- Në QKMF "Dr.Fahredin Hoti" në Rahovec, është vënë në funksion aparati i mamografisë, i cili shërben për ta identifikuar dhe diagnostifikuar me kohë kancerin e gjirit. Aparati i mamografit vlerësohet të jetë një prej aseteve më me rëndësi për mjekësinë primare, sidomos në aspektin shëndetësor, në parandalimin me kohë të sëmundjes së kancerit të gjirit. Komuna e Rahovecit me një investim si ky, ka investuar direkt në shëndetin e grave-nënave si shtyllë kryesore e familjes dhe mirëqenies së saj;
- Me moton GJAKU I LIRISË në QMF në Krushë të Madhe, u organizua aksioni vullnetar për dhurimin e gjakut, në shenjë nderimi dhe respekti ndaj familjarëve të të rënëve për liri.
- Në ambientet e shkollës "Katër Dëshmorët" në Ratkoc, u bë dhurimi vullnetar i gjakut, për të katërmbëdhjetin vit me radhë. Banorë nga Ratkoci dhe fshatrat përreth iu përgjigjen pozitivisht kësaj thirrjeje e cila u dedikohet atyre që humbën jetën në përballje me virusin vdekjeprurës Covid-19.
- Është marrë Vendim mbi caktimin e kujdestarisë për barnatoret në afërsi të QKMF-së "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec, me qëllim të përmbushjes së nevojave të qytetarëve të komunës së Rahovecit;
- Në dy periudha janë kryer vizita sistematike stomatologjike, nga mjek stomatolog dhe vizita të përgjithshme mjekësore nga mjeku familjar si dhe infermierë - për nxënësit e klasës së I dhe V, ku këto vizita sistematike janë konsideruar si tejet të rëndësishme për shëndetin e fëmijëve-nxënësve tanë;
- Janë evidentuar dhe shpërndarë gjithsej 3922 thirrje - ftesa për vaksinimin e fëmijeve në komunën tonë;
- Ofrimi i kujdesit shëndetësor specialistik për gra dhe fëmijë në QKMF është: 5979;
- Në Çerdhen e Qytetit, "Tulipanët" në Rahovec, kryhen rregullisht vizitat mjekësore - një herë në javë nga pediatri;
- Në muajin dhjetor është themeluar Këshilli i Pacientëve i përbërë nga 5 anëtarë, mandati i anëtarëve të Këshillit të Pacientëve është 3(tre) vjeçar.

Mirëqenia Sociale:

Në kuadër të aktiviteteve nga fusha e mirëqenies sociale janë zhvilluar aktivitetet e parapara nga kjo fushëveprimtari, sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi. Komisionet kanë punuar vazhdimisht në terren për evidentimin e familjeve në kushte të rënda sociale dhe këto nevoja janë adresuar vazhdimisht në Qeverinë e Kosovës, donatorë vendorë dhe të huaj, poashtu, janë kontaktuar shoqata të ndryshme dhe OJQ vendore dhe

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

ndërkombëtare. Pra, është intervenuar në të gjitha rastet që është krijuar mundësia. Qendra për Punë Sociale dhe Organi i Kujdestarisë në kuadër të saj, si organ komunal profesional kompetent për çështje sociale, përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe të rriturve, i përbërë nga një grup ekspertësh, ka ndërmarrë të gjitha veprimet për ofrimin e ndihmës për personat në nevojë sociale, sipas procedurave të caktuara, në përputhje me mandatin ligjor.

DREJTORIA PËR ARSIM

Drejtoria për Arsime gjatë gjithë vitit 2022 ka zhvilluar aktivitete në përputhje me planifikimet e bëra sipas planit vjetor të punës. Në këtë raport janë paraqitur synimet, qëllimet, punët dhe aktivitetet kryesore gjatë gjithë vitit 2022 dhe synimet për vitin e ardhshëm.

Synimet kryesore të DKA-së për vitin 2022 ishin:

- Funksionalizimi i plotë i Aktiveve Profesionale dhe Këshillave Drejtuese në secilën shkollë;
- Riparimet në shkolla dhe investimet në efikasitet të energjisë në objektet shkollore;
- Investime për përfundimin e plotë për ndërtimin e 3 çerdheve për fëmijë;
- Vazhdimi i projekteve për përfundimin e ndërtimit të shkollave të filluara nga vitet e mëparshme;
- Fillimi i ndërtimit të shkollave të reja;
- Furnizimi i shkollave me libra, pajisja me mjete konkretizimi të laboratorike dhe teknologji informative.
- Veprime të duhura për të përmirësuar performancën e sistemit edukativ arsimor në komunën tonë.

Qëllime kryesore gjatë këtij viti, kishim:

- Ngritjen e cilësisë së procesit edukativ-arsimor në shkollat e të gjitha niveleve;
- Përmirësimin e infrastrukturës së brendshme dhe të jashtme të institucioneve edukative arsimore;
- Zhvillimin e aktiviteteve të shumta kurrikulare dhe jashtëkurrikulare;
- Funksionimin sa më të mirë të organeve drejtuese të shkollave;
- Ngritjen dhe zhvillimin profesional të kuadrit arsimor.

Objektivat tona të përhershme, që karakterizuan edhe këtë vit, janë:

- Përmirësimi i nivelit të mësimdhënies dhe të nxënësve në të gjitha shkollat;
- Zvogëlimi deri në minimum i mungesave të pa arsyeshme të nxënësve dhe mësimdhënësve;
- Ndërtimi i objekteve të reja shkollore dhe objekteve parashkollore (çerdheve);
- Riparimet e objekteve shkollore;
- Rregullimi i hapësirave të brendshme dhe të jashtme të shkollave;
- Zhvillimi i aktiviteteve të shumta jashtë kurrikulare në nivel shkolle dhe komune;
- Bashkëpunimi me komunitetin dhe me OJQ-të, aksionet vullnetare;
- Integrimi në procesin edukativ-arsimor i të gjithë fëmijëve të të gjitha komuniteteve pa dallim dhe fëmijëve me nevojë të veçanta arsimore.

AKTIVITETET KRYESORE TË DREJTORISË PËR ARSIM GJATË VITIT 2022

Gjatë gjithë vitit 2022 në kuadër të DKA-së u realizuan aktivitete, të cilat i kemi shkoqitur sipas periudhave tremujore të vitit, siç vijon:

Periudha e parë (Janar- Mars)

Më 10 janar ka filluar procesi mësimor në periudhën e dytë të vitit shkollor. Në Shfmu “31 Marsi” në Guri të Kuq, janë kryer punimet e fundit të riparimit të një pjese të nyjeve sanitare nga kompania e kontraktuar Nga KEDS-i, kemi marrë konfirmimin për Pëlqimin Elektroenergjetik (PEE) për fuqinë e angazhuar të energjisë elektrike për objektin e çerdhes në Krushë të Madhe dhe 2 objekteve të tjera të parashikuara të ndërtohen në të ardhmen. Kemi hapur konkursin për bursa studentore dhe menjëherë ka filluar edhe aplikimi i studentëve. Në çerdhen për fëmijë “Tulipanët” u bë edhe furnizimi me tepihë për dysheme. Kemi vazhduar me organizimin dhe mbajtjen e garave shkollore të vlefshme për Olimpiadën Matematike dhe për Garën Republikane të Fizikanëve të Rinjë. Në koordinim me DKRS dhe Këshillin Organizues u kujdesëm për mbarëvajtjen e aktiviteteve të parapara për manifestimet e Flakës së Janarit. Kemi filluar me përgatitjet për hartimin e Pakos Pedagogjike për klasat 6 deri 12. Gjatë javës së parë të shkurtit, kemi shpërndarë lektyrat dhe librat në bibliotekat e 8 shkollave të komunës sonë. Në shkollën “Vëllezërit Frashëri” në Drenoc dhe në paralelen e ndarë të saj në Senoc ka përfunduar instalimi i kamerave të sigurisë. Më 12 shkurt mbajtëm Garën Komunale të Fizikanëve të Rinj. Për nder të 17 shkurtit – Ditës së Pavarësisë së Kosovës, u organizua dhe u mbajt Kuizi i Diturisë për lëndën e Historisë dhe gara për pikturën më të mirë. Më 19 shkurt, organizuam dhe mbajtëm Garën Komunale të Olimpiadës Matematike. Më 27 shkurt, i dërguam për të marrë pjesë në Garën Republikane të Fizikanëve të Rinj 4 nxënësit fitues nga Gara Komunale. U mbajt manifestimi festiv për shënimin e 7 Marsit – Ditës së Mësuesit dhe Shkollës së parë Shqipe. Kemi përfunduar shpërndarjen e mjeteve të konkretizimit dhe pajisjeve laboratorike në 12 shkolla.

Periudha e dytë (Prill – Qershor)

Kemi filluar përgatitjet për organizimin dhe mbajtjen e Testit Ndërkombëtar PISA dhe përgatitjet për Testin e Arritshmërisë për klasat e nënta. Për nder të 22 prillit – Ditës së Tokës, nxënësit dhe mësimdhënësit i janë bashkuar aksionit vullnetar për pastrim dhe pati një pjesëmarrje masive. Në paralelen e ndarë të shkollës “Rudolf Walther” në Dobidol, janë zhvilluar punime në rregullimin e kanalizimit të objektit të shkollës dhe kycjes së tij me rrjetin kryesor të kanalizimit të fshatit. Në MASHT kemi nënshkruar marrëveshjen për fillimin e zbatimit të projektit “EYE” për themelimin e Qendrës së Karrierës në Shkollën e Mesme Profesionale. Në shkollën Rudolf Walther në Dejnë kemi pranuar një donacion të vlefshëm nga një bashkatdhetar, në vlerë prej 8500€, ku përfshihen 10 Smart Tv, 6 fotokopjues dhe një videoprojektor. Mbajtëm Garën Komunale të diturisë me nxënësit e klasave të 6-a, 10-a dhe 11-a. U mbajt Testi i Arritshmërisë për nxënësit e klasave të IX-ta. Organizuar nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe QKMF, janë zhvilluar vizita sistematike mjekësore në shkollat fillore të komunës sonë. Më 10 qershor përfundoi mësimi për nxënësit e klasave 9, 10 dhe 11. U mbajt Gara Komunale e Diturisë në disa lëndë mësimore me nxënësit e klasave të ndryshme. Më 18 qershor, u mbajt Provimi i Maturës,

Periudha e tretë (Korrik – Shtator)

Ka filluar furnizimi me inventar i 4 objekteve të reja të shkollave. Në javën e parë të korrikut u bë pajisja me inventar i Shfmu “Liria” në Fortesë dhe në Shfmu “Milaim Krasniqi” në Kaznik. Kemi nisur procedurën për projektin e drenazhimit të fushës sportive të jashtme në oborrin e SHML “12 MAJI” në Ratkoc. Kemi përgatitur dhe dërguar 5 kërkesa zyrtare drejtuar MASHTI-t. Kemi nisur procedurën për projektin e ndërtimit të objektit të SHFMU “Hamëz Thaçi” në Xërxë, e poashtu edhe për projektin e riparimit të nyjeve sanitare në Shfmu “Sapniqi” në Sapniq. Në bashkëpunim me grupin punues, kemi përgatitur një raport vlerësues për materialin mësimor për edukim mjedisor dhe riciklim të mbeturinave dhe atë raport vlerësues e kemi dërguar në organizatën JICA si pjesë e projektit të bashkëpunimit tonë, që do të zbatohet në 2 shkolla të komunës sonë. U bë ekzekutimi i bursave për 169 studentët përfitues. Në shkollën fillore “Rilindja” në Çifllak përfunduan punimet në projektin e ndërtimit të parkingut dhe rrethojës së oborrit të shkollës.

Periudha e katërt (Tetor – Dhjetor)

Viti i ri shkollor filloi më 3 tetor, pas pezullimit të grevës nga SBASHK-u dhe BSPK-ja. Pas lidhjes së kontratës për lëndë ngohëse, ka filluar furnizimi i objekteve shkollore me dru dhe pelet. Me Aktivat Profesionale kemi mbajtur takimin e radhës për zgjerimin e Pakos Pedagogjike edhe për klasat e larta (9-12). Është lidhur kontrata për ndërtimin e objektit të ri të Shfmu “Hamëz Thaçi” në Xërxë. Me vënien e gurthemelit, filloi puna në ndërtimin e objektit të ri të SHFMU “Hamëz Thaçi” në Xërxë. Është lidhur kontrata për projektin “Ndërtimi i aneksit të objektit të SHFMU “Katër Dëshmorët” në Ratkoc. Janë zhvilluar vizita sistematike shëndetësore tek nxënësit e klasave të para dhe të pesta të shkollave fillore. Ka përfunduar projekti i rregullimit të fushës sportive në oborrin e shkollës “12 Maji” në Ratkoc. Ka filluar furnizimi me inventar për objektin e ri të shkollës në Retijë. Më 19 nëntor u mbajt Gara Komonale e Olimpiadës Matematike. Pas përfundimit të projektit në oborrin e shkollës “12 Maji” në Ratkoc, u bë përrurimi i fushës sportive. Në prag të festës së 28 Nëntorit, u bë përrurimi i shkollës në Retijë, ndërsa në Shfmu “Katër Dëshmorët” përruam fillimin e punimeve. Gjatë muajit dhjetor rregulluam edhe këndin e lodrave për fëmijë në oborrin e Çerdhes për Fëmijë “TULIPANËT” në qytet. Të hyrat sipas muajve në Çerdhen e Fëmijëve “TULIPANËT” deri në datën e përpilimit të këtij raporti vjetor i kemi paraqitur në tabelën e mëposhtme:

• Synimet kryesore të DKA-së për vitin e ardhshëm janë:

- Funksionalizimi i plotë i 3 çerdheve të reja në Krushë të Madhe, Xërxë dhe Ratkoc;
- Funksionalizimi i plotë i aktivave profesionale (AP) në secilën shkollë;
- Vazhdimi i riparimeve në shkolla dhe investimet në efikasitet të energjisë në objektet shkollore sipas kontratave që burojnë nga Marrëveshjet e Mirëkuptimit me Fondin e Kosovës për Efikasitet të Energjisë;
- Vazhdimi i projekteve për ndërtimin e shkollave të reja të filluara në vitin 2022 ;
- Vazhdimi i furnizimit të shkollave me libra dhe vazhdimin me pajisjen e tyre me mjete konkretizimi, laboratorike dhe teknologji informative.

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

Të hyrat e çerdhes së fëmijëve "TULIPANËT" në Rahovec për vitin 2022:

Muaji	Të hyrat
Janar	3.195.00 €
Shkurt	3,420.00 €
Mars	3,540.00 €
Prill	3,690.00 €
Maj	3,690.00 €
Qershor	3,495.00 €
Korrik	1,035.00 €
Gusht	0.00 €
Shtator	0.00 €
Tetor	3,165.00 €
Nëntor	3,390.00 €
Dhjetor	2,805.00 €
Gjithsej	28,230.00 €

DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM

Aktivitetet në periudhën: janar- dhjetor

- Është bërë regjistrimi i të gjitha subjekteve afariste prej librit kryesor të vitit 2021 dhe regjistrimi në librin e ri të vitit 2022, poashtu, gjatë fillimit të vitit 2022 është bërë edhe kalkulimi i ngarkesave për vitin 2022 në formë elektronike, përpilimi dhe analizimi i ngarkesave të taksës afariste komunale për vitin 2022;
- Gjatë muajit janar, aktivitetet tona kanë qenë kryesisht të karakterit informues, ku janë vizituar projektet që janë realizuar nga Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, në vitin 2021 dhe projekte të tjera që janë në proces;
- Në periudhën janar - dhjetor janë zhvilluar takime të ndryshme ku në kuadër të saj kemi organizuar takim me AZHR-në, janë diskutuar temat e dy projekteve që i kemi në proces me bashkëpunim me Bashkimin Evropian;
- Është bërë shtypja e aktvendimeve për të gjithë bizneset që janë të ngarkuara me taksë afariste komunale ku në bazë të kësaj ne kemi arritur të kemi një rritje të konsiderueshme të të hyrave në taksa afariste komunale;
- Nga ana e Kryetarit, z. Smajl Latifi është nënshkruar marrëveshje e mirëkuptimit me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal (MZHR) për financimin e ndërtimit të sheshit në qendër të qytetit, i cili do të financohet me 80% të mjeteve nga ministria dhe me 20% nga Komuna e Rahovecit. DEZHT, poashtu ka përgatitur aplikacionin për të aplikuar për grante në MZHR, në këtë thirrje, kemi aplikuar me projektin "Ndërtimi i Sheshit në Qendër të Qytetit", ky grant është fituar nga MZHR dhe ka filluar të realizohet në korrik të vitit 2022. Aktualisht në këtë projekt janë përfunduar rreth 70% të punimeve ku deri më tani janë zhvilluar këto punë: janë shtuar pllakat në Shesh dhe në trotuare, është vendosur ndriqimi i ri publik në Qendër, ka përfunduar ngjyrsoja e Shtëpisë së Kulturës "Mensur Zyberaj", është bërë mbjellja e drunjve dekorativ etj.;
- Në muajin mars, është publikuar lista e përfituesve nga Organizata Help, ku 28 aplikantë nga komuna e Rahovecit, të cilët kanë aplikuar për grante në vitin 2021, kanë kaluar fazën e parë të përzgjedhjes.

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

këtë memorandum bashkëpunimi në mes të komunës së Rahovecit dhe Organizatës Gjermane Help komuna e Rahovecit, ka financuar me 15,000 €;

- Agjencia për Zhvillim Rajonal, në kordinim me Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, ka organizur sesion informues, lidhur me skemën e granteve që ka hapur MZHR për bizneset;
- Komuna e Rahovecit më datë: 17 shtator 2022, është ballafaquar me shira të rrëmbyeshëm të cilët shkaktuan dëme të mëdha në amvisëri, ekonomi familjare dhe biznese. Pas tejkalimit të kësaj situate emergjente, më 19 shtator me vendim të kryetarit të komunës z. Smajl Latifi u krijuan 7 komisione për vlerësimin e dëmeve në terren ku gjatë këtyre vizitave në terren u konstatua se dëmet janë të konsiderueshme. Ndër vendbanimet më të prekura ishin: Fshati Ratkoc, Fortesë, Krushë e Madhe, Dejnë, Celinë dhe Sopniq. Këto komisione filluan punën e tyre në teren nga data: 19.09.2022 deri më 30.09.2022 dhe kanë arritur të vizitojnë 330 ekonomi familjare, amvisëri si dhe 10 biznese. Vlera e dëmeve në ekonomi familjare dhe amvisëri të konstatuar nga tri komisionet është: 1,182,619.00€, ndërsa vlera e dëmeve në biznese është: 77,285.01€.
- Inicuar nga USAID zhvilluam takimin e parë këshillues me 28 përfaqësues nga komuniteti i biznesit për themelimin e Këshillit Publiko - Privat, si njëri prej aktiviteteve të rëndësishme që USAID - Qeverisja e Pronës, në bashkëpunim dhe partneritet me komunën e Rahovecit, si pjesë e projektit për qeverisje të mirë të pronës. Ky këshill do të ketë karakter këshilldhënës, do të mbajë takime të rregullta me qëllim të paraqitjes së kërkesave dhe harmonizimit të tyre, artikullimit dhe përkrahjes së sektorit privat, duke shfrytëzuar kornizën ligjore, në mënyrë që sektori privat përmes dialogut të vazhdueshëm me sektorin publik, të krijojë mundësi dhe lehtësira që potenciali ynë dhe resurset tona të përdoren për përparimin e zhvillimit ekonomik lokal.

Ecuria e realizimit të projekteve kapitale

- Në muajin prill të vitit 2022, DEZHT ka finalizuar punimet në tregun ditor në fshatin Ratkoc;
- Te projekti "Shtëpia e të Moshuarve" janë vendosur shtyllat elektrike, është nënshkruar marrëveshja me pronarin e "Restaurantit Bjeshka" për kyqje në trafo, poashtu është bërë shpimi i një pusi në thellësi 200 metra, me qëllim të furnizimit me ujë të këtij projekti;
- Në kuadër të mirëmbajtjes është rifunksionalizuar Shtegu i Ecjes te vendi i quajtur Zhdrella, i cili kishte pësuar dëmtime nga vërshimet si dhe Shtegu i Ecjes në Krushë të Madhe;
- Janë duke vazhduar punimet në projektin: "Rregullimi dhe rrethimi i oborrit te depot e Matrexit" në Xërxë, deri më tani kanë përfunduar rreth 60% të punimeve;
- Janë duke vazhduar punimet në projektin: "Ndërtimi, Restaurimi dhe Meremetimi i Shtëpisë së Verës";

Zyra e regjistrimit të bizneseve

Në Zyrën e Qendrës Komunale për Regjistrimin e Bizneseve (QKRB) janë të regjistruara në protokoll, biznese të reja dhe janë shqyrtuar gjithsej lëndët si në tabelën vijuese;

Nr.	Përshkrimi	Nr.
1	Biznese të reja	118
2	Informata të ndryshme	226
3	Vërtetime individuale	47
4	Shuarje e njësisë	06
5	Shuarje të Biznesit	36

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

6	Njësi e re	10
7	Çertifikatë N.U.I	139
8	Vërtetime biznesi	28
9	Historik Biznesi	01
12.	Informata të ndryshme për palë	75
	TOTAL	686

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1	Planifikimi i të hyrave për vitin 2022	65,000.00€
2	Të hyrat në taksë afariste komunale, periudha janar- 9 dhjetor 2022	105,845.90€
3	Tejkalimi i planit të hyrave në taksa afariste të shprehura në Euro	40,845.90€
4	Tejkalimi i planit të hyrave në taksa afariste të shprehura në %	38.5%

Sektori për Zhvillim

Evidenca e të hyrave dhe ngarkesës së qirasë të lokaleve afariste dhe pronës së paluajtshme të Komunës së Rahovecit sipas bazës së shfrytëzimit si pasuri e paluajtshme komunale me të cilat disponon komuna e Rahovecit, mbahet në mënyrë të rregullt dhe është siç vijon: Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, aktualisht i menaxhon tridhjetë e gjashtë (36) kontrata, nga këto njëzetentjë (21) lokale afariste, dhjetë (10) objekte afariste dhe tre (3) hapësira të jashtme. Poashtu në periudhën janar- dhjetor 2022, pëlqime të punës janë lëshuar gjithsej 88.

Të hyrat nga qiraja për periudhën janar-dhjetor dhe saldoja është paraqitur në tabelën më poshtë:

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1	Planifikimi i të hyrave nga qiratë për vitin 2022	80,300.00€
2	Të hyrat nga qiraja për periudhën janar- dhjetor 2022	84,996.00€
3	Tejkalimi i planit të hyrave në qira të shprehura në %	4,696.00€
4	Tejkalimi i planit të hyrave në qira të shprehura në %	0.5%

Menaxhimi i asteteve komunale

Regjistrimet e aseteve janar - dhjetor 2022

Përshkrimi	Numri i Regjistrimeve	Vlera në Euro
Regjistrimet mbi 1,000.00€-Investimet Kapitale	158	5,979,934.00€
Regjistrimet më pak se 1,000.00€	77	26,975.00€
Totali	235	6,006,909.00€

Sektori i Turizmit

- Janë mbajtur takime me organizatën e UNDP-së në lidhje me projektin për Programin Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 2, ReLOad2, ku Komuna e Rahovecit, është njëra nga komunat e përzgjedhura.
- Mbajtje e kontaktit me organizatën Help-Gjermane me seli në Prishtinë; Informimi nga organizata në fjalë për aplikuesit të cilët kanë arritur të kalojnë në listën e ngushtë të aplikimeve.

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

- Informimi i bizneseve të Komunës së Rahovecit, për sesionin informues për Grante të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal për biznese ekzistuese dhe për ndërmarrësit e rinjë (start-up);
- Pjesëmarrja në sesion informues në bashkëpunim me AZHR-në Jug-Prizren dhe zyrën e projekteve në Rahovec, për grante të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal për biznese ekzistuese dhe për ndërmarrësit e rinjë (start-up);
- Dalja në teren me organizatën Help, për të verifikuar aplikuesit të cilët janë përzgjedhur si përfitues të fazës së parë të projektit.

DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

SEKTORI I URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT

Në vitin 2022, zyrtarët e Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, nga sektori për Urbanizëm dhe Planifikim, janë angazhuar në lehtësimin e procedurave për aplikimin e lejeve të ndërtimit, kërkesave të qytetarëve dhe investitorëve. Në aspektin e planifikimit hapësinor dhe urban, brenda afatit ligjor janë trajtuar kërkesat, janë dhënë kushtet e ndërtimit dhe lejet e ndërtimit për objektet të cilat janë në harmoni me planet urbanistike që janë të miratuara në Kuvendin e Komunës, sipas Planit Zhvillimor Komunal në fuqi.

Në sektorin e Urbanizmit dhe Planifikimit gjatë periudhës janar – dhjetor, janë shqyrtuar:

Kërkesat	Nr	Aprovuar	Refuzuar	Shqyrtuar	Hudhet
Leje ndërtimi	58	46	1	6	4 hudhen 1 anuluar
Leje rrënimi	8	8			
Leje përdorimi	2	1		1	
Leje për ashensor	1		1		
Kushte ndërtimore	74	44	14	5	1 anuluar 10 hudhen
Shkresa	40	39		1	
Pëlqim ndërrim -destinim	69	51	8	6	4
Ankesa	4		4		
Referenca	2	1	1		
Pranim Teknik	1	1			
Gjithsej	259	191	29	19	20

SEKTORI I MJEDISIT

Në kuadër të Sektorit të Mjedisit DUPMM, lëshohen Leje Mjedisore Komunale dhe Leje Ujore Komunale.

Në Sektorin
gjatë
janar –
janë

Kërkesa	Nr	Aprovuar	Refuzuar	Shqyrtuar	Hudhet
Leje mjedisore	17	15	1		1

e Mjedisit,
periudhës
dhjetor
shqyrtuar:

LEGALIZIMI

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

Procesi i aplikimit për legalizim ka përfunduar me 5 shtator, kërkesat të cilat janë paraqitur nga qytetarët do të trajtohen brenda këtij viti.

TOTALI I LËNDËVE TË LEGALIZUARA:	43
TOTALI I LËNDËVE NË LISTË TË PRITJES:	13
TOTALI I LËNDËVE TË CILAT KANË MARRË NJOFTIM PËR PLOTËSIM DOKUMENTACIONI:	7
TOTALI I LËNDËVE NË PROCES:	11

HARTIMI I PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL 2022-2023

Plani Zhvillimor Komunal 2022-2030, është një dokument multisektorial i cili përcakton kahet e zhvillimit të komunës për 8 vitet e ardhshme. Në fillim të dhjetorit ky dokument ka marrë pëlqimin e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për hapjen e shqyrtimit publik. Pas marrjes së pëlqimit nga MMPHI-ja materiali menjëherë është përcjellë për KPF për procedim të mëtejshëm në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Në tremujorin e parë të vitit 2023 pritet të miratohet PZHK – ja. Zbatimi i tij dhe hartimi i planeve të tjera zhvillimore që rrjedhin pas PZHK-së, gradualisht Komunën e vë në një sistem zhvillimor të planifikuar mirë.

HARTIMI I HARTËS ZONALE

Sa i përket, hartimit të Hartës Zonale është pranuar drafti i parë i gjendjes ekzistuese dhe puna është duke vazhduar sipas planit të paraqitur në kontratë.

Ecuria e realizimit të projekteve kapitale

- Janë duke vazhduar punimet në projektin: " Sheshi i Republikës";
- Janë duke vazhduar punimet në projektin: " Ndërtimi i Kompleksit Memorial në fshatin Retijë";
- Janë duke vazhduar punimet në projektin: "Ndërtimi i parqeve në komunën e Rahovecit";
- Projekti "Rregullimi i shtretërve të lumenjve nga Hoça e Madhe, Brestoc, Hoçë e Vogël, Nagac dhe Krushë e Madhe", projekti është investim i MMPH-së, të cilin e realizon komuna e Rahovecit;
- Janë duke vazhduar punimet në projektin: " Objekti i Banimit Social";
- Ndërtimi i shtratit të përroit, në lagjen Kelmendi në Kramovik;
- Është lidhur kontrata për ndërtimin e Sheshit Qendror të Qytetit;
- Është bërë zëvendësimi i drunjve dekorues.
- Trajtimi i përrenjve dhe lumenjve në komunën e Rahovecit (Rimnik, ndërmjet Celinës dhe Krushës së Madhe dhe projekte të tjera sipas kontratës që janë në vazhdim.

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

Aktivitetet në periudhën: janar – dhjetor:

- Janë kryer shumë punë të natyrës së intervenimeve emergjente;
- Kanë vazhduar punën me 3 kompanitë e kontraktuar nga Komuna e Rahovecit, në menaxhimin sa më të mirë të mirëmbajtjes së rrugëve dimërore;
- Gjatë kësaj periudhe me donatorin KFOR-it Italian, kemi përfunduar projektin për vendosjen e paneleve diellore në palestrën sportive" Mizahir Isma";

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

- Kemi filluar punën e përbashkët me Drejtorinë për Punë Inspektuese, për të t'u dhënë zgjidhje të gjitha kërkesave dhe vjelë të hyrat nga shfrytëzimi i hapësirave publike;
- Është bërë pastrimi periodik i deponisë legale të mbeturinave inerte;
- Kanë përfunduar punimet në shtrirjen e rrjetit të ujërave të zeza në dy lagje të fshatit Zaqisht, me gjatësi 350 metra dhe 230 metra;
- Është bërë shpërndarja planifikuar dhe me listë e 2000 kontejnerëve 120 L, ku komuna jonë ka qenë përfituese e grantit të performancës në mjedis të pastër;
- Ndërtimi i trotuarit në fshatin prej Malësisë së Vogël në drejtim të Gexhës, përgjatë rrugës rajonale;
- Është lidhur marrëveshja me KRU "Gjakova", për zgjidhjen e problemit të ujit të pijshëm në fshatrat Vrajkë dhe Bërtatin;
- Është nënshkruar marrëveshja me Ministrinë e Infrastrukturës për rregullimin e rrugëve në qytet;
- Është përfunduar shenjëzimi i rrugës një kahore në rrugën "Ibrahim Rugova" dhe "Xhafer Nurkasa", poashtu është vendosur shtegu për biçiklistë dhe trotuari;
- Është miratuar vendimi në Kuvendin Komunal lidhur me Planin për Menaxhimin e Mbeturinave;
- Pas situatës së krijuar nga vërshimet në komunën tonë, ka pasur disa ndërhyrje në pastrim të rrugëve dhe kanaleve sipas nevojës, njësia e FSK-së, ka bërë ndërhyrje në përroin e fshatit në Fortesë. Vlera e dëmit në infrastrukturë publike nga vërshimet është 550,722.00 euro;
- Gjatë muajit shtator është përfunduar ndriçimi publik në rrugën kryesore Brestoc - Hoçë e Vogël, mbi 2,5 km, poashtu janë zëvendësuar poçat e natriumit me ato led në rrugën "Xhelal Hajda" në Rahovec;
- Janë eliminuar deponitë ilegale në rrugën rajonale Rahovec - Suharekë si dhe në rrugën transite, poashtu janë bërë veprime për mbrojtën e vendeve për mos-hedhjen e tyre;
- Ka përfunduar një segment i rrugës në fshatin Nagac si dhe ndërtimi i një pjese të trotuarit;
- Ka përfunduar projekti i ndërtimit të rrugëve lokale të komuniteteve në Lagjen e Epërme dhe këndi i lojërave, i cili është bashkëfinancim me MAPL. Pjesa e grantit është financuar me 40,000.00 euro;
- Kanë filluar procedurat për dhënien e ankandit për deponinë legale të mbetjeve inerte;
- Në projektin e rrugës 4 korsi ka përfunduar shtresa e dytë e asfaltit në rrugën 3 shiritore si pjesë e projektit të rrugës 4 korsi nga kompania Mendi-P, kompania Euroasfalt ka filluar punën në vendosjen e kanalizimit të ujërave të zeza dhe atyre atmosferike;
- Është lidhur kontrata për rrugët në qytet, sipas planit pritët të fillon puna shpejt, në rrugën "Fahredin Hoxha" dhe "Ali Sokoli";
- Janë duke vazhduar punimet në përroin e fshatit Sapniq.

STATISTIKA

- Ndërtimi i rrugëve;
- Ndërtimi i trotareve;
- Ndriçimi publik;
- Rrjeti i ujërave të zeza;
- Rrjeti i ujërave atmosferik;
- Mirëmbajtja e hapësirave publike;
- Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuarëve.

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

Ndërtimi i rrugëve lokale: në vitin 2022, ka pasur aktivitete në këto vendbanime (Rahovec, Brestoc, Retijë e Ulët, Nagac, Krushë e Madhe, Celinë, Xërxë, Sapniq, Pataqan i Poshtëm, Drenoc), sipas projektit LOT 1, 2, 3 janë përfunduar 34 rrugë me gjatësi 6589 metra (12589 m² elemente betoni);

Rrjeti i kanalizimeve: në vitin 2022, të kryera punë në gjatësi 1653 metra (me diametër Fi 250 dhe 315), në Drenoc 343 metra, Rahovec 200 metra, Xërxë 200 metra, Kramavik 140 metra, Nagac 200 metra, Zaqisht 570 metra.

Projekti i ndërtimit të 6 segmenteve rrugore në qytetin e Rahovecit, përfshin; 4240 metra kanalizim (Fi 630,400,315 dhe 250 fekal dhe atmosferik) si dhe 5526 metra rrugë të asfaltuar, projekt i kontraktuar në nëntor të vitit 2022;

Projekti i ndriçimit publik: Janë përfunduar 2.5 km ndriçim në fshatrat Hoçë e Vogël dhe Brestoc, jemi në proces të digjitalizimit të rrjetit të ndriçimit publik (total janë të mbuluara me ndriçim publik 23 vendbanime, kanë mbetur edhe 9 për të përfunduar në tërësi), janë gjithsej 4273 poça, pra në total 128 km rrugë të ndriçuara.

Mirëmbajtja e rrugëve gjate dy sezonave (pastrimi borës dhe larja e rrugëve gjate verës), përfshin 3 lote, sipas kontratës: Lot 1 ka 71 km rrugë, Lot 2 ka 192 km rrugë si dhe Lot 3 ka 68 km rrugë - në total 338 km rrugë të mirëmbajtura;

Mure mbrojtëse: 47 metra në Lagje të Qytetit, në rr. "Sabit Shabandula" dhe Lagjen Vuçitërna;

Ndërtimi i trotuareve: Rr. Tafil Zyberaj 910 m, Malësi - Gexhë 600 m, Pastasel 1550 m, Senoc, 1500 m, Drenoc 1300 m, Krushë e Madhe dhe Nagac 700 m. Gjithsej, 6550 metra gjatësi.

KËRKESAT DHE TË HYRAT NË DSHP GJATË VITIT 2022:

Në DSHP anë adresuar mbi 320 kërkesa të ndryshme, ku 216 janë të apovuara, 86 të refuzuara, 9 kanë qenë në proces, 6 të anuluar, 1 e pranuar dhe 2 janë pezulluar. Të tjerat kanë të bëjnë me investimet publike nga operatorë të ndryshëm.

DSHP gjatë vitit fiskal 2022, ka pasur të planifikuara 12,500.00 euro nga taksat, vazhdimi i lejeve, shfrytëzimi i pronës publike, qiraja nga objektet e përkohshme, qiraja në objekte publike si dhe të hyra të tjera. Deri në muajin nëntor 2022 janë mbledhur 9,369.85 euro (duke përfshirë muajin dhjetor 2022).

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Aktivitetet kryesore në periudhën: janar-dhjetor 2022

- Pranimi i aplikacioneve për subvencionim të qumështit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2021 dhe gjashtëmujorin e parë 2022;
- Përgatitjet rreth funksionalizimit të zyrave në dy qendrat më të mëdha të komunës sonë për aplikim të fermerëve, atë në Ratkoc dhe Krushë e Madhe;
- Planin Zhvillimor Komunal, 2022 – 2029;
- Planin e Vlerësimit të Rrezikut;
- Takim me fermerë për sigurimet bujqësore për produktet e primekulturës, vreshtarisë, pemëtarisë;
- Aplikimi për Pagesat direkt-subvencionet;
- Përcjellja e projekteve kapitale;
- Shpërndarje të Mekanizmave Bujqësor;
- Korrije-Shirjet;
- Festa e Vjeljes së Rrushit - Hardhfest ;
- Dëmet nga fatkeqësitë natyrore;
- Ndërtimi i objektit - Depo Bujqësore;

- Vizitat në ferma blegtorale etj.

Gjashtëmujori i parë: janar- qershor

Ashtu siç e kemi paraparë me planin vjetor të punës, pranimi i aplikacioneve për subvencionim të qumështit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2021 për fermerët blegtorë (MBPZHR), hap thirrjen për aplikim, Drejtoria e BPZHR-së pranon aplikacionet dhe të njëjtat i dorëzon në Ministri për pagesë. Kjo thirrje ka qenë e hapur nga: 21 janar deri më 11 shkurt 2022. Në këtë periudhë, gjithsej kanë aplikuar: 81 fermerë me sasi totale të qumështit të dorëzuar 1,9 milion litra.

Kemi mbajtur kontakte të vazhdueshme me zyrtarët e AZHB-së lidhur me aplikacionet dhe plotësimin e tyre për aplikimet e vitit 2021. Shumë fermerë kanë pasur probleme me llogari bankare, ku është kërkuar nga ne t'i ndryshojmë, në mënyrë që të realizojnë pagesat e tyre.

- Kemi kryer të gjitha përgatitjet rreth funksionalizimit të zyrave në dy qendrat më të mëdha të komunës sonë për aplikim të fermerëve, në Ratkoc dhe Krushë e Madhe. Me kohë jemi pajisur me qasjet e nevojshme në të gjithë softwerët që janë të lidhur me plotësim të dokumenteve që kërkojnë nga MBPZHR. E gjithë kjo me të vetmin qëllim për të ju lehtësuar fermerëve të komunës sonë këtë proces.
- Duke u bazuar në kërkesat e fermerëve për marrje të tokave bujqësore me qera për qëllime bujqësore, kërkesat e fermerëve janë proceduar në Kuvend të Komunës për miratim, që këto parcela të jepen në shfrytëzim, e më pastaj të jepen në shfrytëzim me Ankand Publik, duke respektuar të gjitha procedurat sipas ligjit për dhënie të tokave bujqësore komunale me qera.
- Gjatë muajit shkurt kemi shqyrtuar Planin Zhvillimor Komunal 2022 – 2030 dhe kemi bërë komentet shtesë të nevojshme nga ana statistikore.
- Kemi shqyrtuar Planin e Vlerësimit të Rrezikut për komunën e Rahovecit, ku kemi plotësuar parametrat e caktuara në kuadër të DBPZHR, si dhe përgatitjen e skenarëve të mundshëm, si: fatkeqësitë nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore nga breshëri, vërshimet e faktorë të tjerë.
- Në shkurt, kemi zhvilluar takime të ndryshme të organizuar nga MBPZHR në lidhje me Pagesat Direkt – Subvencionet, takime për skemën e granteve, takime me Entin e Vreshtarisë etj.
- Në muajin mars kemi zhvilluar takim me përfaqësuesit e IFC –së, anëtare të grupit të Bankës Botërore, ku pjesë e këtij takimi ishte diskutimi dhe informimi për sigurimet bujqësore për produktet e perimekulturës, vreshtarisë, pemëtarisë, me pjesëmarrje ishin dhjetra fermerë të interesuar për të siguruar produktet bujqësore. Komuna e Rahovecit, mori përsipër të mbulojë 15% të primit të sigurimit të produkteve bujqësore.
- Në periudhën janar - qershor, në kuadër të drejtorisë së BPZHR-së, kemi shqyrtuar kërkesat e qytetarëve për dhënie të pëlqimit apo ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, për qëllime bujqësore.
- Aktivitete të tjera të cilat e karakterizojnë DBPZHR-në janë: pranim dhe përgjigje ndaj kërkesave të ndryshme nga qytetarët, shërbimet e tjera si: vërtetim për prodhues bujqësorë, NIF, ndërrim i destinimit të tokës bujqësore, vlerësim të dëmeve të shkaktuara në sektorin e bujqësisë, si dhe barazimi mujor i të hyrave me Drejtorinë e Financave për muajt janar, shkurt dhe mars etj.

Pagesat Direkte – Subvencionet

Pas hapjes së thirrjes për aplikim nga ana e MBPZHR-së, jemi mobilizuar me kapacitete të plota, si me staf poashtu edhe me mjete logjistike duke e ditur se komuna jonë ka numrin më të madh në nivel vendi (rreth 3,000).

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

Prandaj jemi angazhuar ashtu sikurse edhe vitet e kaluara që fermerët e disa vendbanimeve të mos krijojnë fluks të madh në zyrat e DBPZHR-së në Rahovec, por aplikimin të kenë mundësi ta kryejnë edhe në dy qendra, Krushë e Madhe dhe Ratkoc. Numri total i fermerëve që kanë aplikuar për vitin 2022 është **2,978**, ku krahasuar me vitin 2021 kemi 71 aplikacione më shumë. Pas përfundimit të procesit të aplikimit, zyrtarët e angazhuar e kanë bërë kontrollimin e secilës dosje dhe të njëjtat janë dorëzuar në AZHB (Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë).


Sikurse në vitet e kaluara pas përfundimit të procesit dhe dorëzimit të aplikacioneve në AZHB, në kuadër të drejtorisë së Bujqësisë bëhet regjistrimi i të dhënave të fermerëve që kanë aplikuar për secilën kulturë bujqësore. Këto të dhëna mëpastaj përlllogariten, analizohen dhe krahasohen me vitet paraprake.

Në tabelat dhe grafikonet më poshtë janë paraqitur të dhënat sipas sektorëve të shprehura në sipërfaqe (ha) si dhe në vlera monetare (€) që nënkupton, se komuna e Rahovecit do të përfitoj mbi 5,4 milionë euro në vitin 2022.

Tabela 1. Të dhënat e sektorëve të shprehura në sipërfaqe sipas viteve


VITET			2020	2021	2022	Diferenca
Sektorët	Lloji	Nj. Matëse				
Sektori i Lavëtarisë	Drithërat	Ha	3,586.00	2,019.81	3,711.24	1,691.43
	Grurë - KG	Kg	0.00	3,585,232.00	0.00	N/A
Sektori i Vreshtarisë	Rrush	Ha	2,406.61	2,342.53	2,322.21	-20.32
	Verë	Litër	5,577,789.96	8,689,227.29	7,274,876.45	-1,414,350.84
	Fidane të hardhisë	Cope	148,000.00	248,000.00	149,900.00	-98,100.00
Sektori i Perimkulturës	Perime	Ha	1,438.64	1,113.94	1,213.94	100.00
	Kungullore	Ha	600.50	457.85	579.58	121.73
Sektori i Pemtarisë			95.92	130.28	165.23	34.95
Sektori i Blegtorisë dhe shpezëtarisë	Bletë	Koshere	6,802.00	5,577.00	4,245.00	-1,332.00
	Lopë	Krerë	2,598.00	2,335.00	1,938.00	-397.00
	Dhi	Krerë	834.00	864.00	248.00	-616.00
	Dele	Krerë	8,886.00	8,142.00	7,226.00	-916.00
	Pula vojse	Cope	74,300.00	43,360.00	59,100.00	15,740.00
Bimë Mjekësore dhe Aromatike	BMA	Ha	14.84	14.52	16.51	1.99
Perime ne Serra	Perime të ndryshme	Ha	16.50	18.70	24.26	5.56

Vlera në € e përfituar ndër vite



Grafiku 1. Përfitimi i fermerëve të komunës për vitet 2020, 2021 dhe 2022

Nga të dhënat e kësaj table mund të vërejmë një rritje të sipërfaqeve në sektorin e lavëtarisë ku krahasuar me vitin 2021 kemi rreth 1600 ha më shumë sipërfaqe të mbjellura (viti 2021: 2,019.81 ha kurse viti 2022: 3711.24 ha), ku konkretisht ndryshimi më i madh është te kultura e grurit (viti 2021: 1,041 ha kurse në vitin 2022: 2,006.11 ha).



Rritje në deklarim kemi edhe te pulat vojse, ku krahasuar me vitin e kaluar këtë vit kemi për 15,740 më shumë.

Për dallim nga sektori i lavërtarisë që kishte ndryshim pozitiv me vitin e kaluar, sektori i blegtorisë, shpezëtarisë dhe bletarisë ka pësuar rënie në numër si psh: këtë vit kemi për 1,362 më pak koshere të bletëve. Poashtu rënie vërehet edhe te lopët qumështore, delet dhe dhitë.




Tabela 2. Të dhënat e shprehura në vlera monetare (€)

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

VITET		2020	2021	2022	Diferenca
Sektorët		Vlera në €	Vlera në €	Vlera në €	Vlera në €
Sektori i Lavërtarisë	Dritherat	537,900.00 €	224,847.00 €	1,255,391.96 €	1,030,544.96 €
	Grurë - KG	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
Sektori i Vreshtarisë	Rrush	2,406,610.00 €	1,952,118.00 €	2,447,609.34 €	495,491.34 €
	Verë	223,111.60 €	347,569.09 €	290,995.06 €	-56,574.03 €
	Fidane të hardhisë	14,800.00 €	24,800.00 €	22,485.00 €	-2,315.00 €
Sektori i Perimkulturës	Perime	431,592.00 €	445,576.00 €	689,203.76 €	243,627.76 €
	Kungullore	180,150.00 €	183,140.00 €	210,956.32 €	27,816.32 €
Sektori i Pentarisë		38,368.00 €	52,112.00 €	74,353.50 €	22,241.50 €
Sektori i Blegtorisë dhe shpezëtarisë	Bletë	102,030.00 €	83,655.00 €	84,900.00 €	1,245.00 €
	Lopë	233,820.00 €	198,475.00 €	174,420.00 €	-24,055.00 €
	Dhi	16,680.00 €	17,280.00 €	6,200.00 €	-11,080.00 €
	Dele	177,720.00 €	162,840.00 €	180,650.00 €	17,810.00 €
	Pula	37,150.00 €	21,680.00 €	27,339.66 €	5,659.66 €
Bimë Mjekësore dhe Aromatike – BMA		7,420.00 €	6,534.00 €	7,429.50 €	895.50 €
Perime ne Serra		7,420.00 €	7,260.00 €	21,931.04 €	14,671.04 €
Gjithsej		4,407,351.60 €	3,720,626.09 €	5,423,440.68 €	1,765,979.05 €

Të dhënat e kësaj tablele tregojnë për vlerën monenetare që fermerët e komunës sonë do të marrin nga programi i pagesave direkte për vitin 2022. Për dallim nga viti i kaluar këtë vit pritjet që të kemi rritje të shumës së përgjithshme prej 1,765,979€. Sektori që ka ndikuar në këtë rritje është në sektorin e lavërtarisë, ku krahasuar me vitin e kaluar këtë vit fermerët kultivues të drithërave do të përfitojnë mbi 1,000,000€ më shumë e poashtu edhe sektori i vreshtarisë do të ketë rritje rreth 500,000€. Diferencën negative mund ta vërejmë te sektori i verëtarisë, ku krahasuar me vitin e kaluar verëtarët e Rahovecit do të përfitojnë 56,574€ më pak. Përfundimisht nuk bënë edhe sektori i blegtorisë ku duke u bazuar në këtë tabelë vërejmë vlerat negative.

PROJEKTET E INVESTIMEVE KAPITALE

Në kuadër të programit për zhvillimin e bujqësisë në komunën e Rahovecit janë duke u zbatuar një numër i konsiderueshëm i projekteve kapitale që kanë ndikim në përmirësimin e kushteve të bujqëve si në infrastrukturë publike (Kanale të Kullimit, Rrugë fushore etj) dhe në përkrahje direkte për bujq (Mekanizëm Bujqësor, ndërtimi i serrave, ndërtimi i komoreve).

Mekanizëm Bujqësor

Komuna e Rahovecit si Autoritet Kontraktues me datë: 22.03.2022 ka nënshkruar kontratat me OE të ndarë në LOT-e, në Tenderët për furnizim me Mekanizëm Bujqësor në Komunën e Rahovecit.

Nga data 30.03.2022 kemi filluar të nënshkruajmë kontratat me secilin fermer përfitues, pasi që ai paraprakisht e ka kryer edhe pjesën e pagesës prej 20% të vlerës së pajisjes. Fillimisht janë kryer participimet e fermerëve përfitues nga viti 2020.

Me datë 07.04.2022 kemi filluar me shpërndarjen e pajisjeve bujqësore te fermerët përfitues varësisht se si Operatorët Ekonomik po arrijnë ta furnizojnë komunën e Rahovecit.

Tabela 3. Llojet dhe data e pajisjeve bujqësore të shpërndara te fermerët

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

Data e	Përshkrimi i mekanizmit përfitues	Numri i fermerëve
06.04.2022	Motokultivator	291
22.04.2022	Mbjellëse e misrit pneumatike	10
	Pllugë 775	7
	Motokultivator	20
16.06.2022	Centrifugë për mjaltë	22
	Shkrirëse dylli me avull	16
Gjithsej		366

Ndërtimi dhe Mirëmbajtja e Rrugëve Fushore

Në projektin për rregullimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve fushore, është duke u punuar në LOT 2 në vendbanimet Kramovik, Dobidol, Çifllak, Bratotinë, Vrajakë. Në Lot 4 kemi intervenuar në disa pozicione nëpër vendbanime të komunës sonë si në Senoc, Krushë e Madhe, Rahovec, ndërsa Lot 1 dhe Lot 3 nuk janë zhvilluar punime si rezultat i rritjes së çmimeve nga fillimi i këtij viti.

Ndërtimi i Kanaleve të Kullimit të Tokave Bujqësore

Projekti i "Kanalet e Kullimit të Tokave Bujqësore", poashtu përshkak të kushteve klimatike jo të përshtatshme nuk është punuar, pasi që në këtë periudhë të vitit, prurjet e ujit janë shumë të mëdha dhe realizimi i projekteve është i vështirë. Gjatë muajit qershor kanë rifilluar punimet në ndërtimin e kanalit të kullimit të tokave bujqësore nga Shtavica deri në Fortesë si dhe në projektin e Kanalit të kullimit në fshatin Ratkoc.

Gjashtëmujori i dytë: korrik- dhjetor 2022

- Kemi formuar shtabin për korrije-shirje 2022. Poashtu është hartuar raport përfundimtar i cili është dorëzuar në MBPZHR.
- Në kuadër të programit të pagesave direkt, kemi pranuar dëshminë e sasisë së kilogramëve të grurit të dorëzuar në Qendrat Grumbulluese dhe Silose. Këto dëshmi janë dorëzuar në Ministrin e BPZHR-së për Subvencionim me 0,03€/kg. Afati për pranim të këtyre dëshmive ka qenë deri më 2 shtator.
- Në datën 20 korrik është hapur thirrja për aplikim për subvencione për qumësht/litër, sipas kategorive të cilësisë, therrjet e raportuara të gjedhit, viçat për majmëri dhe akuakulturë për gjashtëmujorin e parë 2022. Thirrja ka qenë e hapur deri më 19 gusht 2022. Ku gjatë kësaj periudhe janë kryer aplikimet e fermerëve të komunës sonë. Fermer aplikues janë 91, prej tyre 82 fermer blegtor për litrazhë të qumështit me gjithsej 2,149,382 litra dhe 20 fermer aplikues për viça me gjithsej 362 krerë.
- Gjatë muajit korrik është mbajtur sesion informues në skemën e granteve, takimi është mbajtur në sallën e kuvendit ku janë prezentuar masat 1, 3 dhe 7, për fermerët që kishin interesim të aplikojnë.
- Kemi mbajtur kontakte të vazhdueshme me zyrtarët e AZHB-së lidhur me aplikacionet dhe plotësimin e tyre për aplikimet e vitit 2022. Vazhdimisht kemi pranuar lista të fermerëve që nevojitet plotësim në kontrollin administrativ. Zyrtarët e bujqësisë i kanë kontaktuar fermerët, i kanë plotësuar dokumentet dhe të njëjtat i kanë dorëzuar në Ministri.
- Fillimi i muajit shtator është karakterizuar me dorëzimin e dëshmive të sasisë së grurit të dorëzuar në silose dhe qendra grumbulluese, pasi që afati i fundit për aplikim ka qenë deri më 2 shtator.
- Gjatë muajit nëntor është hapur thirrja për shpërndarje të subvencioneve së bashku me DEZHT-në. Qëllimi i kësaj thirrje publike ishte përkrahja financiare për përpunuesit e pemëve dhe perimeve, që bëjnë përgatitjen, ruajtjen dhe konservimin e tyre, duke nxjerrë nënproduktet si: turshitë, ajvari, reçeli etj. Poashtu, është publikuar edhe lista e përfituesve të subvencioneve.

Mekanizëm Bujqësor

- Edhe në gjashtëmujorin e dytë kemi publikuar lista të fermerëve përfitues të mekanizmit bujqësor. Janë nënshkruar kontratat me secilin fermer dhe është kryer edhe pjesa e participimit prej 20%, dhe është bërë shpërndarja e mekanizmave. Poashtu, fermerët që kanë aplikuar dhe nuk kanë qenë përfitues kanë pasur të drejtë për ankesë dhe janë shqyrtuar ankesat nga komisionet.
- Në tabelën e mëposhtme janë të dhënat më të sakta, pra data e shpërndarjes si dhe numri i mekanizmave.

Data e shpërndarjes përfitues	Përshkrimi i mekanizmit përfitues	Numri i fermerëve
08.07.2022	Spërkatëse 500L	54
	Mbjellëse misri	3
	Motokultivator me frezë	25
09.08.2022	Motokultivator me frezë	27
	Roto Kosa	9
09.09.2022	Grabuja me traka me kardan	1
	Spërkatëse 500 L	3
	Motokultivator	6
	Rrotokosa	7
20.09.2022	Freza 1.6 m	12
	Freza 1.8m	56
	Mulqere për Hardhi	8
Gjithsej		211

HARDHFEST 2022

Në korrik është hapur thirrja për OJQ - të për aplikim rreth organizimit të "Festës së vjeljes së rrushit - 7 shtatori – Hardhfest". Pas përfundimit të thirrjes, komisioni i formuar me vendim të kryetarit ka bërë përzgjedhjen e OJQ-së fituese me të cilën kemi bashkëpunuar ngushtë rreth organizimit të kësaj ngjarjeje të madhe, e të mbajtur në datat 2,3,4 shtator, ku janë zhvilluar aktivitete të llojeve të ndryshme.

Dëmet nga fatkeqësitë natyrore

Në fund të muajit gusht për shkak të kushteve të këqija atmosferike, pra kryesisht breshrit, në vendbanimet Ujz, Fshej, Gexhë, Malësi e Vogël..., fermerët e komunës sonë kanë pësuar dëme në prodhimet bujqësore. Është formuar komisioni për vlerësimin e dëmeve në bujqësi, sipas kërkesës me nr. Të Prot. 2925, të datës 15.08.'22, dhe në fund është hartuar raporti për dëmet e shkaktuara. Shuma e dëmeve të shkaktuara nga breshri është rreth **261,584.82 €**. Në mesin e muajit shtator, për shkak të kushteve jo të mira atmosferike, kryesisht shiut dhe vërshimeve, me datë 17.09.22, janë shkaktuar dëme në prodhimet bujqësore, si: në specat, lakra, kunguj, misër etj., ku më 19. 9.2022 janë formuar tre komisione, me numrat e protokollit: 2717, 2718, 2719 për vlerësimin e dëmeve në bujqësi, për të verifikuar dhe vlerësuar dëmet që u janë shkaktuar bujqëve. Anëtarët e këtyre komisioneve janë angazhuar në afat rekord për hartimin e një raporti profesional, ku së bashku me kërkesën i'u kemi drejtuar Qeverisë së Republikës së Kosovës për kompensim të këtyre dëmeve. Nga të dhënat e grumbulluara, të analizuara dhe të përlogaritura del se vlera totale e dëmeve është **1 milion e 735 mijë euro**.

Nr.	Kultura	Vlera në €
-----	---------	------------

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

1	Dëmet në sektorin e perime-kulturës	1,692,169.05 €
2	Dëmet në sektorin e lavëtarisë	15,086.50 €
3	Dëmet në ushqimin e bagëtive të deponuar	9,696.00 €
4	Dëmet në infrastrukturën bujqësore	8,397.20 €
5	Dëmet në produkte të gatshme	7,202.90 €
6	Dëmet në sektorin e shpezëtarisë dhe bletarisë	3,300.00 €
TOTAL		1,735,851.65

Depoja Bujqësore – Qendra për Magazinimin e Prodhimeve Bujqësore

Në datën 04.11.2022 është vendos gurmeheli i ndërtimit të Qendrës për Magazinimin dhe Ruajtjen e Prodhimeve Bujqësore (DEPOSË BUJQËSORE), me kushte dhe standarde bashkëkohore e që do të ketë 7 njësi (7 dhoma ftohëse), ku 3 prej tyre do të jenë edhe për ngrirje të thellë dhe energjia për to do të sigurohet edhe nga panelet diellore. Padyshim se kjo do t'u shërbejë bujqve tanë që t'i ruajnë të freskëta prodhimet e tyre për një periudhë të caktuar.

Ky është projekti i parë i kësaj natyre dhe besojmë që do të jetë shumë i dobishëm për bujqit e komunës sonë.

Vizitat në Ferma

Nga veterinari i komunës janë vizituar fermat në fshatra të ndryshme, e që janë duke vazhduar deri sa të kontrollohen të gjitha fermat e regjistruara.

Projektet Kapitale

Rregullimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore: Në projektin për rregullimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve fushore, janë zhvilluar punimet në LOT 2, në vendbanimet: Kramovik, Dobidol, Çifllak, Polluzhë, Gur i Kuq.

Në Lot 4 - kemi intervenuar në disa pozicione nëpër vendbanime të komunës sonë, ndërsa Lot 1 dhe Lot 3, nuk janë zhvilluar punime.

Kanalet e kullimit të tokave bujqësore: OE që kanë kontratë me komunën e Rahovecit për projektin "Kanalet e Kullimit të Tokave Bujqësore", janë rikthyer në punishte duke zbatuar kontratën. Punimet janë zhvilluar në segmentin: Shtavica-Fortesë, segmentin në fshatin Çifllak dhe segmenti në mes të fshatrave Fortesë – Celinë.

Tabela e mekanizmave të planifikuar për shpërndarje dhe realizimi i shpërndarjes për vitin 2022

Përshkrimi i mekanizmit	Planifikimi	Realizimi	Përqindja e realizimit
Motokultivator	400	317	79.25
Motokultivator me frezë	50	52	104.00
Mbjellëse e misrit pneumatike	10	13	130.00
Pllug 775	50	7	14.00
Spërkatëse 500L	150	57	38.00
Centrifugë për mjaltë	30	22	73.33
Shkrirëse dylli me avull	20	16	80.00

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

Rrotokosa 135	20	16	80.00
Freza 1.6m	25	12	48.00
Freza 1.8 m	100	56	56.00
Mulqere për Hardhi	50	8	16.00
Grabuja me traka me kardan 2.0m	20	1	5.00

DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

Gjatë periudhës janar- dhjetor për të cilën po raportojmë, të tre sektorët e Drejtorisë i kanë përfunduar këto punë:

Sektori:	Lëndët:	Shuma €
Kadastër dhe Pronë	1224	30,420 €
Gjeodezi	1,920	25,700 €
Referenti	3,018+140 L.Z.	16,740 €
Totali	6,274+140 L.Z.	72,860 €

Aktivitetet:

- Pranimi i aplikacioneve të qytetarëve dhe të gjeodetëve privat për ndarje të parcelave, bashkim të parcelave, regjistrim i pjesës së ndarjes, regjistrim të hipotekave, çregjistrim të hipotekave, shitblerje, trashëgimi, falje, ndërrim i paluajtshmërisë, ndarje e bashkësisë familjare etj;
- Kërkesa për certifikatat e pronës dhe kopje plani;
- Pranimi i lëndëve për ndarje fizike, produkte si: koordinata, modifikime dhe punë tjera, të cilat janë kryer nga sektori i gjeodetëve;
- Përgjigje në kërkesat e përfaqësuesit ligjor të Komunës në lidhje me shënimet sipas lëndëve në procedurë gjyqësore dhe padive;
- Me kërkesë të qytetarëve për shpronësim të pronës private - rrugë e kalueshme në terren, ZK Rahovec kemi dalë në terren me gjeodetë dhe kemi përgatitur historiate të parcelave në fjalë;
- Sipas afatit, lëndët i kemi pranuar dhe miratuar me kohë në intranet. Gjatë javës së dytë të muajit janar, kemi pranuar dy kërkesa për fajle të pronës private në pronë publike për hapje të rrugës, gjeodetët kanë dalë në terren, janë kufizuar parcelat në fjalë dhe janë marr deklarata nga palët për falje të pronës;
- Kemi evidentuar të gjitha pronat që janë në territorin e komunës së Rahovecit, e që janë në menaxhim të AKP-së dhe kemi përgatitur një raport të detajuar për secilën parcelë, zonë dhe sipërfaqe të pronave;
- Kemi publikuar në afat ligjor listën e përgjithshme të pronave dhe listën e veçantë të pronave, të cilat planifikojmë për dhënie me qira për vitin 2023;
- Kemi mbajtur takimet e rregullta me Agjencinë Kadastrale të Kosovës;
- Përgjigje në kërkesat e zyrës ligjore, sipas nevojës;
- Kemi pranuar kërkesa nga këshillat e fshatrave për kufizime të rrugëve, varrezave, pronave publike dhe parcelave të tjera si në: ZK Guri i Kuq, Senoc, Rahovec etj. Një punëtor administrativ nga sektori i kadastrit e kemi bartur në zyrë në katin e parë të administratës dhe tashmë ofrohen produktet për qytetarë si: certifikatat e pronës, evidentimi i parcelave dhe shërbime tjera;
- Me kërkesë nga drejtoria e arsimit, kemi dalë në terren me gjeodetë dhe kemi kufizuar parcelën në ZK Rahovec, kemi përgatitur dokumente si: situacionin e terrenit, certifikatën e pronës dhe kopjen e planit për parcelën ku është planifikohet të ndërtohet çerdhja e fëmijëve;
- Kemi përfunduar evidentimin e pronave në nivel komune, e që menaxhohen nga Agjencioni Pyjor i Kosovës.

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

- Sipas planit të Kuvendit Komunal, kemi përgatitur material të nevojshëm për Komitetin për Politikë dhe Financa;
- Kemi përgatitur një raport detal me pronat komunale, në 34 zona kadastrale;
- Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, ka përfunduar raportin detal me prona të uzurpuara publike në 34 Zona Kadastrale, në nivel të Komunës;
- Me kërkesën tone, kemi nënshkruar marrëveshje me AKK-në në Prishtinë në lidhje me shërbimet e Koposit;
- Kemi pritur në takim përfaqësues të AKK-së, ku Kryetari i Komunës z. Latifi ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi për sistemin e adresave, REGIP;
- Me kërkesë të Drejtorisë së Ekonomisë, kemi parcelizuar zonën ekonomike;
- Kemi përfunduar të gjitha lëndët e legalizimit, sipas afateve ligjore;
- Miratimi i kërkesave për falje të pronës private për hapje të rrugve në nivel të komunës;
- Kemi përgatitur shkresa zyrtare për Agjencionin Kosovar të Privatizimit, që t'i heq nga shitja asetet të cilat janë në interes të përgjithshëm të komunës dhe u jemi drejtuar ministrive përkatëse për fillimin e procedurave për shpronësim të parcelave me interes të përgjithshëm;
- Me kërkesë të zyrtarëve të paraburgimit të Prizrenit dhe Istogut, kemi dalë në terren dhe kemi evidentuar nga afër parcelat të përshtatshme për ndërtimin e objekteve të nevojshme për institucionin në fjalë, në tri zona kadastrale;
- Kryetari i Komunës z. Latifi, ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me përfaqësues të USAID-it për menaxhim të pronës, ku është formuar edhe Komiteti për Politikën e Mira për Menaxhimin e Pronës ndërmjet pesë komunave përfituese nga projekti në fjalë, AKK-ja dhe ministrinë përkatëse;
- Në bashkëpunim me AKK-në i kemi kryer të gjitha punët, sa i përket nxjerrjes së certifikatës së pronës edhe në EKIOSK.

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Aktivitetet në periudhën janar – dhjetor:

- Homazhe përkujtimore për nder të “Flaka e Janarit” me datë 27.01.2022 në Celinë, Krushë të Madhe, Nagavc dhe Hoçë të vogël. Manifestimi përkujtimor është përmbyllur me ceremoninë përkujtimore në sallën e Kuvendit Komunal, ku vlen të theksohet se u ndan edhe mirënjohje për të plagosurit më 27.01.1990;
- DKRS në bashkëpunim me shoqatën e pedagogëve të kulturës fizike ka mbajtur garën shkollore në ping - pong;
- Është bërë rregullimi i 120 ulëseve në palestrën sportive “Mizahir Isma”;
2	8764	040	2	2	1	73	LOT II - KONSULENT INDIVIDUAL PËR INTERIME EVROPIANE DHE ADMINISTRATE PUBLIKE	16.08.2022	26.08.2022	13.09.2022	21.09.2022	03.10.2022 - 02.10.2024	02.10.2024	€ 9,360.00	€ 9,360.00	€ 0.00	€ 0.00	€ 0.00	€ 0.00	Dafina Gashi, Nalgave - Rakovica, Rakovica, 123295265	1	6	1	0	1	1
2	8744	041	2	3	6	93	PUBLIKIMI I KOMUNIKATAVE, NJOFTIMEVE DHE PUBLIKIMEVE TËRA NË MEDIA ELEKTRONIKE DHE RADIO	17.08.2022	25.08.2022	04.10.2022	18.10.2022	18.10.2022 - 17.10.2024	17.10.2024	€ 7,200.00	€ 6,960.00	€ 0.00	€ 0.00	€ 0.00	€ 0.00	Radio Kosovo e Linë, Tërnë Mitko, PASHITINË, 600410111	1	9	2	1	1	1

	2	Vlerë e mesme
	3	Vlerë e vogël
	4	Vlerë minimale
Te kolumna 5	Procedura e prokurimit (shënohet vetëm një kod që paraqet procedurën e përdorur. Kodet janë këto:)	
	K o d	
	1	Procedura e hapur
	2	Procedura e kufizuar
	3	Konkurr projektimi
	4	Procedura e negociuar pas publikimit të njoftimit të kontratës
	5	Procedura e negociuar pa publikimit të njoftimit të kontratës
	6	Procedura e kufizimit të Çmimit
	7	Procedura e vlerës minimale
Te kolumna 6	FPP / shënohet dy shifra e para të Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit	
Te kolumna 7	Të gjithë i aktivitetit të prokurimit, (shënohet llogaritja që ka bërë dhënë aktivitetit të prokurimit)	
Te kolumna 8	Data e iniciimit të aktivitetit të prokurimit, (shënohet data e nënshkrimit të Deklaratës së Nevojave dhe Vendosshmëritë për Disponueshmëritë e Fondere - DNVDf)	
Te kolumna 9	Data e publikimit të njoftimit për kontratë, (shënohet data e publikimit të njoftimit për kontratë në web-faqen e krrp-se)	
Te kolumna 10	Data e publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës, (shënohet data e publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës në web-faqen e krrp-se)	
Te kolumna 11	Data e nënshkrimit të kontratës, (shënohet data kur kontrata është nënshkruar nga palët kontraktuese si dhe në rast anulimi data kur bëhet publikimi i anulimit në web-faqen e krrp)	
Te kolumna 12	Afati për implementimin e kontratës, (shënohet data e parapare e fillimit dhe e përfundimit të implementimit të kontratës - kohëzgjatës së kontratës)	
Te kolumna 13	Data e përfundimit të kontratës, (shënohet data e pranimit të përfundimit të kontratës - kohëzgjatës së kontratës)	
Te kolumna 14	Vlera e parashikuar e kontratës, (shënohet vlera e parashikuar dhe vendosur në DNVDf), sipas LP-se)	
Te kolumna 15	Çmimi i kontratës, (shënohet vlera e kontratës së nënshkruar dhe përfshirë të gjitha taksat e tj. nëse ka qenë kontratë)	
Te kolumna 16	Çmimi i Anës kontratës, (shënohet vlera e anës kontratës dhe përfshirë të gjitha taksat e tj. nëse ka qenë kontratë)	
Te kolumna 17	Zbritjet nga kontrata për shkak të ndalesave, (shënohet zbritjet/ndalesat e përlogaritura në rast të aktivizimit të penaltive)	
Te kolumna 18	Çmimi total i paguar për kontratë, (shënohet vlera përfundimtare e paguar e kontratës)	
Te kolumna 19	Çmimi i OE, (shënohet vetëm çmimi i Operatorit Ekonomik të cilin i është dhënë kontrata)	
Te kolumna 20	OE. VENDOR = 1; OE. Jo vendor = 2 (nëse kontrata i është dhënë OE vendor shënoni numrin 1, për OE jo vendor shënoni numrin 2)	
	Nëse projekt iu është dhënë dy OE, shënohet pjesën e kontratës së OE vendor në një rresht dhe pjesën e kontratës OE jo vendor në rreshtin tjetër.	
Te kolumna 21	Numri i kërkesave për DT dhe numri i ofertave të dorëzuara, (shënohet numri i kërkesave për manje e Dosjes së Tenderit-DT dhe numri i ofertave të dorëzuara)	
Te kolumna 22	Numri i ofertave të refuzuara, (shënohet vetëm numri i ofertave me çmimin më të ulët të refuzuara në krashim me fituesin)	
Te kolumna 23	Afati kohor normal = 1; Afati kohor i shkurtuar = 2 (nëse afati kohor ka qenë normal shënoni numrin 1, nëse i shkurtuar shënoni numrin 2)	
Te kolumna 24	Çmimi më i ulët = 1; Tenderi ekonomikisht më i favorshëm = 2, (nëse kriteri ka qenë çmimi më i ulët, shënoni numrin 1, nëse kriteri ka qenë tenderi ekonomikisht më i favorshëm shënoni numrin 2)	
	Raporti duket të përfshijë të gjitha llojet e kontratave me vlerë të madhe, të mesme, të vogël dhe minimale	



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.12.2022 miraton këtë:

V E N D I M

Shpalljen me interes të përgjithshëm publik parcelën P-71510033-01041-1 në Zonën Kadastrale Xërxë

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës me Nr. Prot. 02/3097/22 i datës 08.12.2022 dhe merret vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik parcelën **P-71510033-01041-1** në Zonën Kadastrale Xërxë, në sipërfaqe të përgjithshme prej 1472m² (njëmijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy metra katror) në vendin e quajtur Skeja, me kulturë arë e klasës 4, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Isni (Vehbi) Thaqi nga fsh. Xërxë Komuna e Rahovecit.
2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të parcelës të cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë "Këmbimi i pronës private me pronën komunale".
3. Autorizohet Kryetari i Komunës që komform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmer të gjitha veprime të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin Kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të Kuvendit,
- Shërbimit të Kuvendit,
- Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

K U V E N D I I K O M U N Ě S N Ě R A H O V E C

01Nr. ___/22
Datë: 28.12.2022

Defrim Kafexhiu

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / MAYOR'S CABINET

Njësia Nr./Br./No. 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No. 3097 Nr. i faq./Br. str./No. pg. 81

Data/Datum/Data 8.12.22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13, nenit 14.1, nenit 17 dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008"), nenit 74 paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit i:

PROPOZON

Shpalljen me interes të përgjithshëm publik parcelën P-71510033-01041-1 në Zonën Kadastrale Xërxë

1. Kryetari i Komunës, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit i propozon iniciimin e procedurës për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik parcelën P-71510033-01041-1 në Zonën Kadastrale Xërxë, në sipërfaqe të përgjithshme prej 1472m² (njëmijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy metra katror) në vendin e quajtur Skeja, me kulturë arë e klasës 4, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Isni (Vehbi) Thaçi nga fsh. Xërxë, komuna e Rahovecit.
2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të parcelës të cekur në pikën 1 të këtij propozimi do të jetë "Këmbimi i pronës private me pronën komunale".
3. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronave në Librin kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
4. Për zbatimin e këtij propozimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
5. Ky propozim hyn në fuqi pas miratimit paraprak nga Kuvendi i Komunës.

Të njoftohen:

- Kuvendi i Komunës,
- Sekretaria e Kuvendit,
- Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT / MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE / MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVO / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510033-01041-1

Numeri i tender / Broj Predmet / Case Referent Number:	08-94203-0000237/1
Data dhe koha e kërkesës / Datum i vremen izdavanja / Date and time of submission:	05.01.2021 - 15:24
Komuna / Opština / Municipality:	Rahovec / Orahovac / Rahovec
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	XËRXË / ZRZE / XËRXË
Zyra Kadastrale Komunal / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	Rahovec / Orahovac / Rahovec

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numeri i njësies kadastrale Broj kadastrale jedinice Cad. Unit No.	Lloji i njësies Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta posjede Property Type	Zona UR GIS Unit	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Ashpërtuar Korrigirano Updated
P-71510033-01041-1	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë private / Privatno imovina Land	Rural	1472	Nr.prd.576-5000urp. nr 9-2020	05.10.2020	12.10.2020

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prekshirajte - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Mbajtësit e adresës Poljubiosti adrese Address Details	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Ashpërtuar Korrigirano Updated
SKELA-SKELA-SKELA		SKELA-	08.10.2020	12.10.2020

Printuar nga Qendrimi i Komunikimit dhe Informacionit / Pritur od strane Komunikacion i Informacioni

Zyrtar i përfunduar / Odgovorno lice / Official person

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE				
Numeri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcesë Vrsta koriscenje parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytësimi aktual i parcesë Trenutno koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvaliteti Klase Quality Class	Sipërfaqja Përfaqja Area (m²)
1	Bujësi/Poljovnik/Arboret	Arboret/Arable	Aut E Klase 4/Njimi 4 Klase/4th Class Arable Land	1472

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR								
Të drejtat Prava Rights	Emri i Ime Name	Nr. personal Lloji i ID. No.	Vendbanimi Prokuratore Resident	Kodi postor Postimi i kodit Postal code	Hollësi i adresës Prokurimi i adresës Address details	Pjesa e pronës Drejtoria Share portion	Përshkrimi Ops Description	Akturimi Akturimi Updated
Posedues individual / Indivudualna Drzavna / single possessor	THAQI ISNI (VEHBI)	1171451317	///			1/1	Nr. Pro. 604-2020	03.11.2020



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA


MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : RAHOVEC
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Xërxë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Površina/Area m ²
P-71510033-01041-1	Parcela / Parcela / Parcel	1472



Shkalla/Razmera/Scale: 1:645

Punol/Obradio/Created:


Data/ Data/Date: 01.09.2022


Koha/ Vreme/ Time: 02:23:33

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Apravol/Usvojila/Aproved: Dëgjtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:







Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në bazë të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 51 dhe nenit 52 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 53 paragrafit 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016"), në mbështetje të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 30, nenit 31 paragrafi 1, nenit 32 dhe nenit 40 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në Rahovec në mbledhjen e mbajtur me dt. 00.12.2022 miraton këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 263/22 i datës 25.01.2022 për themelimin e Komitetit për Politik dhe Financa

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi 01 Nr. 263/22 i datës 25.01.2022 për themelimin e Komitetit për Politik dhe Financa.
2. Pika 1.2 e vendimit bazik ndryshohet dhe formulohet si në vijim:

1.2.znj _____ - AAK, emërohet anëtare e Komitetit për Politik dhe Financa.
3. Ndërsa pikët tjera të vendimit bazik me numër 01 Nr. 263/22 i datës 25.01.2022 mbesin të pandryshuara.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të Kuvendit,
- Shërbimit të Kuvendit,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr. ____/22
Datë: 00.12.2022

Defrim Kafexhiu

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës së Rahovec
Opština Skupština Rahovec/Municipality of Rahovec
RAHOVEC / ORAHOVAČ



Njësia Nr./Br./No. 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No. 01/2022 Nr. ifaq/Br.sht./No.pë 1

Data/Donum/Data 25.01.2022

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), nenit 51 dhe 52, të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), në mbështetje të nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.05/2020, për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, neneve 2, 10 paragrafi 1 dhe 2.4, neni 30, 31, 32 dhe 40 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në Mbledhjen e mbajtur me datë:25.01.2022 merr këtë:

V E N D I M

Për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa

- Me këtë vendim Kuvendi i Komunës në Rahovec emëron anëtarët e komitetit për politikë dhe financa në këtë përbërje;
 - 1.1 Defrim Kafexhiu - VV, kryesues;
 - 1.2 Besmire Bytyqi - AAK;
 - 1.3 Bjondina Kleqka - AAK;
 - 1.4 Rumir Zhuniqi - AAK;
 - 1.5 Bejtullah Deliu - PDK;
 - 1.6 Melinda Iska - PDK;
 - 1.7 Burim Krasniqi - LDK;
- Detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit për Politikë dhe Financa janë të përcaktuara në nenin 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe në nenin 32 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe aktet tjera Ligjore dhe nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës
- Mandat i anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa, zgjat atë që zgjat mandati i rregullt i ligjor i Kuvendit të Komunës në Rahovec.
- Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, MAPL-së, konform nenit 81 Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.03/L-040, dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimit e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

U dërgohet:

- MAPL-së
- Arkiva

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01 Nr.263/22
Me datë:25.01.2022





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 pika (d), nenit 17 dhe nenit 40 paragrafi 2 pika (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 4 paragrafi 1 pika 1.5 lidhur me nenin 14 paragrafi 1 pika 1.7 i Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.4 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.12.2022 miraton këtë :

V E N D I M

Për miratimin e Planit të Mobilitetit Urban për Komunën e Rahovecit 2022-2027

1. Me këtë vendim **miratohet** Plani i Mobilitetit Urban për Komunën e Rahovecit 2022-2027.
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani i Mobilitetit Urban për Komunën e Rahovecit 2022-2027.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Shërbime Publike në Komunën e Rahovecit.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Kryetarit të Komunës,*
- *Drejtorisë për Shërbime Publike,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr. ____/22
Datë: 28.12.2022

Defrim Kafexhiu

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna Rahovec
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Predsednik Opštine – Municipal Mayor

Nr./L./No. 02/Kabineti i Kryetarit të Komunës
Nr./L./No. 3400 Nr. ifaq/Br.str/No.pg. 81
Data/Datum/Dat.: 8 / 12 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit Nr. 03/L040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 74 paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës:

PROPOZON

1. Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit që të merret vendim për miratimin e Planit të Mobilitetit Urban për Komunën e Rahovecit 2022-2027.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe Plani i Mobilitetit Urban për Komunën e Rahovecit 2022-2027.
3. Për zbatimin e këtij propozimi do të kujdeset Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.
4. Propozimi hyn në fuqi pas miratimit paraprak nga Kuvendi i Komunës.

Me propozim të njoftohen:

- Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,
- Sekretaria e Kuvendit, dhe
- Arkivi.



Smail Latifi
Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova



Komuna e Rahovecit



Plani i Mobilitetit Urban për Komunën e Rahovecit 2022-2027

Plani i Mobilitetit Urban për Komunën e Rahovecit 2022-2027

Nëntor, 2022

Falënderimet

Ky plan është përgatitur nga grupi punues i Komunës së Rahovecit, bartëse e të cilës është Drejtoria për Shërbime Publike në mbështetje dhe bashkëpunim të ngushtë me grupin koordinues, konsulentët profesional dhe ekspert të fushave të ndryshme.

Grupi punues dhe koordinues për hartimin e planit të mobilitetit në komunën e Rahovecit, kanë bërë analizën e gjendjes në terren dhe kanë propozuar planin e mobilitetit me qëllim të përmirësimit të qasjes dhe lëvizjes së lirë për të gjithë pjesëmarrësit në trafik.

Grupi Punues:

1. Përparim Krasniqi
2. Albnor Mullabazi
3. Sulejman Daka
4. Agim Hoti
5. Shpejtim Mustafa
6. Diellza Çanta
7. Haziz Krasniqi
8. Blerta Gashi
9. Ilir Haxhijaha
10. Masar Vuçiterna
11. Afrim Limani
12. Afrim Oruqi
13. Autoshkollat në komunën e Rahovecit
14. Stacioni Policor në Rahovec
15. OJQ-të në komunën e Rahovecit

Akronimet / Shkurtesat

PMU	Plani i Mobilitetit Urban
PZhK	Plani Zhvillimor Komunal
PZhu	Plani Zhvillimor Urban
PRU	Plani Rregullues Urban
VSM	Vlerësimi Strategjik i Mjedisit
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje.....	9
1.1. Fushëveprimi i planit	9
1.2. Profili i komunës për nga perspektiva e mobilitetit	9
1.3. Parimet bazë nga planet dhe dokumentat komunale dhe objektivat e përgjithshme të komunës	11
1.4. Korniza ligjore	11
2. Gjendja ekzistuese.....	13
2.1. Siguria në trafik	13
2.2. Sinjalizimi horizontal dhe vertikal	17
2.3. Trafiku për këmbësorë	17
2.4. Trafiku për çiklistë	18
2.5. Parkimi	18
2.6. Transporti kolektiv (publiko - privat)	19
2.7. Ngarkesa në trafik	19
2.8. Lëvizja e personave me mobilitet të zvogëluar	21
3. Vizioni - Objektivat strategjike	21
4. Plan i mobilitetit 2022-2027	25
4.1. Rritja e sigurisë nëpër rrugët brenda qytetit	25
4.2. Siguri në afërsi të shkollave	26
4.3. Qasja për njerëz me mobilitet të zvogëluar	28
4.4. Përshtatja e infrastrukturës për biznese	30
4.5. Rregullimi i vendndaljeve të autobusëve	31
4.6. Vendosja dhe mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal	32
4.7. Ndërtimi i rrugëve tranzite	32
4.8. Rritja e sigurisë në udhëkryqe me rrugë magjistrale	34
4.9. Ri-orientimi i qarkullimit në qytet	34
5. Plan i veprimit	37
6. Vlerësimi strategjik në mjedis (VSM)	40
6.1. Përmbledhje e PM.....	40
6.2. Referenca Ligjore e konsultuar për përcaktim.....	41
6.3. Analiza krahasuese sipas kriterëve të shtojcës 1 të ligjit për vsm nr. 03/L-230, si dhe aktiviteteve të PM të komunës së Rahovecit	42
7. Plan i financiar	44
7.1. Hyrje.....	44
7.2. Struktura e Buxhetit Komunal	44
7.3. Plan i Investiv	47
7.4. Analiza buxhetore e kostove investive kapitale	47

Lista e tabelave

7.5. Nevoja për investime të reja.....	49
7.6. Vlerësimi i investimeve të reja në mobilitet	50
7.7. Planifikimi i rrjedhës së parash për investimet në mobilitet	52
8. Monitorimi dhe rishikimi	55
8.1. Monitorimi i planit të mobilitetit urban për vitin 2022.....	55
Aneks I	56
Aneks II	57
Tabela 1: Struktura Buxhetore e Komunës (2022-2025)	44
Tabela 2: Investimet Kapitale (2022 - 2025)	45
Tabela 3: Pasqyra përmbledhëse e planit të mobilitetit për periudhën 2022-2027	48
Tabela 4: Investimet e planifikuara në Mobilitet për periudhën 2022-2027.....	49
Tabela 5: Investimet e planifikuara në Mobilitet për periudhën 2022-2027.....	49
Tabela 6: Rrjedha e parash e investimeve të planifikuara për periudhën 2022-2027-50	50
Tabela 7: Investimet e planifikuara në bazë të kategorive të investimeve për periudhën 2022-2027	50
Tabela 8: Investimet e planifikuara në bazë të prioritetëve të vlerës mesatare për një projekt	51
Tabela 9: Investimet e planifikuara të bazuara në prioritet për periudhën 2022-2027	51
Tabela 10: Burimet e financimit për periudhën e investimeve 2022-2027	52
Tabela 11: Tabela përmbledhëse e projekteve të planifikuara për periudhën e planifikuar 2022-2027 rrjedha e parash	53
Tabela 12: Tabela përmbledhëse e projekteve të planifikuara për periudhën e planifikuar 2022-2027 rrjedha e parash	53

Lista e figurave

Figura 1. Pozita gjeografike e komunës së Rahovecit	10
Figura 2. Raporti mbi numrin e aksidenteve nëpër vite.....	14
Figura 3. Rrethrotullimi në hyrje të qytetit, rruga rajonale Xërxë – Malishevë	14
Figura 4. Kryqëzimi në rrugën magjistrale Prizren – Gjakovë, fshati Xërxë.....	15
Figura 5. Kryqëzimi në rrugën magjistrale Prizren – Gjakovë, fshati Krushë e Madhe....	15
Figura 6. Kryqëzimi në rrugën magjistrale Gjakovë - Prishtinë	16
Figura 7. Kryqëzimi në rrugën rajonale Rahovec – Krushë e Madhe.....	16
Figura 8. Shembuj të rrugëve me siguri të ulët për lëvizje të automjeteve dhe këmbësorëve	16
Figura 9. Parkingjet ekzistuese në qytetin e Rahovecit	18
Figura 10. Pikat karakteristike në të cilat janë bërë matjet e fluksit të qarkullimit.....	19
Figura 11. Fluksi i automjeteve dhe këmbësorëve dhe struktura e qarkullimit	20
Figura 12. Propozimi për kthim në rrugë njëkahore “Gëzim Hamza”	25
Figura 13. Shembull se si do të zhvillohet qarkullimi pas kthimit në rrugë njëkahore	26
Figura 14. Parametrat e ndërtimit të ishullit për këmbësorë.....	27
Figura 15. Zgjidhja ideore duke përdorur ishuj ndarës	28
Figura 16. Lokacioni i propozuar për qetësimin e trafikut me ishuj ndarës në afërsi të një shkolle fillore	28
Figura 17. Kriteret teknike për qasje në trotuare për personat me mobilitet të zvogëluar	29
Figura 18. Një vendkalim i këmbësorëve ku duhet të sigurohet qasje	29
Figura 19. Ideja për ndaljen e automjeteve me kohë të limituar në rrugën “Xhelal Hajda”	30
Figura 20. Vendndaljet e propozuara në qendër të qytetit	31
Figura 21. Vendndaljet e propozuara në dalje të qytetit.....	31
Figura 22. Rruga tranzite në pjesën veriore.....	33
Figura 23. Rrugët tranzite në pjesën Jug-lindore të qytetit.....	33
Figura 24. Disa nga kryqëzimet e rrezikshme me rrugë magjistrale.....	34
Figura 25. Qarkullimi njëkahorë në rrugët kryesore të qytetit	35
Figura 26. Disa skenar të mundshëm për orientimin e qarkullimit njëkahorë në qytet....	36
Grafiku 1: Struktura e të ardhurave komunale	45
Grafiku 2: Struktura e të ardhurave komunale	45
Grafiku 3: Investimet e planifikuara kapitale	46
Grafiku 4: Trendi i të hyrave vetanake	46
Grafiku 5: Paraqitja grafike e strukturës investimeve për periudhën planifikuese 2022-2027	49
Grafiku 6: Paraqitja grafike e strukturës së investimeve për periudhën planifikuese 2022-2027	50
Grafiku 7: Paraqitja grafike e burimeve të financimit.....	52

1. HYRJE

1.1. Fushëveprimi i planit

Plani i mobilitetit është plan strategjik nga fusha e trafikut dhe ka për qëllim përmirësimin dhe harmonizimin e nevojave për lëvizje për të gjithë pjesëmarrësit në trafik. Duke marrë parasysh rritjen e vrullshme të shkallës së motorizimit, infrastrukturën rrugore jo funksionale, sigurinë e pamjaftueshme për lëvizje të pamotorizuara dhe kushtet ambientale, atëherë zhvillimi i një plani të mobilitetit urban nuk mund të kuptohet vetëm si një objektivi i thjeshtë, por si prioritet.

Planet e mobilitetit mbështeten në planet aktuale të zhvillimeve komunale, mirëpo janë shumë më të detajuar dhe më specifike në fushën e trafikut dhe të transportit në përgjithësi.

Qëllimi i planit të mobilitetit urban është krijimi i një sistemi të qëndrueshëm të sistemit të transportit dhe lëvizjeve tjera (lëvizjeve të motorizuara dhe të pamotorizuara) me qëllim që të krijojnë:

- sigurimin e qasjes sa më të lehtë për lëvizjet ditore dhe shërbime tjera;
- përmirësimin e shkallës së sigurisë;
- zvogëlimin e ndotjes së ambientit;
- rritjen e efikasitetit dhe ekonomicitetit gjatë transportit të njerëzve dhe të mallrave;
- rritjen e atraktivitetit dhe kualitetin e mjedisit urban.

Përfshirja e qytetarëve dhe pjesëmarrësve tjerë në hartimin e planit të mobilitetit është ndër principet themelore. Përfshirja dhe mendimet e tyre janë kontribut i rëndësishëm, sepse ndërlihet me nevojat e biznesit, organizimin dhe dinamikën e qytetit si dhe me kualitetin e jetesës.

Me hartimin e planit të mobilitetit, Komuna e Rahovecit tenton të jetë një komunë funksionale dhe e integruar, duke akomoduar të gjithë pjesëmarrësit në trafik dhe krijimin e kushteve për lëvizje të motorizuara dhe të pa motorizuara.

1.2. Profili i komunës për nga perspektiva e mobilitetit

Popullsia

Numri i përgjithshëm i banorëve në Komunën e Rahovecit bazuar në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011 është 56,208 banorë. Në qytetin e Rahovecit jetojnë rreth 15,892 banorë që do të thotë se rreth 28 % e popullsisë së tërësishme jeton në këtë qytet, ndërsa në të gjitha vendbanimet tjera jetojnë rreth 40,316 banorë apo rreth 72 %.

Pozita gjeografike

Territori i Komunës së Rahovecit zë një sipërfaqe prej 275.5 km², që shtrihet në regjionin e Gjakovës dhe ka një pozitë të mirë gjeografike. Në Veri kufizohet me Komunën e Klinës me distancë rreth 45 km, në Veri-Lindje me Komunën e Malishevës rreth 16 km, në Jug-Lindje me Komunën e Suharekës rreth 17 km dhe atë të Mamushës, në Jug me Komunën e Prizrenit 25 km, dhe në Perëndim me Komunën e Gjakovës 28 km dhe në largësi nga kryeqendra e Kosovës (Prishtina) rreth 60 km. Ekziston lidhje të mira komunikative në mes komunave dhe në Lindje të komunës kalon magjistralja Prizren – Pejë dhe hekurudha Prizren–Pejë.

Territori i komunës shtrihet në hemisferën në mes shkallës 42° e 30' dhe 42° e 50' të gjërësisë gjeografike veriore dhe ndërmjet 20° e 21' dhe 20° e 55' të gjatësisë gjeografike lindore. Vendbanimet në Komunën e Rahovecit shtrihen në lartësi mbiidetare prej 310 m Krushë e Madhe deri në 920 m lartësi mbiidetare Zatriqi.




Figura 1. Pozita gjeografike e komunës së Rahovecit

Për kah lartësia mbiidetare këto vendbanime ndahen në lugjnore-rrafshinore, kodrinore dhe malore.

10 PLANI I MOBILITETIT URBAN PËR KOMUNËN E RAHOVECIT 2022-2027

1.3. Parimet bazë nga planet dhe dokumentat komunale dhe objektivat e përgjithshme të komunës

Komuna e Rahovecit është në përfundim të miratimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), si dhe është në proces të hartimit të Planit Rregullues Urban (PRrU) për "Qendrën e Vjetër të Qytetit". Në këtë dokument është trajtuar problemi i komunikacionit dhe mobilitetit në përgjithësi, pastaj është bërë planifikimi i rrugëve, trotuareve dhe për llojet e ndryshme të transportit. Në kuadër të këtyre planeve janë trajtuar edhe vendndaljet e autobusëve dhe parkingjet për lokalitete të ndryshme. Në vijim janë paraqitur disa nga objektivat komunale të cilat janë paraparë në kuadër të këtyre planeve të cilat e trajtojnë hapësirën në përgjithësi:

Strategjia e zhvillimit të infrastrukturës sipas PZHK-së

Synimi 1. Rrugë të asfaltuara të kualitetit të lartë dhe qasje për të gjithë banorët:

- Asfaltimi i rrugëve që lidhin vendbanimet, asfaltimi i rrugëve lokale;
- Mirëmbajtjen e rrugëve lokale;
- Përfundimi i Rrugës Unazore (Tranzite) mbi Rahovec;
- Rregullimi i anësoreve mbrojtëse;
- Rregullimi i sinjalizimit për vendkalim këmbësorësh në vendbanime të mëdha dhe të frekuentuara sidomos në qendrat sekondare;
- Rregullimin e trotuareve në vendbanimet;
- Rregullimin e sinjalizimit për vijën hekurudhore, në vendbanime të mëdha dhe të frekuentuara;
- Rregullimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik në Rahovec dhe qendrat sekondare.

1.4. Korniza ligjore

Plani i mobilitetit urban për Komunën e Rahovecit, është dokument i cili duhet të promovojë interesat e përbashkëta të banorëve të Rahovecit, për lëvizje të lirë dhe të sigurt për të gjithë pjesëmarrësit në trafik, për përmirësimin e kualitetit të jetës, krijimin e ambientit të pastër dhe të shëndoshë mjedisor dhe social.

Plani i mobilitetit urban për komunën e Rahovecit bazohet në kornizën ligjore në fuqi në Kosovë, si dhe parimet dhe konventat ndërkombëtare të cilat janë të ndërlidhura me mobilitetin e qëndrueshëm urban, si:

- Ligji Nr. 02/L-70 për sigurinë e komunikacionit rrugor;
- Ligji Nr. 2004/1 dhe Ligji Nr.04/L-179, të datës 16 maj 2013 për transportin rrugor;
- Ligji Nr. 2003/11 mbi rrugët;
- Ligji Nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale;

- Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë, Kuvendi i Kosovës (2012);
- Ligji Nr. 2012/04-L-174 për planifikim hapësinor;
- Ligji Nr. 03/L-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja;
- Ligji Nr. 03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit.

Siguria në trafik është e rregulluar me Ligjin Nr.02/L-70 për sigurinë e komunikacionit rrugor. Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i të drejtave dhe detyrimeve në sistemin e komunikacionit rrugor.

Përpos ligjit për sigurinë në komunikacion, me geshje të sigurisë në trafik merret edhe Ligji për Policinë, i miratuar në vitin 2012. Nga ana tjetër, edhe Ligji për vetëqeverisje lokale, Rregullorja për shërbime komunale, si dhe aktet tjera nënligjore të komunave të Kosovës trajtojnë fushën e sigurisë së trafik duke kompletuar bazën ligjore në këtë fushë.

Ligji për planifikim hapësinor, ka për qëllim rregullimin e të gjitha geshjeve që kanë të bëjnë me planifikimin hapësinor dhe urban. Në kuadër të këtij ligji, planifikimi hapësinor duhet t'i respektojë parimet e mbrojtjes së burimeve natyrore të Kosovës dhe ta përkrahë zhvillimin e qëndrueshëm, po ashtu duhet t'i përkrahë proceset gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse dhe duhet t'i përfshijë të gjitha palët e interesuara dhe komunitete.

Sipas Ligjit për planifikim hapësinor, parashikohet që ekspertiza profesionale të integrohet në sistemin e planifikimit duke e themeluar komisionin e ekspertëve të planifikimit (në nivelin lokal). Në Kosovë ekzistojnë dy nivele të planifikimit (kombëtare dhe lokale) dhe llojet e planeve janë: Plani Hapësitor i Kosovës, Planet Hapësitor për Zona të Posaçme, Planet Zhvillimore Komunale (PZHK), Planet për Zhvillim Urban, Planet Rregulluese Urbane.

Ligji për mbrojtjen e mjedisit, cakton shfrytëzimin racional të resurseve natyrore dhe kufizimin e ndotjes së mjedisit, parandalimin e dëmtimit, rehabilitimin dhe përmirësimin e mjedisit të dëmtuar, përmirësimin e kushteve mjedisore, që lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut. Ligji për vetëqeverisjen lokale përshkruan bazën ligjore për një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre dhe të organeve përkatëse.

Në kuadër të Ligjit për vetëqeverisje lokale, janë caktuar të drejtat në nivel lokal, si e drejta për:

- zhvillimin lokal ekonomik;
- planifikimin urban dhe rural;
- shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin;
- zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit; mbrojtjen e mjedisit lokal; janë kompetencat vetanake, të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuara në legjislationin e zbatueshëm, këto kompetenca janë përcaktuar me nenin 17 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale.

2. GJENDJA EKZISTUESE

Komuna e Rahovecit shtrihet në mesin e rrugëve magjistrale Gjakovë-Prishtinë dhe Gjakovë-Prizren, si dhe atyre rajonale Malishevë-Gjakovë, dhe Rahovec-Suharekë. Territori i komunës është relativisht i madh i cili ka një rrjet rrugor prej 297 km rrugë të të gjitha kategorive. Rrugët magjistrale dhe rajonale janë të asfaltuara dhe në gjendje të mirë ka edhe prej atyre rrugëve brenda qytetit që janë pa asfaltuara, sidomos në lagjet periferike. Gjendja e trafikut është relativisht në nivel të kënaqshëm në rrugët periferike të komunës, ndërsa sa i përket atyre brenda qytetit ka pak vështirësi në zhvillimin normal të qarkullimit të mjeteve, kjo bëhet edhe më vështirë kur kemi parasysh praninë e madhe të motokultivatorëve. Konfiguracioni i terrenit është kodrinor, ku karakterizohet me dendësi shumë të madhe të vendbanimeve në disa lagje të qytetit, si rezultat i kësaj kemi edhe rrugët shumë të ngushta të cilat përdoren nga të gjithë pjesëmarrësit në trafik. Shumica e këtyre rrugëve janë të asfaltuara, mirëpo nuk kanë trotuare për lëvizjen e këmbësorëve. Për nga aspekti i mobilitetit rrugët në këto lagje mund të cilësohen si të rrezikshme duke mos ofruar siguri të mjaftueshme të gjithë pjesëmarrësve në trafik.

Komuna përveç trafikut rrugor ka edhe atë hekurudhor e cila e lidh Prishtinën – Shkupin, mirëpo aktualisht kjo linjë është jashtë funksionit.

2.1. Siguria në trafik

Siguria në komunën e Rahovecit përkatësisht në zonën urbane sipas konceptit të mobilitetit mund të llogaritet e nivelit të ulët. Kjo për faktin se ka një infrastrukturë rrugore adekuate për automjete, ndërsa jo në nivel të duhur për lëvizje të mjeteve të pa motorizuara si për këmbësorë ashtu edhe për çiklistë. Zona urbane karakterizohet me mungesë të trotuareve për këmbësorë, për shkak se nuk ka pasur mundësi të ndërtimit të tyre. Në këto lagje rrugët janë shumë të ngushta në shumicën prej tyre zhvillohet trafiku në dy kahje dhe e bën shumë të vështirë dhe të rrezikshme lëvizjen e këmbësorëve. Këto rrugë shfrytëzohen shumë sidomos nga nxënësit për të shkuar në shkollë, sepse lëvizja në këmbë është e vetmja mënyrë e lëvizjes për këto nevoja ditore, pasi që transport urban nuk ka të organizuar brenda qytetit.

Problem tjetër i sigurië ka të bëjë edhe me mos rregullimin adekuat të disa kryqëzimeve sidomos atyre që janë të lidhura me rrugët rajonale dhe magjistrale, të cilat kalojnë nëpër komunën e Rahovecit. Edhe sipas raporteve policore mbi numrin e aksidentëve është një numër relativisht i madh, ku shumica e tyre ndodhin pikërisht në këto kryqëzime me rrugët magjistrale dhe rajonale. Në vazhdim do t'i japim disa nga pikat më të rrezikshme të cilat nuk i plotësojnë kriteret teknike gjeometrike për funksionimin e tyre.



Qëllimi i projektit të rrethorullimeve është që në hyrje të udhëkryqit të detyroje automjetet ta zvogelojnë shpejtësinë në mënyrë që të rritet siguria, në këtë udhëkryq me këto parametra gjeometrik kjo gjë nuk ka ndodhur për faktin se mjete të levizin në drejtimin Malisheve – Xërxë i mundësohet e drejta e kallimit krahasuar me ata të cilët është dashur të kenë të drejtë përkatësisht mjete të levizin në rrethorullim, dhe pikërisht është kjo edhe arsyeja se pse ndodhin aksidente në këtë udhëkryq, gjithashtu edhe kështu nga qyteti nuk është projektuar si duhet sepse nuk ka dukshmëri të mjaftueshme.

14 PLANI I MOBILITETIT URBAN PËR KOMUNËN E RAHOVECIT 2022-2027



Figura 4. Kryqëzimi në rrugën magjistrale Prizren – Gjakovë, fshati Xërxë

Ky është njëri ndër udhëkryqet më të rrezikshme në komunën e Rahovecit, sepse në këtë kryqëzim kemi edhe kalimin e hekurudhës. Dihet se një pjesë e madhe e fshatit Xërxë shtrihet në pjesën e poshtme të këtij kryqëzimi, ndërsa në afërsi të tij gjendet shkolla fillore, pikërisht në këto pika gjatë vitit shkollor bëhet edhe më e rrezikshme sepse kërkesa për të kaluar nga njëra anë në tjetrën është shumë e madhe.



Figura 5. Kryqëzimi në rrugën magjistrale Prizren – Gjakovë, fshati Krushë e Madhe



Figura 6. Kryqëzimi në rrugën magjistrale Gjakovë - Prishinë

Disa rrugë të lagjeve që janë të rrezikshme për zhvillimin e komunikacionit të automjeteve dhe të këmbësorëve.



Figura 8. Shembuj të rrugëve me siguri të ulët për lëvizje të automjeteve dhe këmbësorëve





Vendet ku janë paraparë të ndërtohen rreth rrotullimet;

- *Rruga rajonale Xerxe-Kramavik*
- *Rruga rajonale Rahovec-Malishevë*
- *Rruga rajonale Rahovec-Suharekë*

22. Sinjalizimi horizontal dhe vertikal

Të gjitha mangësitë e përmendura më lartë për nga aspekti i sigurisë janë të lidhura drejtpërdrejt edhe me mungesën e sinjalizimit adekuat, niveli i sinjalizimit si atij horizontal po ashtu edhe atij vertikal nuk është në nivelin e duhur në rrugë rajonale, e bëhet edhe më e rëndë kur dihet se në vitet e fundit nuk ka pasur kompani të kontraktuara për mirëmbajtjen e tij.

Në zonën urbane kemi sinjalizim adekuat sidomos në pjesët e qytetit ku janë ndërtuar rrugët e reja, ndërsa në ato rurale ka vetëm në rrugët kryesore. Në zonat rurale ka vetëm disa shenja vertikale STOP, të cilat janë vendosur në kryqëzime me rrugët kryesore, kurse sinjalizim horizontal nuk ka fare në rrugë sekondare, është bërë vetëm njëherë kur është ndërtuar rruga pastaj nuk është mirëmbajtur fare, apo nuk është përsëritur më.

2.3. Trafiku për këmbësorë

Shitigjet e këmbësorëve janë pothuajse pjesa më e rëndësishme e infrastrukturës sidomos për zonat urbane, kur dihet që shumica e lëvizjeve ditore bëhet në këmbë, mirëpo pa i anashkalluar edhe nevojën për rrugët që i lidhin fshatrat. Në komunën e Rahovecit nuk është gjendja e mirë me trotuar, apo thënë më mirë lëvizja në këmbë nuk është e sigurt në këtë qytet. Qyteti ka një terren kodrinor me dendësi shumë të madhe të vendbanimeve që karakterizohen me rrugë të ngushta të cilat janë të asfaltuara në tërësi, ndërsa nuk ka fare trotuar për lëvizjen e këmbësorëve. Sidomos gjatë periudhës së dimrit kemi një gjendje shumë të rrezikshme për lëvizje të këmbësorëve duke pasur parasysh edhe pjerësitë në këto rrugë. Në përgjithësi përveç disa rrugëve kryesore në qendërën e qytetit që kanë trotuar, shumica e lagjeve tjera nuk kanë fare. Këtu duhet të përmendim edhe rrugën që qon në drejtimin e shkollës së mesme "Xhelal Hajda" rrugë e cila është shumë e frekuentuar nga nxënësit nuk ka një infrastrukturë adekuate për lëvizje të këmbësorëve. Në përgjithësi mund të themi se gjendja me trotuar nuk është në nivelin e duhur si për nga mungesa ashtu edhe mirëmbajtja e duhur. Në PZHK është paraparë që të ndërtohen disa trotuar këto sidomos në rrugë që i lidhin fshatrat sepse edhe në këto raste nuk kemi hapësira për lëvizje të sigurtë të këmbësorëve, sidomos në rrugët rajonale kur dihet se mjetet këtu mund të lëvizin me një shpejtësi më të madhe.

Të dhëna të detajuara në lidhje me gjatësinë e trotuareve gjenden në aneks.

24. Trafiku për çiklistë

Në qytetin e Rahovecit kemi disa shtigje për çiklistë deri më tani, edhe pse në PZHK është përmendur që janë të nevojshme këto shtigje mirëpo, duke e marrë parasysh gjendjen e terrenit dhe hapësirat në dispozicion për krijimin e shtigjeve është shumë e vështirë që të krijohen. Në të ardhmen nëse qyteti vazhdon të rritet në pjesën e rrafshët është mirë që të parashihen, dhe të inkorporohet edhe kjo formë e transportit. Kemi shtegun ne rrugën Ibrahim Rugova me gjatësi 609 metra, kemi krijuar përgjatë rrugës Rahovec –Hamoc-Fortes ne segmentin e kësaj rruge është vendosur shtegu për çikliste.

25. Parkimi

Qyteti i Rahovecit ka shumë pak hapësira publike apo private të cilat mund të shfrytëzohen për parkingje. Në zonën qendër nuk ka hapësira as mundësi për krijimin e parkingjeve, kjo njëherit është edhe një shqetësim sepse është një hapësirë shumë e vogël tek shtëpia e Kulturës në qendër të cilin qytetarët e shfrytëzojnë për parking, i cili e pengon rrjedhën e qarkullimit. Ekzistojnë edhe disa parkingje në pjesën e poshtme të qytetit afër tregut i cili mund të shfrytëzohet mirëpo, përveç ditëve të tregut shumë pak shfrytëzohet në ditët tjera.



Figura 9. Parkingjet ekzistuese në qytetin e Rahovecit

26. Transporti kolektiv (publiko - privat)

Trafiku urban në komunën e Rahovecit përkatësisht në zonën urbane nuk ekziston. Ka të organizuar trafikun urban – përiferik dhe atë ndër urban. Të gjitha itineraret janë të caktuara nga disa rregullore të nxjerrra nga Kuvendi Komunal, mirëpo këto janë shumë të vjetra sepse janë nxjerr në vitin 2001 dhe janë të bazuara në ligjin e vjetër të transportit. Kjo mund të cilësohet edhe një e mëte dhe duhet të rishikohet kjo rregullore me qëllim që të përshatet me ligjin e ri që është në fuqi. Transporti urbano – përiferik organizohet me autobus nga kompanitë private, ku gjendenja e mjeteve në disa raste nuk është në nivelin e duhur, linjat kryesisht shfrytëzohen për transportin e nxënësve. Ndërsa sa i përket linjave ndërurbane ka një qasje të mirë dhe shpeshësia e tyre është në nivelin e duhur. Komuna ka stacion të autobusëve që me rregullore është parapare që të gjitha linjat duhet të nisen dhe të përfundojnë në këtë stacion. Mirëpo, një shqetësim tjetër është se operatorët e autobusëve nuk e respektojnë dhe ndalen edhe në pjesët tjera të qytetit, si për zbritjen e udhëtarëve ashtu edhe për marrjen e tyre. Kjo ndodh sidomos në zonat atraktive në qendër apo në afërsi të shkollave. Aktualisht ka disa vendndalje të shënuar për autobusë brenda qytetit, mirëpo në vijmë duhet që ta analizojmë nëse është e nevojshme që të vendoset dhe të krijohet një infrastrukturë adekuate.

27. Ngarkesa në trafik

Për nevoja praktike janë të rëndësishme të veçantë karakteristikat e jolinearitetit kohorë të qarkullimit të automjeteve në periudha të ndryshme kohore. Periudha dhe zgjatja e numërimit varet nga qëllimet dhe mënyra e planifikimit. Për nevoja të planit majet e fluksit të trafikut janë bërë vetëm për një orë në pika karakteristike të hyrjeve të qytetit.

Përpos automjeteve motorike, me qëllim të caktimit të strukturës së qarkullimit, janë bërë edhe matjet e numrit të këmbësorëve dhe biçikletave të cilat qarkullojnë brenda orës.





Figura 10. Pikat karakteristike në të cilat janë bërë matjet e fluksit të qarkullimit

Të dhënat për qarkullimin e mjeteve dhe strukturën e qarkullimit në udhëkryqin U1 tek Semaforët janë dhënë në fig. 11.



Fluksi i automjeteve dhe këmbësorëve - U1



Struktura e qarkullimit




Figura 11. Fluksi i automjeteve dhe këmbësorëve dhe struktura e qarkullimit

Për nga struktura e qarkullimit shihet se në kohën kur janë realizuar matjet e fluksit dominojnë mjete motorike krahësuar me këmbësorët, për nga numri i shfrytëzuesve mund të konstatohet se ky udhëkryq ka kapacitet rezervë për përballimin e një fluksi më të madh të automjeteve dhe këmbësorëve gjithashtu.

28. Lëvizja e personave me mobilitet të zvogëluar

Komuna e Rahovecit përkrahësit zona urbane ka bërë një infrastrukturë adekuate e cila do t'i mundësojë personave me mobilitet të zvogëluar një qasje të lehtë dhe një lëvizje të lirë. Rrugët janë shumë të ngushta në disa pjesë të qytetit kanë të pamundur të krijohen hapësira për lëvizje të lirë të kësaj kategorie. Mirepo, edhe pjesët e qytetit ku ka trotuare, përkate-sisht janë vendosur pjerrinat e duhura për t'u qasur më lehtë në to.

3. VIZIONI - OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Qyteti i Rahovecit i cili konsiderohet me dendësi të madhe në zonën qendër, me një konfiguracion kodrinor të terrenit, me rrugë shumë të ngushta si rezultat i një plani kaotik të ndërtimit të shtëpive individuale e bënë që lëvizshmëria në qytet të jetë e vështirë dhe e pa sigurtë për të gjithë pjesëtarët në trafik.

Gjatë analizës në kapitullin e mësipërm del të jetë se siguria e lëvizjes në qytet është në nivel jo të mirë, sidomos për lëvizjet në këmbë, kjo për faktin se kemi një qarkullim dy kahor të automjeteve në rrugë shumë të ngushta ku madje shumica prej tyre nuk kanë trotuare për lëvizje të sigurt të këmbësorëve.

Aktualisht trafiku për mjete të motorizuara është i orientuar në rrugën kryesore të qytetit, kjo për shkak se nuk ka ndonjë rrugë alternative e cila i plotëson kriteret që të përdoret si rrugë tranzite për mjete të rënda, pak në këtë aspekt mbetemi të hendikepuar për të ofruar zgjidhje për një periudhë afatshkurter, qoftë për nga aspekti i sigurisë apo i ri-orientimit të qarkullimit, kjo për faktin se kërkohen investime pak më të mëdha si për nga aspekti kohor ashtu edhe ai financiar.

Nëse i referohemi Planit Hapësinor të Kosovës, Rahoveci bënë pjesë në "zonën e verdhë" të ashtuquajtur, duke e konsideruar si vendbanim urë lidhës me mes të komunave tjera, me një pemëtar dhe vreshtar të zhvilluar. Për ta arsyetuar këtë epitet kryefjala bie të jetë organizimi i trafikut dhe transportit si në nivelin komunal ashtu edhe në atë lokal në qendër të qytetit. Ndërsa, nëse i referohemi PZHK, planeve rregullative e kemi po të njëjtin vizion ku thuhet që:

"Komunë me sistem të avancuar administrativ, tërësi pozitive në punësim dhe zvogëlim të varfërisë, duke e avancuar sistemin arsimor dhe shëndetësor, zhvillim të vendbanimeve me plan, zhvillim të qëndrueshëm mjedisor duke mbrojtur edhe vlerat e trashëgimisë kulturore, me ekonomitë stabile duke avancuar vreshtarinë dhe perimtarinë, infrastrukturë të planifikuar e bashkëkohore".

- Për t'i plotësuar apo për t'i arritur këto vizione për nga aspekti i mobilitetit na duhet që të kemi një qytet:
- Me qasje të lirë dhe të sigurt për të gjithë pjesëmarrësit në trafik,
- Infrastruktura adekuate për të gjitha format e lëvizjes.

Vizioni i qytetit në aspektin e mobilitetit është ndërtuar në këto katër elemente:

- Kapaciteti,
- Arritshmëria (qasshmëria),
- Atraktiviteti,
- Qëndrueshmëria.

Kapaciteti	Arritshmëria (qasshmëria)
• Kapaciteti i rrjetit rrugor • Kapaciteti i transportit publik • Rrjeti i çiklizmit • Bizneset	• Koha e udhëtimit • Shpejtësia e lëvizjes • Parkingjet • Kënaqshmëria e shfrytëzuesve të rrjetit rrugor
Atraktiviteti	Qëndrueshmëria
• Ecja • Hapësira publike	• Siguria rrugore • Qëndrueshmëria e rrjetit rrugor • Përdorimi i mjeteve alternative të lëvizjes

Nga analiza e gjendjes ekzistuese ashtu edhe nga vizioni për zhvillimin e qytetit objektivat i kemi ndarë në dy periudha:

1. Objektiva afatshkurtra 0-1 vit dhe
2. Objektiva afatmesme 0-5 vite.

1. Objektiva afatshkurtra 0-1 vit:

- Rritja e sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit,
- Qasja për njerëz me mobilitet të zvogëluar,
- Përshtatja e infrastrukturës për biznese,
- Rregullimi i vendndaljeve të autobusëve,
- Vendosja dhe mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal,
- Ndërtimi i rrugëve dhe trotuareve.

2. Objektiva afatmesme 0-5 vite:

- Ndërtimi i rrugëve tranzite,
- Rritja e sigurisë në udhëkryqe me rrugë magjistrale,
- Ri-projektimi dhe rindërtimi i udhëkryqeve të rrezikshme,
- Ri-orientimi i qarkullimit në qytet.

Brenda qytetit të Rahovecit nuk ka vendndalje legale të autobusëve, pra me këtë nënkuptojmë që të gjitha udhëtimet, zbritjet bëhen nga stacioni i autobusëve, edhe pse kjo gëshje është rregulluar me rregullore mbi linjat e transportit nuk respektohet, pothuajse të gjithë operatorët e linjave trans-portuese bëjnë marrjen e udhëtarëve në pika të ndryshme të qytetit. Për këtë arsye është menduar që të bëhen disa vendndalje përveç stacionit të autobusëve, kjo për faktin që të le-galizohet një pikë e vetme e destinuar për këtë gëshje, jo të shfrytëzohet apo të keqpërdoret rruga për ndalje sipas dëshirës së udhëtarëve.

O 1.4. Rregullimi i vendndaljeve të autobusëve

Rruga kryesore e qytetit "Xhehal Hajda", është rruga në cilën janë të shtrira të gjitha bizneset në qyte-tin e Rahovecit, aktualisht në këtë rrugë trafiku zhvillohet në dy kahe ku gjërësia e rrugës është 7m. Në trotuare përgjatë gjithë rrugës janë të vendosura pengesa fizike anti park, mirëpo edhe skajoret e rrugës janë shume të larta, për momentin është e pamundur që të ndalen automjetet për të kryer ndonjë shërbim apo lokale të bëjnë furnizimet e tyre. Për këtë arsye ne kemi menduar të krijojmë një hapësirë legale për ndalje e cila nuk do ta kishte penguar rrjedhën e qarkullimit, kjo hapësirë është menduar që të krijohet në mes të dy drunjtëve dekorativ, ku ekziston një distancë prej 10m.

O 1.3. Përshtatja e infrastrukturës për bizneset

Disa rrugë të qytetit kanë trotuare për lëvizjen e mjeteve të pa motorizuara mirëpo, qasja e njerëzve me mobilitet të zvogëluar nuk është e mundshme, kjo për faktin se pikërisht në vendkalime të këm-bësorëve nuk janë respektuar kriteret teknike për rampa (lëshesa), të cilat do ta mundësojnë një qasje më të lehtë. Ky objektiv është shume i lehtë i realizueshëm dhe nuk kërkon ndonjë investim të madh, andaj edhe mendohet që të kryhet brenda grupit të parë të objektivave.

O 1.2. Qasja për njerëz me mobilitet të zvogëluar

Ashtu siç e kemi potencuar edhe më herët qyteti i Rahovecit ka mungesë të trotuareve për lëvizje të sigurtë të këmbësorëve, nuk janë marrë masa adekuate për ta rritur sigurinë në afërsi të shkollave, ekzistojnë disa udhëkryqe që nuk i plotësojnë kriteret për një lëvizje të sigurt në to. Për këtë arsye janë propozuar disa skenarë për të rritur nivelin e sigurisë në disa pjesë të qytetit.

O 1.1. Rritja e sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit

Objektiva afatmesme 0 – 5 vite

O 2.1. Ndërtimi i rrugëve tranzite

Rruga kryesore e qytetit njëherit është e rruga në të cilën detyrimisht kalojnë të gjitha mjetet, duke i përfshirë edhe ato të rëndat, kjo për faktin se nuk ka rrugë alternative për ta ri-orientuar qarkullimin. Në këtë periudhë afatmesme mendohet që të ndërtohet rruga tranzite në pjesën veriore të qytetit rrugë e cila tashmë është edhe e trasuar. Me ndërtimin e kësaj rrugë do kemi mundësinë që mjeteve të rënda t'ja kufizojmë lëvizjet në qendër të qytetit, me këtë kufizim automatikisht do të ndikojmë në rritjen e sigurisë së pjesëmarrësve tjerë brenda zonës së qytetit, në të njëjtën kohë do të na jepen edhe mundësi që në periudhat afatmesme të bëhet edhe një ri-organizim i brendshëm i rrugëve.

O 2.2. Rritja e sigurisë në udhëkryqe me rrugë magjistrale

Gjatë analizës së gjendjes ekzistuese kemi arritur në përfundim se kemi një numër të konsiderueshëm të udhëkryqeve që mund t'i konsiderojmë me rrezikshmëri të lartë, kjo për faktin se ka ndodhur një numër i konsiderueshëm i aksidentëve. Këtu bëjnë pjesë disa kryqëzime me rrugë magjistrale siç janë në fshatin Xërxë, fshatin Krushë e Madhe, rrethrotullimi në hyrje të qytetit. Të gjitha këto pika duhet të ri-projektohen apo të vendosen masa dhe mënyra të tjera të qarkullimit.

O 2.3. Ri-projektimi dhe rindërtimi i udhëkryqeve të rrezikshme

O 2.4. Ri-orientimi i qarkullimit në qytet

Me ndërtimin e këtyre rrugëve tranzite mundësohet edhe rregullimi apo ri-orientimi i brendshëm i rrugëve, aktualisht kërkesa për lëvizje nuk është shumë e madhe dhe kapaciteti i rrugëve është në nivel të kënaqshëm, mirëpo për një periudhë afatmesme kërkesa për lëvizje mund të rritet, ndërsa është e pamundur zgjerimi i rrjetit rrugor në qendër të qytetit. Për këtë arsye është e nevojshme që të bëhet kahëzimi i trafikut përmes rrugëve njëkahore.

Figura 12. Propozimi për kthim në rrugë njëkahore "Gëzim Hamza"



Në figurën e mëposhtme është marr një shembull model se si mund të rezervohet një hapësirë e destinuar për këmbësorë, brenda sipërfaqes së përbashkët për lëvizje.

Shumica rrugëve brenda qytetit janë shumë të ngushta dhe trafiku në to zhvillohet në të dy drejtimet, me kthimin e tyre në rrugë njëkahore si në figurën e mëposhtme krijohet një hapësirë e cila mund të shënohet për lëvizje të këmbësorëve p.sh në një rrugë gjatësia është 4.5m, 3m mund të ndahen për lëvizje të mjeteve në një drejtim ndërsa 1.5m mund të ndahen për lëvizje të sigurtë të këmbësorëve.

4.1. Rritja e sigurisë nëpër rrugët brenda qytetit

Organizimi i rrugëve njëkahore për disa lagje të thella të qytetit, kjo është bërë sidomos për rrugët të cilat nuk kanë trotuare dhe nuk ka mundësi të ndërtohen trotuare, me orientimin njëkahorë është e mundshme që të krijohet një hapësirë e ndarë për lëvizje të këmbësorëve.



Figura 13. Shembull se si do të zhvillohet qarkullimi pas kthimit në rrugë njëkahore

4.2. Siguri në afërsi të shkollave

Për rritjen e sigurisë në afërsi të shkollave janë propozuar disa modele apo praktika për qetësimin e trafikut si:

- Pengesat në rrugë (të vendosura sipas kriterëve dhe standardeve teknike);
- Ngushtimi i shiritave të lëvizjes me qëllim të zvogëlimit të shpejtësisë;
- Vendosja e sinjalistikës adekuate, në përshtatje me kushtet e lëvizjes në afërsi të shkollave;
- Ndriçimi i vendkalimeve për këmbësorë.

4.2.1. Masat e propozuara për kontrollimin e trafikut

Edhe nëse ndonjëherë duken si tërësi e veçantë, udhëheqja e trafikut dhe qetësimi i tij paraqesin mjete të ndryshme dhe kanë të bëjnë me probleme të ndryshme. Udhëheqja e trafikut përfshinë masa të ndryshme për kontrollimin e trafikut me qëllim të udhëheqjes së lëvizjes dhe rritjen e sigurisë për këmbësorë.

Me rastin e përzgjedhjes së masave për qetësimin e trafikut, janë marrë parasysh tre kritere themelore:

- funksioni dhe karakteri i rrugës;
- kushtet e qarkullimit dhe
- kriteret shtesë (lokacioni i pjesës së rrugës, struktura e qarkullimit etj).

Mbi bazën e analizave të bëra në rrjetin rrugor të komunës së Rahovecit, janë identifikuar pika të rrezikut në pjesët e rrugëve rajonale dhe atyre lokale.

Krahas karakterit të rrugëve, janë konstatuar masat adekuate për përmirësimin e gjendjes së sig-urisë, veçanërisht në pjesët e rrugëve në afërsi të shkollave, dhe në vazhdim do të propozohen rekomandimet si në vijim:

Për rrugët rajonale:

- Masat e qetësimit të trafikut, me aplikimin e ishujve ndarës përgjatë rrugës në të dy anët e vendkalimit për këmbësorë;
- Vendosja e signalizimit adekuat horizontal dhe vertikal, me qëllim të paralojmërimit të afërësise së zonës së shkolles.

Zgjidhja teknike bazohet në:

- Ndërtimin e ishullit qendror në rrugën kryesore në të dy anët e vendkalimit për këmbësorë, secili me gjatësi 10m – 15m, dhe me gjerësi nga 1,5 – 2,0m, ndërsa lartësia e skajorit të ishullit $h = 12$ cm (Fig.14). Kjo zgjidhje parashihet për pjesët e rrugës në të cilat shpejtësia është e kufizuar nga 40-50 km/h, e cila i përgjigjet edhe shpejtësisë së kufizuar në zonat e banuara.




Figura 14. Parametrat e ndërtimit të ishullit për këmbësorë

Përdorimi i gungave ose platformave të ngritura në rrugë për qetësimin e trafikut, nuk preferohen për rrugë magjistrale dhe rajonale. Prandaj, me rastin e aplikimit të masave për qetësimin e trafikut në komunën e Rahovecit, të vlerësohet se në cilat pjesë të rrugëve rajonale mund të përdoret modeli me ishull ndarës në vendkalim për këmbësorë.

Në vijim është dhënë një zgjidhje ideore për një shkollë në qendër të qytetit duke përdorur ishuj ndarës, për kahëzimin e trafikut, këto janë metoda standarde të cilat përdoren për këto raste. Është menduar që rruga të mbetet njëkahore për qarkullim, duke e ngushtuar apo zvogëluar gjerësinë e vendkalimit të këmbësorëve, ky ngushtim drejtpërdrejt do të ndikojë në rritjen e sigurisë për faktin se rruga dhe koha e kalimit në vendkalim të këmbësorëve është më e shkurtër, dhe njëherë i deliron që ngasësit ta zvogëlojnë shpejtësinë në afërsi të vendkalimit.



Figura 15. Zgjidhja ideore duke përdorur ishuj ndarës



Figura 16. Lokacioni i propozuar për qetësimin e trafikut me ishuj ndarës në afërsi të një shkolle fillore

4.3. Qasja për njerëz me mobilitet të zvogëluar

Sipas Ligjit për Ndërtim (LN) Nr. 04/L-110, komunat janë përgjegjëse për implementimin e ligjeve dhe udhëzimeve administrative lidhur me përshtatshmërinë e infrastrukturës për persona me mobilitet të zvogëluar (aftësi të kufizuara). Ato gjithashtu janë përgjegjëse për zhvillimin e PKO (Planin Operativ Kombëtar) për implementimin e SKPAK (Strategjisë Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara), që do të aprovohet në Kuvendin Komunal.

Sipas planit të veprimit për zbatimin e strategjisë kombëtare për persona me aftësi të kufizuara, komunat duhet të ndërmarrin aktivitete të caktuara që ndërlidhen me objektivin e pestë të strategjisë.


Qyteti i Rahovecit karakterizohet me trotuare të mangëta dhe të ngushta, mirëpo edhe në ato segmente ku ka trotuare nuk janë respektuar kriteret për qasje të njerëzve me mobilitet të zvogëluar, për ta arritur këtë më poshtë janë dhënë kriteret për realizimin e këtyre rampave për qasje në trotuare.

Përgjatë rrugës kryesore të qytetit janë tërhequr në të dy anët mirëpo nuk janë të ekzekutuara pjesë-
sat për qasje të njerëzve me mobilitet të zvogëluar, andaj për të mundësuar qasjen e lehtë nevojitet
që në të gjitha vendkalimet e këmbësorëve të implementohen këto rampa sipas kritereve teknike
standarde.

Figura 18. Një vendkalim i këmbësorëve ku duhet të sigurohet qasje



Figura 17. Kriteret teknike për qasje në tërhequr për personat me mobilitet të zvogëluar



4.4. Përshtatja e infrastrukturës për biznese

Rruga kryesore e qytetit “Xhelal Hajda”, është rrugë me dy shirita për lëvizje në të dy kahjet. Para disa viteve rruga ka qenë njëkahore, një shirit për lëvizje një për parking të mjeteve, mirëpo pas analizave të bëra nga zyrtarët komunal kanë ardhur në përfundim se rruga përsëri duhet të kthehet në dykahore, dhe njëherit ka qenë edhe kërkesë e bizneseve të shtrira përgjatë rrugës të cilat e zhvillojnë aktivitetin e tyre të përditshëm, të cilët kanë nevojë për furnizime ditore.

Pasi që trupi i rrugës i ka 7m gjerësi me nga 3.5m për secilin shirit, është e mjaftueshme për t’u ndaluar mjeti nëse merren edhe 80cm nga hapësira në mes të drunjëve. Në figurën e mëposhtme është dhënë në mënyrë të detajuar ideja për ndaljen e automjeteve me kohë të limituar, për shërbime të shkurtra në lokalet përgjatë rrugës.



Figura 19. Ideja për ndaljen e automjeteve me kohë të limituar në rrugën “Xhelal Hajda”

Në këtë mënyrë do të krijohet një hapësirë për ndaljen e mjeteve pa e penguar qarkullimin e tyre në rrugën kryesore, duke e marrur një hapësirë të pa shfrytëzuar në mes të drunjëve. Ky intervenim shihet të jetë i nevojshëm që të krijohet një infrastrukturë më e mirë për biznese dhe të mos pengohet rrjedha normale e qarkullimit.

4.5. Rregullimi i vendndaljeve të autobusëve

Të gjitha nisjet si për linjat urbane - periferike ashtu edhe për ato ndër urbane në qytetin e Rahovecit realizohen nga stacioni i autobusëve. Mirëpo kompanitë auto transportuese, gjithashtu edhe udhëtarët nuk e respektojnë këtë pasi që ndalen respektivisht presin autobusët në pika të ndryshme të qytetit pa ndonjë infrastrukturë adekuate për ndalje apo pritje. Duke e parë nevojën e qytetarëve së bashku me grupin punues kemi ardhur në përfundim që disa vendndalje ilegale të cilat e pengojnë rrjedhën normale të qarkullimit të legalizohen në ato vende që nuk do ta pengonin dhe të krijohet një infrastrukturë e sigurtë për pritjen e autobusëve.

Edhe pse koha e udhëtimit nga pika të largëta deri tek stacioni nuk është shumë e madhe dhe mund të realizohet edhe në këmbë, përsëri kemi menduar që qytetarëve t'i ofrohet një shërbim me kualitet sa i përket transportit.



Figura 20. Vendndaljet e propozuara në qendër të qytetit



Figura 21. Vendndaljet e propozuara në dalje të qytetit

Kështu që është menduar që të krijohen dy vendndalje të autobusëve një në qendër të qytetit, tek semaforët si në figurën 20 dhe tjetri në dalje të qytetit në rrugën rajonale R204 figura 21.

Pasi që ndaljet ilegale nuk janë të përshtatshme si për nga aspekti i sigurisë ashtu edhe për nga ai funksional, kjo është arsyeja kryesore se pse duhet të krijohet një infrastrukturë adekuate me siguri maksimale për të gjithë pjesëmarrësit.

4.6. Vendosja dhe mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal

Gjendja e sinjalizimit në qytetin e Rahovecit nuk është e mirë, për këtë ka nevojë që të përsëritet dhe të vendoset në vendet ku mungon. Gjatë realizimit të vendosjes së shenjave duhet të respektohen të gjitha standardet e parapara me udhëzimin administrativ të Kosovës.

Në një kontekst të tillë, sinjalizimi i trafikut (horizontal, vertikal dhe plotësues) duhet të ofrojë informacionet e duhura dhe lexueshmëri të mirë në të gjitha kushtet atmosferike dhe të shikueshmërisë (ditë, natë, lagështirë, thatësi, mjegull), dhe të garantojnë informacion të plotë në drejtimin e automjetit. Një sinjalistikë e qartë dhe efikase është dhe elementi kyç për përmirësimin efektiv të sigurisë rrugore.

Sinjalizimi horizontal, është i pakët dhe janë evidentuar shumë probleme të shtrirjes dhe mirëmbajtjes. Këto probleme janë shkaktuar nga qëndrueshmëria e dobët e mbulesës së rrugëve dhe nga prezenca e pluhurit e shkaktuar nga rrugët e pa asfaltuara dhe nga trotuaret e pa shtruara ose në një gjendje jo të mirë e rrugëve.

Sinjalizimi vertikal, duhet të kenë një afat teknik përdorimi prej jo më pak se shtatë vjet. Gjithashtu sinjalet vertikale duhet të jenë homogjene, duke mënjanuar fenomenët ku janë vendosur sinjale të vogla dhe të mëdha pa ndonjë kriter të veçantë, shpesh lartësitë nuk janë në përputhje me rregullat e vendosjes, janë shumë të pakta dhe disa herë jo në vende shumë të dukshme.

4.7. Ndërtimi i rrugëve tranzite

Aktualisht në qytetin e Rahovecit rruga kryesore e cila e përshkon qendrën e qytetit është e vetmja rrugë e cila i plotëson kriteret për qarkullimin e mjeteve të rënda, me këtë nënkuptohet se nuk ka ndonjë alternativë tjetër për ri-organizimin e qarkullimit në qytet. Lëvizja e mjeteve komerciale në qendër drejtpërsëdrejt ndikon edhe në sigurinë e këmbësorëve kur dihet se rruga në fjalë nuk ka trotuare adekuate, dhe pjesërisht të ndërprera, ku në këto raste lëvizja e këmbësorëve bëhet në shtresën qarkulluese si e përbashkët me të gjitha mjetet tjera.

Në planin zhvillimor dhe rregullative është paraparë që të ndërtohen rrugët tranzite ku ajo në pjesën veriore tashme është e trasuar dhe është përfunduar, e cila lidhë rrugët rajonale R204, R110 dhe R117. Me këtë segment rrugor do të mundësohet ri-orientimi i automjeteve komerciale, që ta shmangin qendrën e qytetit.

- Rruga Rahovec-Hamoc-Fortesë, rrugë që lidh dy rruge rajonale
- Rruga kater korsi, Rahovec-Xerxe si dhe nga rrethrotullimi ne hyrje te qytit deri te rruga transite eshte ne ndertim shiriti i 3 te rrugor.

Figura 23. Rrugët tranzite në pjesën jug-lindore të qytetit



Aq më shumë do ta lehtësonte qarkullimin edhe ndërtimi i rrugës tranzite në pjesën jug-lindore të qytetit, me këtë do të ishte përmbyllur qarkorja e jashtme e qytetit e cila do ta kishte mundësuar një qasje shumë më të shpejtë dhe më të lehtë në qytet. Një pjesë e kësaj rruge është ndërtuar dhe është në ndërtim e sipër krejtësisht gjatë investimeve për të lidhur këtë. Në figurën 23 me ngjyrë të kuqe është shënuar traseja ekzistuese mirëpo, disa parametra gjeometrikë nuk janë shumë të favorshëm për qarkullimin e mjeteve komerciale, andaj së bashku me grupin punues është menduar që të shqyrtohet mundësia e lidhjes së këtyre dy pikave me trase të re, e cila është e drejtë edhe shumë e favorshme për qarkullim.

Figura 22. Rruga tranzite në pjesën veriore



4.8. Rritja e sigurisë në udhëkryqe me rrugë magjistrale

Gjatë analizës së gjendjes ekzistuese kemi arritur në përfundim se kemi një numër të konsiderueshëm të udhëkryqeve që mund t'i konsiderojmë me rrezikshmëri të lartë, kjo për faktin se ka ndodhur një numër i konsiderueshëm i aksidentëve. Këtu bëjnë pjesë disa kryqëzime me rrugë magjistrale siç janë në fshatin Xërxë, fshatin Krushë e Madhe, rrethrotullimi në hyrje të qytetit. Të gjitha këto pika duhet të ri-projektohen apo të vendosen masa dhe mënyra të tjera të qarkullimit.



Figura 24. Disa nga kryqëzimet e rrezikshme me rrugë magjistrale

Të gjitha kryqëzimet e lartpërmendura, por edhe disa tjera kanë nevojë për një analizë gjeometrike, dhe funksionale me qëllim të rritjes së sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit.

Figura 25. Qarkullimi njëkahorë në rrugët kryesore të qytetit

Figura 26. Disa skenar të mundshëm për orientimin e parkullimit njëkahorë në qytet



5. PLANI I VEPRIMIT

Nëse analizohen faktorët kyç që çuan shumë qytete evropiane në hartimin e planeve të mobilitetit urban këtë alternativë për lëvizje mund ta kuptojmë po kaq të vlefshme edhe për komunën e Rahovecit. Është pikërisht trendi i 20 viteve të fundit në Kosovë për rritjen e shkallës së motorizimit, dhe nevoja që të ndryshohet qasja për analizën e lëvizshmërisë në qytet. Duke e parë këtë trend të rritjes së mjeteve të motorizuara patjetër që duhet të akomodohen në rrjetin ekzistues, i cili nuk ishte i planifikuar për këtë shkallë të motorizimit. Tani sfida kryesore e inxhinierëve mbetet që të ruhet balanca në mes të mjeteve motorike dhe atyre të pa motorizuara, duke i akomoduar në infrastrukturën ekzistuese, mirëpo duke mos bërë asnjëherë kompromis për zvogëlimin e sigurisë.

Sfida është të gjenden mënyra për të promovuar dhe ruajtur kulturën e ecjes, ngasjen e biçikletës qasjen e lirë dhe të sigurt për të gjithë pjesëmarrësit në trafik dhe transferimin e praktikave inovative të përshtatshme në shërbim të mobilitetit në komunën e Rahovecit.

Veprimi 1: Caktimi i zyrtarit për mobilitet urban

Në kudër të drejtorisë për shërbime publike është e nevojshme të caktohet një zyrtar për mobilitet urban, i cili ka për detyrë të përgatis një program për menaxhimin e mobilitetit urban që përfshinë më shumë informata, fushata ndërgjegjësimi, promocion, marketing, koordinim dhe organizim.

Veprimi 2: Rritja e sigurisë në trafik - siguria në rend të parë

Edukimi lidhur me rregullat e trafikut dhe pjesëmarrjen e sigurt në trafik. Drejtorja për Shërbime Publike së bashku me Drejtorinë e Arsimit dhe Policinë, të përgatisin materialin e nevojshëm dhe të organizojnë ligjërata për edukimin në trafik në komunën e Rahovecit. Ligjëratat kryesisht të mbahen nga profesionistë të fushës dhe të organizohen në shkollat fillore dhe të mesme.

Veprimi 3: Promovimi i lëvizjeve të pa motorizuara

Të organizohen fushata ndërgjegjësimi dhe promovimi të lëvizjeve të pa motorizuara. Të bëhet promovim mediatik në nivel lokal (TV lokale, media elektronike etj). Të shfrytëzohen ngjarje të caktuara për promovimin e lëvizjeve të pamotorizuara, si java evropiane e mobilitetit (16-22 shtator), dita pa makina etj. Gjatë kësaj jave në shumë vende, mbahen me mijëra aktivitete për promovimin e lëvizjeve të pamotorizuara. Është i nevojshëm krijimi i partneriteteve ndërmjet Komunës dhe shkollave (mundësisht edhe me përfshirjen edhe të ndonjë OJQ-je) me qëllim të krijimit të politikave më të përshtatshme dhe promovimin lëvizjeve të pamotorizuara.

Veprimi 4: Përshtatja e infrastrukturës për persona me aftësi të veçanta

Drejtorja e Shërbimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanizmit dhe në partneritet me organizatat përkatëse për persona me aftësi të veçanta, në mënyrë që në të gjitha vendet e kalimeve në rrugë dhe në vendkalimet për këmbësorë, të merren masa adekuate në përshtatje me kriteret teknike, që vendkalimet e këmbësorëve t'u mundësojnë qasje edhe personave me mobilitet të zvogëluar.

1	Ndërtimi i ishujve për rrëfjen e sigurtë në afërsi të shkollave	Rregullimi i qarkullimit me qëllim të rrëfjes së sigurtë	Qelësimi i trafikut	Komuna e Rahovecit	1	2000 /shull 2 x 2000 = 4000 €	2023 + 2024
2	Sinjalizimi horizontal dhe vertikal	Vendosja, përmirësimi dhe mirëmbajtja e sinjalistikës rrugore	Nr. i shenjave të vendosura dhe gjatësia/ sipërfaqja e sinjalizimit horizontal	Komuna e Rahovecit	1	16 000 20 000 20 000 20 000 20 000	2023 2024 2025 2026 2027
3	Krijimi i hapësirave për lëvizjen e sigurtë të këmbësorëve në rrugët ekzistuese	Shenjëzimi i tyre, ndarja e tyre nga shiritat qarkullues	Gjatësia e tyre	Komuna e Rahovecit	2	5000	2023
4	Ndërtimi dhe mirëmbajtja e trotuarave	Krijimi i hapësirave të sigurtë për lëvizje të këmbësorëve	Gjatësia e trotuarave të ndërnuara	Komuna e Rahovecit	1	100 000 50 000 50 000 50 000 50 000	2023 2024 2025 2026 2027
5	Infrastruktura rrugore për personave me aftësi të veganta	Përbërja e infrastrukturës rrugore për personave me mobilitet të zvogëluar	Gjendja e infrastrukturës rrugore pas realizimit	Komuna e Rahovecit	1	3000 10 000	2023 2024-2026
6	Riorientimi i qarkullimit	Kahëzimi i trafikut	Infrastruktura e re e krijuar	Komuna e Rahovecit	2	4000	2023
7	Ndërtimi i stacioneve të autobusëve	Përmirësimi i kushteve të trafikut ndërruan – dhe urbano periferik	Numri i stacioneve të ndërnuara	Komuna e Rahovecit	1	4500 2 vendndalje	2023
8	Krijimi i vend-ndaljeve në rrugën Xhelal Hajda	Përbërja e infrastrukturës për bizneset	Numri i vend-ndaljeve	Komuna e Rahovecit	1	300 €/vend-ndalje 5000 për 15 vendndalje	2023 - 2024
9	Ndërtimi i rrugëve tranzite – pjesa veriore, Suharekë – Prishtinë, ndërtimi i rrugës 3 shiritore "rruga e UCK-se"	Krijimi i rrugëve të reja me qëllim të largimit të automjeteve komerciale nga qendra	Riorientimi i qarkullimit	Komuna e Rahovecit Ministria e Infrastrukturës	2	1,500,000.00	2023 2024 2025

1 Rëndësia e masave: 1- urgjente, 2 – mesatare, 3- e ulët

Hyrie	Agjendia e krishures	Vizioni/Qeshilevet	Plani i mobilitetit	Plani i varurvet	Planësimi strategjik	Plani financiar	Monitorimi/mbikëtimi	Anësi
10	Ri-projektimi i udhëkryqeve me rrugën magjistrale – me qëllim të rritjes se sigurisë Udh. Xërxë Udh. Krushë Udh.Rahov.	Rritja e sigurisë në udhëkryqë	Format e reja të rregullimit	Komuna e Rahovecit Ministria e Infrastrukturës	1	150 000 150 000 150 000	2023	
11	Ri-projektimi i udhëkryqeve me rrugën magjistrale – me qëllim të rritjes se sigurisë Udhëkryqët në rrugët rajonale Prishtinë R 204 Suharekë R 117 Xërxë R 110	Rritja e sigurisë në udhëkryqe	Format e reja të rregullimit	Komuna e Rahovecit Ministria e Infrastrukturës	1	-	2023 - 2025	

6. VLERËSIMI STRATEGJIK NË MJEDIS (VSM)

Deklaratë e arsyeimit për përcaktim për mos përgatitjen e raportit të vlerësimit strategjik për mjedis, për planin e mobilitetit (PM) në komunën e Rahovecit.

6.1. Përmbledhje e PM

Komuna e Rahovecit, duke ju falënderuar mbështetjes së projektit të pare për mobilitet nga ana e DEMOS-it, ka përgatitur Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm (PM). Fillimisht është krijuar Grupi Punues i përbërë nga përfaqësues të palëve të ndryshme të interesit, përfaqësues të drejtorive relevante nga Komuna e Rahovecit.

Një rol të rëndësishëm në procesin e përgatitjes së PM kanë luajtur ekspertët e angazhuar nga DEM-OS, të cilët kanë bashkëpunuar ngushtë me ekspertët komunal, në identifikimin dhe përkrahimin e situatës aktuale lidhur me qarkullimin rrugor, analizën financiare dhe mundësitë ekonomike financiare për përmirësimin dhe mundësimin e një mobiliteti të qëndrueshëm, përkufizimin e objektivave, përkufizimin e veprimëve dhe aktivitetëve që duhet të ndërmerren për një mobilitet gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm.

Plan i Mobilitetit përfshinë:

- sigurimin e qasjes me të lehtë për lëvizjet ditore dhe shërbime tjera;
- përmirësimin e shkallës së sigurisë;
- zvogëlimin e ndotjes së ambientit;
- rritjen e efikasitetit dhe ekonomicitetit gjatë transportit të njerëzve dhe të mallrave;
- rritjen e atraktivitetit dhe kualitetit të mjedisit urban.

Plan i Mobilitetit nuk përfshinë:

- ndërtimin e rrugëve të reja (përveç tranzitit i cili nuk do të jetë më i gjatë se 3 km);
- ndërtimin e infrastrukturës përcjellëse siç janë: rrethrotullimet, nënkallimet apo mbikallimet;
- projekte të tjera, për të cilat sipas ligjit do të kërkohej vlerësimi i ndikimit në Mjedis.

6.2. Referenca Ligjore e konsultuar për përcaktim

Ligji për Vlerësim Strategjik Mjedisor, Nr. 03/L-230,

Neni 3

1. VSM për planet dhe programet bëhet atëherë kur ekziston mundësia që realizimi i tyre të shkaktojë dëme të konsiderueshme në mjedis.
2. Hartimi i raportit për VSM është i detyrueshëm për planet dhe programet nga fusha e planifikimit hapësinor dhe urbanistik, në shfrytëzimin e tokës, bujqësisë, pylltarisë, peshkatarisë, energjetikës, industrisë, minierave, **komunikacionit**, menaxhimit të mbeturinave, menaxhimit të ujërave, telekomunikacionit, turizmit, të cilat japin kornizën për zhvillimin e ardhshëm të projekteve të cilat i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis në përputhje me Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis si dhe për planet dhe programet të cilat, duke marrë parasysh lokacionin në të cilin realizohen, mund të ndikojnë në zonat e mbrojtura, në habitatet natyrore dhe në florën e faunën e egër.

Përcaktimi për të mos përgatitur raport të VSM për Planin e Mobilitetit (PM) në komunën e Rahovecit është në përputhje me nenin e lartë përmendur. Pika 2 e këtij neni potencon se **“... VSM është i detyrueshëm për planet nga fusha e ... komunikacionit...”**; Por, në pjesën e dytë të po këtij paragrafi vazhdohet **“... të cilat japin kornizën për zhvillimin e ardhshëm të projekteve të cilat i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis për përputhje me ligjin...”**

Neni 5 Përcaktimi i nevojës për VSM,

1. Autoriteti përgjegjës duhet që të përcaktoj nga hulumtimi i secilit rast veç e veç, mbështetur në kriteret e Shtojcës 1, për planet ose programet referuar në nenin 3, paragrafi 3 dhe 4 i këtij ligji, se a kanë ndikim të theksuar në mjedis në mënyrë që ti nënshtrohen VSM.

Grupi punues për përgatitjen e PM, duke ju referuar provizionit të lartë përmendur, ka shqyrtuar PM duke krahasuar me kriteret e shtojcës 1 të ligjit për VSM, dhe nga ku gjithashtu është konstatuar se PM nuk pritet të ketë ndikime të mëdha në mjedis, dhe si i tillë nuk i nënshtrohet procedurës së VSM.

42 PLANI I MOBILITEITIT URBAN PER KOMUNEN E RAHOVECIT 2022-2027

2. Karakteristika të efekteve dhe të zonave që ka të ngjarë të ndikohen, duke pasur parasysh, në veçanti:

2.1. probabilitetin, kohëzgjatjen, frekuencën dhe natyrën e efekteve,	PM përfshinë periudhë 5 vjeçare (2022-2027). Gjatë këtyre viteve pritet të ketë rritje të efekteve të cilat do të jenë pozitive. (shih pikën 1.3)
2.2. natyrën kumulative të efekteve,	Plani nuk parasheh efektet cilat në kontekstin kumulativ do të rezultojnë me pasoja mjedisore. Përkundrazi me ri-orientimin e trafikut, shtimin e shtigjeve për biçiklist, rritja e sigurisë në rrugë do të ketë efekte pozitive në ngritjen e kualitetit të ajrit në përgjithësi dhe sigurisë në trafik për të gjithë pjesëmarrësit në veçanti.
2.3. natyrën ndërkuftare të efekteve,	Nuk do të ketë efekte negative ndërkuftare. Plani i Mobilitetit është i karakterit lokal. Priten efekte pozitive, por që do të jenë indirekte. Kjo do të rezultojë nga përmirësimi i qarkullimit rrugor dhe rritja e sigurisë në trafik, mundësimin e qasjes për persona me aftësi të kufizuara etj.
2.4. rrezikun e shëndetit të njeriut mbi mjedis (p.sh si shkak i aksidenteve),	
2.5. shkallën dhe shtrirjen hapësinore të efekteve (zona gjeografike dhe madhësia e popullsisë që mund të preken),	Efektet pozitive mjedisore të këtij plani , deri në fund të vitit 2027 do të prekin 80% të territorit dhe banorëve të komunës së Rahovecit.
2.6. vlerën dhe cenueshmërinë e zonës që ka të ngjarë të ndikohet si rezultat i,	Nuk është relevante për PM Rahovec.
2.6.1. karakteristikave të veçanta natyrore ose trashëgimisë kulturore,	Duke qënë se PM nuk parasheh ndërhyrje fizike (përveç ndërtimit të tranzitit), ndërtim të objekteve, infrastrukturës, prerje të pyjeve, zënie tokash, gërmime etj, nuk do të ketë dëmtim/degradim të zonave natyrore apo trashëgimisë kulturore.
2.6.2. standardeve mjedisore të tepërta dhe vlerave limit,	PM nuk parasheh projekte të cilat do të rezultojnë me emisione qoftë në ajër qoftë në ujë, e të cilat do të ishin subjekt i shqyrtimit në kontekstin e tejkallimit të standardeve apo vlerave kufitare.
2.6.3. përdorimit intensiv të tokës,	PM nuk parasheh zënie, apo përdorim të tokave të gjitha vepimet sipas objektivave do të bëhen në gjendjen ekzistuese, me përjashtim të ndërtimit të urës së lartëcekur, por që nuk do të ketë përdorim intensiv të tokës.
2.7. efektet mbi zonat ose sipërfaqet që kanë një status të njohur kombëtar, komunitar ose ndërkombëtar mbrojtës.	Komuna e Rahovecit shtrihet në mesin e rrugëve magjistrale Gjakovë – Prishtinë dhe Gjakovë – Prizren, si dhe atyre rajonale Malishevë – Gjakovë, dhe Rahovec – Suharekë. Konfiguracioni i terrenit është kodrinorë ku karakterizohet me dendësi shumë të madhe të vendbanimeve në disa lagje të qytetit, si rezultat i kësaj i kemi edhe rrugët shumë të ngushta të cilat përdoren nga të gjithë pjesëmarrësit në trafik. Në territorin e komunës së Rahovecit gjenden kanioni i Drinit të Bardhë dhe Parku Regjional i Mirushës të cilat kanë status të njohur kombëtar mbrojtës, por duke pasur parasysh që ky plan sheh intervenime/përmirësime vetëm në gjendjen ekzistuese dhe larg këtyre zonave mund të thuhet se nuk do të ketë ndonjë ndikim negativ i cili do të prekte këto dy zona si rezultat i këtij PM. Në anën tjetër edhe objektivat e caktuara në PM janë me efekt të karakterit pozitiv.

eguilim

7.1. Hyrje

Kapitulli financiar ka të bëjë me analizën e kapaciteteve buxhetore të komunës për periudhën kohore 2022-2027. Në bazë të të dhënave zyrtare komunale siç është Buxheti Vjetor i Komunës dhe Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2022-2024, si dhe trendeve relevante ekonomike-financiare. Në vijim janë paraqitur përilogaritë afat-mesme të trendeve të sipërpermendura të cilat mund të kenë ndikim në investimeve të planifikuara dhe mirëmbajtëse të nevojshme në fushën e mobilitetit komunal për periudhën 2022-2027.

Për më shumë, projektet e identifikuara në fushën e mobilitetit reflektojnë si prioritete të komunës për të njëjtën periudhë (2022-2027), dhe duke marrë parasysh kapacitetin buxhetor të komunës, si dhe trendet ekonomike, mbështetjen me grante nga buxheti qendror, dhe të hyrat vetanake të komunës. Gjithashtu, si burtim shtesë financimi janë identifikuar edhe segmenti i donatorëve, si mundësia e bashkë-financimit të projekteve të identifikuar.


7.2. Struktura e Buxhetit Komunal

Sig u potencua më sipër Buxheti i Komunës së Rahovecit për bazë ka Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH 2022-2024), ndërsa zërbërthimi i shpenzimeve është si vijon:

Tabela 1: Struktura Buxhetore e Komunës (2022-2024)


Viti	Buxheti komunal	Granti Qeveritar	Të hyrat vetanake	Investimet Kapitale
2021	14,548,823	13,487,730	1,061,093	3,905,770
2022	15,053,660	13,703,112	1,350,548	4,354,212
2023	17,548,240	16,102,637	1,445,603	5,651,323
2024	18,868,048	17,362,862	1,505,186	6,653,713

Nga grafiku Nr. 1 mund të shihet një mospërpulthje serioze në mes të ardhurave komunale të cilat tregojnë një varshmëri të madhe të buxhetit komunal në periudhën afatmesme.



Grafiku 1: Struktura e të ardhurave komunale

Nëse bëhet një krahasim në mes të hyrave vetanake të komunës dhe granteve qeveritare, nga grafiku 2 shihet qartë se grantet qeveritare përbëjnë pjesën dërmuese të buxheti më shumë se 85% të ardhurave të buxhetit të komunës së Rahovecit.



Grafiku 2: Struktura e të ardhurave komunale


Me qëllim që të shihet më mirë struktura e shpenzimeve komunale, është me rëndësi të veçohen investimet komunale, ku një pjesë të rëndësishme e përbëjnë investimet kapitale. Planifikimet e komunës për investime kapitale për vitet 2022 - 2024 janë si më poshtë:

Tabela 2: Investimet Kapitale (2022 - 2024)

Viti	Buxheti komunal	Investimet Kapitale
2021	14,548,823	4,354,212
2022	15,053,660	4,815,816
2023	17,548,240	5,651,323
2024	18,868,048	6,653,713


kur ato ishin në nivelin më të lartë për komunën.

Grafiku 3: Investimet e planifikuara kapitale



hën 2023-2025, siç mund shihet edhe nga tabela dhe grafiku i më poshtëm.

Grafiku 4: Trendi i të hyrave vetanake



7.3. Plani Investiv

Investimet e planifikuara në mobilitet janë të bazuara në nevojat e vlerësuara për përmirësimin e gjendjes aktuale. Plani i investimeve është i bazuar në burimet e financimit nga mjetet financiare të aplikueshme në komunë.

Objektivat e planifikimit të investimeve me qëllim të realizimit të planit janë të bazuara në parakushtet e përcaktuara:

- Përcaktimi i nevojave investive i bazuar në nevojat për mobilitet;
- Mundësia e financimit të investimeve të planifikuara bazuar në burimet e njohura të financimit;
- Ndarja e projekteve në bazë të prioriteteve të bazuar për përmirësimin e gjendjes në fushën e mobilitetit. Prioritetet e investimeve janë të planifikuara në tre grupe:
 - Urgjent
 - Mesatare
 - E ulët
- Rrjedha e parasë për investimet e planifikuara është bazuar në kohën e përfundimit të investimeve për detyrimet e kontraktuara me operatorët ekonomik të kontraktuar;
- Burimet e financimit të investimeve janë të arritshëm, janë të njohura për përmbushjen e investimeve të planifikuara;
- Investimet e planifikuara janë të përlogaritura sipas çmimeve aktuale sipas kategorive investive të planifikuara.

7.4. Analiza buxhetore e kostove investive kapitale

Investimet e planifikuara janë të bazuara në 8 projekte të shpërndara në kategori të përcaktuara.

Vlerësimi i projekteve e mundësia e realizimit të planit të investimeve për periudhën e planit 2022-2026 projektet janë të kategorizuara në disa grupe kryesore në varëshmëri prej natyrës së tyre. Investimet janë të bazuara në 5 kategori kryesore të investimeve:

- Siguria në komunikacion;
- Rregullimi i qarkullimit të automjeteve;
- Rregullimi i qarkullimit të këmbësorëve;
- Sinjalizimi;
- Infrastruktura për persona me mobilitet të zvogëluar.

Ndarja e investimeve do të mundësojë monitorimin e realizimit më të lehtë të planit, dhe ndikimin e realizimit të përmbushjes së objektivave të përcaktuara.

Tabela 3: Pasqyra përmbledhëse e planit të mobiliteit për periudhën 2022-2027

Kategoria	Vlera investive	Investimet në %
Signifika në komunikacion	900,000	44.8%
Rregullimi i qarkullimit Automjete	449,000	22.4%
Rregullimi i qarkullimit këmbësor	440,000	21.8%
Signalizim	150,000	7.46%
Infra. për njëzëz me nev. e veganta	71,000	3.54%
Total	2,010,000	100.0%

Investimente/Priorități	1 Lată	Mesatar	1 Ulei	Total
Vieira investimeve	1,039,000	449,000	-	2,010,000
No %	51.7%	22.3 %		100.0%


Burimet e financimit 2016-2020	2022	2023	2024	2025	2026	Total	Në %
Komuna Rahovec	350,000	200,000	165,000	95,000	90,000	900,000	44.8%
Ministria e infrastrukturës	300,000	300,000	200,000	100,000	139,000	1,039,000	51.7%
Donatorët				71,000		71,000	3.5%
Total	650,000	500,000	365,000	266,000	229,000	2,010,000	100%

7.5. Nevoja për investime të reja

Investimet e planifikuara janë të bazuara në burimet e financimit të qëndrueshëm, të cilat mundësojnë siguri në realizimin e investimeve. Investimet kapitale janë të planifikuara në bazë të buxhetit aktual. Vlera e investimeve në fushën e mobilitetit për periudhën 2022-2026 është përlogaritur në 2,010,000 Euro.

Tabela 4: Investimet e planifikuara në Mobilitet për periudhën 2022-2026

Investimet	2022	2023	2024	2025	2026	Total
Vlera Investive	650,000	500,000	365,000	266,000	229,000	2,010,000
Në %	32.3%	24,8%	18.1%	13.23%	11.39%	100.0%



Grafiku 5: Paraqitja grafike e strukturës investimeve për periudhën planifikuese 2022-2026

Investimeve për periudhën planifikuese janë të koncentruara në dy vitet e para të planit të mobilitetit (2022/2023), ndërsa në periudhën 2024-2026 janë në pjesëmarrje më të ulët.

- Investimeve e planifikuara për periudhën 2022/2023 në vlerë prej 1,150,000.00 Euro në përqindje 57.2%.
- Investimeve e planifikuara për periudhën 2024/2026 në vlerë prej 860,000.00Euro në përqindje 42.8%.

Tabela 5: Investimet e planifikuara në Mobilitet për periudhën 2022-2026

Investimet	2022/2023	2024/2026	Total
Vlera Investive	1,150,000	860,000	2,010,000
Në %	57.2%	42.8%	100.0%

Kategoria	2022	2023	2024	2025	2026	Total	Ne %
Siguria në komunikacion		600,000	300,000			900,000	44.7%
Rregullimi i qarkullimit të automjeteve	150,000	250,000	49,000			449,000	22.4%
Rregullimi i qarkullimit të këmbësorëve		200,000	240,000			440,000	21.9%
Sinjalizimi		50,000	40,000	40,000		130,000	6.4%
Sinjalet ndriquese		20,000				20,000	1.0%
Infrastruktura për persona me mobilitet të zvogëluar		71,000				71,000	3.6%
Total	150,000	1,191,000	629,000	40,000		2,010,000	100.0%

Tabela 7: Investimet e planifikuara në bazë të kategorive të investimeve për periudhën 2022-2026

Struktura e investimeve vënë në pah dominimin e kategorive: siguria në komunikacion, rregullimi i qarkullimit, pjesëmarrja e të cilëve është rreth 57.2% nga vlera e përgjithshme e investimeve të planifikuara. Ndërsa, kategoritë e tëra të investimeve kanë pjesëmarrje dukshëm më të vogëla.

7.6.1. Struktura e investimeve për periudhën 2022-2026


7.6. Vlerësimi i investimeve të reja në mobilitet

Investimet	Q1	Q2	Q3	Q4	Total	Ne %
2022	-	50,000	100,000	500,000	650,000	32.3%
2023	-	50,000	100,000	350,000	500,000	25 %
2024	-	-	100,000	265,000	365,000	18.1%
2025	-	-	100,000	166,000	266,000	13.23%
2026	-	-	100,000	129,000	229,000	11.39%
Total		100,000	500,000	1,410,000	2,010,000	100.0%

Tabela 6: Ryjedha e parase e investimeve të planifikuara për periudhën 2022-2026

Investimet në mobilitet janë ndikuar prej alokimit të buxhetit komunal si dhe burimeve të tjera të financimit të cilat sipas përvojës janë të alokuara në kuartalin e tretë dhe të katërt të viteve të investimeve.

Grafiku 6: Paraqitja grafike e strukturës së investimeve për periudhën planifikuese 2022-2026



7.6.2. Investimet e bazuara në prioritetet për periudhën 2022-2026

Kategoria e investimeve me prioritet - Të Lartë: pjesëmarrja e kategorisë në vlerë prej 1,191,000 EURO e shprehur në përqindje 59.2% nga vlera e përgjithshme e investimeve. Vlera mesatare e bazuar në projekt i këtij grupi është 148,875 i cili është më e ulët në krahasim me kategorinë e investimeve me prioritet mesatar. Përcaktimi i prioritetit të lartë të këtij grupi nënkupton një vëmendje të shtuar për realizimin e pa kusht të këtyre investimeve për arritjen e objektivave të përcaktuara. Realizimi me sukses i këtij grupi të investimeve ka ndikim në plotësimin e nevojave me ndikim në mobilitet.

Kategoria e investimeve me prioritet - Mesatar: Projektet e kësaj kategorie kanë pjesëmarrje në vlerë prej 669,000 EURO e shprehur në përqindje 33.2% nga vlera e përgjithshme të investimeve. Vlera mesatare e bazuar në projekt të këtij grupi është 83,625 Euro i cili është më i ultë në krahasim me kategorinë e investimeve me prioritet të lartë.

Kategoria e investimeve me prioritet – Të Ulët: nuk është vlerësuar asnjë investim në këtë kategori për periudhën e planifikuar 2022-2026.

Tabela 8: Investimet e planifikuara në bazë të prioriteve të vlerës mesatare për një projekt

Kategoria	I Lartë	Mesatar	I Ulët	Total
Vlera investimeve	1,341,000	669,000	-	2,010,000
Në %	66.7%	33.3%	0.0%	100.0%
Numri i projekteve	5	3	0	8
Mesatarja për një projekt	148,875	83,625		251,250

Projektet e vlerësuara në bazë të prioriteve janë bazë për monitorimin e aplikimit të planit si dhe ndikimin e planit në objektivat e përcaktuara të planit edhe për faktorët tjerë jo financiar.

Tabela 9: Investimet e planifikuara të bazuara në prioritet për periudhën 2022-2026

Kategoria	2022	2023	2024	2025	2026	Total
I Lartë	600,000	300,000	241,000		200,000	1,341,000
Mesatar	100,000	300,000	269,000	-	-	669,000
I Ulët	-	-	-	-	-	-
Total	700,000	600,000	510,000			2,010,000

Investimet planifikohen të financohen kryesisht nga dy burime:

- Buxheli komunal;
- Grantet qeveritare.

- Mirëpo grupi punues nuk ka përjashtuar mundësinë e financimit nga donatorët. Prandaj plani i mobilitetit lënë të hapur alternativa se një pjesë e projekteve të financohet nga donatorët.

- Financimi nga burimet e buxhetit Komuna e Rahovecit janë në vlerë prej 669,000 e shprehur në përqindje 33.3%. Mijetet nga buxheti komunal janë të angazhuara për gjatë të gjitha viteve të planit (2022-2026);

- Tabela 10: Burimet e financimit për periudhën e investimeve 2022-2026

Kategoria	Përqindje
Komuna Rahovec	33.3%
Grantet Qeveritare	66.7%

Grafiku 7: Paraqitja grafike e burimeve të financimit



Tabela 11: Tabela përmbledhëse e projekteve të planifikuara për periudhën e planifikuar 2022-2026 rjedha e parasë

Nr.	Projekti	Kategoria	Prioriteti	2022	2023	2024	2025	2026	Total
1	Ndërtimi i ishujve për rritjen e sigurisë në afërsi të shkollave	Siguria në komunikacion	I Lartë	2,000	2,000	-	5,000	-	9,000
2	Sinjalizimi horizontal dhe vertikal	Sinjalizimi	I Lartë	15,000	20,000	20,000	5,000	-	60,000
3	Krijimi i hapësirave për lëvizjen e sigurt të këmbësorëve në rrugët ekzistuese	Rregullimi i qarkullimit të këmbësorëve	Mesatar	-	-	-	20,000	-	20,000
4	Ndërtimi dhe mirëmbajtja e trotuareve	Rregullimi i qarkullimit të këmbësorëve	I Lartë	30,000	216,500	200,000	-	-	446,500
5	Infrastruktura rrugore për personat me mobilitet të zvogëluar	Infra. për persona me mobilitet të zvogëluar	Mesatar	3,000	2,500	2,500	-	-	8,000
6	Ndërtimi i kabinave të vendaljeve të auto- busëve	Rregullimi i qarkullimit të automjeteve	I Lartë	-	-	100,000	-	-	100,000
7	Krijimi i vendndaljeve në rrugën Xhelal Hajda	Rregullimi i qarkullimit të automjeteve	I Lartë	-	50,000	50,000	10,000	-	110,000
8	Ndërtimi i rrugëve tranzite dhe rregullimi i rrugëve në qytet	Rregullimi i qarkullimit të automjeteve	I Lartë	100,000	900,000	256,500	-	-	1,256,500
Total				150,000	1,191,000	629,000	40,000	-	2,010,000

Tabela 12: Tabela përmbledhëse e projekteve të planifikuara për periudhën e planifikuar 2022-2026 rjedha e parasë

Masat	Qëllimi	Burimet e Financimit	Prioriteti	2022	2023	2024	2025	2026	Total
Ndërtimi i ishujve për rritjen e sigurisë në afërsi të shkollave									
Ndërtimi i ishujve për rritjen e sigurisë në afërsi të shkollave	Qelësimi i trafikut	Komuna e Rahovecit	I Lartë	2,000	-	-	-	-	2,000
Ndërtimi i ishujve për rritjen e sigurisë në afërsi të shkollave	Qelësimi i trafikut	Komuna e Rahovecit	I Lartë	-	2,000	-	-	-	2,000
Sinjalizimi horizontal dhe vertikal									
Sinjalizimi horizontal dhe vertikal	Nr. i shenjave të vendosura dhe gjatësia/sipërfaqja e sinjalizimit horizontal	Komuna e Rahovecit	I Lartë	16,000	-	-	-	-	16,000
Sinjalizimi horizontal dhe vertikal	Nr. i shenjave të vendosura dhe gjatësia/sipërfaqja e sinjalizimit horizontal	Komuna e Rahovecit	I Lartë	-	20,000	-	-	-	20,000
Sinjalizimi horizontal dhe vertikal	Nr. i shenjave të vendosura dhe gjatësia/sipërfaqja e sinjalizimit horizontal	Komuna e Rahovecit	I Lartë	-	-	20,000	-	-	20,000

Sinjализimi horizontal dhe vertikал	Nr i shenjave të vendosura dhe gjatësia/sipërfaqja e sinjalizimit horizontal	Komuna e Rahovecit	I Latë	-	-	-	-	20,000	20,000
Sinjализimi horizontal dhe vertikал	Nr i shenjave të vendosura dhe gjatësia/sipërfaqja e sinjalizimit horizontal	Komuna e Rahovecit	I Latë	-	-	-	-	20,000	20,000

Masat	Qelimi	Burimet e Pri- Financialit orteti		2022	2023	2024	2025	2026	Total
Ri-orientimi i qarkullimit									
Prioritetimi i qarkullimit	Infrastuktura e re e krruar	Komuna e Rahovecit	Mesatar						
Ndërtimi i stacionëve të autobusëve									
Ndërtime i stacionëve të autobusëve	Numri i stacioneve të ndëtuara	Komuna e Rahovecit	i Lartë						
Krijimi i vendndaljeve në rrugën Xhelai Hajda									
Krijimi i vendndaljeve në rrugën Xhelai Hajda	Numri i vendndaljeve	Komuna e Rahovecit	i Lartë						
Krijimi i vendndaljeve në rrugën Xhelai Hajda	Numri i vendndaljeve	Komuna e Rahovecit	i Lartë						
Ndërtimi i rrugëve tranzite dhe rrugëve brenda zones urbane									

[illegible]

8. MONITORIMI DHE RISHIKIMI

8.1. Monitorimi i planit të mobilitetit urban për vitin 2023

Masat		SIGURIA NË TRAFIK - Masat për qetësimin e trafikut	
Lokacioni		Rruga _____	
Karakteri		magjistrale/rajonale	lokale
1	Veprimet e pritura	- Ishujt në vendkalim për këmbësorë	- gunga në rrugë
		- Masat tjera _____	- shirita vibrues
		1. _____	- platforma
			- disqe nga goma
Realizimi			- vetëm sinjalizim
	PO		
	JO		
	PJESËRISHT		
A është e nevojshme të përdoren masa tjera shtesë për qetësimin e trafikut			
		PO	JO

Shënime shtesë:

Rahovec, më _____


Përgjegjësi i monitorimit të PMU:

Aneksi I

Rëndom para gungës së parë të serisë ka shenjë për parandalim ose shenjë në rrugë. Sipas rregullave, këto elemente artificiale vihen nëpër gjysmën apo tërë gjërësinë e shiritit qarkullues të rrugës. Nëse vihen radhazi, distanca ndërmjet tyre mund të jetë prej 20 deri me 60 m, varësisht nga situata.


Varësisht nga kufizimi i shpejtësisë, të njëjtat janë me dimensione sig vijon:

- Deri me 50 km/h, gjërësia e tyre nuk guxon të jetë më e vogël se 60 cm, ndërsa lartësia nuk guxon të jetë më shumë se 3 cm;
- Deri me 40 km/h, gjërësia e tyre nuk guxon të jetë më e vogël se 90 cm, ndërsa lartësia nuk guxon të kalojë në 5 cm dhe
- Deri në 30 km/h, gjërësia e tyre nuk guxon të jetë më e vogël se 120 cm, ndërsa lartësia nuk guxon të kalojë në 7 cm.



Aneks II

Vendndalja e Autobusëve



PLAN I MOBILITETIT URBAN
PËR KOMUNËN E RAHOVECIT
2022-2027



The first part of the paper discusses the importance of the research and the objectives of the study. It then presents a literature review of the existing research on the topic. The methodology section describes the research design and the data collection process. The results section presents the findings of the study, and the conclusion section summarizes the main findings and provides recommendations for future research.

The second part of the paper discusses the importance of the research and the objectives of the study. It then presents a literature review of the existing research on the topic. The methodology section describes the research design and the data collection process. The results section presents the findings of the study, and the conclusion section summarizes the main findings and provides recommendations for future research.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 pika 1, nenit 17 shkronja (a) dhe nenit 40 pika 2 shkronja (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.4 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.12.2022 miraton këtë :

V E N D I M

Për miratimin e planit të punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2023

1. Me këtë vendim **miratohet** agjenda dhe plani i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2023.
2. Shtojcë e këtij vendimi është edhe plani i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2023.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB).
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **MAPL-së, dhe**
- **Arkivit.**

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

01-Nr. ____/22
Datë: 28.12.2022

Defrim Kafexhiu

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna Rahovec
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Predsednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT I KOMUNES / KABINETI PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 3098 Nr. i faq./Br.sht./No.pg 81
Data/Datum/Date 8 / 12 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit Nr. 03/L040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës:

PROPOZON

1. Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit që të merret vendim për miratimin e agjendës dhe Planit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2023.
2. Pjesë përbërëse e këtij propozimi është agjenda dhe Plani i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2023.
3. Për zbatimin e këtij propozimi do të kujdeset Sekretaria e Kuvendit.
4. Ky propozim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me propozim të njoftohen:

- **Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,**
- **Sekretaria e Kuvendit, dhe**
- **Arkivi.**

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECI / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNES / MUNICIPAL MAYOR

Smajl Latifi
Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROJEKT PLANI PUNËS PËR KËSHILLIN KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI JANAR-DHJETOR 2023

Dhjetor - 2022

Hyrje

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) funksionon duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

Plani Vjetor i Punës së KKSB-së, përcakton objektivat dhe aktivitetet të cilat do të ushtrohen nga anëtarët e KKSB-së në përmbushje të qëllimit të funksionimit të këtij mekanizmi. Ky plan synon që të identifikojë qëllimet, aktivitetet dhe rezultatet, përkatësisht caktimin e përgjegjësiave për kryerjen e detyrave të përcaktuara me udhëzimin administrative për KKSB-në.

Roli i KKSB-së në komunën e Rahovecit është i rëndësishëm sepse grumbullon shqetësimet e qytetarëve nëpërmjet përfaqësuesve të bashkësive etnike, fetare, sociale, profesionale dhe ato shqyrtohen bashkë me përfaqësuesit institucional të komunës dhe të organeve të sigurisë dhe tentohet të zgjidhen në dobi të qytetarëve.

KKSB në Rahovec drejtohet nga kryetari i komunës së z. **Smajl Latifi** në bashkëpunim të ngushtë me komandantin e policisë së Stacionit policor në Rahovec dhe në bashkëveprim të vazhdueshëm me përfaqësuesit e bashkësive fetare myslimane, përfaqësues të organizatave jo qeveritare, të biznesit dhe ekupe për siguri publike në bashkësi, nën monitorim autoriteteve nacionale siç është Departamenti i Sigurisë Publike dhe autoriteti i inspektoratit të policisë si dhe të organizatave të ndërkombëtare si OSBE, KFOR dhe UN.

Nëpërmjet KKSB-së arrihet të kuptohen shqetësimet e të gjithë qytetarëve në komunën e Rahovecit dhe të ndërmerren hapa konkret për zgjidhjen e atyre problemeve. Duke qenë të bindur në rolin e rëndësishëm që ka KKSB, komuna e Rahovecit është në maksimum e përkushtuar që plani i punës së KKSB-së të zbatohet me përpikëri.

Çdo komunë është e obliguar të themelojë Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi. Plani punës së KKSB kalon përmes mbledhjes së KKSB-së, më pastaj themelohet me vendim të kuvendit të komunës dhe kryesohet nga Kryetari i Komunës. Mandati i KKSB-së është 4 vite dhe korrespondon me periudhën e mandatit të Kuvendit të Komunës. Në mënyrë që me sukses të kryej misionin e vetë, duke u bazuar në udhëzimin administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL.

Qëllimi i planit të punës

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi nuk do të kufizohet vetëm në detyrat e përcaktuara me këtë plan, por do të jetë aktiv edhe në përcjelljen e zhvillimeve të përditshme shoqërore, për t'i identifikuar dhe adresuar problemet e qytetarëve nga fusha e sigurisë së përgjithshme dhe trajtimin e kërkesave të tyre të kësaj natyre.

Plani i punës i KKSB-së ka për qëllim përmirësimin e sigurisë së qytetarëve duke u kujdesur për problematika të cilat e prekin drejtpërdrejtë jetën e tyre. Plani i punës ofron qartësi në veprim, definon problematikat dhe afatet që do të trajtohen gjatë vitit, paraqet rezultatet e pritura, tregon se kush janë autoritetet përgjegjëse për të marrë masa në zgjidhjen e problemeve.

Objektivat

Duke u bazuar në udhëzimin administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL KKSB duhet të mbajë së paku 6 mbledhje gjatë vitit. Në këto mbledhje shqyrtohen problemet të cilat synojnë përmirësimin e sigurisë së qytetarëve. Duke u bazuar në këto udhëzime, KKSB në Junik për vitin 2022, përveç mbajtjes së 6 mbledhjeve të obligueshme, synon që të shqyrtojë këto çështje të sigurisë:

Aktivitetet

Për t' arritur këto objektiva, Anëtarët e KKSB do të ndërmarrin këto aktivitete:

1. Do të monitorojnë në vazhdimësi gjendjen e sigurisë në të gjithë territorin e komunës;
2. Do të mbledhin shënime, fakte dhe do të raportojnë në mbledhjet e KKSB-së për secilin problem të vëzhguar, dëgjuar apo supozuar;
3. Do të mbajnë takime me qytetarë, këshilla shkollë, grupe qytetarësh, organizata joqeveritare (OJQ) dhe do të dëgjojnë problemet e tyre;
4. Do të adresojnë problemet në organet kompetente, si dhe krijimin e partneritetit dhe iniciativave të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve të sigurisë në çdo bashkësi;
5. Do të mbajnë evidenca për problemet e shqyrtuara dhe për progresin e arritur në zgjidhjen e problemit;

Rezultatet e pritura

Duke vepruar siç është cekur më sipër dhe duke u përqendruar në objektivat e shënuara më sipër situata do të ndryshojë në të mirë të qytetarëve. Për qytetarët do të sigurohet më shumë siguri në të gjitha fushat.

Përmbledhje

Në këtë plan të punës janë paraqitur informacione për KKSB-në, aktet që e rregullojnë veprimtarinë e saj. Po ashtu është paraqitur qëllimi i planit të punës, objektivat e planit, aktivitetet që do të ndërmerren nga anëtarët e KKSB-së për t'i arritur objektivat si dhe janë paraqitur rezultatet e pritura dhe afatet kohore.

Afati kohor

Plani i punës Janar deri më Dhjetor 2022.

**Pikat e Rendit të ditës Rreth Planit TË Punës së Këshillit Komunal Për Siguri në Bashkësi
2023**

Nr. Re.	Muaji	Çështjet që shqyrtohen	Përshkrimi i shkurtër i iniciativës/projektit	Përgatit	Shqyrton	Specifikat Buxhetore
1.	JANAR 2023	1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; 2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit; - Analizë e sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit për vitin paraprak, - Siguria ne Trafik, - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla, - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit, - Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e Komunës së Rahovecit, - Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore. 3. Të Ndryshme.	Kryetari i komunës dhe Komandanti i policisë raporton para anëtarëve të KKSB-së, rreth gjendjes së sigurisë për muajt raportues.	Kryetari, Policia dhe Koordinatori	Anëtarët e KKSB-së	00.00 €
2.	MARS 2023	1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; 2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit, - Trotualet, lirim i tyre dhe shenjat sinjalizuese. - Qentë endacak. - Siguria ne Trafik, - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për	Kryetari i Komunës dhe Komandanti i Policisë raporton para anëtarëve të KKSB-së, rreth gjendjes së sigurisë për muajt raportues.	Kryetari i Komunës Policia Dhe Koordinatori i KKSB-së	Anëtarët e KKSB-së	00.00 €

	siguri në shkolla, - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit, - Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e Komunës së Rahovecit, - Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore.				
	3. Organizimi i Takimit Publik me qytetarët dhe kryetarët e fshatrave dhe lagjeve urbane,	Shqyrtimi i problemeve të sigurisë të cilat i prekupojnë banorët	Kryetari i Komunës, anëtarët e KKSB-së	Anëtarët e KKSB-së	100.00 €
	4. Të Ndryshme.			Anëtarët e KKSB-së	
3.	1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;	Kryetari i komunës, Komandanti i Policisë, drejtori i DKA-së dhe drejtori i Emergjencave	Kryetari i Komunës, Policia dhe Koordinatorin i KKSB-së	Anëtarët e KKSB-së	00.00 €
	2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit,	Shqyrtimi i dukurive negative, me theks të veçantë trajtimi i objekteve jo të sigurta në Komunën e Rahovecit,			
	- Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla, - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit, Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e Komunës së Rahovecit, Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore. - Parapërgatitja dhe vetëdijësimi i qytetarëve për parandalimin nga zjarri gjatë sezonit veror,	anëtarëve të KKSB-së, rreth gjendjes së sigurisë për muajt raportues			
	3. Identifikimi i çështjeve problematike që ndikojnë në sigurinë publike ndëretnike,	Organizimi i takimeve publike me komunitetet pakicë në Rahovec	Kryetari, Policia, Koordinatorin i KKSB-së	Anëtarët e KKSB-së	100,00 €

	4. Të Ndryshme.			Anëtarët e KKSB-së	
4.	1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; 2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit, - Prishja e qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e pa përgjegjshëm, - Masat për parandalimin e lëmshë-kërkuesit, - Plani operativ për sezonin e pushimeve të mërgimtarëve dhe dasmave, - Siguria në Trafik, - Gjendja e sigurisë në shkolla, - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla, - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit, - Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e Komunës së Rahovecit, - Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore. 3. Sensibilizimi i qytetarëve për rëndësinë e promovimit të bashkëpunimit ndër-etnik, multi-kulturor dhe ndër – fetar.	Kryetari i Komunës, Komandanti i policisë DMSH-ja, DAP-ja dhe DKA-ja, raportojnë të anëtarëve të KKSB-së	Kryetari i Komunës Policia. Koordinatori i KKSB-së	Anëtarët e KKSB-së	00.00 €
		Organizimi i ndonjë kampi ose ndonjë aktiviteti sportiv me të rinjtë e komuniteteve që banojnë në Komunën e Rahovecit	Kryetari i Komunës, Policia, anëtarët e KKSB-së dhe Koordinatori i KKSB-së,	Anëtarët e KKSB-së	1,000.00 €
	4. Të Ndryshme.			Anëtarët e KKSB-së	

QERSHOR 2023

SHTATOR 2023				
5.	1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; 2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit, - Prishja e qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e pa përgjegjshëm - Trajtimi i mbrojtjes së pyjeve nga dëmtuesit ilegalë, - Vetëdijesimi nga minat dhe mjeteve tjera të pa shpërthyer nga lufta, - Gjendja e sigurisë në shkolla - Identifikimi i hapësirave për qasjen e personave me nevoja të veçanta, - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla, - Siguria në trafik. - Raportimi dhe parandalimi i dhunës në familje - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit, - Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e Komunës së Rahovecit, - Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore. 3. Të Ndryshme.	Kryetari i Komunës, Komandanti i policisë DMSH-ja, DAP-ja dhe DKA-ja, raportojnë para anëtarëve të KKSB-së	Kryetari i Komunës, Policia	Anëtarët e KKSB-së 00.000 €
			Anëtarët e KKSB-së	

6.	DHJETOR 2023					Kuvendin Komunës		
						KKSB-së		
	Policia KKSB-së							
	Shërbimi i Kuvendit- Zyra e Kryetarit Anëtarët e KKSB-së Policia e Kosovës DKA-ja DSHP							
	1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; 2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit, - Vetëdijesimi për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike, - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkollë dhe zbatimin e planit për siguri në shkollë, - Mungesa e parkingjeve në qytet dhe ndriçimi publik, - Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e Komunës së Rahovecit, - Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore.							
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës së KKSB-së për vitin 2024.					Bëhet përgatitja e Planit të Punës së KKSB-së nga Kryetari i Komunës dhe Koordinatori KKSB-së	Kryetari i Komunës, anëtarët e KKSB-së, Koordinatori	Anëtarët e KKSB-së	200.00 €
4. Të Ndryshme.							Anëtarët e KKSB-së	

01 Nr. _____/22
Rahovec, 28.12.2022

Defrim Kafexhiu

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 pika (d), nenit 17 dhe nenit 40 paragrafi 2 pika (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.4 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 00.12.2022 miraton këtë :

V E N D I M

Për miratimin e planit të punës të Kryetarit të Komunës për vitin 2023

1. Me këtë vendim **miratohet** axhenda dhe plani i punës i Kryetarit të Komunës së Rahovecit për vitin 2023.
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është plani i punës i Kryetarit të Komunës së Rahovecit për vitin 2023.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **Shërbimit të Kuvendit,**
- **Kryetarit të Komunës,**
- **MAPL-së, dhe**
- **Arkivit.**

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr. ___/22
Datë: 00.12.2022

Defrim Kafexhiu


Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna Rahovec
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Predsednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit Nr. 03/L040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës:

PROPOZON

1. Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit që të merret vendim për miratimin e agjendës dhe Planit të punës së Kryetarit të Komunës së Rahovecit për vitin 2023.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i punës së Kryetarit të Komunës së Rahovecit për vitin 2023.
3. Për zbatimin e këtij propozimi do të kujdeset Sekretaria e Kuvendit.
4. Ky propozim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me propozim të njoftohen:


- *Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,*
- *Sekretaria e Kuvendit, dhe*
- *Arkivi*





PROJEKT PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2023

KOMUNA E RAHOVECIT



PËRMBAJTJA

HYRJE	3
ZOTIMET.....	3
PRIORITETET E PROGRAMIT QEVERISË.....	3
PRIORITETET KRYESORE PËR VITIN 2023	4
SYNIME PËR VITIN 2023.....	5
SFIDAT KRYESORE PËR VITIN 2023	6
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS - PLANET E PUNËS 2023	6
Drejtoria për Administratë	22
Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.....	24
Drejtoria për Arsim	25
Drejtoria për Buxhet dhe Financa	27
Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit	28
Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.....	29
Drejtoria për Shërbime Publike.....	31
Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.....	33
Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë.....	36
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	38
Drejtoria për Punë Inspektuese	42
Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	48
PËRFUNDIM.....	50

HYRJE

Komuna e Rahovecit dhe Qeveria Komunale, prezanton planin e saj qeverisës për vitin 2023, duke e bërë një studim të detajuar të të arriturave, por edhe nevojave dhe pritjeve të qytetarëve nga Komuna e Rahovecit për të ardhmen.

Plani që po paraqesim është sfidues dhe është pjesë e procesit të përmirësimit të kushteve të punës e të jetës për qytetarët e Rahovecit, e që duhet të zbatohet në praktikë. Megjithatë, për zbatimin e këtij plani, kërkohet ndërmarrja e një seri masash dhe veprimesh konkrete në terren, duke u konsultuar vazhdimisht me ekspertë të fushave të ndryshme dhe profesionistë të dëshmuar. Bazuar në përvojën tonë pozitive për qytetarët e komunës së Rahovecit, mund të konstatojmë se ekzistojnë parakushtet për zbatim efikas të këtij plani.

ZOTIMET

- Komunë e hapur për qytetarët, transparencë e plotë dhe llogaridhënie;
- Komunë që qeveriset drejtë dhe mirë, ligjshëm dhe me performancë të lartë;
- Komunë që u shërben qytetarëve pa dallim;
- Komunë me shërbime gjithnjë e më bashkëkohore;
- Komunë ku promovohen politikat dhe praktikat më të mira si dhe standardet e larta të qeverisjes;
- Komunë ku respektohen vlerat njerëzore e qytetare;
- Komunë pa diskriminim, e që qytetarët i trajton barabartë;
- Komunë ku respektohen vlerat kombëtare, historike, vlerat e luftës dhe të lirisë;
- Komunë që nderon sakrificën dhe gjakun e derdhur për liri;
- Komunë që trajton dhe mbështet qytetarët që kanë nevojë të veçanta;
- Komunë që nderon, promovon e i jep përkrahje traditës, trashëgimisë dhe gjithë pasurisë sonë të përbashkët, gjithë asaj që është vlerë dhe identitet i Rahovecit;
- Komunë ku përfaqësohet, mbrohet dhe punohet për interesin publik;
- Komunë ku përkushtimi për të vepruar ndershmëri dhe në pajtim me ligjin, veçse vullnet, përcaktim i të zgjedhurve, jetësohet edhe si detyrim moral ndaj zgjedhësve si dhe ndaj ligjit;
- Komunë ku respektohet mozaiku i vlerave njerëzore, demokratike, kulturore, të trashëgimisë e të besimit në Zot;
- Komunë ku respektohen pakicat dhe promovohen vlerat e tyre.

PRIORITETET E PROGRAMIT QEVERISËS

- Bujqësia;
- Ekonomia, agroturizmi dhe punësimi;
- Administratë bashkëkohore me shërbime të shpejta dhe cilësore;
- Arsimi, shëndetësia dhe përkujdesja sociale;
- Infrastrukturë publike të rregulluar dhe të mirëmbajtur;
- Investime nga fondi i efikasitetit të energjisë në sektorin publik dhe privat;
- Investime në infrastrukturë kulturore, sportive dhe hapësira për të rinjtë si dhe rritja e përkrahjes për këta sektorë;
- Promovimi i potencialit dhe mundësive për investime nga mërgata jonë;
- Trashëgimia kulturore, historike dhe investime për ta nderuar hartën e sakrificës dhe lirisë.

PRIORITETET KRYESORE PËR VITIN 2023

- Sheshi Qendror i Qytetit;
- Funksionalizimi i Shtëpisë për të Moshuar;
- Funksionalizim, mirëmbajtje dhe menaxhim të Maja e Shkodranit;
- Mirëmbajtje dhe menaxhim i Kulles për heronjtë Xhelal Hajda-toni, Selajdin Mullabazi-Mici dhe bashkëluftëtarët e tyre, Hamdi Hajrizi, Nezir Imeri dhe Bektesh Haliti në Opterushtë;
- Edukim dëgjues i brezave të rinj, duke iu ofruar mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësore bashkëkohore, mjedis të përshtatshëm mësimor me infrastrukturë adekuate dhe gjithëpërfshirëse;
- Funksionalizimin i plotë i gerdheve ekzistuese;
- Bursa për student;
- Bibliotekat – kujdes i shtuar për bibliotekat, duke u përkujdesur për bierjen e titujve të ri, por edhe duke i mirëmbajtur dhe investuar në objektet e bibliotekave ekzistuese;
- Laboratorë dhe kabine – do të investojmë në zhvillimin dhe krijimin e laboratorëve të rinj për shkencat natyrore dhe në kabine;
- Përkrahje e fermerëve me serra, stalla, ferma të vogla, inpute dhe pajisje bujqësore;
- Rrugë fushore;
- Përkrahje për pikat grumbulluese të qumështit;
- Kanale të kullimit të tokave bujqësore;
- Shërbime veterinarë periodike, falas;
- Konsulencë dhe hartim të projekteve falas për bujq dhe biznese;
- Ndërtim i rrugëve të reja dhe mirëmbajtja e rrugëve ekzistuese;
- Në bashkëpunim me KEDS, angazhim për furnizim stabil me energji, ndërrim i rrjetit, i shtyllave, instalime nëntokësore etj);
- Bashkëpunim me KRU “Gjajakova” dhe donatorë të tjerë për furnizim me të mirë me ujë të pijshëm;
- Eficienca e energjisë në objekte publike dhe në sektorin privat, përmes fondit të milioniumit;
- Mirëmbajtje e rregullit e hapësirave publike, e objekteve publike dhe të gjitha llojeve të investimeve publike në komunën e Rahovecit;
- Legalizimi i parkingjeve ekzistuese dhe krijimi i parkingjeve të reja;
- Rregullimi i infrastrukturës për persona me nevojë të veganta;
- Trajtimi i ujërave të zeza dhe rrugëve në pjesë problematike të qytetit;
- Mjedise të bukura dhe hapësira për të rinjtë;
- Kënde lojërash për fëmijë;
- Rritje e standardit të shërbimeve shëndetësore, përmes menaxhimit të mirë dhe profesional. Në bashkëpunim me nivelin qendror, do të investohet në pajisje të reja e kapacitete njerëzore, për ta mundësuar rritjen e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara;
- Tradita e investimit në sektorin e kulturës, rinisë dhe sportit do të vazhdojë përmes përkrahjes së të rinjve, shogatave kulturoro-artistike dhe klubeve sportive;
- Do të vazhdojë subvencionimi i projekteve kulturoro-artistike dhe sportive, që janë në interes të komunitetit;
- Vazhdim i zbatimit të strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal për komunën e Rahovecit 2021-2025;
- Përkrahje dhe lehtësira për prodhuesit, tregtinë, zejtarët e veganta, artizanat, etj);
- Trajtim dhe rregullim i shtretërve të lumenjve dhe përrënjeve;
- PZH dhe HZK - do të miratohet Plan i Zhvillimit Komunal dhe Harta Zonale e Komunës, pas shqyrtimit publik;

- Rritja e kapaciteteve inspektuese për mbrojtjen e mjedisit, për të parandaluar e mbrojtur nga ndotësit e shkatërruesit e tij, me shqiptim të gjobave mandatore;
- Investim në Stacionin e Autobusëve në Rahovec, faza e dytë - instalimi i kabinave innovative në stacionet e pritjes, në qytet dhe fshatra;
- Administratë efikase, e përgjegjshme dhe me shërbime moderne,
- Qeverisje energjike, vepruese dhe vendimmarrje pa vonesë,
- Realizim i suksesshëm i projekteve dhe i buxhetit,
- Realizim i planit të të hyrave komunale,
- Promovimi dhe përmirësimi i mjedisit të Rahovecit si qytet lider për ushtrimin e veprimtarive të bizneseve ekzistuese, zgjerimin e tyre si dhe për ato të reja;
- Bashkëpunim i mirë me donatorët e jashtëm,
- Komunikim dhe bashkëpunim me OJQ - të.

SYNIME PËR VITIN 2023

- Bujqësi të përkrahur;
- Riparimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore;
- Intervenimi në ndërtimin e kanaleve të kullimit dhe drenazhimit të tokave bujqësore;
- Zgjerimi i sistemit të ujitjes në pjesët ku mungon;
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e përrenjve;
- Barna esenciale për qytetarët në nevojë nga buxheti i komunës;
- Investime në rritjen e cilësisë së shërbimeve, zgjerimin e tyre, pajisje mjekësore dhe inventarizim për QKMF dhe rrjetin e shërbimeve parësore shëndetësore;
- Arsimit cilësor dhe biblioteka, pajisje bashkëkohore, laboratorë, më shumë teknologji informative dhe mjete konkretizimi në shkollë;
- Hartimi i planeve urbane;
- Zhvillim ekonomik dhe punësim nëpërmjet fuqizimit dhe mbështetjes së sektorit privat;
- Përqendrim për zhvillimin e planifikuar të agroturizmit;
- Rritjen e të hyrave vetanake përmes lëshimit të lejeve ndërtimore, procesit të legalizimit dhe lejeve mjedisore komunale;
- Në bashkëpunim Drejtorinë e Urbanizmit dhe me Drejtorinë për Punë inspektuese, legalizimi i objekteve pa leje dhe respektimi i ligjit të ri për trajtimin e objekteve pa leje;
- Mbikëqyrje aktive dhe rritje e cilësisë në investimet publike;
- Vazhdimi i evidentimit dhe lirit të pronave të uzurpuara;
- Dyfishim i përpjekjeve për mbrojtje të mjedisit, mbrojtjen e tokave bujqësore, mbrojtjen e pronës publike, parandalimi i ndërtimeve pa leje;
- Planifikimi i masave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera;
- Projekte me partneritet publiko-privat;
- Hartimi i planeve, nxjerrja e akteve dhe i rregulloreve të tjera;
- Zhvillimi i Rahovecit në përputhje me planet zhvillimore komunale dhe menaxhimi i burimeve fizike bazuar mbi parimet e shëndosha mjedisore si dhe mbi parimet e partneritetit me mekanizma vendor e ndërkombëtar, për realizimin e vizionit për komunë model me një qeverisje cilësore, efikase dhe llogaridhënëse;
- Vazhdimin e trajtimit të shtretërve të lumenjve dhe përrenjve, përmes investimeve kapitale nga Komuna e Rahovecit dhe mbështetjes nga Qeveria e Kosovës, me qëllim të mbrojtjes nga vërshimet dhe ruajtjen e mjedisit.

SFIDAT KRYESORE PËR VITIN 2023

- Buxheti i ulët i Qeverisë së Kosovës, mungesa e mjeteve të mjaftueshme financiare nga qeveria qendrore, si trend i vazhdueshëm në Kosovë, që i bën investimet edhe më të vështira (angazhime të shtuara në kërkesa nga qeveria qendrore);
- Integrimi i sa më shumë qytetarëve dhe thellimi i bashkëpunimit të ngushtë me organizatat joqeveritare (OJQ-të), bizneset, zanatlinjtë, tregtarët, bujqit, shoqërinë civile etj;
- Mungesa e hapësirave publike në territorin e komunës së Rahovecit;
- Mungesa e burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe profesionale;
- Përfshirja më e madhe e qytetarëve tanë në aktivitetet tona dhe duke i mbajtur ata të informuar për zhvillimet në komunën tonë.

Plani Vjeter i Punës, siç është paraqitur më poshtë, përkufizon synimin me qëllim të realizimit të objektivave të përcaktuara, si dhe njëkohësisht liston të gjithë zyrtarët përgjegjës për mbarevajtjen e punëve për secilin pikë. Personat përgjegjës obligohen që për gjardë shtyrje eventuale të afatit kohor të përfundimit të punëve, apo mospërmbyajtje ndaj të njëjtës, të raportojnë me shkrim të Kryetarit i komunës. Ndryshimet eventuale, për arsye kuptimplota apo faktorëve të jashtëm, do të harmonizohen me Kryetarin e Komunës si dhe ekipin përgjegjës për realizimin e tërësishëm të këtij plani.

Pjesë përbërëse e planit të punës së ekzekutivit komunal për vitin 2023 do të jenë planet e punës të të gjitha drejtorive komunale në komunën e Rahovecit si dhe njësitë të cilat veprojnë në kuadër të zyrës së Kryetarit të Komunës së Rahovecit.

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS - PLANET E PUNËS 2023

Zyra Ligjore

Zyra Ligjore në komunën e Rahovecit me këtë plan synon arrijtjen e objektivave për vitin 2023:

- Ofrimi i kështillave juridike të rregullta për organet komunale dhe trupave të formuara nga organet komunale, kështillave juridike dhe ofrimin e përkrahjes për Kryetarin e Komunës, Kuvendin Komunal, drejtorët e drejtorive, komitetet, zyrën së prokurimit, komisionet etj;
- Hartimi (përpilimi) i vendimeve, aktvendimeve, pëlqimeve, urdhërresave, memorandumeve të mirëkuptimit, kontratave, marrëveshjeve, lejeve të punës, lejeve të ndërtimit dhe shkrësive të tjera për organet komunale dhe trupat e formuar nga organet komunale;
- Hartimi i Rregullores për realizimin e të drejtave të fëmijëve;
- Pjesëmarrje e rregullt në seancat e Kuvendit të Komunës së Rahovecit;
- Pjesëmarrje në komisionet e ndryshme të formuara nga Kryetari i Komunës për çështjet e caktuara;
- Aktivitete, interpretime dhe angazhime të ndryshme për komunën, në nënryrë që të sigurohem për vendimmarrje të ligjshme dhe veprime të bazuara në ligje në gjithë kompleksitetin e qeverisjes në komunën tonë;

Zyra e Burimeve Njerëzore - Njësia e Personelit

Njësia e Personelit në kuadër të kompetencave të saj, për periudhën deri në fund të vitit 2023, ka për synim të arrij këto objektiva:

- Mbajtjen e nivelit të efektivitetit të shërbimeve të Njesisë së Personelit;
- Zbatimin e ndryshimeve të reja ligjore në fushën e resurseve njerëzore;
- Zbatimin dhe familjarizimin e punëtorëve dhe menaxhmentit me programin SIMBNJ;
- Mbikëqyrjen e pranisë së punëtorëve në punë;
- Përkujdesjen për pajisjen e punëtorëve me kartela identifikimi;
- Menaxhimin efikas me arkivin e njesisë së personelit;
- Shkarkimi nga programi PYROLL i listës së pagave dhe pagesave në formë elektronike dhe dërgimi i tyre te zyrtarët përgjegjës;
- Krijimi i dosjeve pasive, sistemimi i dosjeve si dhe ruajtja e tyre.

Zyra e Prokurimit

Plani i punës së Zyrës së Prokurimit është i ndikuar nga planet e punës së drejtorive komunale. Përmes këtij plani synim i zyrës së prokurimit është që të kryejë të gjitha veprimet me kohë, pa vonesa, duke u bazuar në planifikimet e drejtorive komunale për projektet kapitale dhe në pajtim me ligjin e prokurimit publik.

Zyra për Përfaqësim Ligjor - Avokatura

Zyra për Përfaqësim Ligjor (ZPL) e komunës së Rahovecit, kryen detyrat dhe punët në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës, në bazë të praktikës së Avokaturës Publike Komunale dhe Ligjit për Avokaturën Shtetërore.

Ndër aktivitetet kryesore parashihen të jenë: Përfaqësimi i komunës në seanca gjyqësore, ushtrimi i padive për palët, prapësimet e rasteve duke respektuar afatet ligjore, mendime juridike për zyrat e kryetarit dhe të drejtorive komunale, takime konsultuese dhe informuese me Kryetarin e komunës, ushtrimi i mjeteve të rregullta në procedurë përmbartimore, mbajtja e regjistrave të lëndëve, pranim/dorëzim i shkresave dhe klasifikimi, pranimi i ftesave për seanca gjyqësore.

Nr.	Përshkrimi i objektivave të punës	Planit veprimt	Bartësit e aktivitetit	Afati
1	Seancat gjyqësore	Mirëmbajtja e regjistrat elektronik të seancave të caktuara; Pjesëmarrja në seancat gjyqësore sipas ftesave të pranuar nga gjykata; Përgatitja e lëndës për të marrë pjesë në seancë gjyqësore; Përgatitja paraprake e materialit për mbrojtje dhe përpunimi i provave materiale për dorëzim.	Përfaqësuesi i autorizuar / Zyrtari ligjor	Janar- Dhjetor
2	Përgatitja për seancat gjyqësore	Analizimi i lëndës, konsultimi i bazës ligjore; Sigurimi i të dhënave dhe dokumentacionit nga drejtoritë përkatëse; Përgatitja e materialit provues për mbrojtje; Përgatitja e mbrojtjes me shkrim.	Përfaqësuesi i autorizuar	Janar- Dhjetor
3	Ushtrimi i mjeteve të rregullta juridike	Kujdesi ndaj afateve ligjore dhe gjyqësore; Sigurimi i mbështetjes dhe informacioneve të bazuara;	Përfaqësuesi i	

Janar- Dhjetor	autorizuar	Fotokopjimi, përpunimi dhe bashkëngjitja e provave materiale; Ushtrimi i mjeteve të rregullta juridike të bazuara në prova dhe gjendjen faktike.	
Janar- Dhjetor	Përfaqësuesi i autorizuar	Kujdesi ndaj afatave ligjore dhe gjyqësore; Sigurimi i mbështetjes dhe informacioneve të bazuara; Fotokopjimi, përpunimi dhe bashkëngjitja e provave materiale; Ushtrimi i mjeteve të rregullta juridike të bazuara në prova dhe gjendjen faktike.	
Janar- Dhjetor	Përfaqësuesi i autorizuar	Ushtrimi i mjeteve të rregullta juridike të bazuara në prova dhe gjendjen faktike.	
Janar- Dhjetor	Përfaqësuesi i autorizuar	Ushtrimi i mjeteve të rregullta juridike të bazuara në prova dhe gjendjen faktike.	
Janar- Dhjetor	Përfaqësuesi i autorizuar	Konsultimet të rregullta mbi bazën e përgjegjësisë Takime informuese me kryetarin e komunës	
Janar- Dhjetor	Përfaqësuesi i autorizuar	Përgatitja e keshillave ligjore, rekomandimeve, udhëzimeve dhe opinionëve brenda fushëveprimit të komunës dhe me kërkesë të drejtorive apo organeve të komunës.	
Janar- Dhjetor	Përfaqësuesi i autorizuar / Zyrtari ligjor	Mbajtja e regjistrave Regjistrimi i lëndëve të reja; Regjistrimi i lëndëve dhe shënimeve për lëndë të caktuara, ç'është regjistrimi i lëndëve, etj.	
Janar- Dhjetor	Përfaqësuesi i autorizuar / Zyrtari ligjor	Pranimi i shkrësive gjyqësore, etj.; Regjistrimi i shkrësive; Vendosja e shkrësive në lëndë të referuara.	
Janar- Dhjetor	Përfaqësuesi i autorizuar / Zyrtari ligjor	Pranimi i ftesave për seanca gjyqësore Përgatitja e lëndës për seancë; Pranimi dhe regjistrimi i ftesave për seanca;	
Janar- Dhjetor	Përfaqësuesi i autorizuar / Zyrtari ligjor	Punë të daktilografitimit Përgatitja e parashtrësive të ndryshme; Shkruan sipas diktimit të Avokatit; Përgatitja e shkrësive bashkëngjitur provave.	
Janar- Dhjetor	Përfaqësuesi i autorizuar / Zyrtari ligjor	Evidenca për punë Mbajtja e evidencave të lëndëve në punë; Mbajtja e evidencave për lëndë të kryera.	
Janar- Dhjetor	Përfaqësuesi i autorizuar / Zyrtari ligjor	Shënime dhe të dhënat statistikore Mbajtja e shënimeve statistikore për të gjitha lëndët; Nxjerrja e të dhënave statistikore të përgjithshme për punën e zyrës së përfaqësimeve.	
Janar- Dhjetor	Përfaqësuesi i autorizuar / Zyrtari ligjor	Parashtrimi i kërkesave për furnizim Parashtrimi i furnizimit të zyrës me material administrativ;	

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

Me qëllim të rritjes së performancës, transparencës dhe llogaridhënies, Zyra për Informim në Komunën e Rahovecit, ka përgatitur planin e punës me aktivitetet të cilat do të realizohen secilin muaj gjatë vitit 2023.

Në këtë dokument janë paraparë aktivitetet të cilat janë përgjegjësi e Zyrës për Informim: Përgatitja e lajmeve, konferencave për media, publikimi i njoftimeve dhe dokumenteve. Publikimi i dokumenteve që duhet të dalin në konsultime publike dhe në Platformën për konsultime publike të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Publikimi i kalendarit për mbajtjen e takimeve dhe degjimeve buxhetore për vitin 2024.

Nr.	Muaj	Nr. i aktiviteteve	Realizimi
1	Janar	14 aktivitete	
2	Shkurt	9-aktivitete	

3	Mars	9-aktivitete	
4	Prill	9-aktivitete	
5	Maj	9-aktivitete	
6	Qershor	14-aktivitete	
7	Korrik	9-aktivitete	
8	Gusht	9-aktivitete	
9	Shtator	10-aktivitete	
10	Tetor	9-aktivitete	
11	Nëntor	8-aktivitete	
12	Dhjetor	9-aktivitete	

Në tabelën e mëposhtme gjeni emërtimet e aktiviteteve që janë planifikuar të mbahen për secilin muaj:

Nr.	Muaji	Aktiviteti	Realizimi
1	Janar		
1.1		Publikimi në webfaqe i vendimeve të kryetarit	
1.2		Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL	
1.3		Publikimi i planit të punës së Komunës për vitin 2023	
1.4		Publikimi i planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023	
1.5		Publikimi i raportit vjetor financiar (Janar-Dhjetor 2022)	
1.6		Publikimi i lajmeve, njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, drejtorëve dhe KK-së	
1.7		Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e konsultimeve dhe takimeve publike	
1.8		Publikimi i raportit për organizimin e konsultimeve publike	
1.9		Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe KK-së	
1.10		Përgatitja e njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKS-së	
1.11		Publikimi i njoftimit për 'Flakën e Janarit'	
1.12		Publikimi i rregulloreve, planeve dhe strategjive pas marrjes së miratimit nga MAPL, në webfaqe	
1.13		Publikimi i raportit për Qasje në Dokumente Publike	
1.14		Publikimi i raporteve mujore financiare	
2	Dhjetor		
2.1		Publikimi në webfaqe i vendimeve të kryetarit	
2.2		Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL-ë	
2.3		Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e konsultimeve dhe takimeve publike	
2.4		Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe KK-së	
2.5		Përgatitja e njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKS-së	
2.6		Publikimi i lajmeve, njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, drejtorëve dhe KK-së	
2.7		Publikimi i rregulloreve-planeve dhe strategjive pas marrjes së miratimit nga MAPL, në	

2.8	webfaqe		
2.9	Publikimi i raporteve mujore financiare		Përgatitja dhe publikimi i njoftimit për 17 shkurtin - Ditën e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës
3	Mars		
3.1	Publikimi në ëbfaqe i vendimeve të kryetarit		
3.2	Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL		
3.3	Publikimi i njoftimit për ditët përkujtimore të marsit		
3.4	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe kuvendit komunal		
3.5	Përgatitja e njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKS-B-së		
3.6	Publikimi i lajmeve, njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, drejtorëve dhe zyres së kuvendit komunal		
3.7	Publikimi i rregulloreve, planeve dhe strategjive - pas marrjes së miratimit nga MAPL, në webfaqe		
3.8	Publikimi i raporteve mujore financiare		
3.9	Publikimi i njoftimeve - lajmeve për mbajtjen e konsultimeve dhe takimeve publike		
4	Prill		
4.1	Publikimi në webfaqe i vendimeve të kryetarit		
4.2	Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL		
4.3	Publikimi i raporteve mujore financiare		
4.4	Publikimi i njoftimeve-lajmit për mbajtjen e konsultimeve dhe takimeve publike		
4.5	Publikimi i raportit 3 mujor financiar (Janar-Mars)		
4.6	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe KK-së		
4.7	Përgatitja e njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKS-B-së		
4.8	Publikimi i lajmeve, njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, drejtorëve dhe KK-së		
4.9	Publikimi i rregulloreve-planeve dhe strategjive - pas marrjes së miratimit nga MAPL, në webfaqe		
5	Maj		
5.1	Publikimi në webfaqe i vendimeve të kryetarit		
5.2	Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL		
5.3	Publikimi i raporteve mujore financiare		
5.4	Përgatitja dhe publikimi i njoftimit për fillimin e Festivalit "Anadrija Jehon"		
5.5	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe kuvendit komunal		
5.6	Përgatitja e njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKS-B-së		
5.7	Publikimi i lajmeve, njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, drejtorëve dhe zyres së		

		kuvendit komunal	
5.8		Publikimi i rregulloreve, planeve dhe strategjive - pas marrjes së miratimit nga MAPL, në webfaqe	
5.9		Publikimi i njoftimeve - lajmeve për mbajtjen e konsultimeve dhe takimeve publike	
6	Qershor		
6.1		Publikimi në ëebfaqe i vendimeve të kryetarit	
6.2		Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL	
6.3		Publikimi i njoftimit dhe lajmit për mbajtjen e takimit të parë të punës 6 mujore të kryetarit të komunës	
6.4		Publikimi i raporteve mujore financiare	
6.5		Përgatitja dhe publikimi i njoftimit për 14 Qershorin - Ditën e Çlirimit të Rahovecit	
6.6		Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe KK-së	
6.7		Përgatitja e njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKS-së	
6.8		Publikimi i lajmeve, njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, drejtorëve dhe KK-së	
6.9		Publikimi i rregulloreve, planeve dhe strategjive - pas miratimit nga MAPL, në webfaqe	
6.10		Publikimi i raportit 6 mujor për qasje në dokumente publike	
6.11		Publikimi i raportit të punës së kryetarit për 6 mujorin e parë të vitit 2023	
6.12		Publikimi i njoftimit për mbajtjen e konsultimit publik me qytetarë për projekt-buxhetin e Komunës - KAB-in	
6.13		Publikimi i raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2023	
6.14		Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e konsultimeve dhe takimeve publike	
7	Korrik		
7.1		Publikimi në webfaqe i vendimeve të kryetarit	
7.2		Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL	
7.3		Raporti 6 mujor financiar (Janar-Qershor 2023)	
7.4		Publikimi i raporteve mujore financiare	
7.5		Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e konsultimeve dhe takimeve publike	
7.6		Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe KK-së	
7.7		Përgatitja e njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKS-së	
7.8		Publikimi i lajmeve, njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, drejtorëve dhe KK-së	
7.9		Organizimi dhe publikimi i kalendarit për dëgjimet buxhetore	
8	Gusht		
8.1		Publikimi në webfaqe i vendimeve të kryetarit	
8.2		Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL	
8.3		Publikimi i kalendarit për organizimin e dëgjimeve buxhetore për buxhetin e vitit 2024	
8.4		Publikimi i raporteve mujore financiare	
8.5		Publikimi i njoftimeve - lajmeve për mbajtjen e konsultimeve dhe takimeve publike	

8.6	Publikimi i njoftimeve - lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe kuvendit komunal		
8.7	Përgatitja e njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKS-B-së		
8.8	Publikimi i lajmeve, njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, drejtorëve dhe zyres së kuvendit komunal		
8.9	Publikimi i rregulloreve, planeve dhe strategjive - pas marrjes së miratimit nga MAPL, në webfaqe		
9	Shtator		
9.1	Publikimi në webfaqe i vendimeve të kryetarit		
9.2	Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL		
9.3	Publikimi i raporteve mujore financiare		
9.4	Publikimi i njoftimeve - lajmeve për mbajtjen e konsultimeve dhe takimeve publike		
9.5	Publikimi i njoftimeve - lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe KK-së		
9.6	Përgatitja e njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKS-B-së		
9.7	Publikimi i lajmeve, njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, drejtorëve dhe zyres së kuvendit komunal		
9.8	Publikimi i rregulloreve, planeve dhe strategjive - pas marrjes së miratimit nga MAPL, në webfaqe		
9.9	Publikimi i raportit të performancës komunale për vitin 2022 (Nëse përgatitet nga MAPL-ja)		
9.10	Publikimi i njoftimit për dëgjime buxhetore nga ana e KPF-së		
10	Tetor		
10.1	Publikimi në webfaqe i vendimeve të kryetarit		
10.2	Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL		
10.3	Publikimi i raporteve mujore financiare		
10.4	Publikimi i raportit 9 mujor financiar (Janar-Shtator 2023)		
10.5	Publikimi i njoftimeve - lajmit për mbajtjen e konsultimeve dhe takimeve publike		
10.6	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe kuvendit komunal		
10.7	Përgatitja e njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKS-B-së		
10.8	Publikimi i lajmeve, njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, drejtorëve dhe zyres së kuvendit komunal		
10.9	Publikimi i rregulloreve, planeve dhe strategjive - pas marrjes së miratimit nga MAPL, në webfaqe		
11	Nëntor		
11.1	Publikimi në webfaqe i vendimeve të kryetarit		
11.2	Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL		
11.3	Publikimi i njoftimeve - lajmeve për mbajtjen e konsultimeve dhe takimeve publike		

11.4		Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe Kuvendit Komunal	
11.5		Përgatitja e njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKS-së	
11.6		Publikimi i lajmeve, njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, drejtorëve dhe zyrës së kuvendit komunal	
11.7		Publikimi i rregulloreve, planeve dhe strategjive - pas marrjes së miratimit nga MAPL, në webfaqe	
11.8		Përgatitja dhe publikimi i njoftimit për festat e Nëntorit	
12	Bujëtor		
12.1		Publikimi në webfaqe i vendimeve të kryetarit	
12.2		Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL	
12.3		Publikimi i njoftimeve - lajmeve për mbajtjen e konsultimeve dhe takimeve publike	
12.4		Publikimi i njoftimeve - lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe Kuvendit Komunal	
12.5		Përgatitja e njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKS-së	
12.6		Publikimi i lajmeve, njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, drejtorëve dhe zyrës së kuvendit komunal	
12.7		Publikimi i rregulloreve, planeve dhe strategjive - pas marrjes së miratimit nga MAPL, në webfaqe	
12.8		Publikimi i raportit për qasje në dokumente publike	
12.9		Publikimi i planit të punës së zyrës për informim për vitin 2024	

Zyra e Auditimit të Brendshëm

I. Objektivat/detyrat e punës të NJAB për vitin 2023:

Nr	Objektivi/detyra e punës	Aktiviteti	Periudha e planifikuar e aktivitetit 2023
1	Detyra audituese: Rishikimi periodik dhe vjetor i zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportet e Auditorit të Brendshëm.	1.1 Përgatitja e auditimit dhe caktimi i fushëveprimit; 1.2 Rishikimi dhe vlerësimi i proceseve (Puna në terren); 1.3 Raportimi të Kryetari i Komunës dhe njësitë e audituara.	Janar - Korrik

2	Detyra audituese (auditimet) Duke u bazuar në planin e punës për vitin 2023, janë parapare gjashë (6) detyra audituese (auditime) me qëllim të përcaktimit nëse veprimet dhe rezultatet e proceseve të audituara janë në pajtim me ligjet, udhëzimet dhe rregulloret përkatëse.	2.1 Planifikimi dhe përgatitja e secilit auditim sipas metodologjisë së auditimit të përcaktuar nga Ministria e Financave; 2.2 Ndarya e detyrave audituese për anëtarët e ekipit (njësisë) nëse ka anëtar; 2.3 Auditimi dhe vlerësimi i proceseve (Puna në terren) për secilën detyrë audituese; 2.4 Monitorimi i punës së stafit të njësisë për detyrat audituese të caktuara - vien nëse ka staf në njësi; 2.5 Përgatitja e raporteve për detyrat audituese dhe raportimi tek kryetari i komunës dhe njësitë e audituara.	Detyra audituese, 1 Mars, Detyra audituese, 2 Prill - Maj, Detyra audituese, 3 Maj - Qershor, Detyra audituese, 4 Korrik - Gush, Detyra audituese, 5 Shtator - Tetor, Detyra audituese, 6 Nëntor.
3	Raportimi periodik dhe vjetor për: Kryetarin e Komunës, Komitetin e Auditimit dhe Njësine Qendrore Harmonizuese në Ministrinë e Financave.	3.1 Përgatitja dhe dorëzimi i raportit përmbledhës për periudhën janar - Qershor(raporti gjashë mujor i l-rë). 3.2 Përgatitja dhe dorëzimi i raportit përmbledhës për periudhën korrik - Dhjetor (gjashë mujori i ll-të). 3.3 Përgatitja dhe dorëzimi i raportit përmbledhës vjetor (Janar - Dhjetor).	Koha e raportimit: 1-15 korrik 2023 1-15 janar 2024 30 janar 2024
4	Përgatitja e planit strategjik për NJAB për vitin 2023-2025 dhe planit vjetor të punës për vitin 2024.	4.1 Përgatitja e planit nga ekipi i NJAB-ës 4.2 Dërgimi i planit për shqyrtimi nga kryetari i komunës dhe Komiteti i Auditimit; 4.3 Procesi i miratimit të planit nga kryetari dhe Komiteti i Auditimit, dërgimi i planeve të miratuara në NJQH/AB në Ministrinë e Financave.	Dhjetor 2023
5	Bashkërendimi i aktiviteve me NJQHAB/MF, detyrat e keshillëdhënies.	5.1 Detyrat keshillëdhënëse me zyrat dhe menaxhmentin e lartë për proceset të cilat i mbulon auditimi i brendshëm.	Gjatë vitit 2023

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

Nr. Br	Përshkrimi i punëve dhe detyrave të punës Opis poslova i radnih zadataka	PERIUDHA KOHORE (Muaji) E REALIZIMIT - VREMENSKI PERIOD(Mjesec) OSTVARIVANJA												VËREJTJE PRIMEDBE	
		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII		TOTAL
1	Takime të rregullta me stafin Redovni sastanci sa osobljem	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X		
2	Takimet të rregullta me Kryetarin e Komunës Redovni sastanci sa Predsednikom Opštine	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X		
3	Takimet me Komisionin për Kthim të komuniteteve Sastanci sa Komisijom za povratak zajednica													6 TAKIME TË OBLIGUESHME 6 OBAVEZNIH SASTANKA	
4	Monitorimi dhe realizimi i projekteve për të kthyerit Nadzor i realizacija projekata za povratnike.													VARËSISHT NGA NEVOJA ZAVISNO PO POTREBI	
														VAZHDIMISHT	
5	Vizita në Kampet e (Maqedonisë, Malit të Zi, Serbisë) ku jetojnë të zhvendosurit e komunës së Rahovecit Poseta Kampova u (Makedoniji, Crnoj Gori, Srbiji) gde žive raseljeni iz opštine Orahovac						X				X			2 VIZITA ZYRTARE 2 ZVANIČNE POSETE	Varësisht nga Kërkesat për Kthim U zavisnost od zahteva za povratak
6	Implementimi i Planit Lokal të Veprimit për përfshirjen e komunitetit Rom dhe Ashkali 2022-2025. Implementacia Plana Delovanja za Uključenje zajednice Roma, i Aškalija 2022-2025													GJATË TËRË VITIT TOKOM ČELE GODINE 2023	

7	Implementimi i Planit Lokal për Personat e Ri-atdhesuar dhe Kthim të Qëndrueshëm 2022-2025 Implementacia Plana opštinski plan za održivu integraciju povracenih lica 2022-2025	8	Takimet me përfaqësuesit të komuniteteve nëpër të gjitha lokalitete. Sastanci sa përfaqësuesit zajednica na svim lokalijama	9	Monitorimi dhe realizimi i projekteve për komunitet. Nadzor realizacije projekata za povratnike	10	Takimet me OJQ dhe OQ, Sastanci sa vladinim i nevladinim organizacijama	11	Takimet me Policinë e Kosovës dhe KFOR-in. Sastanci sa Kosovskom Policijom i KFOR -om.	12	Pjesëmarrja në gjitha komitetet të formuara në kuadër të komunës Uëshe në svim formiranim komitetima u okviru Opštine	13	Pjesëmarrja në takime të Komisionit Komunal për Ri- atdhesim. Uëshe na sastancima Opštinske Komisije za Repatriaciju	14	Bashkëpunim me Ministrin për Kthim dhe Komunitete dhe Ministritë të tjera të Linjës. Sarađnja sa Ministarstvom Zajednice i Povratka i ostalim veznim Ministarstvima	15	Kontinuirano tokom cijele godine Kontinuirano tokom cijele godine
---	--	---	---	---	--	----	---	----	---	----	---	----	--	----	--	----	--

PROJEKT PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2023

17	Konferenca e Donatorëve Donatorska konferencija													GJATË VITIT 2023 TAKOM GODINE	
18	Bashkëpunim me MPB dhe ministrin për Integrime Evropiane Saradnja sa MUP -om i Ministarstvom za Evropske integracije	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	I VAZHDOUSHËM GJATË TËRË VITIT KONTINUIRANO TOKOM CELE GODINE	
19	Përgatitja dhe dalja me Raport mbi gjendjen e komuniteteve Jo shumicë në komunën e Rahovecit. Izrada i donošenje izveštaja o stanju ne većinske zajednice u Opštini											X		1 HERË NË VIT 1 GODŠNJE	
20	Manifestimi i ditëve Memoriale të komuniteteve në Komunën e Rahovecit. Manifestacije i obilježavanje memorijalnih dana zajednice Opštine Orahovac		X	X		X								MANIFESTIMI I DITËVE TË KOMUNITETIT ROM, ASHKALI , EGIPTIAN DHE SERB MANIFESTACIJA DANA ZAJEDNICE ROMA, AŠKALIJA, EGIPČANA I SRBA	
21	Fushatë /Kampanjë për regjistrimin me Kohë në Shkollë Kampanje za upis na vreme u školi													QERSHOR 2023 JUN 2023	
22	Bashkëpunim me Drejtoritë të tjera në komunë Saradnja sa ostalim opštinskim odeljenjima	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	GJATË TËRË VITIT TOKOM CELE GODINE	
23	Takimi 2 herë në vit mbi gjendjen e komunitetit SERB në HOQË TË MADHE. Sastanak 2 put godišnje o stanju SRPSKE zajednice u VELIKOJ HOĆ														
24	Hartimi i Buxhetit, Planifikimi dhe Propozimi në Komunë. Izrada Budžeta, Planiranje i Predlog u Opštini					X				X				PROPOZIMI I BUXHETIT NË AFATET KOHORE PREDLOG BUDŽETA NA VREMENSKOM ROKU	
25	Krijimi i data bazës me gjendjen në Bujqësi, Shëndetësi, Arsim, Banim dhe gjendjes sociale ndaj komuniteteve. Izrada baze podataka za stambeno i socijalno stanje	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	PËRDITËSIMI I INFORMATAVE NË MËNYRË TË VAZHDOUSHME KONTINUIRANO SVAKODNEVNO	

		zajednice, stanje u poljoprivredi, zdravstvu, i obrazovanju	26	Promovimi i Aktivitetave që kanë te bëjnë me femijët dhe Barazinë gjinore tek pjesëtarët e Komuniteteve . Promocija aktivnosti koji se tiču dece i rodne ravnopравnosti u zajednicama	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	GJATË TËRË VITIT TOKOM CELE GODINE	AŽURIRANJE PODATAKA	
--	--	--	----	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---------------------------------------	---------------------	--

Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut

Objektivat	Promovimi dhe mbrojtja e drejtave të njeriut në drejtat e kornizës ligjore konform komunitet bëhet publikimi i doracakëve dhe drejtat e njeriut, përgatitja, sensibilizuese për të Organizimi i fushatave	Organizimi i kryezave, debatare të ndryshme për gjendjen aktuale të drejtave të njeriut sipas fushëveprimtarisë (numri i kryezave nuk është i caktuar). Ligjëratat me nxënësit e shkollave fillore të komunës sonë përfshirë temata të rrafshëve të mbrojtjes së fëmijëve.	Ngritja e vetëdijës në qytetarëve në proceset që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, në proceset e bërjes së politikave vendimmarrëse	Shkurt – Ditë Ndërkombëtare Kundër Kancerit. Fushatë sensibilizuese, takime me qytetar dhe informim sa i përket sëmundjes së kancerit.	Shënim i Ditës Ndërkombëtare të Personave me Sindromin DOËN.	NJKNDJ në bashkëpunim me aktorët institucional dhe OJQ	Kjo ditë shënohet me një mori aktivitete shvjetërsuese, rekreative, kulturore e sportive. Synimi i kësaj do të jetë ndërgjegjësimi, informimi si dhe promovimi për personat	Afati kohor	Janar – Dhjetor (gjatë gjithë vitit)	Buxheti komunal, qeveritar, donatorët	Buxheti komunal, qeveritar, nga donatorët	21 Mars	Buxheti komunal, donatorët	Ngritja e vetëdijës së popullatës dhe institucioneve nëpërmjet shënimit të
Aktiviteti	Organizimi i fushatave sensibilizuese për të drejtat e njeriut, përgatitja, publikimi i doracakëve dhe broshurave informative.	Organizimi i kryezave, debatare të ndryshme për gjendjen aktuale të drejtave të njeriut sipas fushëveprimtarisë (numri i kryezave nuk është i caktuar). Ligjëratat me nxënësit e shkollave fillore të komunës sonë përfshirë temata të rrafshëve të mbrojtjes së fëmijëve.	Shënim i Ditës Ndërkombëtare Kundër Kancerit. Fushatë sensibilizuese, takime me qytetar dhe informim sa i përket sëmundjes së kancerit.	Drejtoria e shëndetësisë dhe akterët tjerë institucional	NJKNDJ, ZBGJ	Vetëdijësimi i popullatës sa i përket parandalimit të sëmundjes së kancerit. Kontrollat e vazhdueshme të parapara sipas profesionistëve shëndetësor, mund të shpëtojnë jetë.	Vetëdijësimi i popullatës sa i përket parandalimit të sëmundjes së kancerit. Kontrollat e vazhdueshme të parapara sipas profesionistëve shëndetësor, mund të shpëtojnë jetë.	Shkurt	Janar – Dhjetor (gjatë gjithë vitit)	Buxheti komunal, qeveritar, nga donatorët	Buxheti komunal, donatorët	21 Mars	Buxheti komunal, donatorët	Ngritja e vetëdijës së popullatës dhe institucioneve nëpërmjet shënimit të
Aktorët	NJKNDJ	NJKNDJ në bashkëpunim me drejtoritë komunale dhe aktorët tjerë institucional.	NJKNDJ në bashkëpunim me drejtoritë gjendjen aktuale të drejtave të njeriut sipas fushëveprimtarisë (numri i kryezave nuk është i caktuar). Ligjëratat me nxënësit e shkollave fillore të komunës sonë përfshirë temata të rrafshëve të mbrojtjes së fëmijëve.	Drejtoria e shëndetësisë dhe akterët tjerë institucional	NJKNDJ, ZBGJ	Vetëdijësimi i popullatës sa i përket parandalimit të sëmundjes së kancerit. Kontrollat e vazhdueshme të parapara sipas profesionistëve shëndetësor, mund të shpëtojnë jetë.	Vetëdijësimi i popullatës sa i përket parandalimit të sëmundjes së kancerit. Kontrollat e vazhdueshme të parapara sipas profesionistëve shëndetësor, mund të shpëtojnë jetë.	Afati kohor	Janar – Dhjetor (gjatë gjithë vitit)	Buxheti komunal, qeveritar, donatorët	Buxheti komunal, donatorët	21 Mars	Buxheti komunal, donatorët	Ngritja e vetëdijës së popullatës dhe institucioneve nëpërmjet shënimit të
Rezultatet	Përfshirja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në të gjitha sferat shoqërore.	Përfshirja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në të gjitha sferat shoqërore.	Përfshirja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në të gjitha sferat shoqërore.	Respektimi i të drejtave të qytetarëve dhe ngritja e nivelit të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, duke përfshirë fëmijët dhe të akterët në bashkëveprim rinj të bëhet në bashkëveprim me aktorët komunale: drejtoritë përkatëse.	Respektimi i të drejtave të qytetarëve dhe ngritja e nivelit të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, duke përfshirë fëmijët dhe të akterët në bashkëveprim rinj të bëhet në bashkëveprim me aktorët komunale: drejtoritë përkatëse.	Respektimi i të drejtave të qytetarëve dhe ngritja e nivelit të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, duke përfshirë fëmijët dhe të akterët në bashkëveprim rinj të bëhet në bashkëveprim me aktorët komunale: drejtoritë përkatëse.	Respektimi i të drejtave të qytetarëve dhe ngritja e nivelit të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, duke përfshirë fëmijët dhe të akterët në bashkëveprim rinj të bëhet në bashkëveprim me aktorët komunale: drejtoritë përkatëse.	Rezultatet	Janar – Dhjetor (gjatë gjithë vitit)	Buxheti komunal, qeveritar, donatorët	Buxheti komunal, qeveritar, nga donatorët	21 Mars	Buxheti komunal, donatorët	Ngritja e vetëdijës së popullatës dhe institucioneve nëpërmjet shënimit të
Burimet financiare	Buxheti komunal, qeveritar, donatorët	Buxheti komunal, qeveritar, donatorët	Buxheti komunal, qeveritar, donatorët	Buxheti komunal, qeveritar, nga donatorët	Buxheti komunal, qeveritar, nga donatorët	Buxheti komunal, qeveritar, nga donatorët	Buxheti komunal, qeveritar, nga donatorët	Burimet financiare	Janar – Dhjetor (gjatë gjithë vitit)	Buxheti komunal, qeveritar, donatorët	Buxheti komunal, qeveritar, nga donatorët	21 Mars	Buxheti komunal, donatorët	Ngritja e vetëdijës së popullatës dhe institucioneve nëpërmjet shënimit të

PROJEKT PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2023

<i>ditëve Ndërkombëtare Për të drejtat e fëmijëve me Aftësi të Kufizuar</i>			që kanë këtë Syndrome në mënyrë që të jetojnë me dinjitet dhe për të qenë aktiv e pjesëmarrës në komunitetin dhe shoqërinë ku jetojnë.		
<i>7 prilli – Dita Botërore e Shëndetësisë</i>	Shënimi i Ditës Botërore të Shëndetësisë.	NJKDNJ në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.	Fushatë sensibilizuese, tryeza, debate, përgatitja dhe shpërndarja e fletëpalosjeve tek qytetarët, etj. Kjo ditë shënohet me qëllim të ndërgjegjësimin të qytetarëve lidhur me rëndësinë e shëndetit dhe kontrollet që duhet bërë për të parandaluar sëmundjet e ndryshme.	7 Prill	////////
<i>Dita Ndërkombëtare kundër duhanit</i>	Shënimi i 31 majit – Ditës Ndërkombëtare kundër duhanit.	NJKDNJ Drejtoria e Shëndetësisë	Fushatë sensibilizuese me qytetarë të grupmoshave të ndryshme bashkëbisedim dhe shpërndarja e fletëpalosjeve me informacione sa i përket duhanit dhe pasojave tij.	31 maj	Buxheti komunal, donatorët
<i>1 qershori – Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve</i>	Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve.	NJKDNJ në bashkëpunim me akterët institucional dhe OIQ.	Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të fëmijëve NJKDNJ në bashkëpunim me akterët tjerë institucional dhe OIQ organizon aktivitete të ndryshme kulturo-artistike.	1 qeshor	Buxheti komunal, donatorët
<i>Dita Ndërkombëtare kundër punëve të rënda të fëmijëve</i>	Shënimi i Ditës Ndërkombëtare kundër Punëve të rënda të fëmijëve me aktivitete sensibilizuese.	NJKDNJ OIQ-të.	Fushatë sensibilizuese, takime me qytetar dhe informimi i tyre sa i përket punëve të rënda të fëmijëve dhe pasojave të cilat i shkaktojnë punët e rrezikshme krahas moshës që kanë.	Qershori	Buxheti komunal, donatorët
<i>1 tetor – Dita Ndërkombëtare e Njerëzve të Moshuar</i>	Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Njerëzve të Moshuar.	NJKDNJ OIQ	NJKDNJ në bashkëpunim me Shoqatën e Pensionistëve të Komunës, organizon një tryezë diskutimi me Personat e moshuar. Shpërndarja e fletëpalosjeve tek qytetarët.	Tetor	Buxheti komunal, donatorët
<i>Muaji tetor – Muaji i ndërgjegjësimin të Kancerit të gjirit</i>	Fushatë ndërgjegjëse për parandalimin e kancerit të gjirit.	NJKDNJ, ZBGJ në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale,	Organizim i takimeve me gra në fshatra dhe qytet, bashkëbisedim lidhur me parandalimin e sëmundjes së Kancerit të gjirit, rëndësia e kontrolleve mjekësore dhe informimi i tyre se në QKUK	Tetor	Buxheti komunal, donatorët

[illegible]

16 ditë aktivizëm	Fushatë vetdijësuese sa i përket parandalimit të dhunës ndaj grave.	NJKDNJ, ZBGJ GGK	Organizim i aktiviteteve të përbashkëta me të gjithë atkerët institucional dhe OJQ me qëllim të vetdijësimit të popullatës që dhuna nuk është zgjidhje. Me anë të këtyre aktiviteteve ju bëjnë thirrje që gratë duhet të ngrenë zërin dhe të mos heshtin për dhunën që ushtrohet ndaj tyre. Qasja ndaj dhunës mbi gratë e vajzat si shkelje e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut është një komponent kyç i 16 Ditëve të Aktivizmit.	25 nëntor - 10 dhjetor	Buxheti komunal, donatorët
25 nëntori Dita Ndërkombëtare Kundër dhunës ndaj gruas	Fushata e 16 Ditëve organizohet në mbarë botën nga aktivistë të të drejtave të njeriut për të bërë thirrje për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave. Fillon me 25 nëntor dhe përfundon me 10 dhjetor pikërisht në Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut.				
3 dhjetori – Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuar	Shënim i Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar me një mori aktiviteteve për PAK.	NJKDNJ Drejtorja e Shëndetësisë Handikos	Shënim i Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar me aktivitete të ndryshme kulturore e rekreative.	3 dhjetor	Buxheti komunal, donatorët
10 dhjetori – Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut	Shënim i Ditës Ndërkombëtare të të të Drejtave të Njeriut.	NJKDNJ Institucioni i Avokatit të Popullit	Tryezë diskutimi me qytetarë, nxënës dhe mësime të lidhura me të drejtat e Njeriut.	10 dhjetor	Buxheti komunal, donatorët
Dyert e hapura me qytetar	NJKDNJ në bashkëpunim me Institucionin e Avokatit të Popullit çdo muaj organizon aktivitetin "Dyert e hapura me qytetar".	NJKDNJ Institucioni i Avokatit të Popullit	Qytetarët kanë mundësinë që një herë në muaj të parashtrijnë ankesat e tyre (të cilat mendojnë se po iu shkelen të drejtat e njeriut) pranë Avokatit të Popullit dhe zyrtareve të NJKDNJ-së.	Një herë brenda muajit gjatë gjithë vitit	//////

Zyra për Integritet Evropian

Zyra për Integritet Evropian do të kryej funksionin dhe detyrat e veta, duke u bazuar në rregulloren nr. 08/2011 për organizimin dhe përgjegjësitë e zyrtarit komunal për integritet evropian në monitorimin, bashkëpunimin dhe raportimin e rregullt për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Departamentin për Integritet Evropian.

Bashkërendimi i aktiviteteve me Asociacionin e Komunave me ministritë e linjës (MAPL/ MIE), avancimi i sistemit të riintegritetit të qëndrueshëm për personat e riatdhesuar, përmirësimi i bashkëpunimit dhe dialogut civil me shoqërinë civile lokale dhe palët e tjera të interesuara, organizimi i këshillimit të përbashkët me ZKIE-të për finalizimin e planeve individuale nga obligimet e agjendës evropiane, raportet periodike (raporti vjetor janar-dhjetor 2023 për përmbushjen e obligimeve nga Agjenda Evropiane për komuna, raportimet 6 mujore

per raportin e vendit dhe (MSA), raportimet vjetore për Planin Komunal të Veprimit për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit - Asociimit - MSA - janë disa nga aktivitetet kyçe të planifikuara për vitin 2023 në kuadër të ZIF-së.

Zyra për Barazi Gjimore

Punët dhe detyrat e parapara me plan vjetor do të kryhen me efikasitet, përgjegjësi dhe profesionalizëm në harmoni me përcaktimin e detyrave të punës.

Vetëdijësimi në gjuhën e barazisë gjimore, mbajtja e ligjëratave, fushatave sensibilizuese në vise rurale dhe në qytet, zbatim i regullorës për barazi gjimore, takime përgatitore me grata e viseve rurale dhe kryesuesit e fshatrave për identifikimin e prioritetëve të grave, me qëllim të përfshirjes së perspektivës gjimore në rishikimin dhe planifikimin e buxhetit të komunës, përkrahja dhe zbatueshmëria e ligjeve në lidhje me barazinë gjimore, zbatim, monitorimi i tyre dhe raportimi mbi zbatueshmërinë e tyre - janë disa nga aktivitetet kyçe të planifikuara për vitin 2023, në kuadër të ZBGJ-së.

Në kuadër të këtij dokumenti të qeverisjes së Rahovecit, këtu po paraqesim edhe objektivat kryesore të drejtorive komunale.

Secila drejtori është përgjegjëse që në harmoni me objektivat strategjike të qeverisjes së komunës së Rahovecit të përcaktojë planin e vet të punës dhe ta realizojë të njëjtin, gjithashtu duke qenë në shërbim të qytetarëve.

Drejtoria për Administratë

Administratë duke u bazuar në rend të parë në legjislationin në fuqi, lehtësime të procedurave administrative, komunikim korrekt me qytetarët, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, qoftë sipas formave të sistemit elektronik, gjithashtu afirmimi i punës së hapur në administratë, trajtimin me kohë të kërkesave të qytetarëve, profesionalizmi, paraqesin shtyllat bazike përmes së cilave qytetarët absorbajnë shërbime cilësore administrative në komunë. Një administratë funksionale dhe transparente është gjithashtu një kontribues i rëndësishëm për legjitimitet të shtetit dhe besueshmërisë.

Andaj, për të promovuar performancë më të avancuar të shërbimeve cilësore për qytetarët e Komunës së Rahovecit, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, prezanton planin dhe objektivat për vitin 2023.

Tremujori i parë i vitit 2023: janar, shkurt, mars:

- Funksionalizimi i sistemit "One Stop Shop";
- Vendosi e paisjes digjitale (E-KIOSK) në fshatin Ratkoc;
- Ngrija e nivelit të përgjegjësisë dhe disiplinës në punë, shtimin e efikasitetit në shqyrtimin dhe vendosjen e kërkesave/parashtrësive të parashtruara nga ana e qytetarëve/bizneset si dhe subjektet e tjera;
- Përmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë, synohet ngrija e bashkëpunimit me të gjitha drejtoritë e administratës komunale, organet e komunës dhe njësitë e tjera për shqyrtimin dhe vendosjen e kërkesave/lëndëve brenda atateve ligjore;
- Mbikëqyrja e rrjetit, serverëve, kompjuterëve, pajisje të tjera të teknologjisë informative;

- Përgatitja dhe organizimi i seancave të rregullta, seancat e jashtëzakonshme dhe seancat urgjente (gjatë tërë vitit);
- Përgatitja e materialit për mbledhjet e Kuvendit, dërgimi i materialit dhe ftesës MAPL-së dhe kuvendarëve me anë të e-mailit (gjatë tërë vitit);
- Përgatitjen e procedurave për inventar dhe nevoja të tjera për administratën komunale,
- Të gjitha vendimet e nxjerra nga Kuvendi do të procedohen më tutje sipas rregulloreve dhe ligjeve në fuqi, të njëjtat do të kujdesemi që të arkivohen në mënyrën më të mirë të mundshme.

Tremujori i dytë i vitit 2023: prill, maj, qershor:

- Mirëmbajtja e serverëve;
- Përgatitja profesionale dhe teknike e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe komiteteve të tjera të parapara me Statutin e Komunës, bazuar në kalendarin vjetor për mbajtjen e mbledhjeve të komiteteve (gjatë tërë vitit);
- Përkthimi i të gjitha materialeve të Kuvendit, Komiteteve, këshillit të drejtorëve dhe organeve të tjera komunale, si dhe përkthimi simultan i seancave të rregullta dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit, komiteteve dhe takimeve të tjera të institucioneve komunale (gjatë tërë vitit).

Tremujori i tretë i vitit 2023: korrik, gusht, shtator:

- Muajt korrik dhe gusht do të shpallen si muajt e mërgimtarëve, ku përveç aktiviteteve kulturore artistike, në Administratë do të rriten shërbimet për qytetarë dhe zyrtarët komunalë të Administratës do të punojnë me orar të zgjatur. Në kuadër të "Muajt të Mërgimtarëve", do të hapet edhe një sportel i veçantë për mërgimtarë, gjithashtu do të kujdesemi për parking të veturave që të ketë vend të mjaftueshëm për ta;
- Në sektorin e arkivit do të bëhet pranimi dhe arkivimi i lëndëve të përfunduara nga ana e drejtorisë, të gjitha lëndët do të arkivohen në depo të komunës në pajtim me ligjin (gjatë tërë vitit);
- Organizimi i punëve të arkivit komunal përmes një protokollit hyrës, si dhe shpërndarja e lëndëve nëpër organet e komunës, drejtoritë e Administratës si dhe njësitë e tjera.

Tremujori i katërt i vitit 2023: tetor, nëntor, dhjetor:

- Do të vizitohen të gjitha zyrat e gjendjeve civile në bashkësi lokale, në mënyrë që të evidentohet çdo nevojë ose kërkesë e zyrave të vendit për shërbime sa më cilësore për qytetarët tanë;
- Kontrollimi i kabllave dhe pajisjeve të rrjetit, pastrimi i rregullt i serverëve, bartja e incizimeve të mbledhjeve;
- Koordinimi me ASHI për licenca, instalimi i printerëve, instalimi i pajisjeve transmetuese;
- Servisimi i radiatorëve me rreze infra të kuqe;
- Mirëmbajtja e objekteve të komunës;
- Servisimi i automjeteve zyrtare;
- Sigurimi i automjeteve zyrtare.

Synime për vitin 2023:

Shërbimet komunale janë të rëndësishme për qytetarët, prandaj Komuna e Rahovecit do të investojë në vazhdimësi në modernizimin dhe rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve.

Angazhim për vazhdimin e mëtejme të digjitalizimit të administrates komunale.

Komuna e Rahovecit do të përkushtohet në rritjen e transparencës përmes aplikimit të metodave të reja të komunikimit online për qytetarë dhe medie.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale

Drejtoria për DSHPS, për vitin 2023 planifikon rritjen e kapaciteteve të kuadrove mjekësor, modernizimin e shërbimeve shëndetësore, zbatimin e projekteve të hartuara gjatë planifikimit, me qëllim të rritjes së mirëqenies së qytetarëve të komunës së Rahovecit.

DSHPS këtë plan do të mundohet ta arrijë përmes:

- Realizimit të projekteve kapitale në shëndetësi;
- Përkrahjes së mjekëve dhe personelit shëndetësor;
- Shërbimeve këshillimore për pacientë dhe
- Bashkëpunimit me Ministrinë e Shëndetësisë dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare që veprojnë në fushën e shëndetësisë.

Tremujori i parë: janar, shkurt, mars 2023:

Qysh në janar DSHPS-ja, do të përgatitet dhe të jetë e gatshme të përballojë fluksin e pacientëve në raste të gripave virusale. Në dy QMF-të, në Krushë të Madhe dhe Ratkoc do të vazhdojnë me dy ndërrime duke ofruar shërbime mjekësore qytetarëve në nevojë, poashtu do të bëjnë përpjekje për modernizim të shërbimeve, me analizat laboratorike dhe të shërbimeve të Rëntgenit, si dhe ofrimin e shërbimeve stomatologjike në QMF-të, në Qifllak dhe në Opterushe.

Zbatimi i projekteve kapitale si dhe përcjellja e projekteve që janë në vazhdim, me theks të vegantë renovimi i QKMF-së, dhe ndërtim të AMF-së në Lagje të Epërme, po ashtu do të bëjnë zgjidhjen e problematit të QKMF-së në Fortesë, ndërtimin e objekteve të ri për shkak se objekti aktual është jashtë funksionit si pasojë e vërshimeve të muajit shtator 2022 (sipas vlerësimit të komisionit të formuar me vendim të kryetarit për vlerësim të dëmeve të shkaktuara në objektin ekzistues në QMF - Fortesë). Gjithashtu, fokusi do të jetë edhe të mirëmbajtja e mjeteve mjekësore dhe të objekteve shëndetësore.

Në tremujorin e parë të vitit, planifikohet edhe takimi i rregullt me punëtorët shëndetësor.

Tremujori i dytë: prill, maj, qershor:

Në bashkëpunim me ministrinë e linjës që kemi edhe aktivitetet të ndërlidhura, përgatitja e stafit për emergjencën ku do të trajnohen ekipet e veganta për njësinë e emergjencës.

Periudha kyçe në këtë vit është kjo: funksionalizimi i plotë i renovimit të objekteve të QKMF-së, në të cilën qytetarët e komunës sonë do të kenë mundësi të shfrytëzojnë të drejtën e marrjes së shërbimeve mjekësore në të gjithë sektorët e shëndetësisë si: sektori për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, në gjinekologji, stomatologji, vaksininim e shërbime të tjera.

Përcjellja e projekteve kapitale në terren, duke shpresuar në përmirësimin e kushteve atmosferike do të vazhdojnë ta përcjellin këtë periudhë tremujore.

Në këtë periudhë do të ndërmarrim masa parandaluese për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve të komunës sonë: dezinfektimin, deratizimin dhe dezinspektimin e hapësirave me qëllim të mbrojtjes nga pickimi i rriqërave, duke ditur se shumë herë si komunë kemi qenë si vatrë e infeksionit nga rriqërat.

Në tremujorin e dytë të vitit, planifikohet edhe takimi i rregullt me punëtorët shëndetësor.

Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator:

Në tremujorin e tretë të vitit do të vihet në funksion të plotë objekti i rinovuar i QKMF-së dhe ofrimi i shërbimeve edhe më cilësore për qytetarët në nevojë, furnizimi me vaksinat kundër gripit sezonal për të moshuarit, poashtu, nuk do të mungojë përcjellja e projekteve të investimeve kapitale në këtë tremujor, si dhe shpërndarja në mënyrë të drejtë e subvencioneve për ndima momentale.

Në tremujorin e tretë të vitit, planifikohet edhe takimi i rregullt me punëtorët shëndetësor.

Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor:

Fokusi i periudhës së fundit të vitit do të jetë përcjellja e punimeve në investime kapitale, sigurisht se prioriteti kryesor do të jetë realizimi i buxhetit, njëkohësisht do të kujdesemi që punët e kryera të mbikëqyren dhe të shpenzohet buxheti në përpikëri, si dhe planifikimi i buxhetit për vitin e ardhshëm.

Në tremujorin e katërt të vitit, planifikohet edhe takimi i rregullt me punëtorët shëndetësor.

Synimet e DSHPS-së

Përkushtim i veçantë i DSHPS-së do të jetë përmirësimi i infrastrukturës shëndetësore për qytetarët e komunës sonë, ku në kuadër të infrastrukturës parashihet kujdes i shtuar te:

- Riparimi dhe mirëmbajtja e objekteve shëndetësore;
- Intervenimi, meremetimi i QMF-ve dhe AMF-ve;
- Modernizimi i shërbimeve mejkësore;
- Nuk duhet lënë anash vitin 2023 për ndërmarrjen e masave mbrojtëse kundër Covid-19, si dezinfektimin e objekteve shëndetësore: QKMF, QMF-të dhe AMF-të.

Sfidat e DSHPS-së, 2023

Sfidë kryesore e DSHPS është mungesa e stafit mjekësor - mungesë e theksuar e mjekëve, stomatologëve, infermierëve.

Poashtu si sfidë e madhe është edhe hapja e repartit të dializës, edhe pse nuk është kompetencë e DSHPS, duke ditur se këto shërbime janë terciare. Komuna, përkatësisht DSHPS-ja, ka pasur një marrëveshje me QKUK-në, për hapjen e repartit të dializës në objektin e QKMF-së, si njësi satelite e repartit të dializës të Spitalit Rajonal të Prizrenit.

Drejtoria për Arsim

Drejtoria për Arsim për vitin 2023, planifikon të realizojë aktivitetet të shumta me qëllime, synime dhe prioritete të qarta.

Qëllimet kryesore të DKA-së janë:

- Përmirësimi i kushteve për mësimdhënie frytdhënëse dhe cilësore,
- Mbarëvajtja e procesit edukativo arsimor dhe

- Arritja e suksessive më të mëdha të nxënësve të të gjitha niveleve.

Synimet kryesore e DKA-së për vitin 2023 janë:

- Rritja e funksionalitetit të aktivave profesionale (AP) dhe Këshillave Drejtuese në secilin shkollë;
- Riparimet dhe investimet në efizienzë të energjisë në objektet shkollore;
- Përfundimi i investimeve të planifikuara në ndërtimin e gerdheve për fëmijë dhe fillimi i funksionalizimit të tyre;
- Funksionalizimi i plotë i shkollave të reja të sapondërtuara;
- Vazhdimi i ndërtimit të objekteve të reja shkollore
- Vazhdimi i furnizimit të shkollave me libra, pajisja me mjete konkretizimi e laboratorike, me pako pedagogjike edhe për klasat e larta (6-12) dhe teknologji informative dhe pajisje inovative;

Prioritetet themelore të DKA-së për vitin 2023 janë:

- Përmirësimi i infrastrukturës së institucioneve shkollore;
- Mbarëvajtja e procesit edukativo arsimor;
- Nxitja e nxënësve për të mësuar përmes organizimit periodik të garave të diturisë në secilin nivel arsimor dhe në secilin lëndë;
- Ngritja e cilësisë në arsim përmes përdorimit të teknikave të reja inovative dhe përmes trajnimit adekuat të stafit të ri arsimor.

- Në tremujorin e parë, përveç që do të analizohet vijueshmëria dhe suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të parë, do të bëhen përgatitjet e nevojshme për fillimin e gjysmëvjetorit të dytë. Do t'i mbajmë aktive aktivet profesionale në secilin shkollë, të cilat do të jenë në bashkëpunim dhe koordinim të plotë me Ekipin Profesional Monitorues dhe Vlerësues (EPMV) të DKA-së. Do të vazhdojmë me zbatimin e projektit të riparimeve në shkollë. Nga Fondi i Kosovës për Efizienzë të Energjisë, do të insistojmë të përfundojmë projektet e efizienzës në 4 objektet shkollore dhe të fillojmë realizimi edhe i projekteve të tjera të fituara nga komuna jonë për zbatimin e Masave të Efizienzës së Energjisë në shkollë të tjera. Do të zhvillojmë aktivitete kulturore dhe garuese me nxënës për nder të festave të 17 shkurtit dhe 7 Marsit. Do t'i organizojmë dhe mbajmë garat shkollore dhe komunale për olimpiadën e matematikës dhe të lëndës së fizikës. Do të punojmë dhe do të angazhohemi që gërdhet për fëmijë në Kruhë të Madhe, Xërë dhe Ratkoc të vihen në funksion përmes rekrutimit të edukatoreve dhe stafit përkatës.

- Në tremujorin e dytë, Ekipi Profesional Vlerësues dhe Monitorues i DKA-së do të angazhohet në të gjitha shkollat dhe do të koordinojë veprimet me aktivet profesionale të shkollave, për t'u siguruar që ecuria e procesit të realizimit të planprogrameve mësimore dhe pakos pedagogjike po ecën mirë. Do të mbajmë gara të diturisë me nxënës e të gjitha niveleve dhe të shumicës së lëndëve mësimore. Poashtu, do të bëhen përgatitje dhe do të organizohet testi i maturës për nxënës e klasave të 12-ta dhe testi i arritshmërisë për nxënës e klasave të 9-ta. Do të zhvillojmë takimet e rregullta me drejtorët e shkollave, me ç'rast do të bëhet një analizë e përgjithshme e procesit mësimor gjatë vitit mësimor. Në këtë periudhë do të nisen procedurat e prokurimit për lidhjen e kontratave për projektin e pajisjes së shkollave me mjete konkretizimi dhe laboratorike. Poashtu, në këtë periudhë, DKA do të

pranojë dhe analizojë raportet e punës së dy ekipeve, EPRMB-së dhe EPMV-së dhe do të përcjellë hap pas hapi ecurinë e zbatimit të projekteve të planifikuara.

Në gjashtëmujorin e parë synimi ynë kryesor do të jetë përmbyllja e vitit mësimor me një zvogëlim të ndjeshëm të mungesave të nxënësve, sidomos në Shkollat e Mesme të Larta dhe ngritja e nivelit të cilësisë në Arsim, në të gjitha nivelet. Poashtu, në kuadër të DKA-së në këtë periudhë do të nisin procedurat për shumicën e projekteve të parashikuara.

- Në tremujorin e tretë, do të bëhet planifikimi i kuadrit mësimor për vitin shkollor 2022/2023 si dhe do të fokusohemi edhe në projektet e ndërtimit dhe riparimit të objekteve shkollore përmes zbatimit të kontratave përkatëse në vazhdim dhe atyre që do t'i lidhim në ndërkohë. Do të analizohen sukseset dhe mangësitë e vitit shkollor 2022/2023 dhe do të bëhen përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2023/2024. Të gjitha SHFMU-të do të furnizohen me tekste mësimore dhe do të marrim të gjitha masat e nevojshme që viti i ri shkollor të fillojë mbarë në të gjitha shkollat. Në këtë periudhë, do të bëhet gati edhe planifikimi i projekteve kapitale për arsim për vitin pasues 2024, dhe përmes kontratave të lidhura do të bëhet furnizimi i bibliotekave të shkollave me libra, mjete konkretizimi, pajisje laboratorike dhe të teknologjisë informative. Do të bëhet furnizimi me lëndë ngrohëse për të gjitha shkollat dhe institucionet edukativo arsimore para muajit nëntor dhe do të përcillet vazhdimisht realizimi i projekteve kapitale në fushën e arsimit.
- Në tremujorin e katërt, do të mbahen takime me drejtorët e shkollave dhe me koordinatorët e cilësisë për mbarëvajtjen e procesit edukativo arsimor për periudhën e parë vlerësuese të vitit të ri shkollor dhe për ecurinë e zbatimit të planprogrameve mësimore. Gjithashtu, EPMV do të vizitojë të gjitha shkollat, me ç'rast do të koordinojë veprimet me aktivet profesionale të shkollave. Drejtori i DKA-së do të realizojë takime të njëpasnjëshme me këshillat e arsimtarëve, në çdo shkollë.

Në gjashtëmujorin e dytë, synojmë t'i arrijmë qëllimet tona për t'i realizuar dhe përfunduar të gjitha projektet kapitale dhe projektet që kanë të bëjnë me mallra e shërbime për furnizimin e shkollave. Të gjitha këto në funksion të ngritjes së cilësisë në arsim.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Plani i veprimeve në DBF deri në përfundim të vitit 2023.

Veprimet/aktivitetet kryesore të cilat do të ndërmerren:

- Përgatitja e Pasqyrave Financiare;
- Përgatitja e raportit vjetor financiar për Kuvend;
- Përgatitja e rrjedhës së parasë (cash planit);
- Shpërndarja e faturave të Tatimit në Pronë;
- Bartja e të hyrave Vetanake nga viti 2022 në vitin 2023;
- Regjistrimi dhe verifikimi i objekteve;

- Plan-strategjia e realizimit të të hyrave komunale (Tatimi në Pronë) në raport me planifikimin (i përfunduar);
- Përgatitja e raportit tremujor financiar 2023, për kuvend dhe për publikim;
- Përgatitja e KAB-it komunal 2024-2026, sipas qarkoreve buxhetore I dhe II;
- Dërgimi i raportit të auditimit për vitin 2022 në kuvend, i audituar nga ana e Zyres Kombëtare të Auditimit;
- Përgatitja e raportit gjashtëmujor financiar 2023, për kuvend dhe për publikim;
- Dëgjimet buxhetore me qytetarë nga ekzekutivi dhe nga KPF, periudha Qershor - Korrik;
- Dorëzimi i KAB-it komunal 2024-2026, i përgatitur për votim në kuvend;
- Futja e të dhënave buxhetore në sistemin PIP dhe BDMS;
- Përgatitja e raportit nëntëmuajor financiar 2023, për kuvend dhe për publikim;
- Mbyllja e vitit Fiskal 2023, me përqindje të lartë të shpenzimit të buxhetit dhe me një përqindje të lartë të realizimit të të hyrave.

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bazë të statutit të Komunës së Rahovecit dhe rregulloreve në fuqi, paraqet planin vjetor të punës duke u bazuar në prioritetet strategjike dhe të nevojave të qytetarëve të komunës sonë. Duke u bazuar edhe në përvojën e viteve të kaluara, plani vjetor i punës për vitin 2023 është hartuar me kujdes të veçantë, në mënyrë që të jetë i kompletuar në aspektin e zbatimit dhe përmbushjes së vizionit të qeverisë komunale.

Plani është i ndarë në katër periudha tre mujore.

Përkushtim i veçantë i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, do të jetë:

- Miratimi i Planit Zhvillimor të Komunës së Rahovecit;
- Miratimi i Hartës Zonale të Komunës së Rahovecit;
- Sheshi qendror në Qytet.

Tremujori i parë:

Në tremujorin e parë të vitit 2023, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, planifikon të bëjë shqyrtimin e të gjitha kërkesave nga qytetarët në afatin minimal ligjor siç janë: leje ndërtimore, leje të rrënit, kushte ndërtimore, leje mjedisore komunale, vërtetimet urbanistike, certifikata të përdorimit. Poashtu, synojmë rritjen e të hyrave vetanake përmes lëshimit të lejeve ndërtimore, lejeve mjedisore komunale dhe me kalimin e ligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje në kuvendin e Kosovës, do të fillojmë edhe me legalizimin e objekteve pa leje.

Gjatë kësaj periudhe poashtu planifikojmë:

- Zbatimin e Planit të Prokurimit për nisjen e procedurave të prokurimit publik në afatin e përcaktuar në plan;
- Miratimin e Planit Zhvillimor të Komunës së Rahovecit;

- Mbajtjen e diskutimit publik për Vlerësimin Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale të Komunës së Rahovecit;
- Përgatitjet për fillimin e punimeve në projekte kapitale.

Tremujori i dytë:

Në tremujorin e dytë të vitit 2023, DUPMM, planifikon të bëjë shqyrtimin e të gjithë kërkesave nga qytetarët në afatin minimal ligjor siç janë: leje ndërtimore, leje të rrënit, kushte ndërtimore, leje mjedisore komunale, vërtetimet urbanistike, certifikata të përdorimit.

Gjatë kësaj periudhe, planifikojmë:

- Miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Rahovecit;
- Përfundimin e objektit të Banimit Social;
- Mbikëqyrjen e projekteve kapitale për cilësinë e punimeve dhe realizimin e tyre sipas projekteve.

Tremujori i tretë:

Në tremujorin e tretë të vitit 2023, DUPMM, planifikon të bëjë shqyrtimin e të gjithë kërkesave nga qytetarët në afatin minimal ligjor siç janë: leje ndërtimore, leje të rrënit, kushte ndërtimore, leje mjedisore komunale, vërtetimet urbanistike, certifikata të përdorimit.

Mbikëqyrjen e punimeve në projekte kapitale për cilësinë dhe ecurinë e tyre, me inxhinierët e komunës e mbikëqyrje të jashtme, duke kërkuar realizimin sa më të mirë të tyre.

Tremujori i katërt:

Fokusi në periudhën e fundit të vitit do të jetë: menaxhimi sa më efektiv i projekteve kapitale të menaxhuara nga DUPMM, në bashkëpunim me menaxherët e kontratave. Prioritet do të jetë edhe realizimi i buxhetit për vitin 2023.

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, në kuadër të Komunës së Rahovecit, ka një rol kyç në planifikimin, zbatimin, mbikëqyrjen dhe vlerësimin e strategjisë së zhvillimit, siguron koordinim vertikal dhe horizontal dhe komunikim me të gjithë akterët relevant në proces, si brenda administratës komunale poashtu edhe me nivelin qendror, komunitetin dhe më gjerë.

DEZHT, do të punojë sipas planit të punës të përgatitur në mënyrë profesionale dhe do të ndërmerr veprime të përcaktuara qartë dhe të harmonizuara me objektivat strategjike të Strategjisë Zhvillimore Komunale, si dhe dokumente të tjera programore që kanë për qëllim ndikimin në përmirësimin dhe avancimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik lokal. DEZHT, do të ndërmerr iniciativa të cilat çojnë në arritje të rezultateve konkrete dhe do t'i kushtohet vëmendje komunikimit konstruktiv me të gjitha institucionet relevante në nivel lokal dhe

qendror, me donatorët, si dhe investitorët potencial të huaj dhe vendor. Poashtu, do t'i ofrohet mbështetje biznesve fillestare dhe atyre ekzistuese, të vogla e të mesme, përmes aktivitetëve trajnuese, këshilluese duke përfshirë edhe promovimin e bizneseve lokale. Një aktivitet kyç i kësaj drejtorie do të jetë inkurajimi i krijimit të bizneseve të reja duke ofruar shërbime biznesese, sidomos atyre fillestare në përgatitjen e aplikacioneve për thirrje për grante nga burimet e ndryshme financiare. Një synim tjetër ku do të kemi kasje proaktive do të jetë joshja e investitorëve vendor dhe të huaj, përmes ofrimit të informatave profesionale relevante. Në anën tjetër do të identifikohen bizneset të cilat kanë interesim për të zgjeruar aktivitetin e tyre biznesor dhe për të hyrë në partneritet me investitorë potencial.

DEZHT do të jetë e kyçur aktivisht edhe sa i përket realizimit të të gjitha projekteve të financuara nga ana e donatorëve të ndryshëm, me qëllim të koordinimit të aktivitetëve dhe maksimizimit të efektit të rezultateve të pritshme, e në të njëjtën kohë do të angazhohet edhe për identifikimin e donatorëve të mundshëm potencial, në rastet dhe projektet që mund të identifikohen në ndërkohë gjatë këtij mandati.

OBJEKTIVAT KRYESORE TË PUNËS:

- Hulumtimin e mundësive për të siguruar donacione dhe burime të tjera financiare për realizimin e projekteve zhvillimore;
- Hartimin e programeve sipas veprimtarive dhe sektorëve të ndryshëm ekonomik, dhe përgatitjen e propozimeve konkrete për projekte të rëndësishme të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin e sektorëve të vegantë,
- Ofrimin e shërbimeve për regjistrimin e bizneseve - Qendra e Regjistrimit të Bizneseve;
- Bashkëpunimi dhe koordinimi i projekteve lidhur me Partneritet Publiko - Privat;
- Bashkëpunimin me institucionet Ndërkombëtare dhe organizatave të ndryshme financiare për projekte të ndryshme zhvillimore, e sidomos në projekte të investimeve kapitale;
- Koordinimi dhe bashkëpunimi me Organizatat joqeveritare që mund të përkrahin me projektet ideore të cilat kanë në fokus promovimin dhe zhvillimin ekonomik lokal;
- Bashkëpunimi i ngushtë me bizneset lokale lidhur me përmirësimin e klimës për të bërë biznes;
- Komunikimin e vazhdueshëm me investitorë potencial vendor dhe të huaj, përfshirë mërgatën me qëllim të informimit lidhur me lehtësirat, planet zhvillimore, projektet dhe mundësitë praktike që ofron komuna në raport me investitorët;
- Promovimin e potencialeve turistike të komunës së Rahovecit, në ndërlidhje me pakot e mundshme turistike në bashkëpunim me komunat e tjera të rajonit.
- Dhënia e pronave komunale përmes ankandëve publike, me qëllim të krijimit dhe zgjerimit të mundësive që pronat komunale të shfrytëzohen për aktivitete afariste;
- Angazhimi i të rinjve për praktike me pagesë në tregun e punës përmes marrëveshjeve të veganta me ndërmarrjet private;
- Krijta e projekteve investuese në PPP.

Prioritetet e Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm:

Duke u bazuar në planifikimin e buxhetit, përcjelljen e thirrjeve të MINIT, për aplikim të fondeve dhe të granteve, prioritetet e drejtorisë do të kategorizohen në periudha tremujore.

Tremujori i parë: janar, shkurt, mars:

Gjatë periudhës tremujore: janar, shkurt dhe mars, DEZHT planifikon ofrimin e mbështetjes për bizneset fillestare dhe atyre ekzistuese të vogla e të mesme, përmes aktiviteteve trajnuese, këshilluese, duke përfshirë edhe promovimin e bizneseve lokale.

Planifikimi dhe regjistrimi i të gjitha subjekteve afariste prej librit kryesor të vitit 2022 dhe regjistrimi në librin e ri të vitit 2023, kalkulimi i ngarkesave për vitin 2023 në formë elektronike, përpilimi dhe analizimi i ngarkesave të taksës afariste komunale për vitin 2023, mirëmbajtja e sistemit të pasurisë financiare dhe jo financiare, do ta karakterizojnë këtë periudhë tremujore.

Tremujori i dytë: prill, maj, qershor:

Regjistrimi i aseteve kapitale, mbikëqyrja dhe inkasimi i të hyrave në qera, si dhe mbikëqyrja e objekteve afariste komunale gjatë gjithë vitit, lidhja e kontratave të reja, rritja e inkasimit të të hyrave në taksa afariste komunale, ofrimi i shërbimeve për regjistrimin e bizneseve do të vazhdojnë ta karakterizojnë këtë periudhë tremujore.

Hartimi i programeve sipas veprimtarive dhe sektorëve të ndryshëm ekonomik si dhe përgatitja e propozimeve konkrete për projekte të rëndësishme, të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin e sektorëve të veçantë, janë synim i yni me fokus të veçantë për vitin 2023.

Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator:

Gjatë periudhës së tretë të vitit 2023, DEZHT planifikon të vazhdojë me shpërndarjen e të gjitha aktvendimeve të bizneseve për ngarkesën e taksave dhe të saldove ose (obligimeve të mbetura), si në taksa afariste komunale dhe në qera.

Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor:

Në periudhën e katërt të vitit, padyshim që prioritet i DEZHT mbetet realizimi i buxhetit në përpikmëri si dhe rritja e të hyrave komunale nëpërmjet inkasimit të të hyrave nga taksat dhe qiraja.

Prioritet i lartë:

- Zbatimi i memorandumit të bashkëpunimit me MINT, për projektin “Parku Industrial në Opterushë” në vlerë 1,800,000. 00€ si dhe mundësia e lidhjes së marrëveshjeve të reja me MINT, dhe ministrinë tjera, deri në funksionalizimin e plotë të këtij projekti;
- Një prioritet tjetër me rëndësi për ne do të jetë krijimi i hapësirave të reja për biznese;
- Promovimi dhe subvencionimi i bizneseve zejtare dhe atyre artizanale, me qëllim që të ruhen dhe të kultivohen vlerat e këtij sektori me rëndësi për komunën tonë.

Drejtoria për Shërbime Publike

Drejtoria për Shërbime Publike për vitin 2023 planifikon rritjen e investimeve në infrastrukturë publike, në përmbylljen e zgjerimit të ndriçimit publik, ndërtimin e rrugëve lokale, zgjerimin e rrjeteve të kanalizimeve fekale si dhe trajtimin e tyre përmes gropave septike, mirëmbajtjen e hapësirave publike si dhe investimeve tjera të nevojshme që janë prioritet për qytetarët e komunës sonë.

DSHP këtë plan do të mundohet ta arrijë përmes:

- Realizimi i projekteve kapitale në infrastrukturë publike, në rrugë, në efizienzë të ndërtimit publik dhe në mirëmbajtje, në zgjerim të rrjetëve të ujërave fekale dhe atmosferike, në trotuare si dhe në projekte tjera në interes të qytetarëve;
- Mirëmbajtjes së rrugëve, gjatë dy sezonëve;
- Mirëmbajtjen e hapësirave publike, parqeve, varrezave, lapidarëve, si dhe projekteve të tjera që janë implementuar dhe kanë nevojë për mirëmbajtje;
- Realizimin e disa projekteve që janë bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës, MPL-së, MMPH-së si dhe grantet e fituara nga donatorë të ndryshëm si dhe nga granti i performancës.

Prioritetet e Drejtorisë së Shërbimeve Publike

Duke u bazuar në planifikimin e buxhetit, si dhe në planifikimin e bërë nga Drejtoria për investime publike, prioritetet e drejtorisë do të kategorizohen në periudha tremujore.

Tremujori i parë: janar, shkurt, mars:

- Pastrimin e rrugëve dhe trotuareve nga bora dhe intervenimet e tjera emergjente;

- Ndërtime dhe intervenime sipas nevojës në infrastrukturë;

- Heqjen e depozitave ilegale të inerteve (Gjatë tërë vitit 2023);

- Analizimin e kontratave dhe përmirësimit të tyre në projektet si: trotuare, rrugë, rreth-trotullime,

- hapësira publike, mbikëqyrjen dhe mirëmbajtjen e varrezave të dëshmoreve, të martirëve, të civilëve,

- poashtu, të sheshëve, pllakave përkujtimore, të hapësirave të gjelbërueshëm etj. (Gjatë tërë vitit 2023);

- Hartimin e projekteve të reja për ndërtimin e rrjetëve të kanalizimit, të rrugëve, trotuareve, etj.

- Mbledhja e të hyrave nga sipërfatet publike sipas rregullores së DSHP-së;

- Mirëmbajtjen e rrugëve të ujërave fekale nga kompania KRU-Gjakova si dhe investime të reja në ndërtim të gypave të ujit, zgjerime në ujësjellës dhe investime të reja në bashkëfinancim me

komunën;

Tremujori i dytë: prill, maj, qershor

- Ndërtimin e rrugëve në qytet dhe fshatrat e komunës, sipas prioritetëve dhe planit të prokurimit (2023);

- Ndërtimin dhe mirëmbajtjen e kanalizimeve dhe ndërrhyrjet emergjente në disa vendbanime të komunës së Rahovecit (2023);

- Ndërtimin e trotuareve në qytet dhe fshatrat e komunës, sipas prioritetëve (Gjatë tërë vitit 2023);

- Hapjen e procedurave për disa punë si: rrugët lokale qytet - fshat, përmirësimi i kanalizimeve, insistim

- për përmirësimin me furnizimin me ujë të pijshëm për zonën e Il-të në Rahovec, duke përfshirë

- fshatrat Hoçë e Madhe, Zogisht dhe Opterushtë, pasta fshatrat Zatriq, Mirasor dhe Kaznik në

- bashkëfinancim me KRU Gjakovën, gjithashtu, mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe atyre në qytet, muret

- mbrojtëse sipas prioritetëve etj;

- Pas kategorizimit të rrugës qarkore në Rahovec, do të angazhohemi në ç'pronësimin e pronave përmes

- departamentit për ç'pronësimin në MMPH;

- Punët në signalizim horizontal dhe vertikal të rrugëve (Gjatë tërë vitit 2023);

- Vendosja e disa pengesave në rrugë, sipas standardeve të përcaktuara;

- Inicimin, analizimin e madhësisë dhe dendësisë së qarkullimit në rrugët e qytetit për verifikimin e

- senseve të lëvizjes;

- Krijimi i parkingjeve të reja në qytet,

- Krijimin e shtigjeve të reja për biçikleta dhe këmbësorë në zonën urbane,

- investime të reja në infrastrukturën sa më të mirë për personat me nevojë të veqanta,

- Në bashkëpunim me policinë e Kosovës dhe kompaninë për autobusarje të veturave, do të ketë

angazhim gjatë gjithë vitit 2023,

Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator:

- Vazhdimin e projektit të ndërtimit të rrugës 4 korsi Rahovec-Xërxë, fazën përfundimtare;
- Vazhdimin e ndërtimit të rrugëve lokale në qytet dhe në të gjitha vendbanimet e komunës sonë;
- Vazhdimin e ndërtimit të 6 segmenteve rrugore në qytet, bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës,
- Përgatitje për planin e ri për energji dhe klimë,

Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor:

- Infrastruktura në stacionin e autobusëve - vazhdim;
- Menaxhimi i deponive për mbeturina nga demolimet dhe ndërtimet;
- Eliminimin e të gjitha deponive ilegale - inerteve;
- Në bashkëpunim me KEDS do të caktojmë prioritetet për shtrirjen e rrjetit elektrik si dhe vendosjes së trafave sipas kërkesave të qytetarëve;
- Në bashkëpunim me KRU "Gjakova", do të realizohen projekte kapitale në zgjerimin dhe ndërrimin e gypave për ujë të pijshëm,
- Përmbylljen e disa projekteve kapitale;
- Mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonit dimëror;
- Raporti vjetor i drejtorisë, plani vjetor i prokurimit, plani vjetor i drejtorisë për vitin që vjen.

Synimet e DSHP-së:

Përkushtimi i veçantë i DSHP-së do të jetë përmirësimi i infrastrukturës publike për qytetarët e komunës sonë. Në kuadër të infrastrukturës parashihet që kujdes i shtuar do të jetë te:

- Trajtimi i ujërave atmosferik në qytet;
- Infrastruktura publike në rrjetin e kanalizimeve fekale dhe gropave septike, zgjerimet;
- Ndërtimi i rrugëve lokale, përfundimi i ndriçimit publik, trotualet dhe mirëmbajtja e hapësirave publike;
- Vendosja e paneleve diellore në institucione publike si dhe në zvogëlim të shpenzimeve të energjisë përmes platformave të tjera digjitale.

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Duke pasur parasysh, se sektori i Bujqësisë është në fokusin kryesor të komunës tonë, DBPZHR, për vitin 2023, ka paraparë që të vazhdojë përkrahjen e bujqve për rritjen e kapaciteteve prodhuese, modernizimin e bujqësisë, tërheqjen e investimeve, zbatimin e projekteve të hartuara gjatë planifikimit, me qëllim të rritjes së mirëqenies së qytetarëve, rritjes ekonomike dhe të punësimit.

DBPZHR këtë plan do të mundohet ta arrijë përmes:

- Zbatimit të politikave zhvillimore përmes përkrahjes direkte të bujqve - subvencionimit
- Shërbimeve këshillimore, si një instrument shumë i rëndësishëm që ndikon në rritjen e vetëdijes dhe avancimit të ofrimit të produkteve sa më cilësore
- Realizimit të projekteve kapitale në bujqësi, që ndikon në mbrojtje të produkteve bujqësore
- Zbatimin e projekteve të donatorëve dhe mbështetjes direkte në lëmin e bujqësisë për iniciativat e qytetarëve në ngritjen e cilësisë dhe sasisë së prodhimeve bujqësore.

Përveç aktiviteteve të parapara për periudhën kohore janar - dhjetor 2023, stafi i drejtorisë për BPZHR do të jenë të angazhuar edhe në komisione të ndryshme për mbikëqyrjen dhe pranimin e projekteve kapitale pranë kësaj drejtorie, si dhe në komisione të tjera, sipas nevojave dhe kërkesave që do të parashtrihen në drejtorinë tonë.

Prioritetet e DBPZHR-së:

Duke u bazuar në planifikimin e buxhetit, përcjelljen e thirrjeve të MBPZHR-se për skemën e pagesave direkte dhe të granteve, si dhe detyrave të tjera, prioritetet e drejtorisë do të kategorizohen në periudha tremujore.

Përkushtim i veçantë i DBPZHR-së do të jetë: përmirësimi i infrastrukturës bujqësore për fermerët e veshëm të komunës sonë. Në kuadër të infrastrukturës parashihet që vëmendje kryesore do të kenë:

- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore
- Ndërtimi i kanaleve të kullimit dhe drenazhimit të tokave bujqësore
- Zgjerimi i sistemit të ujitjes në pjesët ku mungon
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e përrënjevë,
- Rritja e sipërfaqeve me pyje të reja
- Shfrytëzimi racional i tokave bujqësore dhe pyjore që janë dhënë në shfrytëzim
- Ruajtja dhe mbrojtja e pyjeve nga zjarret

Përveç përkrahjes direkte me aktivitetet, fokus do të ketë edhe ofrimi i kështillave.

Në plan të parë do të jetë komunikimi dhe qasja e zyrtarëve të drejtorisë në raport me bujqit e komunës sonë, që në numër nuk janë pak - mbi 3000.

Tremujori i parë: janar, shkurt, mars:

Fillimi i këtij tremujori do të karakterizohet me thirrjen për aplikim për subvencione për qumësht/liter, sipas kategorive të cilësive, therjet e raportuara të gjedhit, vigat për majmëri dhe akuakulturë për gjashëmujorin e dytë të vitit 2022. Ky aktivitet është i ndërlidhur me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, por që nga praktika zakonisht thirrja hapet në gjysmën e muajit janar.

Poashtu këtë periudhë tremujore do ta karakterizojë edhe hapja e thirrjes për aplikim nga ana e MBPZHR-së për pagesave direkte - subvencione, në si staf i drejtorisë, synojmë të jemi të gatshëm të përballojmë fluksin e fermerëve gjatë kryerjes së procesit të aplikimit, të mobilizohemi me kapacitete të plota, si me staf poashtu edhe me mjete logjistike, duke e ditur se komuna jonë ka numrin më të madh të fermerëve në nivel vendi.

Pas përfundimit të fazës së aplikimit, të gjitha dosjet do të dorëzohen në Agjencionin për zhvillimin e bujqësisë për të vazhduar me kontrollin administrativ dhe kontrollin e terrenit, në mënyrë që të hapet rruga për pagesa të vitit 2023. Gjatë kësaj periudhe, sikurse çdo vit, zyrtarët e DBPZHR-së, procesojnë të dhënat në databazë, ku në fund nxirret raport mbi të dhënat e fermerëve, më pastaj, bëhet analizë me vitet paraprake mbi sipërfaqet e mbjellja, llojet e pemëve dhe perimeve, sasinë, numrin e krerëve të bagëtive, numrin e shoqërive për blatë si dhe të dhënat e përfutura në euro "€" nga skema e pagesave direkte të Ministrisë së BPZHR-së.

Si proces mjaft i rëndësishëm në këtë periudhë kohore do të jetë edhe shpallja e ankandit publik për dhënien e tokës bujqësore komunale me qera. Të gjitha procedurat do të iniciohen duke u bazuar në ligjet në fuqi për dhënien e tokës komunale bujqësore me qera.

Tremujori i parë i vitit 2023 do të karakterizohet edhe me një proces shumë të rëndësishëm për DBPZHR-në, pasi që do të fillojmë me vaksinimin e bagëtive të komunës sonë, në këtë mënyrë synojmë që t'a parandalojmë përhapjen e sëmundjeve të ndryshme.

Me përmirësimin e kushteve atmosferike, do të fillojnë edhe punimet në projektet kapitale në sektorin e zhvillimit rural, duke zbatuar projektet që paraprakisht kemi kontratë të lidhur me operatorë ekonomik.

Në këtë periudhë planifikojmë të vazhdojë edhe shpërndarja e pajisjeve bujqësore për fermerët përfitues, varësisht se si do të kenë mundësi të na furnizojnë operatorët ekonomik që kanë kontratë me Komunën e Rahovecit.

Në sektorin e pylltarisë, kjo periudhë tremujore do të ketë fokusin e përgjigjeve në kërkesat për damkosje të drunjëve në pronat e pyjeve private, aktivitet që është i rregulluar me ligjin e Pylltarisë.

Tremujori i dytë: prill, maj, qershor:

Përcjellja e projekteve kapitale, si: Rregullimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore, Ndërtimi i kanaleve të kullimit dhe drenazhimit të tokave bujqësore, Ndërtimi i infrastrukturës në tregun e Rrushit, Ndërtimi i objektit - Depos bujqësore, e projekte të tjera, do të jetë fokusi kryesor i zyrtarëve të drejtorisë.

Përcjellja e mbjelljeve pranverore për të parë më afër ecurinë e punëve agroteknike, duke u ofruar këshillat e nevojshme fermerëve për mbjelljet, në mënyrë që të kenë rendiment dhe cilësi të kënaqshme.

Përmes thirrjeve publike që do të hapen, do të jenë të përfshirë pothuajse të gjitha sektorët e bujqësisë që zhvillohen në komunën tonë. Zgjerimi i formës së përkrahjes së bujqve (përveç këtyre që janë në zbatim) edhe me inpute bujqësore si: plehra kimik, farëra dhe preparate që shërbejnë për mbrojtje të bimëve për të gjithë sektorët.

Padyshim, së theksi do të bjen në sektorin e vreshtarisë, perime-kulturës, blegtorisë dhe lavërtarisë, por, nuk do të mbeten anash edhe sektorët e tjerë siç janë: bimët mjekësore aromatike, ato të përpunimit të pemëve dhe perimeve, duke avancuar edhe në sektorin e prodhimit të produkteve jo-alkoolike si: pekmez, reçel, pistil etj.

Në kuadër të sektorit të pylltarisë e në koordinim të plotë edhe me Agjensionin Pyjor të Kosovës, planifikojmë të rrisim 25 hektarë me pyje të reja në njësinë menaxhuese, Kaznik-Kramovik.

Objektivat kryesore në gjashtëmujorin e parë të vitit 2023

- Përfundimi me sukses i fazës së aplikimit për subvencione në kuadër të MBPZHR-së;
- Inicimi i procedurave për shpallje të tenderëve për investime kapitale nga buxheti i ndarë për drejtorinë e bujqësisë;
- Vaksinimi i bagëtive;
- Shpërndarja e mekanizmit bujqësor për fermerët përfitues;
- Përcjellja dhe monitorimi i mbjelljeve pranverore, si dhe raportimi në Ministrinë e BPZHR-së.

Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator:

Fillimi i këtij tremujori do të jetë me fushatën e korrje - shirjeve, që edhe do ta karakterizojnë periudhën e tretë të vitit. Do të formohet komisioni për përcjelljen e procesit të korrje – shirjeve, deri në përfundim të kësaj fushate, duke e përcjellë me raport detal për Ministrinë e BPZHR-së.

Edhe gjatë vitit 2023, tradita e vjeljes së rrushit do të organizohet gjatë muajit shtator, ku komuna e Rahovecit do të ofrojë mbështetje të OJQ-ve rreth organizimit dhe mbarëvajtjes së festave me karakter bujqësor si: Festa e vjeljes së rrushit - HardhFest, Agrofesta, Panairi i produkteve të fundvitit etj.

Në këtë periudhë do të hapen thirrje për të përkrahur fermerët, ku do të përfshihen pothuaj të gjithë sektorët e bujqësisë në komunën tonë, si: vreshtaria, perimekultura, blegtoria, bletaria, etj.

Ky tremujor do të karakterizohet poashtu me thirrjen për aplikim për subvencione për qumësht/liter, sipas kategorive të cilësisë, therrjet e raportuara të gjedhit, viçat për majmëri dhe akuakulturë për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023, thirrje kjo që hapet nga Ministria e BPZHR-së.

Për shkak të temperaturave të larta, gjatë kësaj periudhe, zjarret në pyje përhapen shumë lehtë, prandaj si synim i DBPZHR-së, konkretisht i sektorit të pylltarisë, do të jetë parandalimi i përhapjes së zjarreve, pra do të ketë angazhim maksimal për parandalim të zjarreve në bashkëpunim me Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor:

Ky tremujor karakterizohet me përcjelljen e vjeljeve të prodhimave vjetshorë, pos vjeljes së prodhimave, i rëndësishëm është edhe procesi i mbjelljeve vjetshorë. Pra, në këtë periudhë do të bëhet përcjellja e fushatës së mbjelljeve vjetshorë, e që rëndësi të madhe ka procesi i mbjelljes së kultureve të grurit, si kulture strategjike në nivel vendi.

Vizitat në terren janë synimi jonë për këtë periudhë, pasi që në këtë kohë bëhet vjelja e rrushit, vizitat do të fokusohen në bodrumet për grumbullim të rrushit si dhe përpunuesve të perimeve në tërë territorin e komunës sonë.

Prioriteti kryesor për tërë vitin do të jetë realizimi i buxhetit të drejtorisë, i ndarë për vitin 2023, kujdesi që punët e kryera të mbikëqyren dhe të shpenzohet buxheti në përpikëri, duke zbatuar projektet kapitale që shërbejnë për zhvillimin në tërësi të bujqësisë në komunën tonë.

Objektivat kryesorë në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2023

- Fushata e korje-shirjeve;
- Thirja për aplikim për subvencione për qumësht;
- Organizimi i festave që kanë karakter promovim e produkteve bujqësore të komunës sonë;
- Përcjellja e investimeve kapitale;
- Vizitat në terren;
- Përcjellja e mbjelljeve vjetshorë;
- Realizimi i buxhetit të drejtorisë.

PËRFUNDIM

Plani i punës i hartuar nga drejtoria e BPZHR-së është plan ambicioz që përfshin në vete shumë aktivitete duke i prekur të gjithë sektorët e bujqësisë. Ky plan mund të devijojë dhe të ketë mospëputhje, duke u nisur nga fakti që në sferën e bujqësisë mund të ketë situata të pa parashikues nga fatkeqësitë natyrore ku mund të numërojmë: breshër, shira të shumta që shkaktojnë vërshime, temperatura të ulëta, temperatura të larta, etj. Përveç fatkeqësive natyrore, plani mund të devijojë edhe për shkak të aktiviteteve të përbashkëta me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, mund të mos përshatet koha e hapjes së thirrjeve për pagesa direkte, thirrjeve për skemën e grante, etj.

Stafi i DBPZHR-së është i përkushtuar që maksimalisht të zbatojë këtë plan një-vjeçar, duke mos pasur shqepje nga aktivitetet e viteve paraaprake, poashtu duke krijuar vazhdimësi për vitet në vazhdim të harmonizuar edhe me strategjinë e zhvillimit të Bujqësisë 2022-2027, që është miratuar në nivelin qendror.

Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë

Viti i Ri do të fillojë me qasje në detrat e reja dhe obligimet e mbetura nga viti paraprak. Qysh në fillim të vitit 2023, do t'i qasemi punës në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara nga kryetari i komunës në përputhje me Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale dhe Statutin e Komunës së Rahovecit.

Prioritetet e vitit 2023

Prioritet kryesor gjatë vitit 2023 është shërbime sa më të shpejta e cilësore, në përputhje me afatet kohore dhe të unifikuara ligjërisht.

Qëllimi kryesor i drejtorisë do të jetë i fokusuar në:

- Shërbime konform akteve juridike;
- Vazhdimi i evidentimit dhe lirit të pronave të uzurpuara në nivel të komunës;
- Vazhdimi i inventarizimit të dokumentacionit dhe skanimi masiv i dokumentacionit të paskanuar;
- Shpronësimi i pronave private për hapje të rrugëve publike.

Sfidat e vitit 2023

- Themelimi i komisionit për komosacion
- Vazhdimi i migrimit të zonave kadastrale në komosacion të fshatrave:
 1. Bellacërkë
 2. Celinë
 3. Xërxë
 4. Dejnë dhe
 5. Dobidol
- **Spektori për Kadastër dhe Pronë** - gjatë periudhës një vjeçare parashihet që të pranojë dhe kryejë më shumë se 1200 lëndë;
- **Spektori për Gjeodezi** - parashihet që të pranojë dhe zgjidhë mbi 520 lëndë.

Duke filluar nga muaji shkurt i vitit 2023 pritet që të ketë rritje të kërkesave për nxjerrjen e certifikatave pronësore nga ana e fermerëve për aplikim në kuadër të subvencioneve që pritet t'ju ndajë Qeveria e Kosovës, ku këtë proces do ta menaxhojmë me shumë kujdes, duke e rritur stafin mbështetës që të jemi në shërbim të qytetarëve me shumë profesionalizëm dhe në kohë reale.

Vlen të përmendet, sektori i gjeodezisë për punën e tyre që do ta kenë në terren, si dhe shërbimi pronësor juridik për angazhimin e dhënë në përgatitjen e akteve si për nevojat të Kuvendit të Komunës, poashtu edhe përgatitjen e akteve për persona fizik dhe juridik.

Do të vazhdojmë me përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm në lidhje me evidentimin e pronave, si atyre komunale dhe atyre private që janë: vendlënit e dëshmorëve të kombit me qëllim që këto parcela t'i shpallim zona me interes të veçantë, e cila mbetet sfidë që do të përfundohen deri në fund të vitit 2024.

Gjatë vitit 2023, nuk do të mungojë edhe qasja ndaj detyrave të tjera, si në sektorin e gjeodezisë ashtu edhe në atë të kadastrës dhe pronës, ku vlen të cekën:

- Propozim - vendimet për seancat e Kuvendit Komunal;
- Përgatitja e lëndëve për gjykatë dhe subjekte të tjera të përfshira në zbatimin e ligjit;
- Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme të qytetarëve dhe personave juridik;
- Punët e gjeodezisë inxhinierisë për nevojat e Kuvendit Komunal dhe palëve të tjera;
- Matjet kadastrale për vërtetimin e uzurpimeve arbitrare;
- Përgatitja e aktvendimeve për uzurpimet arbitrare;
- Punë të tjera sipas planit.

Me propozim të Kryetarit të Komunës, drejtuar Kuvendit të Komunës, do të bëhet shpallja e interesit të përgjithshëm të pronave komunale për zhvillim ekonomik të Komunës.

Detyra tjera të Drejtorisë;

- Përgatitja e aktdokumentit për angazhimin e gjeodeteve komunal jashtë drejtorisë;
- Përgatitja e akteve ndaj uzurpatorëve në nivel të Komunës;
- Dalja në terren e Shërbimit Pronësor-Juridik, me kërkesë të Drejtorisë për Punë Inspektuese;
- Dalja e gjeodetëve në terren për matjen e rrugëve në nivel Komune.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Drejtoria në përbërje prej këtyre sektorëve; Kulturë, Rini dhe Sport, mbulon fusha me rëndësi në jetën e përditshme, duke përfshirë aktivitetet të ndryshme: muzikë, shfaqje teatrale, art, aktivitetet rinore, sportive dhe ruajtjen e trashëgimisë historike e kulturore. Përveç buxhetit komunal, prioritet është gjetja e burimeve të tjera financiare, duke përfshirë edhe ato qendrore; MKRS dhe donatorë të ndryshëm vendor e ndërkombëtar, si dhe thellimin e bashkëpunimit me komunat tjera, OJQ-të, strukturat e pushtetit lokal, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë dhe donatorë të ndryshëm.

Prioritetet e vitit 2023

Trajtimi dhe shfrytëzimi i objekteve dhe institucioneve ekzistuese kulturore e sportive në komunën e Rahovecit. Objektet që ofrohen për këto aktivitete janë:

- Shtëpia e Kulturës në Rahovec, në Kruhë të Madhe, në Ratkoc, në Xërxe, në Drenoc, Amfiteatri i festivalit Dejnë;
- Biblioteka komunale "Sulejman Krasniqi" në Rahovec, në Kruhë të Madhe dhe Hoçë të Madhe;
- Stadiumi "Jahja Danuza" & fushat sportive;
- Palestra "Mizahir Isma".

Gjatë muajve të parë të vitit 2023, DKRS-së do përkushtohet maksimalisht në arritjen e objektivave në kuadër të kompetencave të drejtorisë, duke përmblusur planin e punës.

- Realizimi i planit të veprimit për vitin 2023;
- Kontrollimi i raporteve të projekteve të subvencionuara nga DKRS-së nga viti paraparak;
- Zbatimi i planit të prokurimit për projekte kapitale.

Sektori i Kulturës:

Puna në kuadër të sektorit të Kulturës në komunën e Rahovecit për vitin 2023, do të bazohet në dokumente sig janë:

1. LIGJI NR. 02/L-88 për Trashëgimi Kulturore;
2. Ligji Nr. 02/L-57 për Institucionet e Kulturës.

Prioritete në sektorin e Kulturës për vitin 2023:

- Nxjta e bashkëpunimit rreth aktiviteteve kulturore;
- Themelimi i Ansambllit Komunal;
- Nxjta e bashkëpunimit me OJQ-të në nivel komunal e më gjërë;
- Projekte me bashkëfinancim në Kulturë, Rini, Sport;
- Vazhdimi i ndërtimit të Shtëpisë muze "Ukshin Hoti";
- Riparimi i monumente historike;
- Restaurimi i objektivit përkujtimor për 64 të masakruarit në Kruhë të Madhe;
- Investime në infrastrukturën kulturore dhe në kënde të lojërave për fëmijë;
- Përkrahja dhe frymëzim i krijimtarisë dhe kreativitetit kulturor;
- Hartimi i projektit për ndërtimin e muzeut për shkrimtarin dhe atdhetarin, Sulejman Krasniqi;
- Përgatitja e projekteve të trashëgimisë kulturore, kujdesi për objektet në listën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe fuqja e atyre që duhet të ruhen, evidencimi dhe përkufizimi i vlerave kulturore e historike i objekteve të trashëgimisë kulturore;
- Përkrahja e trajnimeve për punëtorët e sektorit të Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Bibliotekës;
- Mbështetja e projekteve artistike & kulturore dhe "edukative";

- Mbështetja e ngjarjeve lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare: festivale, panaire artizanale.

Aktivitetet kulturore, sportive dhe ngjarjet historike për vitin 2023 DKRS –së:

Lloji i aktivitetit Data dhe koha	Aktivitetet e planifikuara
♦ 27 janar 2023 Manifestimi kulturor dhe përkujtimor "Flaka e Janarit"	1.Konkurs letrar për fëmijë dhe të rinj (propozim) 2.Homazhe në Brestoc, Hoçë e Vogël, Nagavc, Celinë dhe Krushë e Madhe 3.Akademi kulturore e përkujtimore
♦ Dita e Pavarësisë – 17 Shkurti -2023	1.Homazhe dhe nderime për dëshmorët 2. Kros për fëmijë dhe të rinj 3. Gara në futboll të vogël (tradicional) 4. Manifestimi festiv
♦ Epopeja e UÇK-së 5, 6, mars 2023	1.Homazhe dhe nderime
♦ Dita e Shkollës Shqipe (Mësuesit) 7 mars 2023	DKA&DKRS
♦ Dita e gruas 8 mars 2023	DKA dhe OJQ-të
♦ Dita e Poezisë 21 mars 2023	Orë poetike
♦ Dita Ndërkombëtare e të burgosurve politik	Tryezë diskutimi me të burgosur politik
♦ Dita Ndërkombëtare e Monumenteve kulturore 18 prill 2023	Tryezë historike me historianë dhe njohës të trashëgimisë kulturore
♦ Dita ndërkombëtare e librit dhe e të drejtave autoriale 23 prill 2023	Diskutime dhe promovime
♦ Dita Botërore e lirisë së shtypit 3 maj 2023	Debat&Tryezë
♦ Manifestimet kulturore e përkujtimore "Java e Dëshmorëve"5 – 12 maj 2023	Homazhe e nderime për dëshmorët Aktivitete kulturore e sportive
♦ Dita Botërore e muzeve 18 maj 2022	Diskutime dhe vizitë muzeve
♦ Festivalit folklorit "Anadrija jehon" 11,12,13 maj 2023	1.Promovimi i vlerave kulturore të rajonit të Rahovecit dhe trevave shqiptare.
♦ Dita e Qendrës së Kulturës "Mensur Zyberaj" 27 maj 2023	1. Shfaqje teatrale për të rinj dhe fëmijë 2. Program artistik&kulturor
♦ Dita Olimpike	Gara sportive dhe argëtuese
♦ Dita Botërore e Fëmijëve 1 qershor 2023	Aktivitete argëtuese e festive
♦ Java e Ukshin Hotit 11-16 maj 2023	Akademi politike
♦ Dita e Çlirimit të Komunës së Rahovecit 14 qershor 2023	1.Aktivitete kulturore e përkujtimore 2.Koncert festiv 3.Gara në futboll të vogël (tradicional) Ndarja e Medaljes Ukshin Hoti
♦ 17 qershor 2023 Ditelindja e Ukshin Hotit	Homazhe dhe nderime për të rënë
♦ Epopeja e Rahovecit 17 – 21 korrik 2023	Homazhe dhe nderime për të rënë
♦ Muaji i mërgimtarëve 15 korrik 15 gusht 2023	Aktivitete kulturore, sportive, argëtuese, takime e tryeza me mërgimtarë
♦ Dita Botërore e Rinisë 12 gusht 2023	Aktivitete me të rinj nga diaspora

◆ Shtaqje teatrale (tektor)	◆ Bashkëpunim me teatro profesionale
◆ Krosi vjeshitor, lojrat sportive tradicionale	◆ Vrapim dhe gara sportive me nxënës të shkollave të mesme e fillore
◆ Festat e Nëntorit 28 nëntor 2023	◆ Aktivitete për kujtimore, kulturore
◆ Dita e Bibliotekës "Sulejman Krasniqi" 7 dhjetor 2023	◆ 1 Konkursi letrar për gimin letrar "Sulejman Krasniqi"
◆ Sportisti i vitit 28 dhjetor 2023	◆ Aktivitetet solemn

Biblioteka Komunale "Sulejman Krasniqi":

Puna në kuadër të bibliotekës për vitin 2023, do të bazohet në dokumente siç është:

1. LIGJI Nr. 04/L-097 për Bibliotekat

Projektet dhe planifikimet vjetore në bibliotekë do të fokusohen në këto tema:

- Furnizimi me libra i bibliotekës dhe hulumtimi për dhunues të librave;
- Përgatitja e raporteve mujore dhe vjetore;
- Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare;
- Klasifikimi dhe katalogimi i librave;
- Anëtarësimi/huazime të reja në Bibliotekë;
- Evidentimi i punës përmes kartelave të librave;
- Përgatitja e informative, lidhur me ecurinë e lexuesve në bibliotekë;
- Ngritja e grupeve të leximit në shkollë;
- Java e Bibliotekarisë në Kosovë;
- Dita e Bibliotekës "Sulejman Krasniqi";
- Gmimi letrar "Sulejman Krasniqi";
- Dita Ndërkombëtare e Librit;
- Dita Ndërkombëtare e Poezisë;
- Aktivitete për fëmijë "Rëndësia e bibliotekës për një të ardhme";
- Fuqizimi i librit përmes vizitave nëpër SHFMU dhe aktivitete të ndryshme;
- Organizimi i aktivitetëve edukativo-arsimorë me nxënës;
- Pjesëmarrja në trajnime/konferenca lidhur me librin, në nivel regional dhe qendror;
- Hapja e kështjellit librar.

Sektori i Rinisë:

Puna në kuadër të sektorit të Rinisë për vitin 2023, do të bazohet në dokumente siç janë:

1. Ligji për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë;
2. Rregullorja për punën vullnetare;
3. Udhëzimi Administrativ për Zgjedhje të rinjve në Vendimarrje.

Prioritete për rininë, për vitin 2023:

- Bashkëpunimi me OJQ-të rinore është një nevojë e domosdoshme për përmirësimin e rolit të rinisë dhe për të arritur rezultate konkrete në fushën e rinisë;
- Përkrahja dhe nxitja e punës vullnetare të rinjve dhe bashkëpunimi me OJQ-të në Rahovec, të cilët e kanë fokusin në punën me rinin;
- Fillimi i ndërtimit të Qendrës për Kulturë, Arte dhe Inovacion në Rahovec;
- Krijimin e programeve që kanë qëllim promovimin më të madh në punësimin e rinjve;

- Gjallërimi i jetës kulturore - artistike si edhe nxitja, promovimi i talenteve të rinj dhe inkurajimi i krijuesve të rinj të shkollave të mesme;
- Nxitja e të rinjve nga zonat rurale, që të përfshihen në sa më shumë në aktivitete;
- Organizimi i forumeve dhe konferenca me fokus, rininë;
- Fuqizimi dhe përkrahja e rrjeteve dhe qendrave rinore;
- Përfshirja e minoriteteve dhe grupeve të marginalizuara në aktivitete rinore;
- Organizimi i datave të rëndësishme që ndërlidhen me rininë;
- Aktivitete të ndryshme për promovimin e vullnetarizmit.

Shënimi i datave me rëndësi për Rininë:

- Dita Ndërkombëtare e Vullnetarizmit;
- Dita Ndërkombëtare e Librit;
- Dita Ndërkombëtare e Lumturisë;
- Dita Ndërkombëtare e Solidaritetit Njerëzor;
- Dita Ndërkombëtare e Aftësive të Rinjëve;
- Dita Ndërkombëtare e Rinisë;
- Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit;
- Dita Ndërkombëtare e Poezisë;
- Dita Ndërkombëtare e Vallëzimit;
- Dita Ndërkombëtare e Vajzave në Shkencë;
- Dita Ndërkombëtare e Lumturisë;
- Dita Ndërkombëtare e Lirisë së Shtypit;

Sektori i Sportit:

Puna në kuadër të sportit për vitin 2023, do të bazohet në dokumente sic është:

1. LIGJI Nr. 05/L-075 për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në ngjarjet sportive
2. LIGJI Nr. 05/L-090 për Sponsorizime në fushën e Sportit
3. LIGJI Nr. 04/L-075 Për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit NR. 2003/24 për Sport.

Projektet dhe planifikimet vjetore në Sport, do të fokusohen në këto tema:

- Promovimi i sportit në mesin e të rinjve, si dhe identifikimi dhe përkrahja e talenteve të rinj;
- Forcimin e rolit të mjeteve të informimit në promovimin e idesë për marrjen me sport;
- Rregullimi i terreneve sportive;
- Organizimi i aktiviteteve të ndryshme;
- Masivizimi i Sportit;
- Përfshirja e minoriteteve në aktivitetet sportive;
- Dita Ndërkombëtare e Sportit për Zhvillim dhe Paqe;
- Dita Ndërkombëtare e Sportit për të rinj;
- Sportisti i Vitit "2023";
- Java Olimpikë;
- Kros Vjeshtor;
- Përmirësimi, ndërtimi i terreneve sportive dhe mirëmbajtja e këtyre objekteve.

Ndjekja e të gjitha procedurave të nevojshme dhe insistim në MKRS për fillim të punimeve në tri projekte për komunën e Rahovecit, sipas memorandumeve bashkëpunimit me MKRS-së (2019).

1. Ndërtimin e Stadiumit të Futbollit të kategorisë së dytë, në qytet, sipas standardeve të FIFA-së;
2. Ndërtimin e Palestrës Sportive në Krushë të Madhe;

3. Ndërtimin e stadiumit të futbollit të kategorisë së dytë, me standardet e Superligës së Kosovës, në Ratkoc.
 4. Vzhadimi i ndërtimit të kompleksit Sportiv në zonën turistike në Rahovec- buxheti i komunës.
- Përveç këtyre punëve, do realizohen edhe aktivitetet e punë të përditshme, si:
- Pranimi dhe shqyrtimi i lëndëve;
 - Vizita objekteve sportive;
 - Takimi me klube dhe shoqata sportive;
 - Vizita objekteve kulturore;
 - Takime me rini;
 - Takimet e rregullta në kuadër të DKRS-së;
 - Raportet javore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore;
 - Organizimi i aktivitetëve kulturore e sportive;
 - Monitorimi i aktivitetëve sportive.

Drejtoria për Punë Inspektuese

Planifikimi vjetor i Drejtorisë për Punë Inspektuese për vitin 2023, bazohet në dispozitat që dalin nga: Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji për Inspektoratin e Tregut 03/L-181 dhe Ligjin 04/L-186 për Plotezim Ndryshimin e Ligjit 03/L181, Ligji 04/L- 175 për Inspektoratin e Ujërave, Natyrës, Planifikimit dhe të Ndërtimit, Ligji nr. 04/L-179 Për Transportin Rrugor, Statutin e K.K. Rahovec si dhe akte tjera ligjore.

QËLLIMET E INSPEKTIMIT

Qëllimet e inspektimit arrihen nëpërmjet:

- Respektimi i parimeve ligjore;
- Respektimit të kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit;
- Këshillimi i subjektit të inspektimit për zbatimin sa më korrekt të kërkesave ligjore;
- Urdhërimi për korrigjim të shkeljeve ligjore dhe eliminimin e pasojave që dalin prej tyre;
- Shqiptimi i dënimeve, marrja e masave të tjera administrative.

AKTIVITETET E INSPEKTIMEVE


Aktivitetet inspektuese për realizimin e objektivave të inspektimit janë:

- Inspektimi i veprimtarive-subjekteve afariste, të cilat janë subjekt i inspektimit;
- Përgjigja në kërkesa zyrtare dhe trajtimi i rasteve ad-hoc;
- Përpilimi i procesverbaleve, nxjerrja e vendimeve dhe akteve të tjera dhe ekzekutimi i tyre.

ORGANIZIMI DHE PLANI INSPEKTUES

Gjatë vitit 2023, në Drejtorinë për Punë Inspektuese, inspektimet planifikohen të realizohen në tërësi, duke e mbuluar territorin e Komunës së Rahovecit - DPI do të jetë e organizuar në grupe inspektuese, me nga 4 grupe të kombinuara sipas nevojës. Inspektimi në terren, rregullisht fillon nga ora: 9:00: - 14:00, ndërsa sipas rrethanave dhe kërkesave mund të zgjasë edhe më shumë.

OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET



OBJEKTIVAT E PËRCAKTUARA SIPAS SEKTORËVE:

SEKTORI I NDËRTIMIT:

OBJEKTIVI	AKTIVITETET	VEPRIMET/ MASAT	PLANIFIKIMI
Inspektimi dhe parandalimi i ndërtimeve pa leje	Inspektim i objekteve ndërtimore në të gjitha fazat e ndërtimit.	Udhëzime; Sugjerime; Vërejtje;	2023
	Inspektim përfundimtar i ndërtimit të objektit me leje ndërtimi.	Urdhëresa verbale; Procesverbale;	
	Kompletimi i lëndës për çdo objekt ndërtues.	Njoftime; Aktvendime;	
		Fletëparaqitje; Gjoba mandatore	
Konservimi, rrënimi i ndërtimeve dhe mbindërtimeve që bëhen pa lejen e Drejtorisë Kompetente.	Ndalimi i punimeve ndërtimore me procesverbal.	Udhëzime; Sugjerime; Vërejtje;	2023
	Lëshimi i aktvendimeve të rrënit.	Urdhëresa verbale; Procesverbale; Njoftime;	

Rastet ad - hoc	Konservizimi i objekteve ndërtimor pa leje.	Aktivendime; Fletëparaqitje; Gjoha mandatore.	Përgjigje në kërkesa zyrtare.	2023
-----------------	---	---	-------------------------------	------

SEKTORI I TREGUT:

OBJEKTIVI	AKTIVITETET	VEPRIMET/ MASAT	PLANIFIKIMI
Luftimi i Ekonomisë Informale.	Regjistrimi i bizneseve. Verifikimi i kushteve minimale-tekniqe dhe pajisja e subjekteve me pajisje të punës; Kontrollim, origjina e mallit, mbajtja e evidencës.	Udhëzime; Sugjerime; Vërejtje; Urdhëresa verbale; Procesverbalet; Aktivendime; Fletëparaqitje; Gjoha mandatore	2023
Mbrojtja e Konsumatorit.	Vendosja e gërmimeve dhe verifikimi i gërmimit të deklaruar. Kontrollimi i produkteve, data e skadencës së produkteve.	Udhëzime; Sugjerime; Vërejtje; Urdhëresa verbale; Procesverbalet; Aktivendime; Fletëparaqitje; Gjoha mandatore.	2023
Rastet ad – hoc.	Inspektime të paparashikuara.	Përgjigje në kërkesa zyrtare.	2023

SEKTORI I GËSHITJEVE KOMUNALE:

OBJEKTIVI	AKTIVITETET	VEPRIMET/ MASAT	PLANIFIKIMI
Kontrolli rreth shfrytëzimit të sipërfaqeve publike.	Vazhdim i inspektimeve ndaj subjekteve afariste të cilët bëjnë, shfrytëzimin e hapësirave publike pa lejen e organit kompetent. Aksione të organizuara nga DPI për lirin e hapësirave publike;	Udhëzime; Sugjerime; Vërejtje; Urdhëresa verbale; Procesverbalet; Njoftime; Aktivendime; Fletëparaqitje; Gjoha mandatore.	2023
Vendosja konform ligjeve për mbishkrimet, panot dhe tabelat	Kontrolle inspektuese;	Udhëzime; Sugjerime;	2023

reklamuese .	Respektimi i afateve të dhëna me procesverbale dhe aktvendime.	Vërejtje; Urdhëresa verbale; Procesverbale; Njoftime; Aktvendime; Fletëparaqitje; Gjoha mandatore.	
Rastet ad – hoc.	Inspektime të paparashikuara.	Përgjigje në kërkesa zyrtare.	2023

SEKTORI I TRANSPORTIT DHE KOMUNIKACIONIT RRUGOR:

OBJEKTIVI	AKTIVITETET	VEPRIMET/ MASAT	PLANIFIKIMI
Mbikëqyrja dhe inspektimi i operatorëve për bartjen e udhëtarëve.	Kontrolle inspektuese, licencat, lejet, vijat e regjisturara, kushtet teknike dhe higjienike për transportin e udhëtarëve.	Udhëzime; Sugjerime; Vërejtje; Urdhëresa verbale; Procesverbale; Njoftime; Aktvendime; Fletëparaqitje; Gjoha mandatore.	2023
Inspektimi i vendparkingjeve.	Kontrolla inspektuese lidhur me sinjalizimin e vend – parkingjeve, bashkëpunim me menaxherin e kontratës, për mënjanimin e mangësive në afat të caktuar.	Udhëzime; Sugjerime; Vërejtje; Urdhëresa verbale; Procesverbale; Njoftime; Aktvendime; Fletëparaqitje; Gjoha mandatore.	2023
Rastet ad – hoc.	Inspektime të paparashikuara.	Përgjigje në kërkesa zyrtare.	2023

SEKTORI I MJEDISIT:

OBJEKTIVI	AKTIVITETET	VEPRIMET/ MASAT	PLANIFIKIMI
Dyfishim i përpjekjeve për mbrojtje të mjedisit.	Bashkëpunimi me inspektorët e nivelit qendror për mjedis, lidhur me koordinimin e aktiviteteve në fushën e mjedisit. Eliminimi i deponive ilegale.	Udhëzime; Sugjerime; Vërejtje; Urdhëresa verbale; Procesverbale; Njoftime; Aktvendime; Fletëparaqitje;	2023

		Gjoha mandatore	
	Mbikëqyrja e hapësirave të gjelbëruara.	Kontrolle inspektuese lidhur me mirëmbajtjen e hapësirave publike.	Udhëzime; Sugjerime; Vërejtje; Urdhëresa verbale; Procesverbale; Njoftime; Aktvendime; Fletëparaqitje; Gjoha mandatore
Rastet ad – hoc.	Inspektime të paparashikuara.	Përgjigje në kërkesa zyrtare.	2023

Prioritetet e Drejtorisë për Punë Inspektuese:

Duke u bazuar në zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, prioritetet e drejtorisë do të kategorizohen në periudha tremujore.

Tremujori i parë: janar, shkurt, mars

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2023, planifikojmë të bëjmë kompletimin e lëndëve të bartura nga viti paraprak, duke respektuar afatet procedurale e ligjore.

- Në këtë fazë, kryesisht fillojnë përgatitjet për ndërtime pranverore, por si ngecje do të jenë kushtet atmosferike dhe ne do të jemi vazhdimisht në vëzhgim të terrenit, gjatë kontrollimeve do të verifikojmë objektet të cilat nuk posedojnë leje ndërtimi, do të merren masa paraprake të parapara me ligjet e ndërtimit dhe rregulloret në fuqi;
- Ndallimi dhe asgjësimi i mallrave që shkaktojnë dëme dhe rrezik për shëndetin, jetën dhe mjedisin e konsumatorëve, kontrolle të vazhdueshme në transportim dhe bartje të mallit, gjë kjo e cila mund të arrihet përmes bashkëpunimit të inspektorit të tregut në koordinim me inspektorët e tjerë dhe organet e autorizuar;
- Kontrollimi i objekteve shkollore dhe parashkollore, shëndetësore, kultures fizike, sportit dhe rekreacionit, objektet e mbajtjes së higjienës personale, objektet publike, objekteve për furnizim me ujë të pijshëm etj;
- Detyrimi i biznesve për legalizimin e veprimtarisë pranë zyrës së bizneseve në Rahovec;
- Inspektimi për ruajtjen e tokës bujqësore nga degradimet jo-ligjore dhe inspektimi i barnatoreve veterinarë dhe bujqësore.

Tremujori i dytë: prill, maj, qershor

- Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2023, do të merremi me lëndët e plotëfuqishme me qëllim që t'i ekzekutojmë këto lëndë, duke u përqendruar në vendbanimet e komunës së Rahovecit, aty ku janë evidentuar uzurpues të pronave publike;
- Bashkëpunimi me inspektorët e nivelit qendror për mjedis lidhur me koordinimin e aktiviteteve në fushën e mjedisit, të mbikëqyrjes së hapësirave të gjelbëruara, të inspektimit të ambulantave dhe barnatoreve shëndetësore, lidhur me menaxhimin e mbeturinave sanitare, aktivitete këto që do ta karakterizojnë këtë periudhë tremujore;

- Kontrollime mbi cilësitë, çmimet dhe kushtet e shitjes me çmime në aksion në të gjitha lokalitetet.

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2023, synim kryesor kemi inspektimin dhe parandalimin e ndërtimeve pa leje, kontrollimin e objekteve të vjetra nga aspekti i mirëmbajtjes, mbrojtjen e konsumatorëve, luftimin e tregtisë joformale dhe konkurrencës së padrejtë tregtare si dhe mbikëqyrjen e kushteve higjienike sanitare nëpër të gjitha objektet publike, në bashkëpunim me inspektorët e AUVK-ut.

Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator

- Këtë periudhë tremujore e karakterizon fluks më i shtuar i numrit të automjeteve nga mërgimtarët tanë, si dhe sezona e pushimeve verore, andaj, inspektori i komunikacionit në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, Stacionin Policor në Rahovec, Njësinë e Trafikut, do të kujdesen për krijimin e sigurisë më të madhe dhe qarkullimin e lirë në komunikacion;
- Mbikëqyrja e kyçjeve në sistemin e rrjetit të ujësujellës publik nga personat fizik dhe juridik, mënyra e shfrytëzimit dhe keqpërdorimet eventuale të ujit të pijshëm (larja e rrugëve, sipërfaqeve të hapura publike, autolarjet, ujitja e kopshteve etj), mbikëqyrja e ndërhyrjeve eventuale mbi infrastrukturën rrugore (ekzekutimi i punëve publike apo private), mbikëqyrja e hedhjes së mbeturinave jashtë vendeve të caktuara, do të vazhdojnë ta karakterizojnë periudhën tremujore.

Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor

- Fokusi i periudhës së fundit të vitit do të jetë verifikimi i të gjitha dokumenteve si: procesverbale, vendime, njoftime etj;
- Sigurisht, se prioriteti kryesor do të jetë realizimi i buxhetit, rritja e presionit në mënyrë të vazhdueshme në gjykata me qëllim shqyrtimin e lëndëve të dërguara nga inspektorati, informimi i qytetarëve për domosdoshmërinë e pajisjes me leje të ndryshme që lëshohen nga komuna, pranim-shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, shqiptimi i gjobave ndaj kundërvajtësve.

Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2023, synim kryesor kemi mbrojtjen sa më efikase të interesave të qytetarëve të komunës së Rahovecit, në bashkëpunim me të gjitha palët e interesit si: institucionet shtetërore, organet komunale, komunitetin e biznesit dhe qytetarët, si dhe zbatimin e plotë dhe të paanshëm të rregullativës ligjore dhe nënligjore që është në fuqi, identifikimin dhe eliminimin e dukurive negative, vendosja konform ligjeve për mbishkrime, panot dhe tabelat reklamuese, kontrolli rreth shfrytëzimit të sipërfaqeve publike.

PËRFUNDIM

Përkundër të gjitha sfidave, për përmbushjen e të gjitha objektivave të këtij plani, nevojitet një bashkëpunim me të gjitha institucionet e tjera, të cilat do ta ndihmonin arritjen e rezultateve konkrete. Ky plan pune mund të plotësohet edhe me objektiva dhe detyra të tjera, të cilat mund të jenë të nevojshme, si dhe me kërkesën dhe vendimin e Kryetarit të Komunës, varësisht nga nevojat dhe prioritetet që mund të shfaqen gjatë periudhës planifikuese.

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim (DMSH) në punën e saj mbështetet: në ligjet, urdhëresat administrative dhe rregulloret në fuqi. Aktivitetet e drejtorisë janë të vazhdueshme dhe të pa parashikuara sipas intensitetit që mund të ndodhin nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera brenda vitit.

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim (DMSH) për vitin 2023 planifikon të bëjë keto aktivitete:

Emërtimi i detyrave/aktiviteteve të planifikuara	Bartësi i detyrës/aktiviteteve	Bashkëpunimi me:	Periudha e realizimit:
Inspektimi i lumenjve, përroskave dhe kanaleve të hapura.	Zyrtari për Emergjencë	D.SH.P.K	Janar- Mars
Plani i Reagimit Emergjent	Sektori i Emergjencës	Zyr.Emergjencës Ins.Parandalimit	Janar- Mars
Planifikimi i masave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.	DMSH		Janar-Dhjetor
Ndërmarrja e masave të menjëhershme në ofrimin e ndihmës me rastin e shfaqjes së fatkeqësive elementare dhe aksidenteve.	DMSH	NJPZSH, PK-ës, FSK, Shërbimet Emergjente.	Janar-Dhjetor
Konstatimi dhe evidentimi i dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë elementare dhe ndërmarrja e masave adekuatë për sanimin e gjendjes.	DMSH	Në bashkëpunim me drejtoritë tjera përkatëse.	Janar- Dhjetor
Servisimi i Aparatave kundër zjarrit.	DMSH	D. Administratës D. Shëndetësisë D. Arsimit D. Kulturës	Janar- Dhjetor
Angazhimi në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi.	Drejtori i DMSH	Kryetarin e Komunës, KKS	Janar-Dhjetor
Verifikimi i përgatitjeve për intervenim të forcave dhe të mjeteve për Mbrojtje, Shpëtim dhe Ndihmë.	DMSH	Zyrt.Emergjencës	Prill- Qershor
Zhvillimi i aktiviteteve propagandistike në edukimin dhe vetëdijësimin e qytetarëve- nxënëseve të shkollave nga lëmia e mbrojtjes nga zjarri.	DMSH	Ins.Parandalimit Zyr.Emergjencës	Korrik-Shator
Bashkëpunim me sektor, shërbime e zyra të ndryshme të cilat janë përgjegjëse për planifikim dhe veprim në raste emergjente.	Zyrtari për Emergjencë	Drejtoria për Bujësi Policia e Kosovës dhe Shërbimi Emergjent.	Korrik-Shator
Regjistrimi i mjeteve teknike të	Zyrtari për	NJPZSH	Prill-Qershor

nevojshme për intervenime në raste Emergjente.	Emergjenca		
Ngritja e nivelit të gatishmërisë emergjente në Komunë.	DMSH	Drejtoritë dhe institucionet tjera të Komunës.	Korrik-Shtator
Përpilimi i raporteve dhe informatave të ndryshme nga lëmia e mbrojtjes dhe shpëtimit.	DMSH		Janar- Dhjetor
Planifikimi, evidentimi dhe sistemimi i resurseve njerëzore dhe mjeteve materialo-teknike për nevojat emergjente.	DMSH	Institucionet, kompanit publike dhe private.	Janar- Dhjetor
Përcjellja e gjendjes së gatishmërisë dhe organizimi në hapsirën e mbrojtjes dhe shpëtimit.	Zyrtari për Emergjenca	Drejtori i DMSH	Korrik-Shtator
Inspektimi i rregullt i objekteve publike.	Ins.Parandalimit	DMSH	Janar-Dhjetor
Inspektimi i rregullt i objekteve ekonomike dhe private.	Ins.Parandalimit	DMSH	Janar-Dhjetor
Inspektimet Verifikuese, kontrolli i eliminimit të mangësive.	Ins.Parandalimit	DMSH	Janar-Dhjetor
Kontroilli i radio-lidhjeve - Azhurimi i frekuencave	DMSH	QRAKE-Prizren	Sipas planit të QRAKE
Koordinimi i punëve rreth dhënies së pëlqimeve në dokumentacion investivo-teknik dhe në lokacion, respektimi i standardeve për raste emergjente.	Ins.Parandalimit	AME/MPB	Janar-Dhjetor
Planifikimi i pjesëmarrjes së zyrtarëve të DMSH, në trajnime	DMSH	MPB/AME	Janar- Mars

PËRFUNDIM

Në bazë të Statutit të Komunës së Rahovecit dhe rregulloreve në fuqi, komuna e Rahovecit ka hartuar Planin Vjetor të Punës për vitin 2023, duke u bazuar në prioritetet strategjike dhe të nevojave të adresuara nga qytetarët e komunës sonë.

Zbatimi i këtij plani, kërkon mjete materiale, ekspertizë dhe përkushtim të madh intelektual e fizik. Mbi bazën e përvojës pozitive të kaluar, mund të thuhet se shumica e këtyre sfidave do të jenë të përballueshme. Ky plan është punuar me pjesëmarrjen e të gjithë drejtorëve të drejtorive përkatëse, poashtu, edhe të udhëheqësve të njësive në kuadër të zyrës së Kryetarit të komunës së Rahovecit. Plan i Dinamik i Punës, ka përcaktuar, jo vetëm përgjegjësitë për punët e projektet e caktuara, por edhe afatet kohore gjatë për të përfunduar të njëjtat.

Poashtu, siç është elaboruar shkurtimisht edhe më lartë, Plan i Punës, shprehimisht ndërlidhë edhe vlerat, synimet e qeverisjes, objektivat strategjike dhe prioritetet që dalin nga programi zgjedhor fitues në komunën tonë.

Në planin vjetor të punës për vitin 2023, reflektohen qartë nevojat e qytetarëve të komunës së Rahovecit të identifikuara nga shumë takime, që janë bërë në të gjitha lokalitetet e komunës.

Mirëpresim kontributin e secilit që përmes vërejtjeve, kështillave, plotësimeve apo të dobësive eventuale, që t'i bëjmë bashkërisht përmirësimet e nevojshme, në mënyrë që në të ardhmen ta bëjmë sa më mirë punën tonë!

Ju faleminderit!

Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 pika (d), nenit 17 dhe nenit 40 paragrafi 2 pika (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.4 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt.00.12.2021 miraton këtë :

V E N D I M

Për miratimin e planit të punës të Kuvendit të Komunës për vitin 2023

1. Me këtë vendim **miratohet** agenda dhe plani i punës i Komitetit për Politik dhe Financa dhe plani i punës të Kuvendit të Komunës së Rahovecit për vitin 2023.
2. Shtojcë e këtij vendimi është edhe plani i punës i Kuvendit të Komunës së Rahovecit për vitin 2023.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **MAPL-së, dhe**
- **Arkivit.**

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

01-Nr. ___/22
Datë: 00.12.2022

Defrim Kafexhiu

Kryesues i Kuvendit

Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo



Komuna Rahovec
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kuvendi Komunal – Skupština Opštine – Municipal Rahovec



PROJEKT-PLANI I PUNËS
I KUVENDIT TË KOMUNËS SË RAHOVECIT PËR VITIN
2023

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

Parathënie

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në Komunë dhe zgjidhet drejtpërdrejtë nga qytetarët dhe funksionon në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, Statutit dhe akteve të tjera nënligjore.

Kuvendi i Komunës nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për:

- Statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre;
- Miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
- Miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin sipas statutit apo Rregullores së punës;
- Planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
- Themelimin e komisioneve të kërkuara sipas Ligjit;
- Nivelin e tarifave dhe ngarkesave;
- Krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të Komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- Emërimin dhe riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- Arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale;
- Marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës; dhe
- Përgjegjësi të tjera që kërkojnë me ligj.

Për marrjen e vendimeve, Kuvendi i Komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij komiteteve të përhershme të Kuvendit të Komunës, apo Kryetarit të Komunës. Kuvendi i Komunës mund të tërheqë delegimin në çdo kohë.

Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifën dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal, për marrjen e raporteve nga Kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

Kuvendi i Komunës siguron kushte të punës për mbajtje të seancave të Kuvendit të Komunës, si dhe pjesëmarrje për qytetarë gjatë seancave. Siguron transparencë të plotë ndaj qytetarëve për të gjitha vendimet dhe aktet, si dhe për çdo gjë që është në interes të qytetarëve. Po ashtu, iu krijon mundësi qytetarëve që përmes formave të ndryshme të jenë pjesëmarrës në vendimmarrje.

Përveç këtyre aktëve, Kuvendi i Komunës, kryen edhe aktivitetet e tjera që janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësisë së saj, përfshirë edhe funksione tjera, detyra dhe përgjegjësi të pa deleguara si:

- Vendimet që kanë të bëjnë me pronën e Komunës;
- Miratimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), Planit Zhvillimor Urban (PZHU), dhe Planeve Rregulluese Urbane (PRRU), si dhe ndryshimin e tyre; dhe
- Themelimin e ndërmarrjeve publike të Komunës.

Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Rahovecit është dokument i mbështetur në Ligjin për vetëqeverisje lokale, Statutin e Komunës, Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe aktet tjera nënligjore.

Plani është i hartuar në bazë të një kornize logjike i cili planifikon etapën e realizimit të punëve dhe detyrave të Kuvendit të bazuara në detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga Ligji për vetëqeverisje lokale, Statuti dhe aktet tjera nënligjore.

Me këtë plan synohet arritja e objektivave për vitin 2023, ku Kuvendi i Komunës së Rahovecit planifikon t'i mbajë minimum 10 (dhjetë) seanca të rregullta, 5 (pesë) prej të cilave në gjatshëmujorin e parë dhe 5 (pesë) në gjatshëmujorin e dytë të vitit 2023, në të cilat do të trajtohen të gjitha çështjet që janë në interes të Komunës dhe të qytetarëve të Rahovecit, e të cilat janë të proceduara sipas aktëve në fuqi:

- Cakton datën e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit sipas rregullores së punës së Kuvendit;
- Planifikon shqyrtimin e raporteve të rregullta të punës së Kryetarit të Komunës sipas ligjit;
- Inkorporon planin e tubimeve me qytetarë të Kryetarit të Komunës;
- Miraton buxhetin, planin investues, planin vjetor të prokurimit, planin vjetor të punës së Auditorit të Brendshëm, planin rregullativ etj.
- Miraton çështje tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin, sipas Statutit apo Rregullores së punës;
- Nxjerr rregullore të reja dhe bën harmonizimin e rregulloreve ekzistuese me ligjet në fuqi;
- Inkorporon planin e Kryetarit për festa shpëtimore e kombëtare.
- Mbikëqyr, diskuton, analizon dhe vlerëson punën e ekzekutivit;

Përfundim

Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës, do të ndihmoj dhe lehtësoj punimet e mbledhjeve të Kuvendit, duke iu ofruar anëtarëve të Kuvendit këtë plan, ata do të kenë një pasqyrë për punët dhe aktivitetet e parapara për vitin 2023 e që kanë të bëjnë me interesat e qytetarëve.

Me planin e punës janë paraparë minimum 10 (dhjetë) seanca të rregullta, por sipas nevojës mund të mbahen edhe seanca tjera përfshirë edhe seanca të jashtëzakonshme, solemne siç parashihet me LVL dhe Statutin e Komunës.

Për përmbushjen e Programit të punës, Ekzekutivi ofron mbështetje profesionale dhe administrative organeve të Kuvendit, duke përshtatur organizimin e brendshëm për realizimin e objektivave dhe agjendës sipas këtij plani.

Për mbarëvajtjen e zbatimit të gjitha aktiviteteve, sipas dinamikës së përcaktuar me këtë program - plan, do të përkujdesen Kryetari dhe Kryesuesi i Kuvendit.

Realizimi i Programit të Punës së Kuvendit kërkon bashkërenditje dhe koordinim të aktiviteteve me Ekzekutivin e Komunës, e cila duhet t'i përmbahet planit të Kuvendit për vitin 2023.

Plani i punës së Kuvendit sipas dinamikës mujore përfshin: emërtimin e aktit, propozuesin, afatin e dërgimit nga propozuesi, afatet e shqyrtimeve nga komitetet funksionale përgjegjëse për shqyrtim.

Programi i Punës së Kuvendit për vitin 2023 do të plotësohet edhe me:

- Miratimin e iniciativave për bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkombëtar.
- Propozime për debate dhe propozime përmbajtjesore,
- Propozime për raportime dhe informata,
- Peticione,
- Pyetje të anëtarëve të Kuvendit.

Shtojcë: Plani i punës sipas muajve

Plani i punës së kuvendit të komunës për vitin 2023

Rend dite	Hafton	Propozon	Shqyrton	Miraton
Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kalar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i K.K-së	KPF/KK	Kuvendi
Pyejet dhe përgjigjet në pyejet e kuvendarëve	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Ekzekutivi	
Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Veprimit për Transparencë Komunale 2023-2027	Zyra për Informim Publik	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
Shqyrtimi i Raportit për realizim e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2022	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi, K.K./S.K	KPF/KK	
Shqyrtimi Raportit vjetor financiar 2022	Drejtori për Buxhet dhe Financa	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
Shqyrtimi i implementimit të planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm sipas planit të veprimit për vitin 2022	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
Shqyrtimi i Raportit të punës të Këshillit të Ishanit Hoqë e Madhe për vitin 2022	Kryetari i Këshillit	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
Shqyrtimi i Raportit rreth aktiviteve të KKS-së për vitin 2022	Anëtarët e KKS-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
Shqyrtimi i Raportit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2022	Kryesuesi i K. Komunitete	Kryesuesi i K.K-së	KPF/KK	
Shqyrtimi i Raportit të punës së Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për vitin 2022	Kryesuesi i K. Për Shëndetësi	Kryesuesi i K.K-së	KPF/KK	
Shqyrtimi i Raportit të punës së Komitetit për Arsim për vitin 2022	Kryesuesi i K. Arsim	Kryesuesi i K.K-së	KPF/KK	
Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Anëtarët e K.K-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kalar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i K.K-së	KPF/KK	Kuvendi
Pyejet dhe përgjigjet në pyejet e kuvendarëve	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Ekzekutivi	
Barja (trialokim) i buxhetit të pasqepenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual	Drejtori për Financa dhe Buxhet	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Zhvillimor Komunal PZHK	D. Urbanizimit	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
Shqyrtimi i Raportit të Planit të Integritetit	Ekzekutivi	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
Raport nga Komiteti për Auditim të brendshëm për vitin 2022	Kryesuesi i Komitetit	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
Informaie rreth Planit për Banim Social 3 vjeçar	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
Informaie rreth përfundimit të gjysmëvjetorit të parë arsimor	DKA	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
Informaie mbi kontratat kornizë të Komunës së Rahovecit	Zyra e Prokurimit	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Anëtarët e K.K-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari i Komunës	KPF/KK	Kuvendi

SHKURT

JANAR

MARS	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kaluar Pyetje dhe përgjigjet në pyetje të kuvendareve	Zyra e Kuvendit Anëtarët e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së Anëtarët e Kuvendit	KPF/KK Ekzekutivi	Kuvendi
	Raport mbi menaxhimin e aseteve komunale (inventari) për vitin 2022	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Informata mbi lisiën e pronave komunale dhe menaxhimi i tyre	Sektori i pronës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Informata mbi menaxhimin e situatave në mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror	Drejtoria e Shërbimeve Publike	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
PRILL	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Anëtarët e KK-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kaluar Pyetje dhe përgjigjet në pyetje të kuvendareve	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së	KPF/KK	Kuvendi
	Raport nga komisionet e formuara nga Kuvendi i Komunës	Anëtarët e Kuvendit Komitetet dhe komisionet	Anëtarët e Kuvendit Kuvendi i Komunës/Kryetari	Ekzekutivi KPF/KK	
MAJ	Shqyrtimi i raportit tre mujor financiar janar - mars 2023	Drejtori për Buxhet dhe Financa	Kuvendi i Komunës/Kryetari	KPF/KK	
	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Anëtarët e KK-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kaluar Pyetje dhe përgjigjet në pyetje të kuvendareve	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së	KPF/KK	Kuvendi
QERSHOR	Informata mbi Qarkoren I-rë të MF-së	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Ekzekutivi	
	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Drejtoria për Buxhet	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Anëtarët e KK-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kaluar Pyetje dhe përgjigjet në pyetje të kuvendareve	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2023-2026	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së	KPF/KK	Kuvendi
	Rishikimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2023	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Ekzekutivi	
	Shqyrtimi për dalje në diskutim publik të Hartës Zonale	D. Urbanizmit	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Raporti i punës së Kryetarit të Komunës për gjatshë mujorin e parë të vitit 2023	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Raporti i Performances komunale për vitin 2022	Kordinatore për performancë komunale	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Informata mbi menaxhimin e mbeturinave në komunën e Rahovecit	Dr. e Sh. Publike	KPF/KK	KPF/KK	
	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Anëtarët e KK-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi

KORRIK					
Approvimi i Procesverballit nga mbledhja e Kalar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së	KPF/KK		Kuvendi
Pyeljet dhe përgjigjet në pyeljet e kuvendareve	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Ekzekutivi		
Informahtë për Qarkoren e 2-të buxhetore	Anëtarët e KK-së	Anëtarët e KK-së	KPF/KK		
Shqyrtimi i raportit financiar janar – qershor 2023	Drejtorja për Buxhet dhe Financa	Kryetari i Komunes/Kuvendi	KPF/KK		
Raport nga DKA-jia trell përfundimi të vitit mësimor 2022/2023	Drejtori i DKA-së	Kryetari i Komunes/Kuvendi	KPF/KK		
Informahtë nga Drejtorja e Bujqësisë	Drejtorja për bujqësi	Kryetari i Komunes/Kuvendi	KPF/KK		
Informahtë nga Drejtorja për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale	Drejtori i DSHPS-së	Kryetari i Komunes/Kuvendi	KPF/KK		
Shqyrtimi i Raportit të ZAP-it për vitin 2022 dhe Plani i Veprimi (Para datës 30 shtator)	ZAP	Kryetari i Komunes/Kuvendi	KPF/KK		
Informahtë mbi realizimin e planit për mienbajtjen e Hapësirave të Hapura Publike në komunën e Rahovecit	Drejtori i Shërbimeve Publike	Kryetari i Komunes/Kuvendi	KPF/KK		
Informahtë mbi realizimin e planit të punës së Zyrtës së Prokurimit janar – qershor 2023	Zyra e Prokurimit	Kryetari i Komunes/Kuvendi	KPF/KK		
Shqyrtimi i informahtave mbi qëshijë të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Anëtarët e KK-së	Kryetari i Komunes/Kuvendi	KPF/KK		Kuvendi
Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregullorete nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunes	Kryetari i Komunes/Kuvendi	KPF/KK		Kuvendi
GUSHT					
Approvimi i Procesverballit nga mbledhja e Kalar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së	KPF/KK		Kuvendi
Pyeljet dhe përgjigjet në pyeljet e kuvendareve	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Ekzekutivi		
Shqyrtimi dhe miratimi i Hartës Zonale	D. Uthmanizmit	Kuvendi i Komunes/Kryetari	KPF/KK		Kuvendi
Informahtë mbi implementimin e Planit për Investime në Hapësirat e Hapura Publike në komunën e Rahovecit	Dr. Shërbimeve Publike	Kryetari i Komunes/Kuvendi	KPF/KK		
Informahtë mbi implementimin e Planit për Menaxhimin e Mbledhtave në komunën e Rahovecit	Dr. Shërbimeve Publike	Kryetari i Komunes/Kuvendi	KPF/KK		
Shqyrtimi i informahtave mbi qëshijë të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Anëtarët e KK-së	Kryetari i Komunes/Kuvendi	KPF/KK		Kuvendi
Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregullorete nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunes	Kryetari i Komunes/Kuvendi	KPF/KK		Kuvendi

SHKËRIM	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së	KPF/KK	Kuvendi
	Pyejet dhe përgjigjet në pyejet e kuvendarëve	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Ekzekutivi	
	Shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2024	Drejtori për Buxhet dhe Financa	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për tatimin në pronë	Drejtori për Buxhet dhe Financa	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi i Planit për Energji dhe Klimë	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Informata për përgatitjen e viti shkollor 2023/2024	Drejtori i DKA-së	Kuvendi i Komunës/Kryetari	KPF/KK	
	Informata rreth muajit të mërgimtarëve për vitin 2023	D. Kulturës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Anëtarët e KK-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregullores nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së	KPF/KK	Kuvendi
TETOR	Pyejet dhe përgjigjet në pyejet e kuvendarëve	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Ekzekutivi	
	Shqyrtimi i Raportit financiar për periudhën janar – shtator 2023	Drejtori i Financave dhe Buxhet	Kuvendi i Komunës/Kryetari	KPF/KK	
	Shqyrtimi i Planit për menaxhim të mbeturinave	Drejtori i shërbimeve publike	Kryetari i komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Anëtarët e KK-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregullores nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së	KPF/KK	Kuvendi
	Pyejet dhe përgjigjet në pyejet e kuvendarëve	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Ekzekutivi	
	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Anëtarët e KK-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregullores nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
NËNTOR	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së	KPF/KK	Kuvendi
	Pyejet dhe përgjigjet në pyejet e kuvendarëve	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Ekzekutivi	
	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Anëtarët e KK-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregullores nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi

DHJETOR					
Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kalluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së	KPF/KK	Kuvendi	
Pyejet dhe përgjigjet në pyejet e kuvendarëve	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Elzekuti		
Raporti mbi realizimin e Planit për vitin 2023 si dhe informatë mbi Planin vjetor të prokurimit publik 2024	Zyra e Prokurimit	Kryetari i Komunes/Kuvendi	KPF/KK		
Shqyrtimi i Raportit të punës së Elzekutivit për vitin 2023			KPF/KK	Kuvendi	
Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së kryetari të komunes për vitin 2024	Zyra e kryetari	Kryetari i Komunes/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi	
Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës së kuvendit komunal për vitin 2024	Zyra e kuvendit	Kryetari i komunes/Kuvendi	KPF/KK	kuvendi	
Shqyrtimi i Planit të punës së Keshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS)	Kryetari i Komunes	Kryetari i Komunes/Kuvendi	KPF/KK		
Raportimi i Planit të Integritetit për Komunën e Rahovecit	Kryetari i Komunes	Zyrtari përgjegjës	KPF/KK		
Zgjedhja e kuvendarit/es në të njëjtë për vitin 2023	K. Kuvendit/Z.K	K. Kuvendit	KPF/KK	Kuvendi	

01 Nr. ____/22
Rahovec, 00.12.2022

Kryesuesi i Kuvendit

Deftim Kafexhiu



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 pika (d), nenit 17 dhe nenit 40 paragrafi 2 pika (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 6 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2013"), nenit 4 paragrafi 1 pika 1.5 lidhur me nenin 14 paragrafi 1 pika 1.7 i Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.4 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.12.2022 miraton këtë :

V E N D I M

Për miratimin e Planit të transportit rrugor lokal në Komunën e Rahovecit 2022-2027

1. Me këtë vendim **miratohet** Plani i transportit rrugor lokal në Komunën e Rahovecit 2022-2027.
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani i transportit rrugor lokal në Komunën e Rahovecit 2022-2027.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Shërbime Publike në Komunën e Rahovecit.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **Shërbimit të Kuvendit,**
- **Kryetarit të Komunës,**
- **Drejtorisë për Shërbime Publike,**
- **MAPL-së, dhe**
- **Arkivit.**

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr. ____/22
Datë: 28.12.2022

Defrim Kafexhiu

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna Rahovec
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Predsednik Opštine – Municipal Mayor

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRIDEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësi Nr /B/ /No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br. No 3102 Nr. i faq./Br.shr./No pg 81

Data/Date/ Dat.: 08 / 12 / 22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit Nr. 03/L040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës:

PROPOZON

1. Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit që të merret vendim për miratimin e Planit të Transportit Rrugor Lokal në Komunën e Rahovecit 2022-2027.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i Transportit Rrugor Lokal në Komunën e Rahovecit 2022-2027.
3. Për zbatimin e këtij propozimi do të kujdeset Drejtoria për Shërbime Publike.
4. Propozimi hyn në fuqi pas miratimit paraprak nga Kuvendi i Komunës.

Me propozim të njoftohen:

- Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,
- Sekretaria e Kuvendit, dhe
- Arkivi







Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec



Drejtoria Për Shërbime Publike – Odeljenje za Javne Usluge – Department of Public Services

Plani i transportit rrugor lokal për komunën e Rahovecit

2022-2027

Dhjetor 2022

1.	Hyrje	3
2.	QASJA DHE METODOLOGJIA	4
1.1	Qasja	4
1.2	Vizioni	4
1.3	Misioni	4
3.	OBJEKTIVAT	5
3.1	Lidhja me komunat tjera dhe fshatrat e Komunes së Rahovecit	5
3.2	Infrastruktura Rrugore	6
3.3	Permisimi i Kualitetit të shërbimeve	7
3.4	Rritja e cilësisë së shërbimeve të transportit rrugor të udhëtarëve	7
3.5	Transporti Publik	7
4.	Rendi i udhëtimeve dhe Operatorët Transportues:	8
4.1	Shërbimet Taxi	10
4.2	Parkingjet Publike:	10
4.3	Shërbimet për transportin e mallrave	13
4.4	Rrjetit hekurudhor	13
4.5	Urat	14
4.6	Tunelet	14
5.	Gjendja demografike dhe ekonomike e Rahovecit	16
5.1	Trendet dhe prognozat demografike	16
5.2	Dendësia e popullsisë	20
5.3	Shtirja hapësirë e rrugëve	21
6.	Gjendja egzistuese e infrastrukturës rrugore	22
6.1	Infrastruktura e Transportit dhe Transporti	22
6.2	Vlerësimi i gjendjes	25
7.	SWOT Analiza	26
8.	Sfidat kryesore të identifikuar	27
8.1	Objektivat aktivitetet dhe çagët	27
9.	AZHURNIMI PERIODIK	28
10.	Roli i njësive së planifikimit të transportit	29

1. Hyrje

Duke synuar realizimin sa më të suksesshëm të objektivave strategjike për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të Komunës së Rahovecit, për ngritjen e nivelit të konkurrencës ekonomike, zvogëlimin e dallimeve sociale, arritjen e trendeve ndërkombëtare në zhvillimin e infrastrukturës së transportit. Drejtoria e Shërbimeve Publike, në bashkëpunim me shumë palë të tjera të interesit, ka hartuar Planin e transportit komunal për periudhën 2022-2027. Jemi të vetëdijshëm se realizimi i këtij plani nuk do të jetë i lehtë. Kjo ngase mungesa e investimeve gjatë viteve të fundit të fundit dhe krizës globale, ka bërë që sistemet tona të transportit të mos zhvillohen sa e si duhet. Megjithë këtë, në sajë të angazhimit të Komunës së Rahovecit, dhe të strukturave përkatëse, kemi arritur rezultate të rëndësishme. Dëshmi për këtë janë ndërtimi i shumë rrugëve që lidhin fshatrat e Komunës së Rahovecit, ndërtimi i vendndaljeve për autobus dhe mbulimi i tyre, shenjëzimi i rrugëve dhe rritja e dukshmëris së rrugëve pa dukshme. Kjo strategji parasheh modelet e zhvillimit të infrastrukturës së transportit, realizimi i të cilave do të bëjë që Komuna e Rahovecit të ketë një infrastrukturë të zhvilluar të transportit e njëkohësisht, të ketë qasje më të lehtë në tregjet e mallrave dhe të udhëtarve, të shërbimeve dhe në tregjet e punës. Me këtë plan përcaktohen qartë objektivat për zhvillim të qëndrueshëm të infrastrukturës së transportit në tërësi, për ndërtimin e rrugëve funksionale, që lidhen me fshatrat dhe komunat tjera, me çka do të krijohen kushte për transport të sigurt dhe respektimin e kriterëve të nevojshme për ruajtjen e mjedisit jetësor. Me këtë plan, përveç çështjeve thelbësore që kanë të bëjnë me infrastrukturën e transportit, me ndërtimin e kapacitetve për zbatimin e saj, janë paraparë aktivitete tjera përkatëse të Komunes së Rahovecit.

2. QASJA DHE METODOLOGJIA

1.1 Qasja

Qasja për hartimin e Planit të Transportit komunal ishte një kombinim i zyrtareve nëpër drejtori relevante, pastaj edhe mbajtja e takimeve të rregullta. Paraprakisht, kjo qasje është aprovuar nga Komuna.

1.2 Vizioni

Krijimi i sistemit modern dhe të integruar të shërbimeve të transportit, i cili do të kontribuojë zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe zhvillimit të kapaciteteve njerezore të Komunes së Rahovecit.

1.3 Misioni

Krijimi i ambientit për zhvillim të sigurt, kualitativ dhe funksional të sistemeve të transportit dhe të kapaciteteve njerezore për ofrimin e shërbime cilësore, për mjedis të pastër ekologjik, për rritje ekonomike. Misioni i përgjithshëm i Komunes së Rahovecit në sektorin e transportit është: që të lidhën vendbanimet me qendërën urbane në mënyrë të sigurt, përmes ndërtimit të rrugëve ku qytetarët do të kenë mundësin e zgjedhjes optimale të rrugëve sa më të shkurta e kjo do të kontribuojë në rritjen ekonomike, përmes krijimit të një sistemi efikas të transportit rrugor, me çmim të ulët dhe të sigurt për mjedisin. Komuna e Rahovecit angazhohet për krijimin e një sistemi të përshatshëm të transportit për të gjithë qytetarët i cili do të mundësojë atyre të zgjedhin transportin më efikas dhe më të tërërditshëm që plotëson nevojat e tyre, që garanton ruajtjen e mjedisit. Me këtë plan është përcaktuar edhe plani i veprimit për zhvillimin e sistemit të transportit në Rahovec deri në vitin 2027.

3. OBJEKTIVAT

- Objektiva 1 - Lidhja me komunat tjera dhe rrugët e komunës së Rahovecit, përmirësimi, zhvillimi dhe mirëmbajta e infrastrukturës së transportit.
- Objektiva 2 - Përmirësimi i Kualitetit të shërbimeve, krijimi i ambientit të favorshëm dhe të sigurt rregullativ për ngritjen e cilësisë së shërbimeve në fushën e transportit.
- Objektiva 3- Përmirësimi i sigurisë në komunikacion dhe i mbrojtjes së mjedisit.

Objektiva 1

3.1 Lidhja me komunat tjera dhe vendbanimet e Komunës së Rahovecit

Që të kemi lidhje në mes të komunave fqinje dhe komunës së Rahovecit sa më të përshtatshme për qytetarët duhë të kemi rrugë sa më të shkurta dhe cilësore.

Lidhja e propozuar e sistemit të transportit ndërmjet komunave fqinje, nëpërmjet rrugëve regjionale, magjistrale dhe autostradës, kurse lidhja në mes të komunës së Rahovecit dhe fshatrave përmes rrugëve lokale.

- Rruga regjionale R-107, Prizren - Xërxë - Gjakovë i mundëson komunës së Rahovecit lidhje të mirë me komunën e Prizrenit dhe të Gjakovës. Kjo rrugë i lidhë vendbanimet mjaft të rëndësishme si (Krushë e Madhe, Celinë, kalon në zonën kadastrale të fshatit Bellacerkë dhe Xërxë). Kjo rrugë ka gjatësi 11 km në territorin e komunës së Rahovecit.
- Rruga regjionale R110, – krijon lidhje të mira në mes të komunës së Rahovecit dhe Malishevës dhe pastaj nëpërmjet kësaj rrugë lidhet edhe me Prishtinën (Rahovec- Malishevë – Prishtinë)– kalon në pjesën qendrore të komunës së Rahovecit e deri të kufiri komunal i Malishevës. Kjo rrugë ka gjatësi prej 16.3 km, dhe i prekë komunat në zonat kadastrale të: Xërxë, Bellacerkë, Bërnjak, dhe zonën kadastrale të qytetit të Rahovecit).
- Rruga regjionale R111, Xërxë – Ratkoc - Kramovik - shtrihet kryesisht në pjesën perëndimore të komunës me gjatësi prej 17 km. Nëpërmjet kësaj rruge komuna e Rahovecit ka qasje në rrugën nacionalen Gjakovë- Prishtinë dhe me komunën e Klinës.

3.2 Infrastruktura Rrugore

Komuna e Rahovecit shtrihet në mesin rrugëve nacionale Gjakovë – Prishtinë dhe Gjakovë – Prizren, si dhe atyre regjionale Malishevë – Gjakovë dhe Rahovec – Suharekë.

Territori i komunës është relativisht i madh i cili ka një rjet rrugorë prej 297 km rrugë të të gjitha kategorive. Rrugët nacionale dhe regjionale janë të asfaltuara dhe në gjendje të mire.

Gjendja e trafikut është relativisht në nivel të kënaqshëm në rrugët periferike të komunës ndërsa sa i përket atyre brenda qytetit ka pak vështirësi në zhvillimin normal të qarkullimit të mjeteve.

Konfiguracioni i terrenit është kodrinorë ku karakterizohet me dendësi shumë të madhe të vendbanimeve, si rezultat i kësaj i kemi edhe rrugët shumë të ngushta të cilat përdoren nga të gjithë pjesëmarrësit në trafik. Komuna ka ndërmarr masa për përmirësimin e sigurisë dhe komoditetin e këmbësorëve, me kalime në udhëkryqe, ka përmirësuar ndriçimin, dhe gjendja me trotuare qëndron mirë, sepse është investuar vit pas viti.

Mirëpo, edhe pjesët e qytetit ku ka trotuare i plotësojnë kriterët, përkatësisht janë punuar pjetërsitë për të krijuar qasje më të lehtë.

Komuna përveç trafikut rrugorë ka edhe atë hekurudhore e cila e lidhë Prizrenin – Fushë Kosovën, mirëpo aktualisht kjo linjë është jashtë funksionit.

Në komunën e Rahovecit ekziston niveli i katër kategorive të rrugëve (të klasifikuara në Kosovë), duke filluar prej rrugëve nacionale e deri tek ato të pa kategorizuara.

Rrjeta e rrugëve në komunën e Rahovecit përbehet nga:

- Rruga regjionale R-107, Prizren – Xërë - Gjakovë i mundëson komunës së Rahovecit lidhje të mire me komunën e Prizrenit dhe të Gjakovës. Kjo rrugë i lidhë vendbanimet mjafi të rëndësishme si (Krushe e Madhe, Celine, kalon në zonën kadastrale të fshatit Bellacerkë dhe Xërë). Kjo rrugë ka gjatësi 11 km në territorin e komunës së Rahovecit.
- Rruga regjionale R110, – krijon lidhje të mira në mes të komunës së Rahovecit dhe Malishevës dhe pastaj nëpërmjet kësaj rrugë lidhet edhe me Prishtinën (Rahovec - Malishevë – Prishtinë) kalon në pjesën qendrore të komunës së Rahovecit e deri të kufi

komunal i Malishevës. Kjo rrugë ka gjatësi prej 16.3 km, dhe i prekë zonat e kadastrave të: Xërxës, Bellacerkë, Bërnjak dhe zonën kadastrale të qytetit të Rahovecit).

- Rruga regjionale R111, Xërxë – Ratkoc - Kramovik - shtrihet kryesisht në pjesën perëndimore të komunës me gjatësi prej 17 km. Nëpërmjet kësaj rruge komuna e Rahovecit ka qasje në nacionalen Gjakovë - Prishtinë dhe me komunën e Klinës.
- Rruga regjionale R-204, Rahovec-Krushë e Madhe, shtrihet kryesisht në pjesën jugë lindore të komunës së Rahovecit me gjatësi 12.4 km, kalon përmes fshatrave Brestoc-Hoqë e Vogël, Nagac dhe Krushë e Madhe.

Nr.	Përshkrimi	Gjatësia në km	%
01	Rrugë nacionale	6.51	1%
02	Rruge regjionale	64.37	20%
03	Rruge urbane	67.37	12%
04	Rruge lokale	109.47	19%
05	Rruge të pa kategorizuara	315.24	56%
TOTALI		562.96	100%

Tabla 1- Rrjeta e rrugëve në komunën e Rahovecit

Objektiva 2

3.3 Përmisimi i Kualitetit të shërbimeve

Komuna e Rahovecit ka punuar në përmisimin e shërbimeve të transportit në përgjithësi duke përfshirë ndërtimin e rrugëve, rehabilitimin e tyre dhe ndërtimin e vendndaljeve për autobus.

3.4 Rritja e cilësisë së shërbimeve të transportit rrugor të udhëtarëve

Cilësia e ofrimit të shërbimit, në kuptim të frekuencës, infrastrukturës përcjellëse dhe mjeteve të transportit do të jetë e nivelit të kënaqshëm. Si shërbim i mirëfilltë, transporti publik do të ofrohet si alternativë ndaj qarkullimit me automjete individuale.

3.5 Transporti Publik

Në Transportin Publik në Komunë ka të organizuar trafikun urbano – periferik dhe atë ndër urban. Komuna ka stacion të autobusëve që me rregullore është parapare që të gjitha linjat duhet të nisen dhe të përfundojnë në këtë stacion. Transporti urbano – periferik organizohet me autobus nga kompani private.

Linjat e transportit Urbano-Periferik janë këto:

- Pastasel - Rahovec – Pastasel, (me stacionet në: Pastasel, Senoc dhe Drenoc)
- Patogani i Ulët – Patogani i Epërm – Sopniq - Fortesë – Nashpall – Rahovec, me stacionet në: P. Epërm, Nushpall, P. Ulët, Sopniq dhe Fortesë)
- Rahovec – Aptershtë – Rahovec, (me stacionet në: Rahovec, Hogë e Madhe, Zogisht, Aptershtë dhe Reli)
- Rahovec – Xërë – Raikoc – Bratutin, (me stacionet në: Rahovec, Bërnjak, Fortesë, Xërë, Gexhë dhe Radoste)

4. Rendi i udhëtimëve dhe Operatorët Transportues:

Operatori Transportues: N.T "EMRA" - RAHOVEC											
RELACIONI: PASTASEL - RAHOVEC - PASTASEL											
Koha e nisjes	Koha e nisjes	Koha e nisjes	Koha e nisjes	Km	Stacionet	Koha e kthimit	Koha e kthimit	Koha e kthimit	Koha e kthimit	Koha e kthimit	Koha e kthimit
1	2	3	4			1	2	3	4		
6:50	12:00	14:20	17:30	0	PASTASELE	11:00	14:00	16:40	19:45		
7:00	12:10	14:30	17:40	3	SENOC	10:50	13:50	16:30	19:35		
7:05	12:15	14:35	17:45	5	DRENOC	10:45	13:45	16:25	19:30		
7:20	12:35	14:50	18:00	10	RAHOVEC	10:30	13:30	16:10	19:15		
Rendi i udhëtimëve për ditët: 1 2 3 4 5 6 7											

TRANSPORTI RRUGOR LOKAL PËR KOMUNËN E RAHOVECIT

Operatori Transportues: N.T.SH "MENDI TOURS " - RAHOVEC

RELACIONI: RAHOVEC - XERXE - RATKOC - BRATOTIN

Koha e nisjes	Koha e nisjes	Koha e nisjes	Km	Stacionet	Koha e kthimit	Koha e kthimit	Koha e kthimit	
1	2	3			1	2	3	4
8:10	11:10	13:45	0	RAHOVEC	7:30	9:50	12:40	13:05
8:15	11:15	13:50	5	BERNJAKE	7:30	9:45	12:35	15:00
8:20	11:20	13:55	6	FORTESE	7:25	9:40	12:30	14:55
8:25	11:25	14:00	10	XERXE	7:15	9:35	12:20	14:50
8:35	11:35	14:10	13	GEGJE	7:10	9:25	12:15	14:40
8:40	11:40	14:15	15	RADOSTE	7:05	9:20	12:10	14:35
8:45	11:45	14:20	19	RATKOC	7:00	9:15	12:05	14:30

Rendi i udhëtimiti vlenë për ditët: 1 2 3 4 5 6 7

Operatori Transportues: N.T.SH " MENDI TOURS " - RAHOVEC

RELACIONI: PATOQAN I ULET - P. NALT - SOPNIQ - FORTESE - NASHPALL - RAHOVEC

Koha e nisjes	Koha e nisjes	Koha e nisjes	Km	Stacionet	Koha e kthimit	Koha e kthimit	Koha e kthimit
1	2	3			1	2	3
6:50	12:30	14:30	0	P.NALT	12:40	12:10	19:40
6:50	12:30	14:30	1	NASHPALL	12:35	14:05	19:55
7:00	12:40	14:35	3	P.ULTE	12:30	14:00	19:45
7:10	12:45	14:40	7	SOPNIQ	12:20	13:50	19:40
7:15		14:45	10	FORTESE	12:10	13:40	19:30
7:20	13:00	15:00		RAHOVEC	12:10	13:30	19:20

Rendi i udhëtimiti vlenë për: 1 2 3 4 5 6 7

Operatori Transportues : N.P.T.SH."LATA"								
RELACIONI:								
Koha e nisjes	Koha e nisjes	Koha e nisjes	Koha e nisjes	Km	Stationet	Koha e kthimit	Koha e kthimit	Koha e kthimit
1	2	3	4			1	2	3
4				0	RAHOVEC	8:20		
	18:50							
	18:55			5	BERNJAK	8:15		
7:20	19:00			7	FORTESE	8:10		
7:25	19:05			9	XERXE	8:05		
7:30				13	GEXHE	8:00		
7:35				15	RADOSTE	7:55		
7:40					RATKOC	7:50		
Rendi i udhëtimit vlenë për ditët : 1 2 3 4 5 6 7								

4.1 Shërbimet Taxi

Në Komunen Rahovecit janë të regjistruara 22 (njëzet e dy) vetura taksi për transport të udhëtarëve brenda dhe jashtë komunës. Të gjithë janë të pajisur dhe kanë leje Auto-Taxi. Me hyrjen në fuqi të rregullores komunale për trafik lokal do të certifikohen Taxi me 4+1 dhe mbi 8+1 deri në 17+1 ulëse. Ekzistojnë vendëqëndrime për Auto-Taxi. Një në Fshatin Xërë dhe tjetri afër Stacionit të Autobusëve.

4.2 Parakingjet Publike:

Numri i përgjithshëm i vend parkimjeve publike dhe publiko private në komunën e Rahovecit është siq vijon:

Parkimet në Territorin e Komunës së Rahovecit			
Nr	Emri i Parkimit - Lokacioni	Nr, u	Nr. i
		vendeve për parkim të automjeteve e	parkingjeve për personat me nevojë të veçanta
	Emri i Parkimit - Lokacioni		
1	Oborri i Komunës	40	1

TRANSPORTI RRUGOR LOKAL PËR KOMUNËN E RAHOVECIT

3	Parkingu nën Park	20	
4	Parkingu nën Bodrum	30	
5	Vendparkimi te trafoja te Komuna	6	
6	Parkingu i QPS	6	
7	Parkingu në oborrin e Gjykates	10	
8	Parkingu në oborrin e Policisë	8	
9	Oborri i Zjarrfikësve	15	
10	Parkungu përballë Policisë	32	1
11	Parkingu Objekti i OVL UÇK	12	1
12	Parkingu te objektet i MPB	4	
13	Parkingu përballë objekteve të MPB	24	1
14	Parkingu në Qendër	20	1
15	Parkingu te ish I Maji	10	
16	Parkingu te Vrella	10	
17	Parkingu te KEDS- ne te dy anet	33	1
18	Parkingu te tregu	60	1
19	Parkingu te rruga njëkahë 28 Nëntori	25	1
20	Parkingu te varrezat e Martireve ne Pastasel	20	
21	Parkingu i Hotel Parkut	75	1
22	Parkingu te Sh . E Mesme , Xhelal Hajda	14	
23	Parkingu te OJQ Hareja ne te dy anët	35	1
24	Parkingu ne Qender te Drenocit te Lapidari	20	
25	Parkingu ne oborrin e Ambullantes ne Rahovec	30	1
26	Parkingu te Ambulinta ne Rahovec	8	
27	Parkingu te Z.K.peringu te Z.K.peringu e punes ne Rahovec	5	1
28	Parkingu ne oborrin e Ambullantes ne Drenoc	8	1
30	Parkingu në oborrin e AMF -se në Xërxë	10	1
31	Parkingu te AMF në Krushë të Madhe	10	1
32	Parkingu jashte oborrit te Shkollës në Celinë	20	1
33	Parkingu jashte oborrit te shkolles se mesme ne P. Te Ulet.	15	1
34	Parkingu ne oborrin e Ambullantes ne Ratkoc	15	1
35	Parkingu te varrezat në Rahovec	8	
36	Parkingu te Sh.F.në Ratkoc	10	1
37	Parkingu te Shkolla Mesme në Krushë të Madhe	9	
38	Parkingu te shkolla dhe Ambullanta në M.te Vogël .	30	1
39	Parkingu te rrethi ne Ratkoc	28	
40	Banesat publike ne rr.Deshmoret e Pashtrikut	10	
41	Parkingu te Instituti I Bujqesise	15	1
42	Parku ne oborrin e AMF ne lagjen Arat .	2	
43	Parkingu te Kryqi i kuq dhe Handikosi	8	1
44	Parkingu te Parku i Qytetit	35	

45	Parkingu te Palestina	62	1
46	Parkingu te fusha e Sportit – Barcodi	17	
47	Parkingu te BPB	8	
48	Parkingu te Muzeu i qytetit	4	1
49	Parkingu te Radoniqi	4	
50	Parkingu te ETC	66	1
51	Parkingu te Super Viva	11	
52	Parkingu te Viva Fresh ne Rahovec	75	1
53	Parkingu te QTX 2	100	1
54	Parkingu te Super Viva ne Xerxe	30	1
55	Parkingu te Shkolla ne Xerxe	12	
56	Parkingu te QTX 1	10	
57	Parkingu te Le-Nar	15	
58	Parkingu te Xaja ne Krushe te Madhe	30	1
59	Parkingu te Jaha Petrolli	62	1
60	Parkingu te Haxhijaha Restaurant	9	1
61	Qendra En-Sharku Keds	10	
62	Pallati Esra	75	1
63	Haxhijaha - Mekanizem	20	
64	Shtepia Muze "Ukshin Hoti "	5	
65	Parkingu te zyra e vendit ne K.te Madhe	10	1
66	Varrezat e Martireve ne Fortese	14	1
67	Keds - Administrata	12	
68	Shtepia e Kultures ne Drenoc	8	
69	M&Silllosi	50	1
70	Restaurant Saranda - Fortese	60	1
71	Parkingu ne oborrin e ish objektit te shkolles se mesme te Policia	43	1
72	Parkingu te rr.Bekim Sylka.	6	
73	Restaurant Bashkimi - Fortese	22	1
74	Parkingu ne Apterushe - ne Qender	12	
75	Parkingu te e Shtepia e Kultures ne Raikoc	8	
76	Parkingu te Adora ne Xerxe	66	1
77	Parkingu i Rest - Kosova, Xerxe	86	1
78	Parkingu te frigo - ETC, Xerxe	37	1
79	Koperative Bujqesore Krusha, e madhe	30	1
80	Parkingu te shkola ne Palluzhe	6	
81	Parkingu te shkola ne Zaqisht	9	1
82	Kompleksi Memorial ne Krushe te Madhe	5	
83	Parkingu te Ambullanta ne Fortese	8	1
85	Rest Grill, Fortese	8	1

TRANSPORTI RRUGOR LOKAL PËR KOMUNËN E RAHOVECIT

86	Rest. Ura e Shejt	50	1
87	Restaurant Genisi, Malësi e Vogël	60	1
88	Sh.F.Kramovik	8	
89	Sh.M.P. Selajdin Mullabazi - Mici	10	1
90	Salloni I Mobileve - Venera	6	
91	Stone Castle	14	
92	Osa Termosistem	20	
93	Gorenje	6	
94	Agoni - M	6	
95	Fat Oil baza	12	
96	Dina H, Pompa Ratkoc	5	
97	Supermarketi Dina - H	8	1
98	Restaurant Te Dollari, Ratkoc	10	
99	Parkingu Privat, Ratkoc	20	
100	Sh.M.Ratkoc	8	
	Gjithsej	2173	49
	parkingje :		

4.3 Shërbimet për transportin e mallrave

Kufizimi i rrugëve sipas ngarkesës së përgjithshme brenda qytetit dhe orientimi i tyre në rrugët e tranzitit.

4.4 Rrjeti hekurudhor

Rrjeti hekurudhor në komunën e Rahovecit është i karakterit regional dhe ka shtrirje në pjesën perëndimore të komunës së Rahovecit, përkatësisht i takon kategorisë së komunikacionit regional i cili i lidhë Prizrenin dhe kalon në territorin e komunës së Rahovecit dhe e lidhë Klinen - Fushë Kosovë. Kjo linjë hekurudhore është një binarësh me gjatësi prej 33 km. Zonat kadastrale të cilat preken nga rrjeti hekurudhorë, përkatësisht kanë qasje direkt në këtë rrjet janë gjithsejtë 12, duke filluar nga (Mrasor, Kramovik, Çifllak, Dabidol, Dejnë, Ratkoc, Radostë, Gexhë, Xërxë, në zonën kadastrale të Bellacerkës, Celinë dhe Krushës së Madhe).

Duke u nisur nga ky fakt mund të konstatojmë se rrjeti hekurudhorë i cili është mjaft i hershem në këtë komunë është edhe si indikator për zhvillimin e vendbanimeve më të rëndësishme të komunës. Rrjeti hekurudhor është i një rëndësie të veçantë, jo vetëm për komunën e Rahovecit por edhe tjerat

sepse ndihmon në transportimin e mallrave dhe udhëtarëve. Linja hekurudhore për momentin nuk është në funksion dhe si rrjedhojë nuk ka qarkullim të udhëtarëve dhe mallrave përmes saj.

4.5 Urat

Të gjitha urat të identifikuara në tërë territorin e komunës së Rahovecit, i takojnë dy kategorive të komunikacionit:

1. Komunikacionit rrugor, dhe
2. Komunikacionit hekurudhor.

1. **Urat mbi rrugë regjionale** - janë të vendosura në të dy drejtimet e rrugëve regjionale, 1 Urë është e vendosur në rrugën regjionale Rahovec - Xërxe - Gjakovë (përkatesisht në zonën kadastrale të Xërxës me gjatësi prej 65 m, mbi lumen Drin i Bardhë (Ura e fshejtë) tjerat në komunën kadastrale të Ratkocit me 20 metra, dhe tjetra 15 m, dhe në zonën kadastrale të Çifllakut me gjatësi 18 metra në rrugën regjionale Xërxe - Ratkoc - Kramovik).
2. **Urat në komunikacionin hekurudhor** - në rrjetin hekurudhor të komunës së Rahovecit janë të ndërtuara gjithsej të 4 ura prej të cilave 1 në zonën kadastrale të Mirasorit, 1 në Çifllak, 1 në Ratkoc, 1 në zonën kadastrale të Bellacerkës,

4.6 Tunelet

Karakteristikë e komunikacionit hekurudhor është tuneli në mes të vendbanimit Gexhë dhe Xërxe (tuneli në zonën kadastrale të Gexhës dhe të Xërxës me gjatësi prej 730 m të ndërtuara në rrjetin hekurudhor).

Objektivës 3- Përmirësimi i sigurisë në komunikacion

Komunikacioni rrugor ka ndryshuar mënyrën e jetës, duke ndikuar kështu edhe në zhvillimin njerëzor. Të mirat materiale që barten sot kanë ndikuar që ky komunikacion të zë një vend të rëndësishëm, pasi që mënyra e të barturit ``dere-më derë'', ka ndikuar që ky lloj i komunikacionit të jetë më fleksibil. Pra jeta në kohët moderne, në shumëçka mund të konsiderohet më e mirë me e lehtë dhe më e rehatshme. Mirëpo përkundër të gjitha këtyre të mirave komunikacioni rrugor ka edhe mangësitë e tij që shprehën përmes ndotjes së mjedisit,

nivelit të zhurmës, dëme materiale, e çka është më e dhimbshme lëndimeve dhe humbjes së jetërëave të njerëzve.

Numri i madh i të vdekurve dhe i të lënduarve rëndë në fatkeqësitë e komunikacionit mund të shpjegohet në rend të parë si shkak i:

- Rritjes së vullshme të numrit të automjeteve,
- Gjendjes jo të rregullt teknike të automjeteve,
- Njohjes jo të mirë rregullave të qarkullimit nga ana e pjesëmarrësve në komunikacion,
- Mospërshtatja e kushteve të rrugës trendeve dhe zhvillimeve bashkohore në komunikacion
- Masave të dobëta parandaluese dhe ndëshkuese për pjesëmarrësit që veprojnë në kundërshtim me rregullat e komunikacionit etj.

Duhet të ndikohet në mendjen e këmbësorëve për përgjegjësinë dhe rëndësinë që kanë këmbësorët si pjesëmarrës në komunikacion. E në anën tjetër do të ndërtohen ose rindërtohen rrugët me të cilat si këmbësori ashtu edhe pjesëmarrësit tjerë në komunikacion janë më të sigurt.

- Ndërtimin e trotuarëve,
- Ndërtimin e shtegut të biçiklistëve,
- Vetëdijesimin e fëmijëve nëpër shkolla përmes ligjeratave vetëdijesuese,
- Fushata vetëdijesuese për respektimin e rregullave të komunikacionit

149	Xhafer	Gashi	044 779 649	Sopniq	4,970.00 €
150	Remzi	Gashi	044 442 238	Sopniq	4,910.00 €
151	Zelfi	Morina	044 638 798	Sopniq	5,490.00 €
152	Agip	Morina	044 766 375	Sopniq	5,460.00 €
153	Agron	Morina	045 384 133	Sopniq	3,260.00 €
154	Besnik	Morina	044 957 478	Sopniq	2,920.00 €
155	Nail	Morina	044 193 174	Sopniq	3,950.00 €
156	Masar	Morina	049 887 006	Sopniq	4,570.00 €
157	Minir	Morina	045 623 676	Sopniq	3,400.00 €
158	Hajdar	Morina	045 648 433	Sopniq	2,210.00 €
159	Burim	Morina	049 340 981	Sopniq	550.00 €
160	Bahric	Morina	44	Sopniq	2,210.00 €
161	Melsur	Morina	044 300 841	Sopniq	6,480.00 €
162	Qendrim	Morina	045 631 845	Sopniq	2,920.00 €
163	Enis	Morina	044 151 566	Sopniq	3,544.00 €
164	Aziz	Popaj	044 199 332	Fortesë	1,240.00 €
165	Valdet	Popaj	044 117 353	Fortesë	1,980.00 €
166	Shendet	Popaj	045 245 725	Fortesë	1,520.00 €
167	Valmir	Fetoshi	049 152 772	Fortesë	3,040.00 €
168	Nazim	Zhuniqi	045 948 395	Fortesë	900.00 €
169	Naim	Bytyqi	044 584 291	Xërxë	2,900.00 €

170	Vezire	Kriezi	044 798 836	Xërxë	2,500.00 €
171	Kasum	Krasniqi	044 203 895	Xërxë	1,115.00 €
172	Islam	Kryeziu	044 697 869	Xërxë	1,740.00 €
173	Vezire	Kryeziu	044 963 915	Xërxë	3,110.00 €
174	Florentin	Gashi	044 660 670	Fortesë	3,050.00 €
175	Avni	Zhuniqi	44	Fortesë	820.00 €
176	Halil	Popaj	049 280 850	Fortesë	6,270.00 €
177	Endrit	Popaj	049 333 218	Fortesë	4,750.00 €
178	Endrit	Ukaj	045 577 660	Radoste	1,160.00 €
179	Xhevdet	Kastrati	044 255 095	Radoste	1,750.00 €
180	Hajriz	Lushi	044 269 211	Radoste	1,280.00 €
181	Mexhit	Ukaj	044 450 329	Radoste	2,510.00 €
182	Ragip	Ukaj	044 160 251	Radoste	2,110.00 €
183	Khavit	Kastrati	049 586 302	Radoste	2,830.00 €
184	Selva	Morina	049 564 105	Radoste	1,580.00 €
185	Elfete	Dema	044 670 854	Radoste	2,200.00 €
186	Perparim	Dema	044 487 772	Radoste	1,570.00 €
187	Remzie	Morina	44	Radoste	1,300.00 €
188	Sherif	Morina	049 462 370	Radoste	2,940.00 €
189	Vadet	Zena	044 134 629	Radoste	2,970.00 €
190	Nazmi	Morina	045 662 525	Radoste	2,250.00 €
191	Avni	Morina	045 662 625	Radoste	720.00 €
192	Gazmend	Zena	044 236 701	Radoste	1,680.00 €
193	Jahe	Kastrati	045 334 426	Radoste	1,410.00 €
194	Aferdita	Berisha	049 466 941	Drenoc	1,390.00 €
195	Fadil	Shala	045 927 864	Rahovec	1,920.00 €
196	Xhevdet	Krasniqi	049 004 554	Senoc	3,190.00 €
197	Fatmir	Hajredini	049 389 965	taqan i poshte	2,855.00 €
198	Bedri	Zeka	044 613 857	taqan i poshte	1,020.00 €
199	Sabri	Zhuniqi	44	Fortesë	1,940.00 €
200	Zenel	Morina	044 693 325	Gexhe	3,220.00 €
201	Bajram	Kryeziu	045 308 356	Gexhe	2,110.00 €
202	Cane	Krasniqi	044 126 533	Gexhe	2,480.00 €
203	Agim	Morina	044 975 022	Gexhe	2,240.00 €
204	Shedat	Ukaj	044 748 337	Radoste	1,810.00 €
205	Hasan	Krasniqi	044 115 074	Pastasel	1,840.00 €
206	Avdyl	Krasniqi	049 145 568	Pastasel	1,920.00 €
207	Nysret	Thaqi	044 963 662	Xërxë	2,120.00 €
208	Naser	Krasniqi	044 111 820	Pastasel	1,990.00 €
209	Edona	Popaj	049 903 663	Fortesë	3,340.00 €
210	Jeton	Popaj	044 757 618	Fortesë	1,750.00 €
211	Jeton	Zyberaj	044 652 541	Drenoc	2,420.00 €
212	Adonis	Topalli	044 410 252	Rahovec	750.00 €
213	Besim	Himaj	044 173 157	Gexhe	860.00 €

214	Xhafer	Berisha	045 971 035	Drenoc	1,150.00 €
215	Defrim	Popaj	044 451 773	Fortesë	930.00 €
216	SADRI	GASHI	44887720	BRATOTIN	12,293.00 €
217	ARGJEND	GASHI	45730597	BRATOTIN	4,460.00 €
218	LATIF	GASHI	45373762	BRATOTIN	7,716.00 €
219	HAXHI	GASHI	44781963	BRATOTIN	15,486.00 €
220	AGIM	GASHI	44385807	BRATOTIN	2,280.00 €
221	ENVER	MORINA	49335447	DEJN	3,930.00 €
222	ALBI	BYTYQI	49713326	DEJN	6,560.00 €
223	MUHAMET	BYTYQI	44230729	DEJN	2,210.00 €
224	SHYHRET	MORINA	44759780	DEJN	5,030.00 €
225	BUKURIE	KRASNIQI	46145435	DEJN	5,065.00 €
226	BINAK	MORINA	49351752	DEJN	1,580.00 €
227	XHEFER	KRASNIQI		DEJN	8,990.00 €
228	REXHEP	KRASNIQI	45359951	DEJN	7,220.00 €
229	HISEN	KRASNIQI	45359951	DEJN	8,210.00 €
230	IMER	KRASNIQI	45359951	DEJN	10,830.00 €
231	NAIM	KRASNIQI	44839916	DEJN	4,838.00 €
232	GËZIM	BYTYQI	44489243	DEJN	6,660.00 €
233	ADIL	BYTYQI	49217505	DEJN	1,557.00 €
234	FATMIR	KRASNIQI		DEJN	5,115.00 €
235	BLERIM	BERISHA	44458736	DEJN	3,110.00 €
236	ILIR	KRASNIQI	49541678	DEJN	4,700.00 €
237	HIL	GASHI	44888066	DOBIDOL	3,900.00 €
238	KADRI	RUDI	44329971	DOBIDOL	5,135.00 €
239	FADIL	MORINA	45655928	DOBIDOL	320.00 €
240	ALI	MORINA	44318647	DOBIDOL	3,170.00 €
241	BRAHIM	BERISHA	44343520	DOBIDOL	600.00 €
242	GËZIM	BERISHA		DOBIDOL	1,449.00 €
243	DURIM	BERISHA	45614471	DOBIDOL	1,524.00 €
244	BINAKE	LITAJ	45624276	DOBIDOL	4,580.00 €
245	NDERIM	RAHMANI		DOBIDOL	2,620.00 €
246	SEJFI	MORINA	43831931	DOBIDOL	2,780.00 €
247	REFKI	RUDI	44268577	DOBIDOL	4,895.00 €
248	GJERGJ	GASHI	44269873	DOBIDOL	644.00 €
249	BAJRUSH	BEQIRAJ	45811724	GURI KUQ	2,350.00 €
250	HISEN	BEQIRAJ	45378230	GURI KUQ	376.00 €
251	FADIL	FETAHAJ	44114723	GURI KUQ	2,646.00 €
252	FERAT	SYLEJMANI	49280126	GURI KUQ	5,647.00 €
253	MON	REXHEPI	44487822	VRAJAK	7,685.00 €
254	MUJ	MORINA	44441373	VRAJAK	7,102.00 €
255	SOKOL	BYTYQI		BABOVC	4,587.00 €
256	ALI	HOTI	45397405	RATKOC	5,374.00 €
257	ISUF	HOTI	44221739	RATKOC	678.00 €

258	SHEFKUJE	HOTI		RATKOC	8,332.00 €
259	AHMET	LATIFI	44710888	RATKOC	5,903.00 €
260	HALIL	HOTI	44268765	RATKOC	560.00 €
261	JAKUP	HOTI	44784196	RATKOC	550.00 €
262	DAUT	LATIFI		RATKOC	4,850.00 €
263	RAMIZ	HOTI	49315741	RATKOC	430.00 €
264	HAXHI	SHALA	44285019	RATKOC	1,828.00 €
265	NUHI	HOTI		RATKOC	6,535.00 €
266	ISMET	KRASNIQI	49121276	RATKOC	15,550.00 €
267	SAMI	MORINA	44393639	RATKOC	10,342.00 €
268	FEHMI	MORINA	46180374	RATKOC	3,475.00 €
269	BEKIM	MORINA	44101183	RATKOC	7,662.00 €
270	RASIM	KRASNIQI	44386692	RATKOC	560.00 €
271	JEMIN	KRASNIQI	45884718	RATKOC	1,684.00 €
272	SEF	HOTI	44330047	RATKOC	10,626.00 €
273	SKENDER	HOTI	44708081	RATKOC	12,105.00 €
274	SAFET	HOTI	44657996	RATKOC	10,862.00 €
275	ISUF	HOTI	44886422	RATKOC	2,781.00 €
276	SMEJL	HOTI	44537264	RATKOC	1,722.00 €
277	MILAZIM	HOTI	45314453	RATKOC	5,000.00 €
278	VESEL	MORINA		RATKOC	7,325.00 €
279	NJAZI	HOTI	44339064	RATKOC	1,101.00 €
280	MUHAMET	MORINA	44191705	RATKOC	765.00 €
281	NAZIF	BERISHA	44255430	RATKOC	4,130.00 €
282	AFRIM	MORINA	44677322	RATKOC	4,180.00 €
283	SHABAN	HOTI	44128932	RATKOC	7,930.00 €
284	RAMADAN	HOTI	44975093	RATKOC	740.00 €
285	FADIL	HOTI	44400414	RATKOC	15,065.00 €
286	ILJAS	HOTI	45331300	RATKOC	10,919.00 €
287	BESIM	HOTI	45954852	RATKOC	5,115.00 €
288	RESHAT	MORINA	44187172	RATKOC	1,976.00 €
289	BERAT	HOTI	44901913	RATKOC	7,169.00 €
290	ALBINA	HOTI	44537385	RATKOC	7,447.00 €
291	SADRI	HOTI	44537385	RATKOC	7,690.00 €
292	FLORIJE	HOTI	49229006	RATKOC	8,668.00 €
293	RESIM	BYTYQI	44937003	RATKOC	600.00 €
294	HAZIR	HOTI	44329994	RATKOC	10,910.00 €
295	MURAT	HOTI	49804053	RATKOC	6,710.00 €
296	BLERIM	HOTI	44217054	RATKOC	17,418.00 €
297	DAUT	HOTI		RATKOC	6,588.00 €
298	ISLAM	HOTI	44330067	RATKOC	4,502.00 €
299	ISUF	HOTI	44475914	RATKOC	1,217.00 €
300	RUZHDI	HOTI	44329997	RATKOC	7,056.00 €
301	HAXHI	SHALA	44296422	RATKOC	1,955.00 €

302	ISLAM	HOTI		RATKOC	3,137.00 €
303	AHMET	HOTI		RATKOC	4,865.00 €
304	FARUK	HOTI		RATKOC	7,610.00 €
305	VALMIR	HOTI	45678723	RATKOC	9,150.00 €
306	FAIK	HOTI		RATKOC	3,480.00 €
307	HAZIZ	MORINA		RATKOC	4,750.00 €
308	SALI	MORINA		RATKOC	6,942.00 €
309	MUHAMET	MORINA	46180374	RATKOC	6,170.00 €
310	ALI	MORINA		RATKOC	4,022.00 €
311	BESIM	MORINA	44135251	RATKOC	260.00 €
312	LEONARD	HOTI	44992908	RATKOC	1,490.00 €
313	ZYBER	HOTI	44992908	RATKOC	3,990.00 €
314	VJOLLCA	BERISHA	44388279	RATKOC	17,022.00 €
315	NUREDIN	MORINA	44634602	RATKOC	10,180.00 €
316	HAJREDIN	MORINA		RATKOC	10,530.00 €
317	FADIL	HOTI	44329981	RATKOC	3,540.00 €
318	BLEONA	MORINA	49131857	RATKOC	10,005.00 €
319	BAJRAM	HOTI		RATKOC	8,449.00 €
320	AVNI	HOTI	44127971	RATKOC	9,805.00 €
321	MUSAJ	HOTI		RATKOC	1,215.00 €
322	BAJRUSH	HOTI	44670185	RATKOC	8,290.00 €
323	NAXHIE	SHALA	44230034	RATKOC	1,638.00 €
324	SHABAN	SHALA	44230034	RATKOC	3,040.00 €
325	HAZIR	SHALA	44659834	RATKOC	500.00 €
326	BEHIJE	KRASNIQI		RATKOC	300.00 €
327	VISAR	MORINA		RATKOC	1,724.00 €
328	SHEMSEDIN	MORINA		RATKOC	6,104.00 €
329	BEKIM	SHALA	44384610	RATKOC	425.00 €
330	BADEM	HOTI	45668461	RATKOC	2,976.00 €
331	Agron	Sallahi	45568687	QIFLLAK	3,490.00 €
332	Ali	Morina	44454492	VRAJAK	3,380.00 €
333	Sabri	HOTI	43993267	DEJN	3,020.00 €
TOTALI:					1,192,509.25 €



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 53 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016"), nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 17 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 28.12.2022 merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 341/22 i datës 29.06.2022 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi 01 Nr. 341/22 i datës 29.06.2022 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite të pronës së paluajtshme të komunës.
2. Pika 1 e vendimit bazik riformulohet si në vijim:
 1. Me këtë vendim formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite të pronës së paluajtshme të komunës duke u bazuar në vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 338/22 i datës 29.06.2022 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës P-71510033-01055-2, P-71510033-01034-0, P-71510033-01045-0 dhe P-71510033-01044-0.
3. Ndërsa pikët tjera të vendimit bazik me numër 01 Nr. 341/22 të datës 29.06.2022 mbesin të pandryshuara.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të Komisionit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm*
- *MAPL-së dhe*
- *Arkivi*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01 Nr. ____/22
Datë: 28.12.2022

Defrim Kafexhiu

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës Rahovec

Opština Skupština Rahovec / Општина / Општина



RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 341/23 Nr. i faq./Br./Str./No.pg

Data/Datum/Date 29.06.2022

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 17 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.06.2022 merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

1. Me këtë vendim formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite të pronës së paluajtshme të komunës duke u bazuar në vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 338/22 i datës 29.06.2022 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës P-71510033-01038-2, P-71510033-01055-2, P-71510033-01034-0, P-71510033-01045-0, P-71510033-01033-2, P-71510033-01044-0, P-71510033-01040-0 dhe P-71510033-01036-2.
2. Komisioni sipas pikës 1 të këtij vendimi përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve, si në vijim:
 - 2.1. Berat Duraku, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
 - 2.2. Albtor Mullabazi, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
 - 2.3. Sinan Kryeziu, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
 - 2.4. Burim Krasniqi, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
 - 2.5. Blerina Hajda, përfaqësues nga sektori joqeveritar.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite të pronës së paluajtshme të komunës janë: shpallja e njoftimit publik për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të përcaktoj çmimin fillestar, të caktoj kushtet dhe kriteret e ankandit publik etj.
4. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

5. Obligohet Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, ti zhvillojë procedurat e ankandit publikë dhe vlerësimin e ofertave.
6. Administrata e komunës i ofron përkrahje komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
7. Kuvendi i Komunës së Rahovecit e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të komisionit kurdo herë që kërkohet.
8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Zyra e Prokurimit.
9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të Komisionit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *MAPL-së dhe*
- *Arkivi*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

Nr. 341/22
Datë: 29.06.2022





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008), nenit 53 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 20/2016"), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenit 8 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 6, nenit 8 dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 00.12.2022 merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 338/22 i datës 29.06.2022 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi 01 Nr. 338/22 i datës 29.06.2022 për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.
2. Pika 2.1, 2.5, 2.7 dhe 2.8 shfuqizohen nga vendimi bazik 01 Nr. 338/22 i datës 29.06.2022.
3. Ndërsa pikët tjera të vendimit bazik me numër 01 Nr. 338/22 i datës 29.06.2022 mbesin të pandryshuara.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **Shërbimit të Kuvendit,**
- **Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,**
- **MAPL-së, dhe**
- **Arkivit.**

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr-_____22
Me datë:00.12.2022

Defrim Kafexhiu

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)
Nr./Br./No 388/22 Nr. ifaq/Br./str./No.pg
Data/Datum/Date 29.06.2022

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenit 8 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 6, nenit 8 dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.06.2022 merr këtë:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. 02/2259/22 i datës 10.06.2022 dhe merret vendimi paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.
2. Pronat e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 të këtij vendimi janë:
 - 2.1. Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01038-2 në zonën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur Skeja, me kulturë Arë e Klasës 4, në sipërfaqe të përgjithshme prej 1231m² (një mijë e dyqind e tridhjetë e një metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit;
 - 2.2. Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01055-2 në zonën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur Skeja, me kulturë Kullosë e Klasës 2, në sipërfaqe të përgjithshme prej 362m² (treqind e gjashtëdhjetë e dy metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit;
 - 2.3. Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01034-0 në zonën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur Skeja, me kulturë Arë e Klasës 3, në sipërfaqe të përgjithshme prej 549m² (pesëqind e dyzet e nëntë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit;
 - 2.4. Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01045-0 në zonën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur Skeja, me kulturë Arë e Klasës 3, në sipërfaqe të përgjithshme prej 4138m² (katërmijë e njëqind e tridhjetë e tetë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit;
 - 2.5. Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01033-2 në zonën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur Skeja, me kulturë Arë e Klasës 3, në sipërfaqe të përgjithshme prej

2162m² (dymijë e njëqind e gjashtëdhjetë e dy metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit;

2.6.Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01044-0 në zonën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur Skeja, me kulturë Arë e Klasës 3, në sipërfaqe të përgjithshme prej 2142m² (dymijë e njëqind e dyzet e dy metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit;

2.7.Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01040-0 në zonën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur Skeja, me kulturë Arë e Klasës 4, në sipërfaqe të përgjithshme prej 1491m² (njëmijë e katërqind e nëntëdhjetë e një metra katror), dhe në shfrytëzim jepet vetëm pjesa e parcelës në sipërfaqe prej 400m² (katërqind metrakatror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit;

2.8.Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01036-2 në zonën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur Suga-kod puta, me kulturë Arë e Klasës 4, në sipërfaqe të përgjithshme prej 2445m² (dymijë e katërqind e dyzet e pesë metra katror), dhe në shfrytëzim jepet vetëm pjesa e parcelës në sipërfaqe prej 1700m² (njëmijë e shtatëqind metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit.

3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekura në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale dhe zhvillimi i aktivitetit biznesor dhe tu jepet mundësi qytetarëve të velëpunësohen, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.
4. Parcelat e cekur në pikën 1 të këtij propozimi sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 të datës 30.05.2013 ka destinim të përhershëm dhe gjendet brenda Zonës Ndërtimore.
5. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është afatshkurtër në periudhën prej 15 (pesëmbëdhjetë) vite.
6. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
7. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi mbi baza mujore, përcaktohet nga komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës sipas vlerës së përcaktuar në Rregulloren 01 Nr. 80/20 e datës 29.06.2020 për Taksa Komunale në Komunën e Rahovecit.
8. Obligohen Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë që të zhvilloj procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

9. Obligohet Kryetari i Komunës që pas përfundimit të procedurave të ankandit publik nga Komisioni për zhvillimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale afatshkurtër dhe afatgjatë, të përcaktoj me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.
10. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.
11. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web - faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Shërbimit të Kuvendit,
- Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr- 338/22

Me datë:29.06.2022





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në bazë të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 51 dhe nenit 53 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 53 paragrafit 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016"), në mbështetje të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 30, nenit 31 paragrafi 2, nenit 33 dhe nenit 40 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në Rahovec në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.12.2022 miraton këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 264/22 i datës 25.01.2022 për themelimin e Komitetit për Komunitete

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi 01 Nr. 264/22 i datës 25.01.2022 për themelimin e Komitetit për Komunitete.
2. Pika 1.1 e vendimit bazik ndryshohet dhe formulohet me tekstin si në vijim:

1.2.znj _____ - AAK, emërohet anëtare e Komitetit për Komunitete.
3. Ndërsa pikët tjera të vendimit bazik me numër 01 Nr. 264/22 i datës 25.01.2022 mbesin të pandryshuara.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Kryetarit të Komunës,
- Shërbimit të Kuvendit,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.____/22
Datë:28.12.2022

Defrim Kafexhiu

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës së Rahovec
Opština Skupština Rahovec / Municipality of Rahovec



Njesia Nr./Br./No. 01 Kuvendi i Komunës

Nr./Br./No. 01/264 Nr. ifaq./Br.sh./No. p. 1

Data/Datum/Date 25.01.2022

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), nenit 51 dhe 52, të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), në mbështetje të nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.05/2020, për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, neneve 2, 10 paragrafi 1 dhe 2.4, neni 30, 31, 33, dhe 40 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në Mbledhjen e mbajtur me datë: 25.01.2022 merr këtë:

VENDIM

Për themelimin e komitetit për Komunitete

- Me këtë vendim Kuvendi i Komunës në Rahovec emëron anëtarët e komitetit për komunitete në këtë përbërje:
 - 1.1 Shqipe Kryeziu - AAK;
 - 1.2 Edona Kryeziu - LDK;
 - 1.3 Faton Ramadani - LDK;
 - 1.4 Dusan Stojanovic - Komuniteti Serb;
 - 1.5 Bajram Morina - Komuniteti Ashkali;
 - 1.6 Ramë Berisha - Komuniteti Egjiptian;
 - 1.7 Edonita Berisha - Komuniteti Romë.
- Detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit për Komunitete janë të përcaktuara në nenin 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe në nenin 33 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe aktet tjera Ligjore dhe nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës
- Mandat i anëtarëve të Komitetit për Komunitete, zgjat aq sa zgjat mandati i rregullt i ligjor i Kuvendit të Komunës në Rahovec.
- Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, MAPL-së, konform nenit 81 Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.03/L-040, dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

U dërgohet:

- MAPL-së
- Arkiva

01 Nr.264/22
Me datë:25.01.2022

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 dhe nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.7 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në Rahovec, në mbledhjen e mbajtur me dt. 00.12.2022 miraton këtë:

V E N D I M

1. Me këtë vendim **Miratohet** propozimi që "Lulëkuja me katër petale" të bëhet simbol unik përkujtimor i gjenocidit në Kosovë.
2. Simboli sipas pikës 1 të këtij vendimi, paraqet katër format e akteve gjenocide, të cilat Republika e Serbisë i zbatoi në Republikën e Kosovës, si vrasjen, dhunën seksuale, spastrimin etnik dhe shkatërrimin e objekteve që lidhen me përkatësinë etnike dhe identitetin shqipëtar.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Simboli "Lulëkuja me katër petale".
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **Shërbimit të Kuvendit,**
- **Kryetarit të Komunës,**
- **MAPL-së, dhe**
- **Arkivit.**

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr-____/22
Me datë:00.12.2022

Defrim Kafexhiu

Kryesuesi i Kuvendit



QENDRA

GJENOCIDI NË KOSOVË **PLAGË E HAPUR**

KËRKESË

Lulekuqja me katër petale të bëhet simbol unik përkujtimor i gjenocidit në Kosovë

ARSYETIM:

Në disa vende të botës, së paku prej një shekulli, lulëkuqet kanë shërbyer si simbol për të përkujtuar të rënët gjatë luftërave anekënd globit. Kështu, për shembull, në Britaninë e Madhe dhe në disa vende të Komonuelthit, lulëkuqja, me ngjyrën e saj të gjakut, është simbol i përkujtimit të luftëtarëve të rënë në fushëbeteja, veçanërisht të rënëve gjatë Luftës së Parë Botërore, dhe i solidarizimit me familjet e tyre. Edhe kanadezët e kanë përcaktuar këtë lule si simbol të premtimit, që do t'i përkujtojnë dhe që nuk do t'i harrojnë kurrë, ata të cilët u sakrifikuan për lirinë e vendit. Përkujtimi i të rënëve në Kanada bëhet çdo vit në orën 11:00, në ditën e 11-të të muajit të 11-të. Që nga viti 1922, edhe Franca, më 11 nëntor të çdo viti përkujton viktimat e Luftës së Parë Botërore. Francezët kanë zgjedhur lulen e kokoçelit të kaltër, për arsye të ngjyrës së kaltër që kishin uniformat e ushtarëve të vrarë, si simbol nderimi ndaj të gjithë atyre që kishin dhënë jetën për lirinë e Francës.

Madje edhe në përkujtim të viktimave të Luftës së Dytë Botërore, që u përcaktua të bëhet çdo vit më datë 8 maj, kokoçeli i kaltër mbeti simboli kombëtar i Francës.

Pas konsultimeve të shumta, Qendra “Gjenocidi në Kosovë – plagë e hapur” mbështeti idenë e Adnan Asllanit, që lulëkuqja të jetë simbol i viktimave të gjenocidit në Kosovë. Në dallim nga lulëkuqet që përdoren si simbol në shumë vende të tjera, katër petalet e lulëkuqes në logon e dizajnuar prej tij paraqesin katër format e akteve gjenocidare, që Serbia zbatoi në Kosovë:

vrasjen,
dhunën seksuale,
spastrimin etnik dhe
shkatërrimin e objekteve që lidhen me përkatësinë etnike dhe identitetin shqiptar.

Përveç domethënies së veçantë që ka çdo petal i simbolit tonë dhe që e dallon nga forma e petaleve që kanë lulëkuqet-simbol të vendeve të tjera, në simbolin e gjenocidit në Kosovë dallon edhe “zemra e lulëkuqes”: në vend të kokrrave të zeza të farës së lulëkuqes, në logon tonë janë paraqitur figura burrash, grash, djemsh dhe vajzash, për të kujtuar njerëzit e të gjitha moshave dhe gjinive, që ishin viktimat të këtij gjenocidi.

Petalet e lulëkuqes në këtë logo janë të vendosura në formën e shkronjës X, për arsye se gjatë luftës, në disa vendbanime ku popullsia ishte e përzier në aspektin e përkatësisë etnike, okupatorët serbë kishin shënuar shtëpitë e shqiptarëve me një X, me qëllim që forcat e armatosura serbe të udhëzoheshin drejt vendeve ku duhej të kryheshin krimet.

Me një fjalë, forma e petaleve dhe figurat e burrave, grave, djemve dhe vajzave simbolizojnë mbi dhjetë mijë civilë shqiptarë të vrarë dhe të gjymtuar, të të gjitha moshave dhe gjinive, mbi njëzet mijë viktimat të dhunës seksuale, rreth një milion viktimat të spastrimit etnik dhe qindra- mijëra shkatërrimeve që u kryen gjatë zbatimit të gjenocidit në Kosovë.

Si e tillë, mendojmë se kjo logo meriton të jetë simbol i përbashkët i përkujtimit të viktimave të gjenocidit të Serbisë ndaj shqiptarëve të Kosovës.

Meqë jemi në prag të 15 janarit, ditës së përkujtimit të gjenocidit në Kosovë, përcaktimi nga institucionet tona shtetërore i një simbol unik, që mishëron këtë tragjedi kombëtare, është mënyra më e mirë për të përçar mesazhin e unitetit përballë krimit të gjenocidit – plagës së hapur në qenien tonë kombëtare.

Gjenevë, më 16 nëntor 2022

Qendra “Gjenocidi në Kosovë – Plagë e hapur”

Kryetar
Bardhyl Mahmuti



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17, nenit 24 dhe nenin 40 të Ligjit Nr. 03/L040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.9, nenit 57 dhe nenit 63 të Statutit të Komunës Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në Rahovec në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.12.2022 miraton këtë:

V E N D I M

Për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2022

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës me Nr. Prot. 02/___/22 i datës 00.12.2022 dhe merret vendimi me të cilin i lejohej Kryetarit të Komunës, që në interes të qytetarëve, në emër të mbulimit të shpenzimeve të varrimit për vitin 2023, të lidh marrëveshje me të gjitha bashkësitë fetare që veprojnë në territorin e komunës së Rahovecit, konform planit buxhetor afatmesëm (mbështetje në mbulimin e shërbimeve të varrimit).
2. Pakoja e shërbimeve primare do të definohet në marrëveshje të re dhe ajo nuk mund të ketë kosto më të lartë se **000.00 € (dyqind euro)** për një rast, ndërsa për shërbimet tjera të cilat nuk janë pjesë e marrëveshjes, qytetarët do t'i sigurojnë ato personalisht.
3. Qytetarët të cilët do të marrin shërbim nëpërmjet bashkësive fetare, do të pajisen me një fletushkë me të cilën do të informohen për shërbimet të cilat janë pjesë e marrëveshjes.
4. Shërbimet të cilat do të jenë pjesë e marrëveshjes, në asnjë rast nuk mund të kushtëzohen me pagesat e anëtarësive fetare apo të tjera.
5. Obligohet Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, që në kuadër të implementimit të marrëveshjes t'i respektoj afatet kohore, si dhe të kërkoj prej bashkësisë fetare (palëve nënshkruese të marrëveshjes) që t'i përmbahen të gjitha pikave të marrëveshjes si dhe obligimeve në kompletimin e dokumentacionit konform saj.
6. Mjetet të sigurohen nga kodi **Mallra dhe Shërbime**.
7. Për zbatimin e këtij vendimi do të jetë Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Komunën së Rahovecit.
8. Pas miratimit nga Kuvendit të Komunës në Rahovec, ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **Kryetarit të Komunës,**
- **Shërbimit të Kuvendit,**
- **MAPL-së, dhe**
- **Arkivit.**

KUVENDI I KOMUNËSNËRAHOVEC

01 Nr. ___/22
Datë: 28.12.2022

Defrim Kafexhiu

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 314 Nr. i faq./Br.str./No.pg 82

Data/Datum/Date 9 / 12 / 22

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), nenit 74 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës:

PROPOZON

1. Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit, miratimin e vendimit me të cilin i lejohej Kryetarit të Komunës, që në interes të qytetarëve, në emër të mbulimit të shpenzimeve të varrimit për vitin 2023, të lidh marrëveshje me të gjitha bashkësitë fetare që veprojnë në territorin e komunës së Rahovecit, konform planit buxhetor afatmesëm (mbështetje në mbulimin e shpenzimeve të varrimit).
2. Pakoja e shërbimeve primare do të definohej në marrëveshje të re dhe ajo nuk mund të ketë koston më të lartë se 220.00 € (dyqind e njëzetë euro) për një rast, ndërsa për shërbime të tjera të cilat nuk janë pjesë e marrëveshjes, qytetarët do t'i sigurojnë ato personalisht.
3. Qytetarët të cilët do të marrin shërbim përmes bashkësive fetare, do të pajisen me një fletushkë me të cilën do të informohen për shërbimet të cilat janë pjesë e marrëveshjes.
4. Shërbimet të cilat do të jenë pjesë e marrëveshjes, në asnjë rast nuk mund të kushtëzohen me pagesat e anëtarësive fetare apo të tjera.
5. Obligohet Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, që në kuadër të implementimit të marrëveshjes t'i respektojë afatet kohore, si dhe të kërkoj prej bashkësisë fetare (palëve nënshkruese të marrëveshjes) që t'i përmbahet të gjitha pikave të marrëveshjes si dhe obligimeve në kompletimin e dokumentacionit konform saj.
6. Mjetet të sigurohen nga kodi **Mallra dhe Shërbime**.
7. Për zbatimin e këtij propozimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
8. Propozimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me propozim të njoftohen:

1. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,
2. Sekretaria e Kuvendit dhe
3. Arkivi.



NR.REND	LLOJI I SHËRBIMIT	SHUMA
1	TRANSPORTI I KUFOM;S BRENDIA TERRITORIT TË KOMUNËS SË RAHOVECIT (bartja e kufomës nga shtëpia deri në xhami (vendfalje) dhe përcjellja në varreza.	35
2	HAPJA DHE MBYLLJA E VARRIT (sipas parimeve fetare islame) . Transporti i punëtorëve dhe mjeteve të punës në varreza	55
3	DËRRASAT-(pa arkivol)- dërrasat me të cilat mbulohet i vdekuri pas lëshimit në varr me dimens. 2.10 x 1.10 x 0.4) . Transporti i dërrasave deri te vendi i varrimit.	55
4	QEFINI - mbështjellës i veçantë për kufomën sipas parimeve islame dhe mjetet higjienike, (përfshihen dorëzat higjienike si dhe pambuku,shamponi dhe sapuni).	25
5	PIRAMIDA (dërrasë me mbishkrimin e të dhënave të të vdekurit)	20
6	KUJDESTARIA 24 orë duke përfshirë edhe ditët e vikendeve. Regjistrimi i të dhënave të personit të vdekur në librin amëz i të vdekurëve	15
7	DEZINFEKTIMI I VETURËS	5
8	LETËR E ZEZE	10
	TOTALI	220